FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 137

Tiranë – E enjte, 31 korrik 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 23.7.2025	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2024, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III).....	19367

VENDIM
Nr. 414, datë 23.7.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EVROPIAN, NË LIDHJE ME PLANIN VJETOR TË VEPRIMIT NË FAVOR TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2024, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni", i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "BE",

nga njëra anë, dhe

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si "përfituesi IPA III", e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

nga ana tjetër,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi

1. BE-ja bie dakord të financojë dhe përfituesi IPA III bie dakord të pranojë financimin e Programit në vijim:

Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2024,

që konsiston në këto veprime:

Veprimi 1: BE-ja për Luftën kundër Korrupsionit

Veprimi 2: BE-ja për Qeverisje Vendore

Veprimi 3: BE-ja për Sigurinë Ushqimore

Veprimi 4: BE-ja për Pyjet

Veprimi 5: BE-ja për Punësim dhe Përfshirje Sociale

Numri i angazhimit global: JAD.1354182

Ky Program financohet nga buxheti i BE-së sipas aktit bazë: Instrumenti për Asistencën e Para anëtarësimit, IPA III.[1]

2. Kostoja totale e llogaritur për këtë Program është 67 350 000 euro;

dhe kontributi maksimal i BE-së për këtë Program është vendosur të jetë 67 350 000 euro.

Nuk kërkohet kontribut financuar nga përfituesi IPA III.

3. Programi zbatohet në përputhje me dokumentet e Veprimit në shtojcën I.

Neni 2
Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është 12 vjet nga nënshkrimi i saj, siç përcaktohet në nenin 12 të shtojcës II ("Kushtet e përgjithshme").

2. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional është 6 vjet nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 12 të shtojcës II ("Kushtet e përgjithshme").

[1] Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 shtator 2021, e cila krijon Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), GZ L 330, 20.9.2021, f. 1.

Neni 3
Adresat dhe Komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhen në formë të shkruar, i referohen shprehimisht këtij Programi siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe dërgohen në adresat më poshtë:

1. **Për Komisionin:**
Drejtori B, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
Rue de la Loi 15
B -1049 Brussels, Belgium (Bruksel, Belgjikë)
E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

2. **Për përfituesin IPA III:**
Eridana Çano
Koordinatore Kombëtare e IPA-s
Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
Rruga "Kuvajt".
Tiranë, Shqipëri
E-mail: eridana.cano@saspac.gov.al

Neni 4
Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pika e kontaktit e përfituesit IPA III që ka tagrin e duhur për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), me qëllim lehtësimin e aktiviteteve operacionale, është:

Znj. Blerina NASKA,
Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit Financiar pranë Drejtorisë së Inspektimit të Financave Publike në Ministrinë e Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri
E-mail: blerina.naska@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshja Financiare Kuadër për Partneritetin

Programi zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare Kuadër për Partneritetin (MFKP) ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për modalitetet e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III) e cila hyri në fuqi më 14 tetor 2022 (në vijim e referuar si "MFKP"). Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e MFKP-së. Në rast konflikti midis dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe dispozitave të MFKP-së, kanë përparësi dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 6
Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
a) këto kushte të veçanta;
b) Shtojca I: Dokumentet e Veprimit që detajojnë objektivat, rezultatet e pritshme, aktivitetet, metodat e zbatimit dhe buxhetin;
- Shtojca I.1 Veprimi 1: BE-ja për luftën kundër korrupsionit;
- Shtojca I.2 Veprimi 2: BE-ja për qeverisje vendore;
- Shtojca I.3 Veprimi 3: BE-ja për sigurinë ushqimore;
- Shtojca I.4 Veprimi 4: BE-ja për pyjet;
- Shtojca I.5 Veprimi 5: BE-ja për punësim dhe përfshirje sociale;
- Lidhje e shtojcës I.5: Marrëveshjet e disbursimit, kushtet dhe treguesit e performancës;
- Shtojca IA: Tabela e buxhetit;
c) Shtojca II: Kushtet e përgjithshme.

2. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe dispozitave të këtyre kushteve të veçanta, kanë përparësi dispozitat e kësaj të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe dispozitave të shtojcës II, kanë përparësi dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 7
Dispozitat që shmangin ose plotësojnë shtojcën II

Shtojca II plotësohet me sa vijon:

Transferimet e këmbimit valutor do të kontabilizohen sipas datës së vlerës kur njoftohet krediti në llogarinë e Thesarit nga Banka e Shqipërisë. Kursi i këmbimit do të jetë kursi unik i llogaritur nga Banka e Shqipërisë për të gjitha transfertat hyrëse, në përputhje me klauzolën e mosdiskriminimit, sipas datës së vlerës të transfertës hyrëse në valutë – kursi i këmbimit të lekut i përcaktuar në vendimin nr. 66, të Këshillit

Mbikëqyrës të Bankës, gusht 2006, dhe dispozitat pasuese.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje Financimi konsiderohet e nënshkruar në datën kur nënshkruhet nga pala e fundit, jo më vonë se 31 dhjetori 2025.

2. Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga përfituesi IPA III në të cilin konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA III që janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Financimit. Komisioni e informon përfituesin IPA III për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat njëra i dorëzohet Komisionit dhe tjetra përfituesit IPA III.

Për përfituesin IPA III:	**Për Komisionin:**
Znj. Eridana Çano Koordinatore Kombëtare e IPA-s, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Tiranë, Data: Nënshkrimi:	Znj. Valentina Superti Drejtore B, Ballkani Perëndimor Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit Komisioni Evropian Bruksel, Data: Nënshkrimi:

AL

KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA I

Vendimi Zbatues i Komisionit për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024

Dokumenti i Veprimit për BE-në për Luftën kundër Korrupsionit

PLANI VJETOR I VEPRIMIT

Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës sipas nenit 110(2) të Rregullores Financiare, dhe planet dhe masat vjetore dhe shumëvjeçare të veprimit sipas nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23(2) të Rregullores NDICI/IFZHBN (Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar) – Global Europe.

1. PËRMBLEDHJE

1.1 Tabela përmbledhëse e Veprimit

Titulli	Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024 BE për Luftën kundër Korrupsionit
OPSYS *(Sistemi Operacional i Komisionit Evropian për Menaxhimin e Projekteve dhe Kontratave)*	Referenca e biznesit OPSYS: ACT-62387
ABAC *(Sistemi Financiar i Komisionit Evropian)*	Numri i nivelit 1 të angazhimit ABAC: JAD.1354182
Akti themelor	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III)
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	Jo
Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	Jo
Nisma Team Europe	Jo
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III

FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia Prioriteti tematik 2: Lufta kundër Korrupsionit			
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ kryesorë: nr. 16 Paqe, drejtësi dhe institucione të forta, synimi 16.5: Ulja e ndjeshme e korrupsionit dhe ryshfetit në të gjitha format e tyre OZHQ-të e tjera të rëndësishme dhe, kur është e nevojshme, synimet: nuk zbatohet			
Kodi(et) DAC	Kodi kryesor DAC: 15113 - Organizata dhe institucione kundër korrupsionit			
Kanali Kryesor i zbatimit	Komisioni Evropian - Pjesa e Buxhetit për Zhvillim– 42001			
Synimet	☐ Klima ☒ Gjinia ☐ Biodiversiteti			
Treguesit (nga formulari DAC)	**Objektiv i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/mirëqeverisja	☐	☒	☐
	Ndihma për mjedisin	☒	☐	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☐	☒
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, i të saposalindurve dhe i fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i Rrezikut të Fatkeqësive	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta kundër shkretëtirëzimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues dhe etiketime të brendshme	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	☒	☐	☐
	Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	PO ☐		JO ☒
	Etiketime: Transporti Energjia Mjedisi dhe qëndrueshmëria ndaj klimës Digjitale Zhvillimi ekonomik (përfshirë sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike) Zhvillimi njerëzor (përfshirë kapitalin njerëzor dhe të rinjtë) Rezistenca shëndetësore Migrimi dhe lëvizshmëria Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike Të tjera	PO ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☒ ☐		JO ☒ ☒ ☒ ☒ ☒ ☒ ☒ ☒ ☐ ☒
	Digjitalizimi	☐	☒	☐
	Etiketime: Ndërlidhja digjitale qeverisje digjitale sipërmarrje digjitale aftësi/shkrim-lexim digjital shërbime digjitale	PO ☐ ☒ ☐ ☒ ☒		JO ☒ ☐ ☒ ☐ ☒
	Lidhshmëria	☐	☐	☒
	Etiketime:	PO		JO

	ndërlidhja digjitale energji transport shëndetësi arsim dhe kërkim	☐ ☐ ☐ ☐ ☒		☒ ☒ ☒ ☒ ☐
	Migrimi	☒	☐	☐
	Reduktimi i pabarazive	☐	☒	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION MBI BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020101.01 Kostoja totale e vlerësuar: 3 850 000 EURO Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së: 3 850 000 EURO			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	**Menaxhim i drejtpërdrejtë përmes**: - Granteve të binjakëzimit - Prokurimit			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor 2025			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit, të prokurimeve dhe kontratave grant	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, me përjashtim të rasteve të listuara në nenin 114(2) të Rregullores Financiare.			
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas lidhjes të Marrëveshjes së Financimit			

1.2 Përmbledhja e Veprimit

Objektivi i përgjithshëm i veprimit është të ndihmojë në uljen e korrupsionit në Shqipëri nëpërmjet parandalimit, shtypjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit. Objektivi përfundimtar është të promovohen institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë një shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm.

Ky veprim mbështet institucionet shqiptare në përputhjen me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu, do të mbështesë zbatimin e angazhimeve të Shqipërisë për antikorrupsionin, duke përfshirë ato të bëra në Planin e Veprimit për Shtetin e së Drejtës, i cili është përgatitur për të përmbushur kriteret fillestare për hapjen e kapitujve në kuadër të procesit të aderimit në BE, si dhe angazhimet që pritet të përfshihen në Agjendën e Reformës që do të mbështetet nga Mekanizmi për Reforma dhe Rritje. Ky veprim do të pasqyrojë parimin e një qasjeje të integruar horizontale ndaj luftës kundër korrupsionit, përmes disa fushave të ndërhyrjes.

Konferenca e parë Ndërqeveritare (IGC) për negociatat e aderimit u mbajt midis BE-së dhe Shqipërisë, më 19 korrik 2022. Kjo shënoi fillimin zyrtar të bisedimeve të aderimit. Përveç kësaj, Komisioni Evropian nisi procesin e shqyrtimit dhe Qeveria Shqiptare miratoi Planin e Veprimit për Shtetin e së Drejtës nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, i cili është përfaqëson zyrtarisht një kriter fillestar për grupkapitullin 1 mbi themelorët. Ky Plan Veprimi përmban dispozita specifike që adresojnë gjetjet e Raportit të Shqyrtimit lidhur me luftën kundër korrupsionit, të cilat përfshijnë një periudhë nga viti 2024 deri më 2030.

Objektivi specifik i këtij veprimi është të ndihmojë autoritetet përkatëse shqiptare, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit[2] (DPAK), Inspektoratin e Lartë të

[2] Që nga data 15 janar 2024, Qeveria e Republikës së Shqipërisë përfshin një Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Ministri i Shtetit aktualisht është ngarkuar gjithashtu me rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 26.6.2024, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së përgjithshme të luftës kundër korrupsionit", Drejtoria e Përgjithshme e

Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), si dhe autoritete të tjera, në përmbushjen e roleve të tyre specifike lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe ruajtjen e besimit publik. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sektorëve me rrezik të lartë dhe të prirë ndaj korrupsionit. Rezultati i pritshëm është përparimi në zbatimin e plotë të politikave kundër korrupsionit dhe përmirësimi i praktikës institucionale në luftën kundër korrupsionit.[3]

Ky veprim kontribuon në mbështetje gjithëpërfshirëse në fushat e parandalimit, sensibilizimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në Shqipëri, në përputhje me objektivat e përcaktuar në strategjinë kombëtare kundër korrupsionit dhe marrëveshjet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Një ndërhyrje e tillë do t'i lejojë Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) dhe administratës së tij/saj, ILDKPKI-së, si dhe autoriteteve të tjera të avancojnë agjendën e zhvillimit të kapaciteteve në planin afatgjatë dhe t'u ofrojë vendimmarrësve një pasqyrë të detajuar mbi nevojat dhe prioritetet, në të cilat duhet të përqendrohen strukturat administrative kombëtare kundër korrupsionit dhe të alokojnë burimet e nevojshme për realizimin e tyre.

Ky veprim është i rëndësishëm në kontekstin e reformës së përgjithshme, pasi vendi duhet të krijojë një kuadër efektiv dhe funksional, i cili të ketë një qasje gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh si masat ndëshkuese edhe masat parandaluese ndaj korrupsionit, përfshirë edhe ato që zbatohen përmes institucioneve të specializuara kundër korrupsionit[4].

Kjo dritare thekson prioritetin që vendet kandidate dhe ato potenciale kandidate duhet të rrisin ndërgjegjësimin në luftën kundër korrupsionit dhe të rrisin efikasitetin në përpjekjet e tyre për çrrënjosjen e tij. Meqenëse korrupsioni mbetet një problem në rajon, me vazhdimësi të pandëshkueshmërisë në shumë raste, veçanërisht për korrupsionin në nivele të larta, asistenca e IPA III do të jetë thelbësore për të mbështetur përfituesit në forcimin e mëtejshëm të kuadrit të tyre ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit dhe për përmirësimin e historikut të zbatimit.

Për më tepër, ky veprim i përgjigjet objektivit të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) nr. 16: Të promovohen shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të garantohet qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, dhe në veçanti objektivit 16.5: Të reduktohet ndjeshëm korrupsioni dhe ryshfeti në të gjitha format e tyre.

1.3 Përfituesi i Veprimit

Ky Veprim do të realizohet në Shqipëri.

2. ARGUMENTIMI

Raporti i Komisionit për Shqipërinë i vitit 2023 thekson se[5] pavarësisht disa përparimeve, përpjekjeve të shtuara dhe angazhimit politik në luftën kundër korrupsionit, kjo mbetet një fushë shqetësuese serioze. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka realizuar procedime penale dhe hetime financiare në disa çështje të nivelit të lartë dhe janë shpallur disa vendime dënimi të formës së prerë për funksionarë të lartë shtetërorë Njësia Kombëtare e Inteligjencës Financiare, Agjencia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë (AIF) ka marrë kohët e fundit më shumë autonomi dhe mjete buxhetore. AIF është përgjegjëse për pranimin dhe analizimin e transaksioneve të dyshimta dhe informimin e autoriteteve kompetente për hetime dhe ndjekje penale të mëtejshme. Gjithashtu, AIF kryeson grupin e punës ndërinstitucional të krijuar së fundi për luftën kundër pastrimit të parave (AML/LPP). *Vetingu* i anëtarëve të sistemit gjyqësor vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda

Luftës kundër Korrupsionit u riorganizua (meqë deri atëherë një strukturë brenda Ministrisë së Drejtësisë – Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit deri në janar 2024) dhe tashmë është krijuar si një institucion në varësi të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Ky Veprim do të mbështesë njësinë administrative të ngarkuar me planifikimin dhe koordinimin e politikave kundër korrupsionit dhe masave për parandalimin e korrupsionit, si dhe autoritetet e tjera përkatëse me funksione kundër korrupsionit.

[3] Seksioni 23.6 – Mungesat dhe prioritetet/lufta kundër korrupsionit: masa në nivel derregullimi; masa në nivel zbatimi; masa në nivel institucional dhe administrativ; prioritetet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, 2023–2025. Udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës.

[4] Dritarja 1 – Shteti i së drejtës, të drejtat themelore dhe demokracia e shtojcës së vendimit zbatues të Komisionit për miratimin e Kuadrit të Programimit të Instrumentit për Asistencë Paraaderimi (IPA III) për periudhën 2021–2027.

[5] Raporti për Shqipërinë 2023 – Komisioni Evropian (europa.eu)

gjyqësorit. Shqipëria duhet të përparojë më tej procesin dhe të përshpejtojë procedurat, veçanërisht ato në apel, duke i kushtuar vëmendje cilësisë së procesit, si dhe të garantojë një ndjekje gjyqësore sistematike të çështjeve të *veting*-ut ku janë identifikuar vepra penale. Një Drejtori e re e Përgjithshme kundër Korrupsionit u krijua në Ministrinë e Drejtësisë për të përmirësuar koordinimin në nivel qendror; efikasiteti i saj mbetet ende për t'u dëshmuar[6]. Rritja e numrit të vendimeve të dënimit të formës së prerë të funksionarëve të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të luftuar më tej kulturën e pandëshkueshmërisë. Sektorët më të rrezikuar nga korrupsioni, si sektori i pronës, shëndetësisë, arsimit dhe doganave dhe taksave, kërkojnë vlerësime të fokusuara të rrezikut dhe veprime të dedikuara ndërhyrjesh.

Në përputhje me Raportin e Komisionit për Shqipërinë, Kuadri i Programimit IPA III thekson se korrupsioni mbetet një problem serioz në vendet kandidate dhe ato potencialisht kandidate dhe duhet të zhduket pa asnjë kompromis. Institucionet e forta dhe të pavarura janë thelbësore për të parandaluar dhe trajtuar efektivisht mashtrimin dhe korrupsionin, për të kryer hetime dhe ndjekje penale më efektive, duke çuar në vendime përfundimtare gjyqësore që zbatohen dhe përfshijnë sanksione ndëshkuese dhe rekorde të forta dhe të qëndrueshme. Po ashtu, është thelbësore që në kuadër të reformës së administratës publike, të ndërmerren përpjekje për të rritur transparencën dhe parashikueshmërinë në planifikimin strategjik, për të përmirësuar zhvillimin e politikave dhe legjislacionit të bazuar në prova dhe gjithëpërfshirës, për të depolitizuar shërbimin civil, për të rritur llogaridhënien e administratës dhe forcuar menaxhimin e qëndrueshëm financiar publik. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të matjeve dhe treguesve të korrupsionit, në mënyrë që të realizohet një pasqyrë e plotë e rezultateve.

Përgjigja Strategjike e Qeverisë për IPA III deklaron se prioritetet kombëtare që synojnë përmirësimin e kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Rrjetit kundër Korrupsionit për parandalimin e korrupsionit janë në përputhje me objektivin specifik të IPA III për të garantuar një kuadër institucional të fortë kundër korrupsionit. Strategjia e re kundër korrupsionit 2024–2030, e cila pritet të miratohet brenda vitit 2024[7], do të fokusohet në kuadrin institucional dhe kapacitetet e autoriteteve publike përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit, si dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, përfshirë strukturën e rikonceptuar të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), si dhe ato të SPAK-ut, prokurorisë dhe Policisë së Shtetit. Qasja represive e strategjisë do të trajtojë çështje që lidhen me hetimin penal dhe ndjekjen penale; sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive; reformën gjyqësore; kontrollet dhe auditimet; mekanizmat e ankesave; si dhe hetimin dhe sanksionet administrative. Një nga sfidat kryesore në luftën kundër korrupsionit mbetet mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme dhe të kualifikuara të stafit në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Rrjetin kundër Korrupsionit për të monitoruar dhe koordinuar në nivel të mjaftueshëm zbatimin e procesit kompleks të reformës antikorrupsion dhe kuadrit legjislativ, mungesa e kapaciteteve të mirëtrajnuara për rolet organizative dhe funksionale në fushën e antikorrupsionit, mungesa e koordinimit të duhur midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, si dhe nevoja për të intensifikuar luftën kundër pastrimit të parave nëpërmjet një përdorimi më efektiv të inteligjencës penale. Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional kërkon zbatim më të fuqishëm dhe kapacitetet operacionale të institucioneve të reja duhet të përmirësohen.

Për më tepër, *Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor* përcakton se faktori kryesor për dobësitë strukturore ekzistuese është qeverisja e dobët dhe në veçanti, progresi i kufizuar në adresimin e mangësive në sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Shteti i së drejtës dhe respektimi i të drejtave themelore, funksionimi i institucioneve demokratike dhe administratës publike nuk janë vetëm në themel të procesit të aderimit, por gjithashtu motorët kryesorë për rimëkëmbjen ekonomike të rajonit dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj krizave dhe tronditjeve ekonomike të mundshme në të ardhmen. Respektimi i shtetit të së drejtës të ligjit është gjithashtu i nevojshëm për të mbrojtur fondet e BE-

[6] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2022. Përditësime mbi ristrukturimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit (DPAK) janë dhënë në Shënimin 1 dhe në të gjithë dokumentin.

[7] ISAC (Sistemi i Integruar i Antikorrupsionit) aktual dhe plani i veprimit shtrihen deri në dhjetor 2023.

së dhe për të garantuar që ato përdoren për të mbështetur zhvillimin e Ballkanit Perëndimor. Për të shmangur çdo boshllëk në mbrojtjen e fondeve të BE-së, është e domosdoshme që partnerët e Ballkanit Perëndimor të sigurojnë se mashtrimet, korrupsioni, pastrimi i parave dhe përvetësimi i paligjshëm trajtohen me sanksione penale efektive, ndaluese dhe proporcionale. Njëkohësisht, digjitalizimi është mundësuesi kryesor për kalimin në dy tranzicionet e gjelbra dhe digjitale, të përcaktuara në Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Digjitalizimi i shërbimeve publike do të jetë një nga mjetet kryesore për të luftuar korrupsionin në kuadër të veprimit.

Për të përmirësuar aftësinë e vendit për të parandaluar dhe frenuar korrupsionin, Shqipëria miratoi në vitin 2015 Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (ISAC/SNKK)[8]. Kjo Strategji dhe Plan Veprimi kanë përfunduar në fund të vitit 2023. Një numër i madh reformash janë udhëhequr nga dhe kanë dhënë rezultate në kuadër të zbatimit të ISAC-ut.

SNKK-ja dhe planet e veprimit 2015–2023 janë dokumentet kryesore që përcaktojnë politikën kundër korrupsionit të Shqipërisë dhe udhëheqin veprimtarinë kundër korrupsionit në nivel kombëtar. Që nga miratimi i ISAC në vitin 2015, Shqipëria ka kaluar nëpër një sërë reformash të orientuara për të forcuar aftësinë e vendit për të parandaluar dhe ndëshkuar korrupsionin. Disa nga këto përfshijnë:

1. forcimin e kuadrit të transparencës në të gjitha institucionet në të tria degët e qeverisë;

2. digjitalizimin e 95% të shërbimeve publike, duke mundësuar zgjerimin e sistemeve digjitale, me qëllim uljen e korrupsionit administrativ, duke eliminuar faktorin njerëzor në ofrimin e shërbimeve;

3. përputhjen e legjislacionit mbi prokurimin me forcimin e standardeve të BE-së dhe forcimin e kuadrit dhe kapaciteteve për transparencë dhe llogaridhënie;

4. përmirësimin e sistemit për deklarimin e pasurive dhe kuadrit të integritetit nëpërmjet digjitalizimit të mëtejshëm;

5. miratimin e ligjit për denoncuesit dhe mbrojtjen e denoncuesve, si dhe krijimin e kuadrit për zbatimin e tij;

6. miratimin e kuadrit për vlerësimin periodik të rreziqeve të korrupsionit dhe zhvillimin e planeve të integritetit për të parandaluar korrupsionin në nivel agjencie dhe ministror, si dhe në nivel qeverisjeje vendore;

7. përmirësimin e sistemit të auditimit të financave të partive duke forcuar integritetin e partive politike dhe zgjedhjeve.

Si pjesë e qasjes së kombinuar, SNKK-ja përfshin gjithashtu frenimin e korrupsionit. Përmes zbatimit të SNKK-së, disa nga arritjet kryesore në këtë drejtim përfshijnë:

8. forcimin e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë për hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të korrupsionit dhe krimit ekonomik në kuptimin më të gjerë;

9. forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;

10. përshpejtimin e hetimeve për çështjet e korrupsionit në nivele të larta;

11. forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

12. konsolidimin e mbledhjes dhe përpunimit të statistikave mbi të dhënat e korrupsionit.

Duke njohur përhapjen dhe qëndrueshmërinë e korrupsionit, reformat kryesore dhe sfidat e mbetura do të trajtohen në strategjinë e re kundër korrupsionit, e cila pritet të miratohet së shpejti, me periudhë zbatimi 2024–2030. Reformat kryesore që konsiderohen për t'u mbështetur më tej, janë të lidhura me tri qëllime kryesore, të tilla si:

1. forcimi i mekanizmave dhe kapaciteteve ligjore dhe institucionale për parandalimin e korrupsionit dhe forcimi i integritetit në administratën publike, me fokus në sektorët me rrezik të lartë korrupsioni.

2. përmirësimi i mëtejshëm i ndëshkimit të korrupsionit duke rritur performancën e të gjitha strukturave përgjegjëse për ndjekjen, hetimin dhe ndëshkimin e çështjeve të korrupsionit.

3. ndërgjegjësimi dhe arsimi i qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit për angazhimin e tyre proaktiv në luftën kundër korrupsionit dhe

[8] Fillimisht 2015–2020, por më pas u zgjat deri në vitin 2023. Objektivat kryesorë të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion janë parandalimi, ndëshkimi dhe rritja e ndërgjegjësimit/edukimit publik mbi korrupsionin. Plani i fundit i Veprimit 2020–2023 përmban 83 masa që përfshijnë 22 institucione.

përfshirja e gjithë shoqërisë në luftën kundër korrupsionit.

Qasja e re strategjike e periudhës 2024–2030 është në nivel ndërsektorial që kombinon parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin, fuqizimin dhe mobilizimin e qytetarëve. Kjo strategji parashikon një qasje gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërisë kundër këtij fenomeni, ku institucionet shtetërore, sektori privat, shoqëria civile dhe qytetarët luajnë rolin e tyre në një përpjekje kolektive për të ulur korrupsionin dhe ndikimin e tij. Strategjia e re do të ketë fokus të orientuar në fusha të tilla si përmirësimi i kuadrit legjislativ dhe institucional dhe kapaciteteve për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë kuadrin ligjor mbi instrumentet kundër korrupsionit, lobimin dhe denoncimin; transparenca, llogaridhënia dhe integriteti i institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes; zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorë me rrezik të lartë/përhapje të korrupsionit; forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetime dhe ndjekje penale efektive të korrupsionit. Edukimi që në moshë të re dhe i rinisë mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit, si dhe përfshirja e gjithë shoqërisë, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe botës akademike në luftën kundër korrupsionit.

Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me rrezik të lartë/përhapjeje të korrupsionit konsiderohet si karakteristika kryesore e strategjisë së re për periudhën 2024–2030, që duhet të çojë vendin në një qasje të suksesshme për parandalimin e korrupsionit. Menaxhimi i pronësisë së tokës, sistemi shëndetësor/siguria dhe kujdesi social, sistemi arsimor, prokurimi publik, partneritetet publike-private, administrata tatimore dhe doganat janë sektorë të cenueshëm që kërkojnë ndërhyrje.

Siç shumë raporte ndërkombëtare theksojnë praninë e korrupsionit në vend[9], ende ka shumë për të bërë për ta luftuar atë.

Konkretisht, ky veprim do të ndihmojë në përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në rolin e parandalimit[10] dhe hetimin e rasteve të korrupsionit administrativ, si dhe të stafit dhe Rrjetit të Koordinatorëve të Antikorrupsionit, si një mekanizëm referimi të antikorrupsionit nën Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit[11]. Kjo do të sigurojë ndikim të drejtpërdrejtë të vërtetuar për qytetarët dhe palët e interesuara, më konkretisht për OJQ-të që punojnë në mjedisin e antikorrupsionit dhe qeverisjen e mirë. Ky veprim do të ndihmojë gjithashtu në rritjen e kapaciteteve të ILDKPKI-së dhe autoriteteve të tjera, duke marrë parasysh fushat dhe kompetencat e tyre përkatëse.

Vlera e shtuar nga BE-ja në këtë veprim konsiston në forcimin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri në perspektivën e negociatave të aderimit dhe procesit të shqyrtimit të filluar në vitin 2022, si dhe në ndarjen e ekspertizës, përvojës dhe praktikave më të mira të BE-së në fushën e luftës kundër korrupsionit. Përveç Kontratës së Asistencës Teknike në kuadër të veprimit "Për Qeverisjen e Mirë të BE-së" (në kuadër të IPA 2020): IPA/2023/445–248 për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit në vend dhe të Programit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, i cili fokusohet më shumë në implementimin e rekomandimeve të GRECO-s, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion nuk ka pasur donatorë të tjerë që mbështesin aktivitetet e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mund të koordinojë me donatorët e tjerë për të identifikuar fushat ku financimi është më i nevojshëm dhe për të garantuar që burimet të alokohen në mënyrën e duhur.

Mënyra sesi Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë do të koordinohet me donatorët në Fushën e Drejtësisë, përfshirë Antikorrupsionin, përcaktohet në kapitullin VII të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 583, datë 6 tetor 2023, "Për miratimin e rregullores për koordinimin e ndihmës së huaj". Sipas nenit 18, Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë kryen detyrat e mëposhtme për të organizuar donatorët dhe projektet:

[9] Duke përfshirë raportet e Komisionit Evropian, raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së (mbi të drejtat e njeriut, mbi trafikimin e personave, deklaratat për klimën e investimeve), Raundin e 5-të të Vlerësimit të GRECO-s.

[10] Kërkimi, analiza dhe komunikimi dhe vizibiliteti në fushën e luftës kundër korrupsionit.

[11] Në përputhje me kompetencat e saj të përcaktuara në VKM-në 436, datë 26.6.2024.

a) siguron që donacionet të koordinohen dhe komunikohen me njëra-tjetrën, si dhe me donatorët e drejtorive të ndryshme të Ministrisë së Drejtësisë, institucioneve në varësi dhe institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë;

b) mban kontakt teknik të vazhdueshëm me anëtarët e stafit të ngarkuar për organizimin e ndihmës ndërkombëtare në institucionet e Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë;

c) organizon një takim koordinimi me rrjetin e anëtarëve të stafit të ngarkuar për organizimin e ndihmës ndërkombëtare në institucionet e Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë të paktën dy herë në vit;

d) siguron që anëtarët e stafit të ngarkuar për organizimin e ndihmës ndërkombëtare në institucionet e Ministrisë së Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë të kenë akses në informacionin e nevojshëm për mundësitë për të përfituar nga ndihma dhe përgjegjësitë rezultuese;

e) identifikon nevojat dhe sugjeron mënyra për të përmirësuar aftësitë teknike të rrjetit të punonjësve të ngarkuar me koordinimin e ndihmës ndërkombëtare në institucionet e lidhura me Ministrinë e Drejtësisë ose në institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë.

Takimet me donatorët në fushën e drejtësisë, janë parashikuar në nenin 20 si më poshtë:

1. Drejtoria e Projekteve në Fushën e Drejtësisë ndihmon zëvendësministrin përgjegjës për koordinimin e ndihmës ndërkombëtare për të organizuar një takim me donatorët e interesuar ose të gatshëm të mbështesin financimin e projekteve ose investimeve në fushën e drejtësisë, të paktën një herë në vit.

2. Takimi, i cili drejtohet nga zëvendësministri përgjegjës për koordinimin e ndihmës së huaj, synon të informojë donatorët dhe të mbledhë të dhëna në lidhje me:

Këto përfshijnë:

a) projektet që po realizohen në sektorin e drejtësisë;

b) çështjet që lindin gjatë zbatimit të projekteve;

c) politikat e qeverisë ose ministrisë në sektorin e drejtësisë;

d) hapësirat dhe nevojat për mbështetje me projekte ose investime në sektorin e drejtësisë;

e) planet dhe mundësitë e tyre për financim ose mbështetje në projekte.

Për sa u përket autoriteteve të tjera, përfshirë ILDKPKI-në, donatorë të tjerë janë angazhuar për të mbështetur aktivitetet e tyre. Megjithatë, masat e propozuara në këtë veprim nuk bëjnë pjesë në asnjë mbështetje tjetër që u jepet këtyre autoriteteve.

Garantimi i përfshirjes dhe angazhimit me shoqërinë civile është një objektiv i përgjithshëm nëpërmjet këtij programi dhe të gjitha veprimtaritë që përfshihen në të. Nuk është parashikuar mbështetje specifike direkte për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit në kuptimin e gjerë, por BE-ja ka dhe do të vazhdojë të mbështesë OJQ-të që veprojnë në këtë fushë përmes instrumenteve të tjera, dhe temat e financimit të këtyre OJQ-ve mund të jenë të përshtatura me fushat që mbështeten nëpërmjet këtij veprimi.

Ky veprim mund të kontribuojë gjithashtu në Planin e Investimeve Ekonomike, duke krijuar një mjedis më tërheqës për investimet e huaja, ulur kostot, promovuar konkurrencën e ndershme, përmirësuar besimin e publikut në institucionet qeveritare, si dhe lehtësuar bashkëpunimin me palët e interesuara (përfshirë OJQ-të) në këtë fushë.

Ky veprim mund të ofrojë mbështetje teknike për reformat kundër korrupsionit që mund të përfshihen në Planin e Reformës që do të përgatitet në kuadër të Programit të Reformës dhe Rritjes, i cili është aktualisht në fazë përgatitore, duke garantuar përputhshmëri dhe shmangur financimin e dyfishtë.

BE-ja ofron mbështetje teknike për Shqipërinë për të garantuar që mashtrimi dhe korrupsioni të menaxhohen në kontekstin e angazhimeve të Shqipërisë në menaxhimin e fondeve të BE-së përmes IPA-s, si dhe mekanizmave të tjerë të financimit si IPARD (Instrumenti i Ndihmës së Paraaderimit për Zhvillimin Rural) dhe aksesin në financim nga DG REGIO (Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Rajonale dhe Urbane). Masat e marra në këtë kontekst duhet të integrohen brenda përpjekjeve më të gjera kundër korrupsionit. Kur është e mundur, mbështetja teknike në kuadër të këtij veprimi duhet të koordinohet me asistencën teknike që ofrohet nga instrumente të ndryshme nga BE-ja për të mbështetur forcimin e një kuadri të përshtatshëm për menaxhimin e fondeve të BE-së. Për më tepër, duhet arritur koordinimi me mbështetje për luftën kundër korrupsionit dhe, më

gjerësisht, për integritetin, në nivel lokal nëpërmjet programit të BE-së për Qeverisjen Lokale dhe mbështetje të tjera për nivelet lokale dhe rajonale të qeverisjes.

2.1 Analiza e problemit

Analiza e shkurtër e problemit

Sipas draftit të SNKK-së të vendit për vitet 2024–2030, korrupsioni përbën një sfidë në nivel kombëtar pasi ndikon në shoqëri në mënyra të ndryshme, duke sjellë pasoja negative si në jetën ekonomike ashtu edhe në atë sociale të qytetarëve. Në këtë drejtim, u vu re se në raste të caktuara, korrupsioni ka ndikuar në integritetin dhe besimin në lidhje me institucionet publike. Për më tepër, korrupsioni dëmton efikasitetin dhe profesionalizmin e institucioneve dhe autoriteteve publike, veçanërisht kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve me interes publik, duke rezultuar në një nivel të ulët besimi midis qytetarëve në aftësinë e shtetit për të menaxhuar marrëdhëniet shoqërore. Shkaqet e korrupsionit janë të shumta dhe si rezultat, çështja e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit përfshihet në fushëveprimin e punës së një sërë institucioneve, të cilat do të jenë të afta të bashkëpunojnë për të arritur unifikimin dhe garantuar integritetin në aktivitetet e tyre nëpërmjet SNKK-së për vitet 2024–2030.

Gjatë dekadës së kaluar, Shqipëria ka miratuar një paketë të gjerë politikash, legjislacioni dhe institucione për të forcuar luftën kundër korrupsionit.

Kjo përfshiu krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Rrjetit të Posaçëm të Koordinatorëve për Luftën kundër Korrupsionit që nga viti 2021, të cilat përbëjnë strukturën institucionale kryesore për të forcuar përpjekjet qeveritare në luftën kundër korrupsionit, me kompetenca tejet të qarta për parandalimin, represionin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, të bazuara në kuadrin strategjik të vendosur. Krijimi i Drejtorisë së Përgjithshme, dhe, më e rëndësishmja, ristrukturimi i saj më i fundit si një institucion në varësi të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin/KKK, gjithashtu adreson disa nga rekomandimet e raporteve të Komisionit Evropian dhe organizatave të tjera[12] ndërkombëtare që theksojnë nevojën për krijimin e një autoriteti qendror të luftës kundër korrupsionit. Këto ndryshime janë të rëndësishme pasi krijojnë një strukturë qendrore unike nën autoritetin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, duke shfuqizuar strukturat e mëparshme të decentralizuara që operonin nën autoritetin e Kryeministrit dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Përveç rezultateve pozitive në rritje të kapaciteteve për hartimin e politikave, monitorimin dhe raportimin, si dhe kryerjen e hetimeve administrative, ka ende hapësirë për të rritur kapacitetet e DPAK-së, si dhe të koordinatorëve antikorrupsion të caktuar në institucionet e cenueshme ndaj korrupsionit. Rrjeti fillimisht u zgjerua në 44 institucione, dhe tani është kanalizuar në 26 institucione në nivel qendror, duke përfshirë agjenci që janë më të prekshme ose të rrezikuara nga korrupsioni, në sektorë të ndryshëm, si spitale, kompani shtetërore, inspektorate, porte detare etj. Rrjeti kryen vlerësime të rrezikut të korrupsionit, mbi të cilat Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit mund të rekomandojë masa specifike, si ndryshimi i legjislacionit përkatës, legjislacionit dytësor/nënligjor, ose procedurave standarde të operimit, me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me të gjitha mjetet dhe mekanizmat për parandalimin e korrupsionit. Konsolidimi dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të praktikuesve të Rrjetit është i nevojshëm.

Sa i përket Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, Raporti i BE-së për Shqipërinë 2023 thekson se efikasiteti i saj ende mbetet për t'u vlerësuar dhe kapaciteti institucional dhe operacional i rrjetit të luftës kundër korrupsionit në ministritë përkatëse, në nivelin koordinues lokal dhe qendror, ka vazhduar të rritet lehtësisht. Rekrutimi i stafit në Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka përfunduar ende. Krijimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe mekanizmi i Rrjetit të Koordinatorëve për Luftën kundër Korrupsionit është bërë si përgjigje ndaj nevojës për burime më të përshtatshme për të luftuar korrupsionin në nivelin administrativ të autoriteteve publike që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Bashkëpunimi me

[12] Raporti i Pajtueshmërisë GRECO 2022 - https://www.coe.int/en/web/greco/evaluations/albania

partnerët e jashtëm ende ka nevojë të përpunohet dhe miratohet.

Në përgjithësi, mandati i Drejtorisë përcaktohet nga funksione kyçe, të tilla si hetimi, ndjekja penale, parandalimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi, si dhe koordinimi. Para ristrukturimit, është vërejtur gjithashtu mungesa e një plani strategjik zhvillimi, së bashku me mungesën e një buxheti të dedikuar që të menaxhohej në mënyrë të pavarur nga Ministria e Drejtësisë për të financuar koordinimin ndërinstitucional dhe kostot e tjera të lidhura me zbatimin e aktiviteteve kundër korrupsionit. Megjithëse, në përgjithësi, krijimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë ka siguruar një strukturë relativisht të konsoliduar për sa i përket numrit të stafit, vetëm 45% e stafit ishte dedikuar për koordinimin dhe zbatimin e strategjisë, si dhe hartimin e politikave, të cilat përbëjnë funksionet thelbësore të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, ndërsa 55% e stafit trajtonin kompetenca hetimore. Numri total i miratuar i stafit në organikë është 27 persona dhe aktualisht janë në detyrë 23 persona. Janë vetëm 4 vende vakante që duhet të plotësohen. Si e tillë, Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit është kthyer në një strukturë hibride, që përfshin si koordinimin dhe hartimin e politikave, ashtu edhe kompetencat operacionale (kompetencat hetimore).

Krijimi i fundit i një posti të ministrit të Shtetit për Antikorrupsionit dhe Reformës së Administratës Publike ofron potencialin e një fokusi politik më të përkushtuar dhe të nivelit të lartë ndaj Antikorrupsionit, dhe siç u shpjegua më sipër, çoi edhe në ristrukturimin e Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit (DPAK). Megjithëse përshtatja e vazhdueshme institucionale është normale dhe e duhur, duke pasur parasysh natyrën ende të re të disa prej subjekteve të përfshira, do të duhet të tregohet kujdes që kjo të mos pengojë zhvillimin e subjekteve institucionale të pjekura dhe të mirëkonsoliduara në fushën e antikorrupsionit.

Nga kjo perspektivë, veprimi do të ndihmojë në bërjen më efikase dhe më të orientuar drejt ndikimit të strukturave të krijuara, me qëllimin përfundimtar për të reduktuar ndjeshëm korrupsionin dhe përmirësuar perceptimin publik.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015–2023 ka përfunduar. Ministria e Drejtësisë, dhe aktualisht edhe ministri i Shtetit për Antikorrupsionin dhe Reformën e Administratës Publike, është në fazat përfundimtare të hartimit të një Strategjie të re Ndërsektoriale kundër Korrupsionit që do të mbulojë periudhën pasuese, 2024–2030. Ky pritet të miratohet deri në maj 2024.

Draftkoncept-dokumenti strategjik është hartuar dhe vizioni i tij është: "Institucione publike që veprojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, duke siguruar shërbime efikase për qytetarët". Procesi i hartimit të dokumentit të ri strategjik kundër korrupsionit është duke vazhduar që nga marsi i vitit 2022. Ky proces po realizohet në koordinim me institucione të tjera, si: ministritë, organet e pavarura dhe organet e zbatimit të ligjit, me të cilat dokumenti po konsultohet paraprakisht.

Strategjia e re kundër korrupsionit ofron një kombinim të qasjes horizontale kundër korrupsionit me sektorë specifikë që janë evidentuar si problematikë dhe me perceptimin më të lartë të korrupsionit, të tillë si: pronat, arsimi, shëndetësia, taksat dhe tatimet.

Risitë e SNKK-së së re janë: prioritizimi i elementeve të integritetit, forcimi institucional i burimeve njerëzore dhe profesionale kundër korrupsionit, mekanizimi i lobimit si një instrument kundër korrupsionit, përfshirja e kapaciteteve të biznesit në mekanizmat kundër korrupsionit, si dhe orientimi i qasjes gjinore në luftën kundër korrupsionit.

Miratimi i kuadrit të ri strategjik kombëtar kundër korrupsionit 2024–2030 dhe fillimi i zbatimit të tij përbëjnë gjithashtu një prioritet të luftës kundër korrupsionit, i cili është theksuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023–2025.

Për sa i përket Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ky institucion auditon deklaratat e pasurisë së zyrtarëve publikë, zhvillon verifikime dhe hetime administrative mbi deklaratat e pasurisë dhe rastet e konfliktit të interesit, duke ushtruar një funksion thelbësor në parandalimin e korrupsionit dhe shkeljeve të integritetit nga zyrtarët e administratës publike. Inspektorati kohët e fundit ka krijuar një sistem *online* që mirëfunksionon për deklarimin e pasurisë, duke shkuar një hap më tej në procesin e shqyrtimit të pasurisë të të gjithë zyrtarëve. Kapacitetet e ILDKPKI-së duhet të forcohen më tej, me qëllim që të angazhohet në nxjerrjen e praktikave më të mira në vendet e tjera

dhe përmirësimin e mëtejshëm të kontrollit ligjor mbi konfliktin e interesit dhe pasuritë.

AIF-ja (Agjencia e Inteligjencës Financiare) (funksionon si ndërmjetësues ndërmjet subjekteve private, të cilat janë të detyruara të zbatojnë detyrimet (AML/PP) *(kundër pastrimit të parave)* dhe (CFT/FT) *(luftimit të financimit të terrorizmit)* dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Funksionet e saj në përpjekjet kundër pastrimit të parave, rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve të shqetësuara mbi detyrimet për raportim, analizimin dhe raportimin në mënyrë efikase të transaksioneve të dyshimta, duhet të forcohen edhe me qëllim rritjen e kapaciteteve të saj për të ndërvepruar, bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion në mënyrë efektive brenda **Grupit Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare**, i cili është krijuar për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit të inteligjencës midis juridiksioneve.

Përfitues të tjerë të veprimit janë ministritë e linjës dhe agjencitë e tyre në sektorët me rrezik të lartë, autoritetet e tjera përkatëse, bashkitë dhe bizneset. Në fund, grupi i synuar përfundimtar është e gjithë popullsia e Shqipërisë, veçanërisht individët dhe bizneset që ndërveprojnë me subjektet publike.

Mësime të nxjerra:

BE-ja ka mbështetur Shqipërinë në luftën kundër korrupsionit përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë dialogun politik dhe të politikave, mbështetje përmes programeve të mbështetjes për reforma sektoriale, operacione ndërkombëtare monitoruese për të mbikëqyrur me kujdes të plotë procesin e *vetingut* në organet gjyqësore, si dhe përmes komunikimit dhe vizibilitetit të dedikuar, projekteve të binjakëzimit dhe asistencës teknike, dhe granteve për organizatat e shoqërisë civile.

Lufta kundër korrupsionit ka qenë pjesë e IPA II të mëparshme në kuadër të sektorit të paracaktuar të Qeverisjes së Mirë, i lidhur me dy prioritetet e Strategjisë së Zgjerimit për Shqipërinë, për të reformuar administratën publike me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimit të saj dhe bërë përpjekje të mëtejshme të vendosura në luftën kundër korrupsionit.

Mësimet e nxjerra për Shqipërinë në kuadër të IPA-s mund të përmblidhen si më poshtë: prioritizimi i qeverisjes demokratike dhe sundimit të ligjit/shtetit të së drejtës, promovimi i zhvillimit ekonomik dhe përfshirjes sociale, adresimi i sfidave mjedisore dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe integrimit në BE.

Bazuar në mësimet e nxjerra nga kjo përvojë, është përgatitur programi i ri i mbështetjes për buxhetin sektorial dhe asistencës teknike përkatëse "BE për mirëqeverisjen". Në këtë kuadër, lufta kundër korrupsionit është marrë parasysh në projektimin e programit dhe, në mënyrë më specifike, në indikatorin 6: *Integriteti i institucioneve publike*, i cili konsiston në miratimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në administratën qendrore dhe lokale[13].

Mësime të tjera të nxjerra për Shqipërinë janë rëndësia e dialogut politik dhe të politikave, vlera e monitorimit dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare, efektiviteti i komunikimit dhe vizibilitetit të dedikuar, si dhe rëndësia e asistencës teknike dhe projekteve të binjakëzimit[14].

Asistenca teknike dhe projektet e binjakëzimit të BE-së kanë qenë efektive në ndihmën për Shqipërinë për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe ekspertizës për të luftuar korrupsionin. Shqipëria mund të mësojë nga kjo eksperiencë dhe të prioritizojë asistencën teknike dhe projektet e binjakëzimit për të forcuar kuadrot institucionale dhe për të ndërtuar kapacitete.

Në vitin 2016, filloi një projekt binjakëzimi i financuar nga BE-ja me temën "Mbështetje për formulimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit"[15], duke mbështetur Këshillin Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), si dhe institucione të tjera kryesore, si Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit, në kapacitetet e tyre të planifikimit. Projekti i binjakëzimit i financuar nga BE-ja përfundoi në maj 2019 dhe i la KKK-së kapacitete dhe mjete/rezultate të përforcuara.

Në vitin 2019, një projekt i financuar nga BE-ja mbi Komunikimin dhe Vizibilitetin: Kontrata e Reformës Sektoriale për Luftën kundër

[13] https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/202110/AL%20IPA%202020%20EU%20for%20Good%20Governance.pdf

[14] https://euprojects.al/euprojects/sector-reform-contract-for-the-fight-against-corruption-in-albania/

[15] https://www.eeas.europa.eu/node/15120_en

Korrupsionit iu dorëzua KKK-së, duke mbështetur dhe forcuar kapacitetet dhe mjetet për komunikimin dhe vizibilitetin në luftën kundër korrupsionit.

Në vitin 2020, u lançua një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian mbi "Asistencën Teknike për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit për Kontratën e Reformës Sektoriale për Luftën kundër Korrupsionit", i cili ofroi mbështetje për forcimin e rolit të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), stafit të KKK-së dhe institucioneve kryesore zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, në funksionet e tyre të planifikimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave, si dhe në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të KKK-së. Projekti përfundoi në shkurt 2023.

Që nga viti 2023, Shqipëria merr pjesë gjithashtu si vëzhguese në instrumentin pilot të Mbështetjes Teknike për vendet e zgjerimit dhe ndjek një projekt shumëkombësh të Portugalisë, Spanjës dhe Holandës mbi "Pjesëmarrjen qytetare dhe teknologjitë emergjente", i cili ofron njohuri mbi mënyrën sesi Shtetet Anëtare po përpiqen të rikthejnë besimin e qytetarëve përmes zhvillimit të zgjidhjeve të përbashkëta digjitale për pjesëmarrjen demokratike, duke adresuar kështu çështjen e transparencës dhe në mënyrë të tërthortë edhe atë të luftës kundër korrupsionit.[16]

Mësimet kryesore të nxjerra gjatë ndihmave të mëparshme janë se krijimi i Drejtorisë së parë të Përgjithshme kundër Korrupsionit në vitin 2021 ishte një hap i nevojshëm jo vetëm për të siguruar procese të qëndrueshme monitorimi dhe praktika ndërinstitucionale, por ishte thelbësor në garantimin e qëndrueshmërisë institucionale të ndihmës së dhënë gjatë gjithë vitit.

Ndikimi i ndihmës në zhvillimin e kapaciteteve të mjaftueshme për të koordinuar në mënyrë efektive aktivitetet, për të monitoruar dhe vlerësuar dokumentet strategjike (planet e veprimit dhe treguesit) dhe për të propozuar përmirësime të politikave ka qenë i konsiderueshëm në ndihmën e qeverisë në krijimin e praktikave të mira dhe rrjedhave të punës brenda drejtorisë, që nga fillimi i saj. Megjithatë, me konsolidimin e Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit (DPAK) dhe Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në kuadër të ristrukturimit të tyre të fundit, ekziston ende një nevojë urgjente për të rritur kapacitetet për të kryer një sërë aktivitetesh gjithëpërfshirëse brenda kompetencave për të parandaluar, ndëshkuar dhe edukuar mbi antikorrupsionin.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1 Logjika e ndërhyrjes

Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) i këtij Veprimi është:

Korrupsioni në Shqipëri është ulur dhe kapaciteti legjislativ, institucional dhe operacional i vendit për të luftuar kundër korrupsionit është më i pajtueshëm me standardet e BE-së.

Objektivi (rezultati) specifik i këtij Veprimi është:

I) Për t'u mundësuar autoriteteve përkatëse kundër korrupsionit që të kryejnë plotësisht rolin e tyre në parandalimin, shtypjen dhe ndërgjegjësimin e korrupsionit.

II) Për të përmirësuar performancën e ILDKPKI-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, kuadrin ligjor dhe rregullator, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të funksionarëve publikë dhe personave të zgjedhur në Shqipëri, si dhe kontrollin e konflikteve të interesit dhe mbrojtjen e personave që denoncojnë korrupsionin.

Dokumenti i Veprimit do të ofrojë mbështetje për autoritetet shqiptare me kompetenca në luftën kundër korrupsionit për të rritur kapacitetet në fushat e tyre kryesore funksionale, për të përmirësuar funksionet e politikave: (i), funksionet e kontrollit dhe zbatimit (ii) dhe komunikimin dhe angazhimin me publikun (iii). Pika kryesore e projektit është përforcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si autoriteti qendror multidisiplinor kundër korrupsionit, si dhe autoriteteve të tjera me funksione kundër korrupsionit, duke i siguruar kapacitetet e nevojshme teknike dhe funksionale në përputhje të plotë me standardet e BE-së.

Dokumenti i Veprimit do të sigurojë, në veçanti, përmirësimin e performancës së ILDKPKI-së si autoriteti kryesor dhe unik në zbatimin e instrumenteve të integritetit kundër korrupsionit në deklarimin e pasurive, konfliktet e interesit dhe mekanizmat e mbrojtjes së personave që denoncojnë korrupsionin.

[16] Instrumenti i Mbështetjes Teknike (IMT) (europa.eu)

Produktet që do të ofrohen nga ky Veprim, të cilat kontribuojnë në objektivin specifik përkatës (I), janë:

1. Forcimi i kapaciteteve teknike dhe funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në përputhje me rolin e një autoriteti kombëtar multidisiplinar kompetent. Ekspertiza e qëndrueshme dhe e përshtatur e DPAK-së për të luftuar korrupsionin në fusha të zgjedhura të ndjeshme ndaj korrupsionit.

2. Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Rrjetit të Koordinatorëve të Antikorrupsionit për të kryer hetime administrative në mënyrë efektive.

3. Forcimi i kapaciteteve të përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për të formuluar dhe shqyrtuar strategji, politika, programe dhe projekte mbi antikorrupsionin.

4. Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e promovimit dhe komunikimit, bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare dhe institucione përkatëse kombëtare kundër korrupsionit; duke përfshirë bashkëpunimin me shoqërinë civile.

5. Forcimi i aftësive të autoriteteve të tjera me funksione antikorrupsion.

Produktet që do të ofrohen nga ky Veprim që kontribuojnë në objektivin specifik (II) përkatës, janë:

1. Përmirësimi i performancës së ILDKPKI-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, kuadrin ligjor dhe rregullator, në lidhje me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve publikë dhe personave të zgjedhur në Shqipëri, së bashku me kontrollin e konflikteve të interesit.

2. Përmirësimi i kuadrit legjislativ dhe rregullator dhe kapaciteteve të ILDKPKI-së për të zbatuar legjislacionin mbi denoncuesit dhe mbrojtjen e denoncuesve.

Rezultatet e planifikuara/propozuara do të ndikojnë në arritjen dhe do të kontribuojnë në ndikimin kryesor, duke prodhuar dhe vënë në dispozicion njohuri, ndërtuar memorien institucionale, mbrojtur ndryshimin dhe rritur ndërgjegjësimin publik, promovuar përdorimin efektiv të njohurive, ndarë njohuri me palët e interesuara dhe ndërtuar kapacitetet e tyre.

Ky veprim do të:

Rriste kapacitetet dhe ofronte mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit për të koordinuar dhe vlerësuar nën drejtimin e KKK-së performancën e zbatimit të SNKK-së në nivel kombëtar; do ta konsideronte mjedisin mundësues si faktor vendimtar në realizueshmërinë e arritjes së objektivave; do të përpunonte konceptin e integritetit, sjelljen e rreziqeve të korrupsionit dhe zbatimin e monitorimin e instrumentit të integritetit në sektorin publik, do të kuptonte natyrën ndërsektoriale të korrupsionit, shkaqet, efektet dhe mënyrat e tij për ta parandaluar dhe luftuar atë; do të inkurajonte qytetarët të raportonin korrupsionin në Rrjetin e Rrjetit Antikorrupsion; do të zhvillonte dhe zbatonte fushata efektive të informimit publik dhe ndërgjegjësimit; do të vazhdonte dhe do të krijonte partneritete të rregullta dhe të suksesshme me OJQ-të, do të forconte kapacitetet profesionale të koordinatorëve antikorrupsion për të hetuar dhe zbuluar rastet e korrupsionit dhe abuzimin me pushtetin/procedurat abuzive. Performanca e ILDKPKI-së do të përmirësohej më tej. Gjithashtu, veprimi do të rriste kapacitetet dhe do të ofronte mbështetje për institucione të tjera përkatëse si AIF, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ose Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA/ SHSHAP).

3.2 Aktivitetet indikative

Aktivitetet do të konsistojnë në ofrimin dhe hartimin e këshillave strategjike të zbatueshme, reagimeve të ekspertëve mbi politikat kryesore (kërkime dhe hartim politikash), raportimit dhe monitorimit të dokumenteve, ndërtimit të kapaciteteve, hartimit të fushatave të ndërgjegjësimit, ndarjes së përvojave.

Për këtë qëllim, do të zbatohet një projekt asistence teknike për të rritur kapacitetet, efikasitetin dhe autonominë e mandatit të KKK-së, në mënyrë që të ofrojë kapacitete të mjaftueshme për të udhëhequr qasjet strategjike të qeverisë në të gjithë sektorët përkatës në lidhje me politikat kundër korrupsionit.

Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit duhet të tregojë rritje të kapaciteteve për nisjen e procedurave të hetimeve dhe masave parandaluese, si dhe për hetimet administrative, shqyrtimin dhe veprimin ndaj ankesave të adresuara nga burime të ndryshme. Asistenca teknike do të udhëheqë kapacitetet e Drejtorisë së Përgjithshme drejt marrjes në dorë të formulimit të politikave në lidhje me kuadrin strategjik për antikorrupsionin (Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit -

SNKK), si dhe për shqyrtimin e nismave ligjore për rreziqet e korrupsionit, do të asistojë institucionet publike nga sektorët e lartë të rrezikut, si dhe bashkitë kryesore, për të rishikuar dhe zbatuar vlerësimet e rreziqeve të korrupsionit dhe planet e integritetit. Ajo gjithashtu do të rishikojë dhe ndihmojë në zbatimin e strategjive të komunikimit kundër korrupsionit të KKK-së në bashkëpunim me OJQ-të, bizneset kryesore dhe përputhshmërinë e sektorit privat.

Sipas kërkesës, projekti mund të këshillojë gjithashtu autoritetet e auditimit, të tilla si ASPA-ja (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) në hartimin dhe zbatimin e kurrikulave antikorrupsion në nivel qendror dhe vendor të qeverisjes, Agjencinë Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, duke iu referuar kurrikulave antikorrupsion në shkolla, për Shkollën e Magjistraturës në ofrimin e programit të trajnimit për inspektorët antikorrupsion dhe për Rrjetin e Koordinatorëve.

Sektorët dhe aktivitetet përkatëse do të zgjidhen në fillim të procedurës së prokurimit, në varësi të raporteve ndërkombëtare (BE, GRECO, OECD) dhe raporteve kombëtare (monitorimi i SNKK-së) për korrupsionin.

Asistenca teknike për SPAK-un dhe NBI-në do të konsolidojë strukturat dhe do t'i bëjë më produktive dhe operacionale për të adresuar nevojat dhe, në veçanti, për t'u ofruar atyre njohuri dhe ekspertizë të veçantë.

Aktivitete të lidhura me produktin 1 (objektivi specifik I) – aktivitetet që lidhen me rezultatin 1 (objektivi specifik I) – forcimi i kapaciteteve teknike dhe funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në përputhje me rolin e një autoriteti kombëtar multidisiplinor kompetent në luftën kundër korrupsionit që merret me detyra parandaluese, ndërgjegjësuese dhe represive.

Aktivitetet janë hartuar në një mënyrë që të rrisin kapacitetet dhe ofrojnë mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në kryerjen e funksioneve të saj, duke përfshirë:

- Rolin/detyrën parandaluese – ruajtjen e rolit udhëheqës dhe koordinues në procesin e hartimit të strategjisë dhe politikave kombëtare kundër korrupsionit; monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë kombëtare; hartimin dhe propozimin e masave për të përmirësuar legjislacionin kundër korrupsionit; hartimin e udhëzimeve dhe rolin mbështetës mbi planet e integritetit dhe sigurimin e "kulturës së integritetit" në administratën publike; rritjen e aftësive kërkimore dhe analitike, forcimin e kapaciteteve në komunikim në luftën kundër korrupsionit.

- Rolin/detyrën represive – fillimin e procedurave hetimore dhe masave parandaluese; hetimet administrative, shqyrtimin dhe veprimin sipas ankesave dhe garantimin e ndërveprimit me Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në planifikimin strategjik antikorrupsion, programimin, monitorimin, si dhe hetimin e çështjeve të korrupsionit në institucionet publike.

2. Përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të planit të zhvillimit të kapaciteteve nga autoriteti i KKK-së në mënyrë të rregullt.

3. Ofrimin e opinioneve të ekspertëve dhe mbështetjes teknike për përafrimin e legjislacionit kundër korrupsionit me standardet ndërkombëtare dhe *acquis* të BE-së.

4. Kontributin në parandalimin e korrupsionit përmes hartimit të një qasjeje të synuar në ndryshimin e kurrikulave shkollore për të ofruar edukim të përmirësuar mbi ligjshmërinë dhe integritetin.

5. Mbështetje në ndërtimin e partneriteteve me agjencitë/autoritetet antikorrupsion të BE-së për të avancuar bashkëpunimin për të ekzekutuar më mirë kompetencat e autoritetit kombëtar antikorrupsion (ndarja e praktikave më të mira).

6. Përmirësimin e praktikave në kontekstin e hetimeve administrative të çështjeve të dyshuara të korrupsionit në institucionin qeveritar të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Shënim. Barazia gjinore do të integrohet kur të jetë e nevojshme; kuadri institucional dhe struktura e pushtetit dhe ndikimit do të merren parasysh kur të jetë e nevojshme.

Aktivitete që lidhen me produktin 2 (objektivi specifik I) – ekspertizë e fuqishme dhe e përshtatur për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit (DPAK) për të luftuar korrupsionin në fusha të caktuara të ndjeshme ndaj korrupsionit.

Aktivitetet specifike do të konsistojnë në rritjen e kapaciteteve profesionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, duke trajtuar analizat e rrezikut të korrupsionit dhe duke siguruar kapacitete të mjaftueshme të Drejtorisë për t'u përballur me nevojën për të adresuar sektorët veçanërisht të ndjeshëm ndaj korrupsionit, sipas përparësive të përcaktuara nga SNKK-ja e re 2024–2030.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Mbështetje për forcimin e kapaciteteve të stafit antikorrupsion në verifikimin e raportimeve për korrupsion dhe verifikimin e denoncimeve në fusha të ndjeshme ndaj korrupsionit.

2. Mbështetje për vlerësimin e sektorëve me rrezik korrupsioni dhe zbatimin e masave lehtësuese për fushat e ndjeshme ndaj korrupsionit (pronësia, shëndetësia, arsimi, prokurimi publik, partneritetet publike-private, tatimet dhe doganat).

3. Përmirësimin e procedurave të inspektimit dhe mekanizmave të hetimit në institucionet e Rrjetit Antikorrupsion.

4. Përmirësimin e kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në kërkimin, analizën dhe vlerësimin e politikave antikorrupsion.

Shënim. Barazia gjinore do të integrohet kur të jetë e nevojshme; kuadri institucional dhe struktura e pushtetit dhe ndikimit do të merren parasysh, kur të jetë e nevojshme.

Aktivitetet e lidhura me produktin 3 (objektivi specifik I) – forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion dhe Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion për të realizuar në mënyrë efektive hetimet administrative.

Aktivitetet specifike do të përfshijnë forcimin e kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, duke trajtuar analizat e rrezikut nga korrupsioni dhe duke siguruar kapacitete të mjaftueshme të drejtorisë për të përballuar nevojën për të adresuar verifikimin e rasteve (ankesave dhe denoncimeve) për korrupsion, si dhe mbështetje për ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme me organet e zbatimit të ligjit për trajtimin e hetimeve, rezultateve të hetimeve dhe denoncimeve publike kundër korrupsionit.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Programe trajnimi: kryerja e programeve të trajnimit për stafin e DPAK-së/KKK-së dhe koordinatorët e antikorrupsionit për të rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushat e hetimit administrativ.

2. Këshillim dhe trajnim: ofrimi i këshillimit dhe trajnimit individual për koordinatorët për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre.

3. Bashkëpunim me ekspertë të jashtëm: bashkëpunim me ekspertë të jashtëm në fushën e hetimit administrativ dhe interpretimit profesional për të fituar njohuri dhe perspektiva të reja.

4. Vizita studimore në agjencitë antikorrupsion të BE-së me kompetenca në hetimin e korrupsionit dhe inspektimet administrative.

5. Rritjen e kapaciteteve të stafit antikorrupsion në DPAK/KKK dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar dhe koordinuar në mënyrë efektive veprimet e tyre në luftën kundër korrupsionit.

Shënim. Barazia gjinore do të integrohet kur të jetë e nevojshme; kuadri institucional dhe struktura e pushtetit dhe ndikimit do të merren parasysh, kur të jetë e nevojshme.

Aktivitetet që lidhen me produktin 4 (objektivi specifik I) – forcimi i kapaciteteve të përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit të nevojshme për të formuluar dhe shqyrtuar strategjitë, politikat, programet dhe projektet në fushën e antikorrupsionit.

Aktivitetet specifike do të konsistojnë në rritjen e kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, që merret me planifikimin strategjik, monitorimin, propozimet e dokumenteve të politikave, kërkimet dhe analizat.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Përmirësimin e kapaciteteve të Drejtorisë për të analizuar kontekstin social, politik dhe ekonomik (mjedisi i favorshëm);

2. Mbështetje për të kryer diagnostikime/ identifikime dhe kërkime mbi korrupsionin;

3. Mbështetje për të vlerësuar efektivitetin e politikave antikorrupsion;

4. Mbështetje në procesin e hartimit, monitorimit dhe raportimit mbi kuadrin strategjik për antikorrupsionin;

5. Përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse sipas strategjisë së antikorrupsionit për t'u përballur me nevojën për të adresuar treguesit e performancës të përcaktuar në strategji.

Aktivitetet që lidhen me produktin 5 (objektivi specifik I) – forcimi i kapacitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në kapacitetet promovuese dhe të komunikimit, bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe

institucionet përkatëse kombëtare antikorrupsion; duke përfshirë bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Mbështetje për kapacitetet e DPAK-së/KKK-së në komunikimin strategjik mbi antikorrupsionin dhe integritetin.

2. Përmirësim të zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira mbi rritjen e ndërgjegjësimit mbi antikorrupsionin dhe integritetin, të përshtatura sipas kontekstit specifik kombëtar.

3. Mbështetje në kryerjen e një analize të plotë mbi ndërhyrjet e mundshme në kurrikulat shkollore mbi edukimin mbi ligjshmërinë bazuar në praktikat më të mira të UNODC/ ZKBDK (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin) dhe BE-së. Mbështetje në rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në aktivitetet antikorrupsion.

4. Mbështetje në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për planifikimin e politikave dhe strategjisë kundër korrupsionit.

Aktivitetet që lidhen me produktin 6 – Forcimi i aftësive të autoriteteve të tjera me funksione antikorrupsion.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Mbështetje për SSA/SMA (Sekretariati për Mbështetjen e Antikorrupsionit), AFIA/ AIF (Agjencia e Inteligjencës Financiare), ASPA/AMAP (Agjencia për Mbështetjen e Administratës Publike) dhe autoritetet e tjera për të forcuar funksionet dhe aktivitetet e tyre të fokusuara në antikorrupsion.

Aktivitete që lidhen me produktin 1 të rezultatit II: Përmirësimi i performancës së ILDKPKI-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, kuadrin ligjor dhe rregullator, të cilat lidhen me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të funksionarëve publikë dhe personave të zgjedhur në Shqipëri, së bashku me kontrollin e konflikteve të interesit.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Kryerjen e programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit dhe takimeve të përbashkëta të punës me institucionet partnere nga BE-ja për stafin e ILDKPKI-së mbi procedurat e deklarimit të pasurisë, duke përfshirë praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare.

2. Ndarjen e praktikave më të mira në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit me institucionet partnere të BE-së.

Aktivitete që lidhen me produktin 2 të rezultatit II: Kuadri legjislativ dhe rregullator i përmirësuar dhe kapacitetet e ILDKPKI-së për të zbatuar legjislacionin mbi denoncimin dhe mbrojtjen e denoncuesve.

Aktivitetet e propozuara mund të përfshijnë:

1. Rishikimin dhe rishkrimin e legjislacionit ekzistues në lidhje me sinjalizuesit për t'u siguruar që është në përputhje me direktivën 2019/1937;

2. Ofrimin e trajnimit për njësinë e dedikuar për mbrojtjen e sinjalizuesve brenda ILDKPKI-së;

3. Zhvillimin e një fushate ndërgjegjësimi publik për të edukuar qytetarët dhe sinjalizuesit e mundshëm rreth të drejtave dhe mbrojtjeve të tyre sipas legjislacionit të ri.

3.3 Integrimi

Veprimi do të kontribuojë në sigurimin e një veprimi efektiv dhe gjithëpërfshirës kundër korrupsionit në Shqipëri, duke pasur parasysh se është thelbësore të merren parasysh çështjet që kalojnë përtej një sektori të vetëm, të cilat kanë ndikim në projektimin dhe zbatimin e veprimit. Këto çështje përfshijnë respektimin e mbrojtjes së mjedisit, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, personat me aftësi të kufizuara, demokracinë dhe uljen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, si dhe fushat e tjera përkatëse që mund të ndikohen nga korrupsioni.

Në këtë projektim dhe zbatim të veprimit, çështjet që kalojnë përtej një sektori të vetëm integrohen, duke i përfshirë në të gjitha fazat e procesit. Kjo përfshin identifikimin e prioriteteve, përcaktimin e objektivave, përzgjedhjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve. Integrimi i çështjeve që kalojnë përtej një sektori të vetëm është formuluar në një mënyrë që garanton që ato të mos trajtohen si komponentë të ndarë ose të izoluar, por si pjesë të pandashme të veprimit të përgjithshëm.

Për të zbutur efektin e korrupsionit në integrimin e politikave dhe praktikave të Shqipërisë me politikat përkatëse të BE-së, ky veprim përqendrohet në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e sundimit të ligjit. Kjo përfshin masa të tilla si përmirësimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë, forcimi i efektivitetit të institucioneve të mbikëqyrjes, promovimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes dhe mbështetja e zhvillimit të një sistemi gjyqësor të pavarur.

Për më tepër, veprimi duhet të synojë gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit dhe nxitjen e një kulture integriteti dhe sjellje etike si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Kjo mund të bëhet përmes programeve të synuara të ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimit, si dhe fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe aktiviteteve të informimit.

Së fundi, është thelbësore të sigurohet koordinim dhe bashkëpunim efektiv midis palëve të interesuara përkatëse, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat e shoqërisë civile, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo mund të arrihet përmes këtij veprimi duke krijuar kanale të qarta komunikimi, ndarë informacion dhe praktikat më të mira, si dhe miratuar një qasje bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse ndaj hartimit dhe zbatimit.

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti

Vlerësimi strategjik mjedisor (VSM), vlerësimi i ndikimit mjedisor (VNM) ose vlerësimi i rrezikut klimatik (VRK) nuk kërkohen.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

Sipas kodeve të OECD/OBZHE (Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) Gender DAC/KNZH (Komiteti i Ndihmës për Zhvillim) të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si G1. Kjo do të thotë se të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij veprimi do të nxisin barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, aftësitë e kufizuara, demokracinë dhe uljen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

Lidhur me barazinë gjinore, ky Veprim, nëpërmjet aktiviteteve të tij, do të nxisë përfshirjen më të gjerë të grave në përpjekjet dhe aktivitetet kundër korrupsionit.

Përmbledhje e çështjeve kryesore të pabarazisë gjinore që lidhen me korrupsionin:

1. Korrupsioni ndikon në mënyrë të veçantë te gratë, veçanërisht në lidhje me aksesin e tyre në drejtësi[17];

2. Gratë përballen me ekspozim më të lartë ndaj korrupsionit gjatë aksesit në shërbime sociale, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe arsimin;

3. Format e korrupsionit të lidhura me gjininë ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe vajzat[18];

4. Gratë priren ta perceptojnë dhe të sillen ndryshe nga burrat ndaj korrupsionit;

5. Korrupsioni ndikon negativisht në barazinë gjinore dhe në agjencinë e grave;

6. Mungesë informacioni në të dhënat gjinore mbi korrupsionin.

Si rrjedhojë, duke pasur parasysh se efektet e korrupsionit nuk janë të paanshme ndaj gjinisë, është e nevojshme të krijohet një dialog ndërmjet atyre që luftojnë korrupsionin dhe atyre që punojnë për barazinë dhe drejtësinë gjinore, në mënyrë që të mundësohet: (i) një perceptim i përbashkët dhe më i gjerë i lidhjeve ndërmjet pabarazisë gjinore dhe korrupsionit; (ii) afrimi i prioriteteve të politikave publike për të dyja çështjet; dhe (iii) veprime specifike, të koordinuara dhe të artikuluara për të adresuar çështjet që mbivendosen dhe konvergojnë me njëra-tjetrën[19].

Treguesit e antikorrupsionit të lidhur me gjininë, të rëndësishëm për Shqipërinë/ kontekstin e aderimit në BE

Tabela më poshtë paraqet përputhshmërinë midis:

i. kapitujve të BE-së që lidhen me një fushë të caktuar politike;

ii. dokumenteve përkatëse të politikave kombëtare që do të përfshijnë konsideratat ndërkombëtare për barazinë gjinore; dhe

iii. treguesve specifikë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin që do të reflektohen në kuadrin kombëtar të monitorimit.

Përputhshmëria plotësohet duke renditur treguesit përkatës të SDG-së/ OZHQ-së, të cilët lidhin integrimin e perspektivës gjinore në procesin e aderimit në BE me objektivat e barazisë gjinore në nivel global.

[17] GRETA – Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprime kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

[18] Vlerësimi paraprak i kryer nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri tregon se **shantazhi seksual**– praktika në të cilën seksi përdoret si valutë korrupsioni me efekte të rënda negative për gratë dhe vajzat – është e pranishme në sektorin e arsimit të lartë, edhe pse ende duhet të mblidhen të dhëna më të plota mbi këtë çështje.

[19] Rekomandimet bazohen dhe përshtaten nga ato të paraqitura në burime të ndryshme, duke përfshirë: ZKBDK(2020), Tani është momenti i duhur: Adresimi i ndikimeve gjinore të korrupsionit; Transparenca ndërkombëtare (2014), Pabarazia gjinore dhe korrupsioni: Cilat janë Lidhjet?; OSBE (2021), Ndikimi gjinor i korrupsionit në sektorët e kujdesit shëndetësor dhe arsimit të lartë në Shqipëri, Hulumtime paraprake dhe vlerësim i nevojave; OSBE (2021), Gjinia dhe korrupsioni: Çfarë dimë? Një dokument diskutimi; Banka Ndëramerikane e Zhvillimit (2018), Integrimi gjinor në fondin e transparencës.

Kontributi në disa kapituj të BE-së nën grupkapitullin e parë ("Themeloret"), veçanërisht: **Kapitulli 23 –** Gjyqësori dhe të drejtat themelore **Kapitulli 24 –** Drejtësia, liria dhe siguria **dhe për zbatimin e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore**	
Dokumentet strategjike kombëtare përkatëse	- Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2023 dhe Plani i Veprimit 2020–2023 - Strategjia për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimit të Rëndë 2021–2025 dhe Plani i Veprimit 2021–2022 - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021–2030 - Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit 2021–2025 - Strategjia Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut 2018–2022 - Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023
Treguesit e antikorrupsionit që lidhen me gjininë	- Numri i planeve të veprimit kundër korrupsionit në nivel kombëtar që marrin në konsideratë rrethanat e ndryshme dhe pozitat e pabarabarta të grave dhe burrave. - Plani i veprimit kundër korrupsionit përfshin të paktën një rezultat të nivelit të lartë mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, i cili do të kontribuojë në përmbushjen e objektivave të OZHQ-së, duke iu referuar objektivave 5 dhe 16. - Numri i mjeteve të standardizuara (p.sh. sondazhe të opinionit publik, renditja e niveleve të korrupsionit ose niveli i ryshfetit në sektorin publik) që matin shpeshtësinë me të cilën gratë përballen me korrupsionin në krahasim me burrat. - Numri i mjeteve të standardizuara të aplikuara që përfshijnë mundësinë për të specifikuar pagesën e ryshfetit përmes shërbimeve, si dhe favoreve seksuale.
	- Numri ose përqindja e studimeve të çështjeve ose moduleve të trajnimit që trajtojnë çështjet që lidhen me gjininë dhe stereotipat gjinorë. - Ekspozimi dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave ndaj korrupsionit dhe përvojat e tyre me të në sektorin e shërbimeve publike, analizohen dhe dokumentohen. - Qëndrimet e grave dhe burrave në lidhje me raportimin e korrupsionit dhe ndaj autoriteteve të luftës antikorrupsion. - Besimi dhe perceptimi i grave dhe burrave për qeverinë.
Treguesit e lidhur me OZHQ-të	16.5.1 Përqindja e personave që kanë pasur të paktën një kontakt me një zyrtar publik dhe që i kanë dhënë ryshfet një zyrtari publik, ose u është kërkuar ryshfet nga këta zyrtarë publikë, gjatë 12 muajve të mëparshëm (metodologjia lejon ndarjen sipas gjinisë). 16.6.2 Përqindja e popullsisë së kënaqur me përvojën e tyre të fundit me shërbimet publike (metodologjia lejon ndarjen sipas gjinisë).

3.4 Rreziqet dhe supozimet

Kategoria	Rreziqet	Probabiliteti (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Masat zbutëse
Njerëzit dhe organizata	Mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi midis palëve të ndryshme të interesuara në luftën kundër korrupsionit.	Mesatare	I lartë	Do të ketë një mekanizëm efektiv koordinimi midis palëve të ndryshme të interesuara në luftën kundër korrupsionit.
Politike	Paqëndrueshmëria politike në Shqipëri mund të çojë në mungesë të vullnetit politik dhe mbështetjes për masat kundër korrupsionit.	I lartë	I lartë	Qeveria shqiptare është e përkushtuar për të luftuar korrupsionin dhe do të ofrojë mbështetje të mjaftueshme për strukturat antikorrupsion.
Organizata	I. Burime dhe kapacitet i kufizuar i institucioneve antikorrupsion për të realizuar mandatin dhe angazhimet e tyre në mënyrë efektive. II. Sfidat e vazhdueshme në lidhje me regjistrin/ të	Mesatare	I lartë	Institucioneve antikorrupsion do t'u ofrohen burime dhe masa të mjaftueshme për ndërtimin e kapaciteteve për të realizuar në mënyrë efektive mandatin dhe përmbushur angazhimet e tyre.

	dhënat e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit.			
Operacionale	Tendencë negative në treguesit e perceptimit të korrupsionit.	I lartë	I lartë	Konsultime me OJQ-të, median dhe ekspertët e njohur si burime të raporteve dhe organizatave që i prodhojnë ato.

Supozime të jashtme

Supozimet janë:

DPKK-ja/KKK-ja, ILDKPKI-ja dhe autoritetet e tjera kanë kapacitetin dhe burimet për të koordinuar dhe zbatuar planin e veprimit në mënyrë efektive.

BE-ja do të ofrojë mbështetje të mjaftueshme financiare dhe teknike për të zbatuar planin e veprimit dhe arritur rezultatet e dëshiruara.

Institucionet shtetërore që trajtojnë parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë organet ligjzbatuese, gjyqësorin dhe administratën publike, kanë gatishmërinë për të përmirësuar kapacitetet e tyre dhe bashkëpunuar me njëra-tjetrën.

Trajnimi dhe asistenca teknike që ofrohen nga nismat e financuara nga BE-ja, do të jenë efektive në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Organizatat e shoqërisë civile dhe media mbështesin përpjekjet kundër korrupsionit dhe luajnë rol pozitiv në rritjen e ndërgjegjësimit publik për korrupsionin dhe mbajtjen përgjegjës të funksionarëve publikë.

Zbatimi i rekomandimeve është i nevojshëm për suksesin: Ato janë të bazuara në fakte dhe kanë treguar se janë efektive në përmirësimin e performancës së përgjithshme të vendit.

Zbatimi i Dokumentit të Veprimit IPA III të janarit 2023 – për vitin 2024 do të çojë në krijimin e sistemit të lartpërmendur dhe uljen e korrupsionit në Shqipëri.

Ky partneritet i krijuar do t'i ndihmojë të gjithë aktorët e përfshirë të mësojnë përmes praktikave më të mira, të ndajnë njohuritë dhe të krijojnë rezultate të forta në parandalimin - rritjen e ndërgjegjësimit dhe qasjen represive.

Matrica treguese e kuadrit logjik

Rezultatet	Lidhja e rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Nivelet bazë (vlerat dhe vitet)	Objektivat (vlerat dhe vitet)	Burimet e të dhënave	Supozime
Ndikimi	Korrupsioni në Shqipëri është zvogëluar dhe kapaciteti legjislativ, institucional dhe operacional i vendit për të luftuar korrupsionin është më në përputhje me standardet e BE-së.	Perceptimi nga ekspertët dhe drejtuesit e biznesit se sa i korruptuar është sektori publik i një vendi.	Vlerësuar 36/100 (2022)	Vlerësuar 43/100 (2030)	CPI/IPK (Indeksi i perceptimit të korrupsionit) nga transparenca ndërkombëtare	*Nuk aplikohet*
		Rritje e cilësisë së angazhimit dhe pjesëmarrjes së palëve të interesuara dhe qytetarëve në përpjekjet kundër korrupsionit.	1 342 komente të dhëna në forumet e AK-së/mbledhjet e KKK-së (2022) Baza cilësore: Raporti i shqyrtimit Grupkapitulli 1 (2023) Raporti i zgjerimit të Komisionit (2023)	Tendencë në rritje (2028) Objektivi cilësor: Vlerësimi i progresit në raportet e zgjerimit të Komisionit	Barometri Global i Korrupsionit nga Transparenca Ndërkombëtare dhe raporte të tjera të perceptimit (nga organizatat rajonale dhe lokale) Raportet e zgjerimit të Komisionit	*Nuk aplikohet*
		Hartimi, miratimi dhe zbatimi i një plani zhvillimi të Drejtorisë dhe rritja e kapaciteteve profesionale	27 persona (2023) Mungon Plani i Zhvillimit të Drejtorisë (2024)	Plani i Zhvillimit të Drejtorisë, i zbatueshëm dhe i rishikuar rregullisht (2026) Kapacitete të rritura njerëzore në përputhje me vlerësimin e nevojave në Planin e Zhvillimit të Drejtorisë (2027) Objektivi cilësor: Vlerësimi i progresit mbi kapacitetin e Drejtorisë në raportet e zgjerimit të Komisionit.	Raportet e brendshme të KKK-së	
Rezultati 1	Mundësimi i autoriteteve qendrore antikorrupsion në Shqipëri që të vlerësojnë mjedisin dhe të lidhin fushëveprimin dhe gamën e veprimeve antikorrupsion në kontekstin e kuadrit ligjor, politik, institucional dhe zbatues për të luftuar në mënyrë efektive korrupsionin në të gjitha nivelet.	1.1 Kontrolli i përshtatshmërisë së kuadrit ligjor, politik dhe institucional për parandalimin e korrupsionit, është rishikuar, përmirësuar dhe zbatuar.	0 (2022)	I rishikuar dhe i përmirësuar 25% (2025) 50% (2026) 75% (2027) 100% (2028) Objektivi cilësor: Progresi në zbatim në raportet e zgjerimit të Komisionit	Raportet e KKK-së; Miratimi i ISAC 2024–2030; Raportet e Monitorimit mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (ISAC/SNKK)	Qeveria shqiptare është e përkushtuar për të ulur korrupsionin dhe ka vullnetin politik për të zbatuar reformat e nevojshme. DPAK-ja ka kapacitetin dhe burimet për të koordinuar dhe zbatuar planin e veprimit në mënyrë efektive. DPAK-ja dhe ILDKPKI-ja kanë kapacitetin dhe burimet për të analizuar kontekstin social, politik dhe ekonomik

						(mjedisin premtues). BE-ja do të ofrojë mbështetje të mjaftueshme financiare dhe teknike për të zbatuar planin e veprimit dhe arritur rezultatet e dëshiruara.
		1.2 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore (a) zbatimi i ligjit, (b) sistemi gjyqësor, dhe (c) administrata publike) të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe/ose luftën kundër korrupsionit me mbështetje të BE-së (të ndara përkatësisht	Paketa e zgjerimit të Komisionit (2023) Raporti i shqyrtimit të Komisionit (2023)	Objektivi cilësor: Vlerësimi i progresit mbi kapacitetin e Drejtorisë në raportet e zgjerimit të Komisionit	DPAK Delegacioni i Bashkimit Evropian	Institucionet shtetërore të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë organet e zbatimit të ligjit, sistemin gjyqësor dhe administratën, kanë vullnetin për të përmirësuar kapacitetet e tyre dhe bashkëpunuar me njëra-tjetrën.
		1.3 Numri i individëve nga autoritetet kryesore kombëtare dhe lokale, veçanërisht institucionet e KA-së dhe koordinatorët e KA-së të trajnuar mbi kuadrin e rishikuar ligjor, institucional dhe të politikave (të ndara sipas gjinisë, sektorit dhe subjektit/entit (autoritetit publik)	50 (2021)	Plotësisht i trajnuar (2028)	Raportet e KKK-së Ministritë e linjës Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile Delegacioni i Bashkimit Evropian	Trajnimet dhe asistenca teknike e ofruar nga nismat e financuara nga BE-ja, do të jenë efektive në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat mbështesin përpjekjet kundër korrupsionit dhe luajnë dhe luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me fenomenin e korrupsionit, si dhe në mbajtjen e zyrtarëve publikë përgjegjës për veprimet e tyre.
		1.4 Numri i rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe organeve të tjera përkatëse të Këshillit të Evropës (p.sh. GRECO), të zbatuara plotësisht	5 (2022)	Rekomandimet e pazgjidhura të GRECO-s u trajtuan plotësisht (2026) Angazhimet e udhërrëfyesit për luftën kundër korrupsionit me afat para vitit 2028, u trajtuan plotësisht	Raportet e GRECO-s (*Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit)* Raportet e zgjerimit të Komisionit Delegacioni i Bashkimit Evropian	Zbatimi i rekomandimeve është i domosdoshëm për arritjen e suksesit: ato bazohen në prova dhe janë dëshmuar si efektive në përmirësimin e performancës së përgjithshme të vendit.

Përfitimi 1 i lidhur me rezultatin 1	Forcimi i kapaciteteve teknike dhe funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në përputhje me rolin e një autoriteti kombëtar multidisiplinor kompetent në luftën kundër korrupsionit që trajton detyra parandaluese, ndërgjegjësuese dhe represive.	1.1.1 Përqindja e dokumenteve strategjike, të politikave dhe akteve të tjera ligjore të zbatueshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, e përmirësuar. 1.1.2 Përqindja e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit të trajnuar mbi dokumentet strategjike, të politikave dhe aktet ligjore, e rishikuar	1.1.1 *(Për t'u konfirmuar)* (2022) 1.1.2 *(Për t'u konfirmuar)* (2022)	1.1.1 100% e dokumenteve strategjike, të politikave dhe akteve të tjera ligjore (deri në fund të projektit IPA) 1.1.2 100% e stafit përkatës të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit	1.1.1 DPAK 1.1.2 DPAK	Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm është i domosdoshëm për të luftuar në mënyrë efektive korrupsionin.
Përfitimi 2 i lidhur me rezultatin 1	Ekspertizë e fortë dhe specifike për të luftuar korrupsionin në fusha të caktuara sensitive ndaj korrupsionit.	1.2.1 Miratimi dhe zbatimi i planeve të dedikuara të veprimit në sektorët sensitivë ndaj korrupsionit 1.2.2 Numri i analizave dhe rekomandimeve të dhëna institucioneve përgjegjëse brenda sektorëve sensitivë	1.2.1 0 (2022) 1.2.2 0 (2022)	1.2.1 Zbutja e riskut të integritetit në fusha sensitive dhe zvogëlimi i shfaqjes së korrupsionit në këto fusha (1 sektor/çdo vit) 1.2.2 Analizat vjetore të dorëzuara (1 analizë për institucion të cenueshëm të identifikuar në SNKK/çdo vit)	1.2.1 DPAK 1.2.2 DPAK	Vlerësimi i rrezikut të integritetit po zbatohet me sukses nga DPA-ja që nga viti 2021. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për të zgjeruar fushëveprimin nga vlerësimi i rrezikut institucional në atë sektorial.
Përfitimi 3 i lidhur me rezultatin 1	Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Rjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion për të kryer hetime administrative në mënyrë efektive;	1.3.1 Numri i seancave/trajnimeve mbi ndërtimin e kapaciteteve në verifikimet administrative 1.3.2 Numri i çështjeve të korrupsionit të proceduara në Prokurori nga DPAK dhe Rjeti 1.3.3 Niveli i besimit të qytetarëve në mungesën e korrupsionit në qeveri	1.3.1 7 (2022) 1.3.2 46 (2023) 1.3.3 TBC *(Për t'u konfirmuar)* (2023)	1.3.1 Trajnime/sesione të rregullta periodike mbi verifikimet administrative (tendencë në rritje) 1.3.2 rritje e numrit të çështjeve të hetuara dhe të referuara në Prokurori nga DPA 1.3.3. Rritja e besimit të qytetarëve në mungesën e korrupsionit në qeveri	1.3.1 Delegacioni i Bashkimit Evropian 1.3.2 DPAK/KKK Sondazhi Botëror i Drejtësisë Transparenca Ndërkombëtare Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit	Luftimi i korrupsionit përbën aktualisht një nga fushat kryesore të punës së DAP-së dhe çdo vit vërehet një rritje e qëndrueshme në numrin e çështjeve të hetuara.
Përfitimi 4 i lidhur me rezultatin 1	Forcimi i kapaciteteve të përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për të formuluar dhe shqyrtuar strategji, politika, programe dhe projekte mbi antikorrupsionin.	1.4.1 % e analizave që vlerësojnë politikat kombëtare kundër korrupsionit 1.4.2 % e raporteve përkatëse në përputhje me metodologjinë e monitorimit	1.4.1 1 (2022) 1.4.2 0.9% (2022)	 1.4.1 Deri në 100% të institucioneve që hartojnë raporte vjetore monitorimi, në zbatim të planeve të integritetit, deri në vitin 2028.	Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qeveritare që kanë miratuar dhe monitoruar Planet e Integritetit dhe janë të përfshira në dokumentin strategjik	DPA
Përfitimi 5 i lidhur me rezultatin 1	Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në kapacitetet promovuese dhe	1.5.1 Krijimi i Koalicionit të Hapur kundër Korrupsionit dhe Rjetit Kombëtar të Organizatave të Shoqërisë Civile aktive	0 (2022)	Koalicioni kundër Korrupsionit është krijuar dhe është vënë në funksionim (2024)	1.5.1 Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në konsultim me shoqërinë civile	Ky partneritet i krijuar do t'i ndihmojë të gjithë aktorët e përfshirë që të mësojnë përmes praktikave më të mira, të

	komunikuese, bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet përkatëse kombëtare antikorrupsion; bashkëpunimin me shoqërinë civile.	në fushën e antikorrupsionit		Numri i raporteve dhe politikave të konsultuara me Koalicionin (nga viti 2026 e në vazhdim	Raportet e zgjerimit të Komisionit Delegacioni i Bashkimit Evropian	ndajnë njohuritë dhe të krijojnë rezultate të qëndrueshme në parandalimin - rritjen e ndërgjegjësimit dhe qasjen represive/luftimin.
Përfitimi 6 i lidhur me rezultatin 1	Forcimi i aftësive të autoriteteve të tjera me funksione antikorrupsion	1.6.1 Rritja e përfshirjes së organeve të tjera kundër korrupsionit në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të udhëhequra nga DPAK	Numri i stafit të organeve të tjera kundër korrupsionit që përfitojnë nga aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të udhëhequra nga DPAK (2023)	Numri i stafit të organeve të tjera kundër korrupsionit që përfitojnë nga aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të udhëhequra nga DPAK (2023)	Raportet e AIF-së, AMAP-it, dhe SMA-së	Përmirësimi i koordinimit dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve të ndryshme kundër korrupsionit është i domosdoshëm për ta luftuar në mënyrë efektive.
Përfitimi 1 i lidhur me rezultatin 2	Përmirësimi i performancës së ILDKPKI-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, kuadrin ligjor dhe rregullator, që lidhen me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve publikë dhe personave të zgjedhur në Shqipëri, së bashku me kontrollin e konfliktëve të interesit.	2.1.2 Kapacitete më të zgjeruara të stafit profesional të ILDKPKI-së 2.1.3 Kapacitete më të zgjeruara të ILDKPKI-së për të kryer verifikime efektive të deklaratave të pasurisë, veçanërisht auditime të plota.	Numri i stafit 70 që kanë nevojë për trajnime të mëtejshme dhe shkëmbim ekspertize (2023) Procedura për auditim të plotë e rishikuar në kontekstin e standardeve më të mira (2024)	Numri i stafit është më shumë se 70, të trajnuar dhe me njohuri të mjaftueshme mbi praktikat më të mira të BE-së. (Çdo vit, 2023–2030) Cilësia e auditimeve të ILDKPKI-së është përmirësuar	Raportet e ILDKPKI-së Raportet e zgjerimit të Komisionit Delegacioni i Bashkimit Evropian	Ekspertiza e mirë është e vendosur për zbatimin e legjislacionit mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe parandalimin e konflikteve të interesit. Një shkëmbim praktikash më të mira me shtetet anëtare të BE-së në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe parandalimin e konflikteve të interesit është ende i nevojshëm.
Përfitimi 2 i lidhur me rezultatin 2	Kuadër legjislativ dhe rregullator i përmirësuar dhe kapacitete të ILDKPKI-së për të zbatuar legjislacionin mbi sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	1.2 Përafrimi i ligjit të ri me Direktivën e BE-së. 1.3 Kapacitetet e nevojshme njerëzore në zbatim, përfshirë trajnimin	2.2 Ligji i vitit 2016, jo në përputhje me direktivën e vitit 2019. (2023) 2.3 TBC *(Për t'u konfirmuar)*	2.2 Miratimi i ligjit të ri deri në vitin 2025, duke garantuar përputhshmëri me Direktivën e vitit 2019 dhe forcim të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të sapomiratuar 2.3. 100% e stafit të ILDKPKI-së dhe qeverisë me përgjegjësi për zbatimin e legjislacionit të direktivave të BE-së, u trajnua.	Raportet e ILDKPKI-së Raportet e zgjerimit të Komisionit Delegacioni i Bashkimit Evropian	Sistemi i mbrojtjes së sinjalizuesve që është në fuqi, ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm dhe përafrim të mëtejshëm me *acquis* të BE-së.

4. MARRËVESHJET E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e Financimit

Për të zbatuar këtë veprim, parashikohet të lidhet një marrëveshje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2 Periudha e parashikuar e zbatimit

Periudha e parashikuar për zbatimin operacional të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 72 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të miratohen nga zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit duke ndryshuar këtë vendim financimi, kontratat, si dhe marrëveshjet përkatëse.

4.3 Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë që rregullat dhe procedurat e përshtatshme të BE-së për ofrimin e financimeve për palët e treta të respektohen, duke përfshirë procedurat e rishikimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së.

4.3.1 Menaxhimi i drejtpërdrejtë (grantet)

4.3.1.1 Granti i binjakëzimit

a) Qëllimi i grantit

Një projekt binjakëzimi i hartuar për ILDKPKI-në me objektivin për të përmirësuar performancën e ILDKPKI-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, kuadrin ligjor dhe rregullator, në lidhje me deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve publikë dhe personave të zgjedhur në Shqipëri, së bashku me kontrollin e konflikteve të interesit, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Rezultati i pritshëm i mbështetjes së binjakëzimit është që performanca e ILDKPKI-së (kapacitetet institucionale, deklarimi dhe kontrolli i pasurive të zyrtarëve publikë, mbrojtja e sinjalizuesve) do të përmirësohet përmes ndarjes së përvojave, deklarimit të rregullt në sistem të numrit të pasurive të deklaruara dhe ofrimit të modeleve më të mira të mbrojtjes së sinjalizuesve. Binjakëzimi do të kontribuojë në rezultatin 2.

b) Lloji i aplikantëve të synuar

Aplikantët duhet të jenë administrata të shteteve anëtare të BE-së ose organe të autorizuara prej tyre.

4.3.2 Menaxhimi i drejtpërdrejtë (prokurimi)

Objektivat e prokurimit janë që të ofrojë mbështetje për institucionet përkatëse. Së pari, ai është i dedikuar për mbështetje të kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për të koordinuar më mirë përpjekjet kundër korrupsionit. Rezultati i pritshëm është që kapaciteti i stafit përkatës të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për të koordinuar dhe analizuar, do të rritet përmes trajnimeve dhe sesioneve informative.

Prokurimi do të kontribuojë në rezultatin 1.

4.3.3 Ndryshime nga grantet në prokurim sipas mënyrës së menaxhimit të drejtpërdrejtë për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme

Nëse modaliteti i zbatimit sipas mënyrës së menaxhimit të drejtpërdrejtë të grantit të binjakëzimit, siç përcaktohet në seksionin 4.3.1, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, do të përdoret modaliteti i zbatimit me anë të prokurimit, siç përcaktohet në seksionin 4.3.2.

4.4 Fushëveprimi i përshtatshmërisë gjeografike për prokurim dhe grante

Përshtatshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve dhe për sa i përket origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin themelor dhe parashikohet në dokumentet kontraktuale përkatëse, do të zbatohet në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund ta zgjerojë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet, kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores së (NDICI/Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar/IFZHBN-së) – Global Europe).

4.5 Buxheti tregues/i parashikuar

Komponentët e buxhetit të parashikuar	Kontributi i BE-së (shuma në EURO)	Kontributi tregues/ i parashikuar i palës së tretë (EURO)
Metodat e zbatimit – shihni seksionin 4.3		Nuk zbatohet
Rezultati 1 dhe 3 përbëhen nga:	**2 850 000**	Nuk zbatohet
Prokurimi (menaxhim i drejtpërdrejtë) – shihni seksionin 4.3.2	2 850 000	Nuk zbatohet
Rezultati 2 i përbërë nga:	**1 000 000**	Nuk zbatohet
Grant (menaxhim i drejtpërdrejtë) – shihni seksionin 4.3.1.1	1 000 000	Nuk zbatohet
Vlerësimi – shihni seksionin 5.2 Auditimi – shihni seksionin 5.3	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk zbatohet
Komunikimi Strategjik dhe Diplomacia Publike – shihni seksionin 6	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk zbatohet
Totali	**3 850 000**	Nuk zbatohet

4.6 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Agjencia kryesore dhe përfituesja kryesore për qëllimin e zbatimit të këtij veprimi është Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK). DPAK-ja vepron si një institucion në varësi të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe kundër Korrupsionit si Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit (DPAK) është krijuar si një subjekt/ent juridik publik buxhetor, i financuar nga buxheti i shtetit. Ajo përbëhet nga dy drejtori teknike: Drejtoria e Analizave, Kontrollit dhe Hetimeve Administrative, dhe Drejtoria për Zbatimin e Politikave në Fushën e Antikorrupsionit, me një staf total prej 27 anëtarësh.

Përgjegjësitë kryesore funksionale të DPAK-së përfshijnë:

1. përdorimin e ekspertizës së avancuar për të identifikuar tendencat e korrupsionit dhe fushat më sensitive ndaj praktikave korruptive;

2. rritjen e ndërgjegjësimit, koordinimit dhe sigurimit të instrumenteve për zbatimin e politikave antikorrupsion, dhe

3. kryerjen e hetimit administrativ bazuar në denoncime dhe ankesa mbi praktikat abuzive/ praktikat e korrupsionit në institucionet ku Drejtoria mund të ndërhyjë.

Organika e DPAK-së u miratua me urdhrin e Kryeministrit nr. 146, datë 1 gusht 2024. ILDKPKI-ja është një institucion me strukturë të qartë, i përbërë nga një numër prej 70 personash, të konsideruar si të pranueshëm për qëllimin e zbatimit të rezultateve brenda objektivit të dedikuar për ILDKPKI-në, duke përfshirë 28 inspektorë dhe 12 inspektorë ndihmës, si dhe njësi të tjera mbështetëse.

Si pjesë e kompetencave të saj për zbatimin e buxhetit dhe mbrojtur interesat financiare të Bashkimit, Komisioni mund të marrë pjesë në strukturat e lartpërmendura të qeverisjes të ngritura për menaxhimin e zbatimit të veprimit.

Një komitet drejtues mund të organizohet për të mbikëqyrur zbatimin e projekteve të parashikuara në kuadër të këtij veprimi, me pjesëmarrjen e të gjitha agjencive përkatëse dhe partnerëve zbatues.

4.7 Parakushtet

Parakusht për këtë veprim është gatishmëria e institucioneve përfituese për t'u angazhuar plotësisht në zbatimin e këtij veprimi. Ekziston një vullnet i qartë institucional për t'u angazhuar në sigurimin e qëndrueshmërisë së këtij veprimi nga DPAK-u dhe ILDKPKI-ja, i siguruar gjatë të gjithë procesit të konsultimit për hartimin e këtij veprimi. Një parakusht tjetër që do ta përmirësonte më tej, është miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit ISAC/SNKK 2024–2030, e cila do të krijojë kushtet për një angazhim më të plotë në zbatimin e veprimeve sipas afatit kohor të caktuar dhe brenda buxhetit të caktuar.

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues do të krijojë një sistem të përhershëm të monitorimit të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin, dhe të hartojë raporte të rregullta progresi (jo më rrallë se një herë në vit) dhe raporte përfundimtare. Çdo

raport duhet të ofrojë një përshkrim të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësive të hasura, ndryshimeve të prezantuara, si dhe shkallës së arritjes së produkteve të tij dhe kontributit në arritjen e rezultateve të tij, dhe nëse është e mundur, në momentin e raportimit, edhe kontributin në arritjen e ndikimeve, të matur nëpërmjet treguesve përkatës, duke marrë si pikë referimi matricën e kuadrit logjik.

Komisioni mund të kryejë vizita shtesë monitorimi të projektit, si nëpërmjet stafit të vet, edhe nëpërmjet konsulentëve të pavarur të rekrutuar drejtpërdrejt nga Komisioni për rishikime të pavarura monitorimi (ose të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e këtyre rishikimeve).

Rregullimet për monitorimin dhe raportimin, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizën dhe monitorimin e të dhënave: parashikohet që KKK-ja (nëpërmjet sekretariatit të tij) të përgatisë raportet e monitorimit, të cilat do të ndahen për qëllime konsultimi dhe do të diskutohen dy herë në vit – gjithashtu me synimin për përshtatje apo rishikime të mundshme – për t'i paraqitur më vonë pranë mekanizmit të monitorimit për miratim. Çdo institucion zbatues është përgjegjës për të raportuar mbi progresin e tij në lidhje me planin e veprimit, një proces i cili koordinohet nga KKK-ja që gjithashtu verifikon informacionin e paraqitur përmes kontrolleve verifikuese.

Një pjesë e veçantë e procesit të konsultimit është ndarja e draftraporteve të monitorimit, duke mbledhur komente nga OJQ-të. Gjithashtu, pjesëmarrja e OJQ-ve në takimet e Grupit Tematik Antikorrupsion, si dhe në takimet e tjera tematike të organizuara nga KKK-ja. OJQ-të do të ofrojnë një rol të dedikuar ndërhyrjeje në raportet e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, dokumentet e politikave antikorrupsion, si dhe në nivele të tjera bashkëpunimi në fushën e antikorrupsionit, përmes shkëmbimit të informacionit, takimeve të dialogut dhe mekanizmave të tjerë të përshtatur.

5.2 Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij veprimi, do të kryhet një vlerësim(e) afatmesëm dhe përfundimtar për këtë veprim ose komponentët e tij nëpërmjet konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni.

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet për zgjidhjen e problemeve, dhe në veçanti për vlerësimin e nivelit të arritjes së rezultateve të parashikuara në kuadrin logjik të veprimit dhe projekteve.

Vlerësimi përfundimtar do të kryhet për qëllime llogaridhënieje dhe mësimi në nivele të ndryshme (duke përfshirë rishikimin e politikave), duke marrë parasysh në veçanti rezultatet dhe ndikimin e pritshëm të veprimit.

Komisioni do të formojë një grup reference (GR) të përbërë nga përfaqësues të grupeve kryesore të interesit në nivelet e BE-së dhe ato kombëtare (përfaqësues të qeverisë, organizatave të shoqërisë civile (sektori privat, OJQ-të etj.). Nëse çmohet e nevojshme, do të ftohen të bashkohen edhe donatorë të tjerë.

Raportet e vlerësimit do të ndahen me vendin partner dhe grupet e tjera kryesore të interesit, duke ndjekur praktikat më të mira të shpërndarjes së vlerësimeve. Partneri zbatues dhe Komisioni do të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e nevojshme, në marrëveshje me vendin partner, do të vendosin bashkërisht për veprimet që do të ndërmerren më tej dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse tregohet, riorientimin e projektit.

Shërbimet e vlerësimit mund të kontraktohen në kuadër të një kontrate kuadër.

5.1 Auditimi dhe verifikimet

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij veprimi, Komisioni, mbi bazën e një vlerësimi risku, mund të kontraktojë auditim ose verifikim të pavarur për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual për të informuar audiencat përkatëse për mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre, duke shfaqur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër mbi financimin, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me veprimet përkatëse. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022 "Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme" (ose në çdo dokument pasues që e zëvendëson atë).

Ky detyrim do të zbatohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse veprimet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve ose subjektet e

besuara ose të deleguara, siç janë agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e Shteteve Anëtare të BE-së. Në çdo rast, një referencë ndaj detyrimeve përkatëse kontraktuale duhet të përfshihet në marrëveshjen përkatëse të financimit, kontratat e prokurimit dhe granteve, si dhe në marrëveshjet e kontributit.

7. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria e rezultateve të këtij veprimi do të mbështetet duke ndjekur nga afër zbatimin e strategjisë së re kundër korrupsionit nga qeveria, duke garantuar koordinim të ngushtë me përfituesit shtetërorë, duke angazhuar shoqërinë civile, si dhe përmes dialogut politik dhe të politikave, veçanërisht në lidhje me negociatat e aderimit.

Projektet që do të ndërmerren në kuadër të këtij veprimi pritet të përfshijnë ekspertizën e ofruar në dokumentet politike dhe rregullatore, si dhe ta zgjerojnë këtë ekspertizë përmes modaliteteve të trajnimit të trajnerëve.

AL

KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA II

Vendimi Zbatues i Komisionit për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024

Dokumenti i Veprimit për BE-në për Qeverisjen Vendore

PLANI VJETOR I VEPRIMIT

Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës sipas nenit 110(2) të Rregullores Financiare, dhe planet dhe masat vjetore dhe shumëvjeçare të veprimit sipas nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23(2) të Rregullores NDICI/IFZHBN (Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar) – Global Europe.

1. PËRMBLEDHJE

1.1 Tabela përmbledhëse e Veprimit

Titulli	Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024 BE për Qeverisje Vendore
OPSYS *(sistemi operacional i Komisionit Evropian për menaxhimin e projekteve dhe kontratave)*	Referenca e biznesit OPSYS: ACT-62388
ABAC *(sistem financiar i Komisionit Evropian)*	Numri i nivelit 1 të angazhimit ABAC: JAD.1354182
Akti themelor	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III)
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	Po Mirëqeverisja si themel për rritje ekonomike të qëndrueshme
Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	Jo
Nisma Team Europe	Jo
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL	

Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 2 *"Mirëqeverisje, përafrimi me acquis-në, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik"* Prioriteti tematik 1 Mirëqeverisje			
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ kryesorë (vetëm 1): Qëllimi 11 qytete dhe komunitete të qëndrueshme; synimi 11.a: Planifikim i fortë i zhvillimit kombëtar dhe rajonal			
Kodi(et) DAC	Kodi kryesor 151 Qeveria Nënkodi 15112 Decentralizimi dhe mbështetja për qeverinë nënkombëtare			
Kanali kryesor i zbatimit	Komisioni Evropian - Pjesa e buxhetit për zhvillim – 42001			
Objektivat	☐ Klima ☐ Gjinia ☐ Biodiversiteti			
Treguesit (nga formulari DAC)	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/mirëqeverisja	☐	☐	☒
	Ndihma për mjedisin	☐	☒	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, i të porsalindurve dhe i fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i rrezikut të fatkeqësive	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☐	☒	☐
	Luftimi kundër shkretëtirëzimit	☐	☒	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
Tregues dhe etiketime të brendshme	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	☐	☒	☐
	Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	PO ☐		JO ☒
	Etiketime:	PO		JO
	Transporti	☐		☒
	Energji	☐		☒
	Mjedisi dhe qëndrueshmëria ndaj klimës	☐		☒
	Digjitale	☐		☒
	Zhvillimi ekonomik (përfshirë sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike)	☐		☒
	Zhvillimi njerëzor (përfshirë kapitalin njerëzor dhe të rinjtë)	☐		☒
	Rezistenca shëndetësore	☐		☒
	Migrimi dhe lëvizshmëria	☐		☒
	Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural	☐		☒
	Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike	☐		☒
	Të tjera	☐		☒
	Digjitalizimi	☐	☒	☐

	Etiketime: lidhshmëri digjitale qeverisje digjitale sipërmarrje digjitale aftësi/shkrim-lexim digjital shërbime digjitale	PO ☐ ☒ ☐ ☐ ☒		JO ☒ ☐ ☒ ☒ ☐
	Lidhshmëria	☐	☒	☐
	Etiketime: lidhshmëri digjitale energji transport shëndetësi arsim dhe kërkim	PO ☐ ☐ ☐ ☐ ☐		JO ☒ ☒ ☒ ☒ ☒
	Migrimi	☒	☐	☐
	Reduktimi i pabarazive	☐	☒	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION MBI BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020101.01 Kostoja totale e vlerësuar: 10 000 000 EURO Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së: 10 000 000 EURO			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	**Menaxhim indirekt** me subjektin(et) që do të zgjidhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.1.			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	Deri më 31 dhjetor 2025			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit, të prokurimeve dhe kontratave grant	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, me përjashtim të rasteve të listuara në nenin 114 (2) të Rregullores Financiare.			
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas lidhjes të Marrëveshjes së Financimit			

1.1 Përmbledhja e Veprimit

Ky Veprim kontribuon në përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimit ekonomik vendor. Më konkretisht, qëllimet e tij janë të përmirësojë cilësinë, shtrirjen apo aksesin në infrastrukturën dhe shërbimin e qeverive vendore, të forcojë dialogun politik midis qeverisë vendore dhe qendrore në lidhje me procesin e aderimit, si dhe të forcojë llogaridhënien dhe transparencën e qeverisë vendore dhe qendrore përmes dialogut proaktiv mbi politikat ndërmjet qeverisë qendrore dhe vendore dhe angazhimit aktiv dhe pjesëmarrës të qytetarëve[20].

Ky veprim është në përputhje me prioritetin tematik 1 "Qeverisja e mirë" (dhe në një masë më të vogël, me prioritetin tematik 2 "*Kapaciteti administrativ dhe përafrimi me acquis-në e BE-së*" dhe prioritetin tematik 4 "*Komunikimi strategjik, monitorimi, vlerësimi dhe komunikimi*") që lidhet me Dritaren 2 "*Mirëqeverisja =, përafrimi me acquis-in, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik*" të Kuadrit Programues IPA III. Për më tepër, ky veprim është në përputhje me pesë shtyllat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor[21], duke mbështetur zhvillimin ekonomik lokal dhe shërbimet lokale dhe synon të kontribuojë në nismat e mëposhtme të Planit Evropian të Investimeve (PEI)[22]: Vala e Rinovimit për ndërtesa me efikasitet energjetik, Menaxhimi i Mbetjeve dhe Ujërave të Zeza për menaxhim të qëndrueshëm, infrastruktura digjitale për përdorim më të mirë të teknologjisë dhe Garancia Rinore për punësim cilësor, veçanërisht për të rinjtë. Përveç kësaj, ky veprim kontribuon në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ), pasi qeverisja lokale luan rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në nivelet lokale dhe rajonale, përmes ofrimit të shërbimeve thelbësore, zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Kjo është gjithashtu në përputhje me disa tregues të Komitetit të Ndihmës për Zhvillim (KNZh) dhe tregues të brendshëm në kontekstin e qeverisjes vendore, siç është rritja e decentralizimit dhe autonomisë vendore, mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve, në veçanti, dhe administratën publike në përgjithësi. Duke qenë se decentralizimi ka një natyrë ndërsektoriale, ky Dokument Veprimi (DV) përfshihet në tregues të tjerë të KNZH-së, të tilla si mbrojtja e përgjithshme e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, barazia gjinore dhe pjesëmarrja demokratike në nivel lokal.

1.3 Përfituesi(it) e Veprimit

Veprimi do të zbatohet në Shqipëri

2. ARGUMENTIMI

2.1 Konteksti

Në përputhje me agjendën e aderimit në BE, Qeveria e Shqipërisë (QSH) shprehu angazhimin e saj për të zbatuar disa reforma që synojnë përmirësimin e qeverisjes së mirë. Këto reforma trajtojnë çështje të ndryshme komplekse, duke përfshirë reformën e administratës publike, menaxhimin e financave publike, luftën kundër korrupsionit, decentralizimin dhe dixhitalizimin.

Në këtë drejtim, Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka vijuar me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II), si dokumenti kryesor strategjik që përcakton vizionin e saj për zhvillim dhe integrimin në Bashkimin Evropian, i cili përditësohet rregullisht nëpërmjet zgjerimit të planit të veprimit. Vizioni i SKZHI-së II për decentralizimin dhe qeverisjen vendore synon fuqizimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e efikasitetit të procesit të decentralizimit. Ky vizion mbështetet përmes rritjes së efektivitetit të strukturave të qeverisjes vendore, forcimit të financave vendore dhe promovimit të autonomisë fiskale, nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm vendor, si dhe forcimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Në shkurt të vitit 2023, Shqipëria miratoi Strategjinë e re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE)[23]. Vizioni i SKZHEI-së 2022–2030 për "decentralizimin dhe fuqizimin e qeverisjes vendore" synon fuqizimin e qeverisjes vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, në përputhje me standardet evropiane. Ky vizion mbështetet përmes forcimit

[20] Termi "qytetarë" i përdorur në këtë dokument nënkupton individë të të gjitha identiteteve gjinore dhe prejardhjeve të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e nxitjes së përfshirjes dhe barazisë gjinore në dialogun politik dhe proceset e vendimmarrjes.

[21] factsheet green agenda oct2023 final_0.pdf (europa.eu)

[22] EIP (wbif.eu)

[23] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030", i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 24.02.2023. Shihni: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88/59519cb2–2180-4e7e-9d91-68545a68e008

dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm vendor; përmirësimit të ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve të tyre për qytetarët; digjitalizimit të shërbimeve vendore dhe përmirësimit të infrastrukturës së ofrimit të tyre; rritjes së autonomisë financiare vendore përmes konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta; përmirësimit të demokracisë vendore dhe avancimit të agjendës së integrimit evropian në nivel lokal; si dhe forcimit të kapaciteteve qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore, si dhe të shoqatave të vetëqeverisjes vendore. Reforma Administrativo-Territoriale (RAT) e vitit 2014 synonte të përmirësonte shërbimet e ofruara qytetarëve në nivel lokal, të maksimizonte efikasitetin dhe qeverisjen e mirë, si dhe të fuqizonte qeveritë vendore dhe rajonale. Kjo reformë konsolidoi dhe eliminoi fragmentimin e panevojshëm, duke rezultuar në 12 rrethe dhe 61 bashki të mëdha. Miratimi i RTA-së shënoi një reformë të rëndësishme administrative në Shqipëri, që synonte të përmirësonte efikasitetin dhe efektivitetin në ofrimin e shërbimeve, si dhe autonominë fiskale vendore.

Reforma Administrativo-Territoriale u pasua nga miratimi i: (i) "Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020 (SKNDQV)"; (2) ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ndër të tjera u transferoi bashkive disa funksione të reja; (iii) ligjit nr. 68/2017, "Për financimin e vetëqeverisjes vendore", i cili garanton të drejtën e NJVV-ve për të gjeneruar të ardhura në mënyrë të pavarur, për të përfituar nga një transferim i pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit dhe për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare. NJVV-të kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të tyre, transferimit të pakushtëzuar dhe të ardhurave nga ndarja e taksave të përbashkëta, i plotësuar nga ligji nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30 tetor 2006, "Për sistemin e taksave vendore".

Aktualisht, QSH-ja miratoi një Strategji të re Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030[24]. Strategjia synon të forcojë qeverisjen vendore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik drejt standardeve evropiane; ajo përfshin konsolidimin e procesit të decentralizimit, krijimin e një mjedisi nxitës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik vendor, forcimin e bashkive me të ardhura vendore, digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre *online*, sigurimin e një qeverisjeje të hapur, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe zgjerimin e qeverisjes elektronike në nivel vendor, si dhe avancimin e agjendës së BE-së në nivel vendor.

Gjithashtu, që prej vitit 2023, Shqipëria po merr pjesë si vëzhguese në projektin pilot të Instrumentit të Mbështetjes Teknike për vendet e zgjerimit dhe ndjek një projekt shumëpalësh të Portugalisë, Spanjës dhe Holandës mbi "Pjesëmarrjen qytetare dhe teknologjitë emergjente", i cili ofron njohuri se si Shtetet Anëtare po përpiqen të rifitojnë besimin e qytetarëve përmes zhvillimit të zgjidhjeve të përbashkëta digjitale për pjesëmarrjen demokratike.[25]

Kuadri programues IPA III paraqet një qasje të orientuar nga politikat, me një shpërndarje strategjike dhe dinamike të asistencës, duke vendosur në qendër "themeloret". Ai përqendrohet në sundimin e ligjit, respektimin e vlerave themelore dhe forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike. Në përputhje me prioritetin tematik 1 "Qeverisja e mirë" (dhe në një masë më të ulët me prioritetin tematik 2 "*Kapaciteti administrativ dhe përafrimi me acquis-në e BE-së*" dhe prioritetin tematik 4 "*Komunikimi, monitorimi, vlerësimi dhe komunikimi strategjik*") që lidhet me dritaren 2 "*Mirëqeverisja, përafrimi me acquis-në, Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe Komunikim strategjik*", ky Veprim synon të përmirësojë cilësinë dhe llogaridhënien e administratës, të rrisë profesionalizmin, depolitizimin dhe transparencën, të përmirësojë menaxhimin e financave publike dhe të ofrojë shërbime më të mira për qytetarët, gratë dhe burrat në të gjithë diversitetin e tyre, në përputhje me rregullat dhe standardet e BE-së.

Në këtë kuadër, Veprimi kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e Strategjisë së re për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, si dhe në zbatimin e Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian

[24] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.4.2023, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 68 datë 26.4.2023. https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/04/20/252/ea30c5f2-a4bc-4ee4-b826-22afbe1bbaf9;q=strategjia%20ndersektoriale%20per

[25] Instrumenti i Mbështetjes Teknike (IMT) (europa.eu).

2022–2030, veçanërisht seksionit të saj mbi "decentralizimin dhe fuqizimin e qeverisjes vendore". Veprimi synon të forcojë dhe promovojë zhvillimin e qëndrueshëm vendor, të përmirësojë ofrimin e shërbimeve vendore për të rritur cilësinë dhe standardin e tyre për qytetarët, të përmirësojë demokracinë vendore, të avancojë agjendën e integrimit evropian në nivel lokal dhe të forcojë kapacitetet qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore dhe shoqatave të vetëqeverisjes. Ajo gjithashtu do të integrojë çështjet e mjedisit dhe ndryshimit të klimës në qeverisjen vendore.

Ky Veprim është në përputhje me pesë shtyllat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe shërbimet lokale dhe synon të kontribuojë në nismat e PIE-së: Vala e rinovimit për ndërtesa me efikasitet energjetik, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të zeza për menaxhim të qëndrueshëm, infrastruktura digjitale për përdorim më të mirë të teknologjisë dhe garancia rinore për punësim cilësor, veçanërisht për të rinjtë. Për më tepër, ky veprim mbështetet në kontributin ekzistues të BE-së përmes projekteve të ndryshme në qeveritë lokale (qoftë si kontribues i vetëm ose bashkëfinancues) përmes mbështetjes direkte me grante, përafrimit të politikave, përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve dhe promovimit të qeverisjes së mirë, duke kontribuar rrjedhimisht në forcimin e qeverive lokale dhe rrugën e vendit drejt integrimit në BE. Përveç kësaj, dokumenti i veprimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë ndërtimit mbi aktivitetet ekzistuese dhe të ardhshme të projekteve të ndryshme të tjera në qeverisjen vendore në Shqipëri dhe sigurimin e përputhshmërisë me to. Në përgjithësi, të gjitha aktivitetet e këtij Veprimi, janë bazuarkryesisht në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030.

2.2 Analiza e problemit

Pavarësisht shumë sfidave që krijuan tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID-19, Shqipëria ka performuar mirë, duke regjistruar vlera më të larta se mesatarja rajonale për gjashtë fushat kryesore të treguesve të MPQM-së për Reformën në Administratës Publike (RAP). Megjithatë, pavarësisht kësaj performancë relativisht të fortë dhe përparimi të arritur, mbeten disa dobësi dhe sfida që kërkojnë një planifikim dhe implementim më të koordinuar dhe me qëllim për të plotësuar boshllëqet në kornizat rregullatore dhe metodologjike, për të forcuar kapacitetet dhe për të garantuar një zbatim më të mirë dhe më të qëndrueshëm të mjeteve dhe procedurave ekzistuese.

Progresraporti i Vendit i KE-së për vitin 2022 deklaron se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e reformës në administratën publike. Në mënyrë të qartë, reforma administrative territoriale duhet të konsolidohet më tej si pjesë e një agjende më të gjerë decentralizimi. NJVV-ve u mungojnë ende burime të mjaftueshme financiare dhe kapacitete administrative për të ushtruar në mënyrë efektive kompetencat e tyre më të mëdha të hartimit të politikave. Autonomia fiskale e NJVV-ve mbetet në rrezik, pasi pjesa më e madhe e buxhetit të tyre varet nga transfertat kombëtare. Situata financiare e komunave është bërë më e ndërlikuar për shkak të goditjeve ekonomike, duke çuar në një ulje të burimeve të veta të disponueshme për NJVV-të. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore në nivel lokal mbetet i kufizuar. SKNDQV 2023–2030 thekson disa sfida me të cilat përballen bashkitë në përmbushjen e detyrimeve të tyre. Këto sfida përfshijnë nevojën për më shumë autonomi fiskale, mungesën e standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve, qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore, pasiguritë ligjore dhe administrative, digjitalizimin dhe nevojën për të forcuar demokracinë lokale. Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, SKNDQV-ja mbështet zbatimin e taksave të përbashkëta për të mbështetur NJVV-të dhe krijimin e instrumenteve dhe mekanizmave për të monitoruar ofrimin dhe performancën e shërbimeve, sipas standardeve të mirëpërcaktuara dhe për të siguruar qëndrueshmëri dhe përfshirje në digjitalizim. Raporte të tjera të publikuara nga Bashkimi Evropian dhe nga donatorë të tjerë konfirmojnë se, për të arritur rezultate efektive në proceset e decentralizimit, nuk mjafton vetëm fuqizimi i anës ofruese. Qeverisja efektive vendore kërkon një qeverisje vendore përgjegjëse dhe të ndjeshme, e cila ka struktura institucionale të fuqishme për të përfshirë qytetarët në çështjet vendore. Ky aspekt i qeverisjes vendore mbetet ende i pazhvilluar, si në aspektin institucional ashtu edhe në nivelin e angazhimit qytetar. Këshilli Konsultativ vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun dhe koordinimin institucional midis qeverisjes qendrore dhe vendore. Megjithatë, sipas Raportit të Statusit të Qeverisjes Vendore 2021

të lëshuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, edhe pas pesë vitesh funksionimi, ky Këshill nuk arritur të ndryshojë rrjedhën e politikave të ndryshme.

Identifikimi i palëve kryesore të interesuara dhe çështjeve përkatëse institucionale dhe/ose organizative (mandatet, rolet e mundshme dhe kapacitetet) që do të mbulohen nga ky veprim.

Koordinimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i reformës së administratës publike (RAP) drejtohen nga Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara për Mirëqeverisjen = dhe RAP (GMPI-RAP). Grupi Tematik i Decentralizimit brenda GMPI-RAP drejtohet nga ministria përgjegjëse për agjendën e decentralizimit (ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore), i mbështetur nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes (AMV). Të gjithë aktorët kryesorë institucionalë përfaqësohen në grupin tematik të GMPI-së për decentralizimin. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimit është përgjegjës për të siguruar që parimet e qeverisjes së mirë të respektohen. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC/ASPSKN) është përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet e zhvillimit, si dhe për mbështetjen e strukturave vendimmarrëse në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe monitorimin e zbatimit të saj. Gjithashtu, ajo ofron mbështetje metodologjike në hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, me synimin për t'i harmonizuar ato me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), si dhe për të monitoruar zbatimin e tyre. Përveç kësaj, SASPAC/ASPSKN koordinon procesin e administrimit të projekteve me interes kombëtar dhe ofron mbështetje për institucionet e administratës shtetërore për të rritur kapacitetet e tyre në fushën e programeve dhe projekteve të zhvillimit. Palët e tjera të interesuara përfshijnë Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe njësitë e qeverisjes vendore (NJVV-të) si institucionet më të afërta me qytetarët. Shoqatat e Autoriteteve Vendore, në nivel vendor dhe rajonal, janë palët kryesore të interesuara në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe në përfaqësimin e interesave të tyre. Roli i tyre në fuqizimin e autoritetit vendor dhe forcimin e dialogut midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është thelbësor. Aktorët joshtetërorë të përfshirë në RAP përfshijnë organizatat e shoqërisë civile (OSHC), grupet e ekspertëve, akademinë, institutet kërkimore, universitetet, sektorin privat, donatorët, partnerët e zhvillimit dhe median. Këta aktorë joshtetërorë zakonisht angazhohen për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive në projektet e qeverisjes vendore, jo vetëm në drejtim të përfaqësimit të aktorëve të ndryshëm, por edhe në aspektin e ekspertizës, advokimit, përfshirjes së komunitetit, inovacionit dhe shpërndarjes së njohurive. Palët kryesore të interesuara në fushën e trajtuar nga ky dokument veprimi janë agjencitë donatore, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC/AZZHB) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA/ASBNZH).

2.3 Mësimet e nxjerra

Bashkëpunimi dhe koordinimi me të gjithë aktorët e përfshirë janë të nevojshëm për të çuar përpara dhe konsoliduar më tej agjendën e decentralizimit. Harmonizimi ligjor dhe administrativ është thelbësor për të siguruar zbatimin efikas dhe ofrimin cilësor të shërbimeve nga qeveritë vendore. Dialogu ndërinstitucional dhe ai qeveri qendrore-qeveri vendore është gjithashtu i rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me politikat, strategjitë dhe harmonizimin ligjor. Në këtë proces, përcaktimi i përparësive për një listë shërbimesh lokale për qytetarët është thelbësor, me fokus specifik te gratë, në të gjithë diversitetin e tyre, dhe te komunitetet e marzhinalizuara në shoqëri që vuajnë nga diskriminimi ndërsektorial dhe i shumëfishtë. Për më tepër, marrëveshjet ndërvendore janë një mjet për të nxitur bashkëpunimin ekonomik ndërvendor dhe duhet të rigjallërohen dhe të përdoren për të rritur cilësinë e shërbimeve për qytetarët. Për të ofruar shërbime në mënyrë uniforme, pavarësisht ndryshimeve në madhësinë e bashkisë, standardet e shërbimit duhet të vendosen dhe përditësohen nga NJVV-të përgjegjëse për menaxhimin dhe organizimin e ofrimit të shërbimeve publike. Nisma e qeverisë për të digjitalizuar shërbimet dhe për t'i ofruar ato në internet është një strategji vizionare dhe ndërsektoriale që rrit transparencën, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike, duke rezultuar në

uljen përfundimtare të kostove për qytetarët dhe bizneset.[26]

Deri më tani, BE-ja ka luajtur një rol vendimtar në mbështetjen e procesit të decentralizimit të Shqipërisë. Qasja e BE-së ishte në përputhje me prioritetet kombëtare dhe objektivat e saj, duke rritur kështu rëndësinë dhe përshtatshmërinë e mbështetjes së ofruar. Përpjekjet për të forcuar dialogun dhe koordinimin me BE-në kanë pasur ndikim të kufizuar, por përafrimi i mbështetjes me prioritetet kombëtare ka sjellë rezultate strategjike dhe **reciprokisht përforcuese**. Angazhimi proaktiv i BE-së me qeverinë dhe partnerët e zhvillimit ka siguruar koherencë dhe sinergji të brendshme dhe të jashtme, duke rezultuar në një mbështetje më gjithëpërfshirëse për përpjekjet e decentralizimit. Mbështetja e BE-së për qeverisjen vendore përfshinte ndërhyrje të synuara dhe projekte për rritjen e kapaciteteve, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar (CBC/BPN) me vendet fqinje. Megjithatë, këto përpjekje nuk ishin gjithmonë të efektshme ose të integruara me strukturat institucionale vendore ose planet e zhvillimit të bashkive, duke e bërë të vështirë të kuptohet kontributi i tyre i përgjithshëm dhe qëndrueshmëria.[27]

BE-ja ka ofruar ndihmë të jashtme për qeverisjen vendore përmes programeve të ndryshme, siç është "Programi i Veprimit për Qeverisje të Mirë 2014–2020" në kuadër të IPA II, i cili është Programi i Parë i Veprimit i dedikuar për Qeverisjen Vendore. Programe dhe Projekte të tjera kanë synuar qeverisjen vendore përmes objektivave specifikë dhe ndërhyrjeve të dedikuara, siç është Kontrata e Reformës Sektoriale (KRS) mbi RAP (2016–2020), e cila synonte të kontribuonte në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës publike të Shqipërisë, me fokus në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Mbështetje tjetër e BE-së është ofruar përmes Veprimeve IPA 2017 dhe IPA 2018, si dhe Programit IPA 2020, "Programit të Veprimit të BE-së për Qeverisje të Mirë". Ky i fundit reagon ndaj boshllëqeve dhe rekomandimeve të përcaktuara në SKNDQV PV për vitet 2018 dhe 2019, si dhe vlerësimit dhe rekomandimeve të BE-OBZHE MPQM për Shqipërinë. Ky program ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e një sektori publik më të aftë dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe të përmirësojë efikasitetin, llogaridhënien, transparencën, përfshirjen dhe efektivitetin e administratës publike në nivelet kombëtare dhe lokale.

Është vërejtur se mbështetja e Bashkimit Evropian për procesin e decentralizimit në Shqipëri ka qenë efektive, veçanërisht kur është përputhur me prioritetet kombëtare, ka angazhuar aktivisht qeverisjen vendore dhe ka siguruar një ndërveprim intensiv ndërmjet aktorëve përkatës. Megjithatë, fleksibiliteti mund të kufizojë qëndrueshmërinë, dhe nevojitet një mbështetje më e synuar për të adresuar sfidat në promovimin e integritetit, politikave të konsultimit dhe nevojave të popullatave të cenueshme. Ndihma e BE-së duhet të përmirësojë integrimin e çështjeve gjinore, të rrisë grantet e përqendruara në mbrojtjen e mjedisit dhe të integrojë më mirë OZHQ-të dhe parimin **"Të mos lëmë askënd pas"**.

Mësimet e nxjerra përfshijnë rëndësinë e ndërveprimit intensiv dhe praktik me qeverisjet lokale që mbështetja e BE-së të jetë efektive. Mbështetja e BE-së për trajnime, zhvillim kapacitetesh dhe dhënien e granteve për infrastrukturën socio-ekonomike ka pasur potencial transformues, pavarësisht sfidave të hasura. Kjo ka rezultuar në rritjen e përgjegjësisë mbi aktivitetet e lidhura me BE-në dhe në përmirësimin e besimit të drejtuesve të bashkive mbi rëndësinë e integrimit evropian në nivel lokal. Megjithatë, janë identifikuar disa fusha me mungesë rezultatesh transformuese dhe të qëndrueshme, si sfidat në promovimin e integritetit të qeverisjes vendore dhe politikat e konsultimit vendor. Qëndrueshmëria ka qenë gjithashtu problematike në disa fusha, veçanërisht në lidhje me rezultatet e ndërtimit të kapaciteteve, të cilat janë sfiduar nga qarkullimi i lartë i stafit, mungesa e kujtesës institucionale, ndryshimet e vazhdueshme të politikave dhe riprioritizimi i procedurave. Burimet e kufizuara dhe kuptimi i rolit të Njësive të Integrimit në Bashkimin Evropian (NJIBE) brenda bashkive paraqesin sfida. "Pavarësisht se roli i bashkive në proceset e

[26] QSH, drafti i SKNDQV-së 2023–2030, mars 2023.

[27] Komisioni Evropian, Vlerësimi i Ndërhyrjeve të Portofolit të Qeverisjes Vendore, Raporti Përfundimtar, shkurt 2023.

integrimit të BE-së është i njohur mirë në administratën lokale, ka nevojë për më shumë përpjekje për të inkurajuar procesin e integrimit të BE-së në proceset vendimmarrëse të bashkive". Mbështetje më e synuar dhe fuqizim i Njësive të Integrimit të Bashkimit Evropian (NJIBE), trajnim për administratën e gjerë të qeverisjes lokale dhe personelin e zgjedhur lokal për aderimin në BE, si dhe rritje të ndërgjegjësimit mbi vlerën e mundshme të shtuar dhe angazhimin e tyre janë të nevojshme për zhvillimin e qeverisjes lokale dhe vizionin për aderimin në BE. Po ashtu, aktivitetet për informimin dhe për ndërtimin e kapaciteteve mbi integrimin gjinor janë të nevojshme për administratën e qeverisjes vendore, veçanërisht për stafin e NJIBE-së, si dhe për stafin që merr vendime dhe për përfaqësuesit e zgjedhur vendorë; ata duhet të kuptojnë se rruga e tyre për aderimin në BE do të thotë gjithashtu përpjekje të intensifikuara dhe të dedikuara për trajtimin e pabarazive gjinore (pra, për t'u bërë të vetëdijshëm dhe për t'u përpjekur të zbatojnë *acquis*-në BE-së për Barazisë Gjinore).

Përpjekjet mbështetëse të BE-së nuk i përfshinë në mënyrë të vazhdueshme çështjet gjinore. I vetmi përjashtim këtu është "BE-ja për Barazinë Gjinore në Shqipëri: Zbatimi i *acquis*-së së BE-së për Barazinë Gjinore" (BEPBGJ), një Program i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara (PPKB) i zbatuar nga UN Woman (OKB për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave) dhe UNFPA/UNFPA dhe i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) përmes Fondit të Përshpejtimit OZHQ-ve të OKB-së në Shqipëri (2021–2023). Kjo ndërhyrje reflekton angazhimin e BE-së për barazinë gjinore si një parim që mbështet marrëdhëniet e jashtme të saj brenda kuadrit të aderimit të Shqipërisë në BE dhe me fokus në procesin e negociatave, megjithatë ajo mbulon vetëm një numër të vogël bashkish. Nga ana tjetër, shqetësimet mjedisore u përfshinë mirë në projektimin dhe zbatimin e projektit "BE-ja për bashkitë" (BEPB). Megjithatë, kishte një normë të ulët të granteve të fokusuara në mbrojtjen e mjedisit, pavarësisht se elementet mjedisore ishin përfshirë në të gjitha propozimet që lidhen me infrastrukturën. OZHQ-të dhe parimi "Të mos lëmë askënd pas" nuk u integruan në mënyrë të drejtpërdrejtë, megjithëse disa grante dhe ndërhyrje ndihmuan në promovimin e aksesit dhe mbrojtjes për grupet vulnerabël.

Ndërtimi i kapaciteteve të bashkive nuk i trajtoi drejtpërdrejt nevojat e grupeve vulnerabël, siç dëshmohet nga mungesa e kushteve për personat me aftësi të kufizuara në ambientet e *One Stop Shop (pikë që ofron një gamë të gjerë shërbimesh për qytetarët)* dhe mungesa e kërkesave për këto kushte në udhëzimet e BEPB-së. Situata është e ngjashme edhe në shërbimet e specializuara të mbështetjes nën përgjegjësinë e bashkive, ose që funksionojnë në nivel bashkie me qëllim ofrimin e mbështetjes për gratë dhe vajzat viktima/të mbijetuara të dhunës – ato ose nuk kanë mjediset e nevojshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, dhe/ose nuk kanë staf të trajnuar për të mbështetur rastet e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, probleme të shëndetit mendor etj.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AZZHB) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (ASBNZH) po punojnë për krijimin e një skeme grantesh të bazuara në performancë, të menaxhuar nga qeveria qendrore, dhe për përcaktimin e standardeve kombëtare për shërbimet publike lokale, veçanërisht në sektorët e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve vendore për fëmijët parashkollorë. Për të mbështetur këto përpjekje, ky dokument veprimi synon të kryejë një analizë hartëzimi dhe boshllëqesh për standardet në shërbimet që lidhen me QL-në dhe të zhvillojë standarde të përditësuara dhe të reja në koordinim me qeverinë qendrore, me fokus në shërbimet që nuk mbulohen nga këto agjenci. Duke mbështetur përcaktimin e standardeve dhe duke nxitur qeverisjen pjesëmarrëse të qytetarëve, ky dokument veprimi plotëson dhe ndërton mbi programet e mbështetura nga AZZHB-ja dhe ASBNZH-ja duke shtuar një fokus më të madh në pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen vendore. Ndërkohë që të dyja agjencitë fokusohem në krijimin e skemave të granteve të bazuara në performancë dhe përcaktimin e standardeve kombëtare për shërbimet publike vendore, veçanërisht në sektorët e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve vendore parashkollore, ky dokument veprimi thekson rëndësinë e përcaktimit të standardeve vendore dhe të zërit të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1 Logjika e ndërhyrjes

Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) i këtij Veprimi është përmirësimi i qeverisjes vendore dhe zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Objektivat (rezultatet) specifikë të këtij veprimi janë:

1. Përmirësimi i cilësisë, mbulimit dhe aksesit në infrastrukturën dhe shërbimet e qeverisjes vendore, në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe në favor të zhvillimit socio-ekonomik.

2. Forcimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore për të avancuar dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit të integrimit evropian përmes dialogut proaktiv të politikave midis dy niveleve të qeverisjes, së bashku me angazhimin aktiv pjesëmarrës të qytetarëve.

Produktet që do të ofrohen nga ky Veprim që kontribuojnë në objektivat (rezultatet) specifikë përkatës janë:

Produkti 1.1 (që kontribuuon në objektivin specifik 1). Fuqizimi i NJVV-ve për të planifikuar, hartuar, zbatuar dhe monitoruar veprime për përmirësimin e cilësisë, mbulimit ose aksesit në infrastrukturë dhe shërbim të qeverisjes vendore përmes integrimit të aspekteve mjedisore, sociale dhe gjinore dhe mundësive të zgjeruara socio-ekonomike për komunitetet lokale.

Produkti 2.1 (që kontribuuon në objektivin specifik 2). Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të NJVV-ve për të kontribuar dhe përfituar nga procesi i aderimit në BE, për të kryer në mënyrë efikase funksionet e tyre bazuar në vlerat dhe standardet e BE-së, për të forcuar dialogun ndërqeveritar mbi politikat, koordinimin dhe bashkëpunimin mbi vetëqeverisjet vendore dhe për t'u angazhuar në mënyrë efikase me palët e interesuara dhe komunitetet lokale në procesin e aderimit në BE.

Më konkretisht, NJVV-të janë njohur me kuadrin e politikës së kohezionit të BE-së, veçanërisht me Kodin Evropian të Sjelljes mbi Partneritetin, duke përfshirë objektivat specifikë të politikave dhe prioritetet e financimit, si dhe rëndësinë e angazhimit me palët e interesuara lokale për të garantuar që politikat dhe programet e BE-së të zbatuara të jenë përgjegjëse ndaj nevojave të komunitetit.

Për më tepër, njësitë e qeverisjes vendore janë të pajisura teknikisht për të rritur rolin e tyre koordinues në procesin e aderimittë Shqipërisë në BE. Për të përmirësuar më tej sistemin e menaxhimit të performancës së funksioneve të qeverisjes vendore bazuar në parimet e BE-së për demokracinë vendore dhe vetëqeverisjen, institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore janë gjithashtu të pajisura teknikisht, me fokus në burime të mjaftueshme financiare, subsidiaritet dhe qeverisje të orientuar drejt qytetarit. Për të siguruar plotësueshmëri dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve, ky aktivitet është në sinergji me donatorë të tjerë që punojnë në të njëjtën fushë.

3.2 Aktivitete indikative

Aktivitetet që lidhen me produkti 1.1 NJVV-të e fuqizuara për të planifikuar, hartuar, zbatuar dhe monitoruar veprime për përmirësimin e cilësisë, mbulimit ose aksesit në infrastrukturë dhe shërbim të qeverisjes vendore përmes integrimit të aspekteve mjedisore, sociale dhe gjinore dhe mundësive të zgjeruara socio-ekonomike për komunitetet lokale.

- A.1.1.1. Vlerësimi i nevojave të qeverive vendore dhe identifikimi i prioriteteve më urgjente të infrastrukturës dhe shërbimeve, sipas objektivave dhe planeve strategjike të zhvillimit komunal.

Ky aktivitet do të përfshijë kryerjen e një ankete me bashkitë mbi investimet e tyre kapitale, shqyrtimin e të dhënave të disponueshme nga partneri zbatues dhe angazhimin me NJVV-të, shoqata(t) e qeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe palët e interesuara kryesore lokale. Një fokus i veçantë duhet t'i kushtohet nevojës për integrimin e aspekteve mjedisore, sociale dhe gjinore.

- A.1.1.2 -Të zhvillohet dhe zbatohet një skemë grantesh për të mbështetur financiarisht bashkitë për të zhvilluar cilësinë dhe aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet publike bashkiake nëpërmjet investimeve kapitale.

- Aktiviteti do të përfshijë:

- a) përgatitjen e skemës së granteve, duke përfshirë zhvillimin e udhëzimeve të granteve për skemën e nëngranteve sipas nevojave dhe prioriteteve të bashkive dhe komuniteteve të tyre lokale, zhvillimin e rregullave, procedurave dhe modeleve të aplikimit për grante, rregullat dhe procedurat e vlerësimit; b) shtrirjen dhe komunikimin mbi skemën e granteve; c) shpalljen e thirrjeve për propozime; d) menaxhimin e procesit të përzgjedhjes së granteve; d) kontraktimin dhe shpërndarjen e skemës së granteve; e) monitorimin dhe vlerësimin e granteve të BE-së.

- Skema e granteve do të përfshijë një komponent kryesor të fokusuar në investimet kapitale (midis 70-80%) dhe një komponent më të

vogël të fokusuar në përmirësimin e kapaciteteve institucionale bashkiake dhe qeverisjen për ofrimin e shërbimeve në nivele lokale (20%-30%). Fushat prioritare të skemës së granteve do të jenë në përputhje me përgjegjësitë bashkiake në Shqipëri dhe nismat e tjera të BE-së në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. Barazia gjinore dhe përfshirja sociale do të integrohen në mënyrë të vazhdueshme.

- A.1.1.3 Të zhvillohen ndërgjegjësimi institucional dhe kapacitetet në nivelin e bashkive për planifikimin, ofrimin, monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve bashkiake.

- Aktiviteti do të përfshijë koordinimin e aktiviteteve të ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve në nivelin e sub-granteve (nga bashkitë vetë si pjesë e përpjekjeve të tyre për forcimin e kapaciteteve bashkiake për planifikimin, ofrimin, monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve) dhe në nivelin e veprimit. Mbështetja mund të përfshijë trajnime tematike, shkëmbim të njohurive dhe praktikave të mira rajonale, shkëmbim përvoje dhe praktike ndërmjet kolegëve, rrjetëzim të zyrtarëve bashkiak përmes komiteteve teknike të shoqatës(ave) të qeverisjes vendore për të garantuar qëndrueshmërinë e masave të ndërtimit të kapaciteteve, mbështetje për angazhimin e komunitetit në planifikimin dhe vlerësimin e shërbimeve dhe hartimin e planeve të veprimit për përmirësimin e shërbimeve.

Aktivitetet që lidhen me Produktet 2.1 Përmirësimi i kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të NJVV-ve për të kontribuar dhe përfituar nga procesi i aderimit në BE, për të kryer në mënyrë efikase funksionet e tyre bazuar në vlerat dhe standardet e BE-së, për të forcuar dialogun ndërqeveritar mbi politikat, koordinimin dhe bashkëpunimin mbi vetëqeverisjet lokale dhe për t'u angazhuar në mënyrë efikase me palët e interesuara dhe komunitetet lokale në procesin e aderimit në BE.

A.2.1.1 Forcimi i kapaciteteve institucionale në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore për të kontribuar në procesin e aderimit në BE

- A.2.1.1.1. Lehtësimi i punës së Strukturave Negociuese (specifikisht, Zyra e Kryenegociatorit me BE-në dhe Grupet e Punës) për të mbajtur zyrtarët e qeverisjes vendore të informuar rreth progresit të negociatave, për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin e tyre;

- A.2.1.1.2 Ofrimi i ndërtimit të kapaciteteve, këshillave ligjore, materialeve kërkimore dhe analizës së të dhënave për të mbështetur më mirë reagimet/kontributet cilësore dhe substanciale të qeverisjes vendore në procesin e negociatave;

- A.2.1.1.3 Ofrimi i mbështetjes për qeverinë qendrore për të rritur kapacitetet për të koordinuar, monitoruar dhe vlerësuar vazhdimisht efektivitetin e angazhimit të qeverisjes vendore në procesin e integrimit në BE, identifikimi i fushave për përmirësim dhe zhvillimi i politikave dhe programeve specifike për mbështetjen e qeverisjes vendore për përmbushjen e detyrimeve të integrimit në BE.

- A.2.1.1.4 Ofrimi i mbështetjes për të rritur kapacitetet e bashkëpunimit midis autoriteteve publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal dhe me partnerët socialë, OJQ-të dhe palët e tjera të interesuara përkatëse për të vënë në praktikë gradualisht parimet e partneritetit të BE-së, siç përcaktohen në Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin.

A.2.1.2 Forcimi i dialogut ndërqeveritar dhe rajonal të politikave mbi rolin e autoriteteve vendore në procesin e aderimit në BE

A.2.1.2.1 Lehtësimi i dialogut rajonal të politikave në nivel të lartë, rrjetëzimit dhe ndarjes së njohurive mbi rolin e autoriteteve lokale në procesin e pranimit në BE. Lehtësimi i shkëmbimeve të praktikave të mira dhe qasjeve inovative me Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet kandidate duke mobilizuar veçanërisht asistencen TAIEX/IATSHI (Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit).

A.2.1.2.2 Forcimi i dialogut ndërqeveritar mbi zhvillimin komunal **dhe aderimin në BE**, duke lehtësuar angazhimin aktiv të autoriteteve lokale në procesin e negociatave dhe siguruar që interesat lokale të mirëpërfaqësohen në negociatat e kapitujve/grupeve të ndryshme të negociatave.

A.2.1.3 Forcimi i kapaciteteve institucionale bashkiake dhe gatishmërisë për të përfituar nga procesi i aderimit në BE.

A.2.1.3.1 Zgjerimi i programit të ndërtimit të kapaciteteve për të rritur informacionin, njohuritë dhe kapacitetet e administratës lokale dhe zyrtarëve të zgjedhur mbi mundësitë e financimit nga BE-ja dhe forcimi i kapaciteteve të NJVV-ve për të thithur dhe menaxhuar ndihmën financiare të BE-së;

A.2.1.3.2 Lehtësimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet kolegëve, ndarjes së njohurive dhe rrjetëzimit ndërmjet vetë njësive të qeverisjes lokale, dhe ndërmjet njësive të qeverisjes lokale të Shqipërisë me shtete të tjera anëtare të BE-së dhe vende të Ballkanit Perëndimor, mbi mënyrën se si të përmirësohet aksesimi i financimeve nga BE-ja, veçanërisht në lidhje me fondet për zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

A.2.1.3.3 Ofrimi i mbështetjes për qeverinë qendrore dhe administratat e qeverisjes vendore për të rritur kapacitetin e tyre për monitorimin dhe raportimin mbi projektet e financuara nga BE-ja dhe donatorët e tjerë, sigurimi që informacioni raportohet rregullisht, është i disponueshëm, i hapur dhe transparent për publikun dhe grupet e tjera të interesit.

A.2.1.3.4 Ofrimi i mbështetjes për administratat e qeverisjes vendore për të rritur kapacitetin e tyre për transparencë, llogaridhënie dhe integritet, në veçanti për të hartuar, përditësuar dhe zbatuar planet e integritetit.

A.2.1.3.5 Ofrimi i mbështetjes për administratat e qeverisjes lokale dhe zhvillimi dhe implementimi i mekanizmave që sigurojnë që politikat dhe nismat lokale të realizohen përmes një procesi të hapur konsultimi, pjesëmarrjeje dhe dialogu me partnerët dhe komunitetet.

A.2.1.4 Forcimi i kapaciteteve bashkiake për t'u angazhuar me palët e interesuara lokale dhe komunitetet në procesin e aderimit në BE dhe përfitimet e tij.

A.2.1.4.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie komunikimi për të informuar dhe rritur në mënyrë efektive ndërgjegjësimin mbi rolin e bashkive në vlerat e BE-së dhe procesin e aderimit, mbi objektivat, përparimin dhe rezultatet e negociatave, për palët e interesuara lokale dhe komunitetin më të gjerë.

A.2.1.4.2 Ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për zyrtarët e qeverisjes vendore për t'i ndihmuar ata të komunikojnë në mënyrë efektive informacionin në lidhje me mbështetjen financiare të BE-së me zgjedhësit e tyre, përmirësimi i aftësive të komunikimit, ofrimi i aksesit në mjetet e komunikimit dhe mbështetje në organizimin e eventeve të informimit brenda komunitetit të tyre.

3.3 Integrimi

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti

Në përputhje me politikën mjedisore të BE-së, ky Veprim do të kontribuojë në agjendën mjedisore të vendit duke promovuar politikat dhe praktikat mjedisore, duke mundësuar planifikimin dhe zbatimin e masave të infrastrukturës dhe shërbimeve publike që i japin përparësi mbrojtjes së mjedisit. Për më tepër, masat inkurajojnë miratimin e politikave miqësore me mjedisin nga bashkitë dhe zbatimin e masave që marrin në konsideratë qasje miqësore me mjedisin. Përveç kësaj, objektivat specifikë të këtij Veprimi do të mbështesin bashkitë në promovimin e përfitimeve ekonomike të kalimit në një ekonomi miqësore me mjedisin dhe me karbon të ulët.

Për më tepër, ky aktivitet promovon llogaridhënien dhe transparencën mjedisore duke angazhuar qytetarët në procesin e vendimmarrjes; duke lehtësuar konsultime publike ose duke krijuar platforma për qytetarët për të ofruar mendime mbi shërbimet publike, përfshirë politikat dhe nismat mjedisore; duke përfshirë qytetarët në këtë proces, aktiviteti mund të sigurojë që shqetësimet mjedisore të merren parasysh dhe që qeverisjet lokale të japin llogari për veprimet e tyre.

Ky veprim do të mbështesë forcimin e kapacitetit administrativ të bashkive, i cili do të mbështesë zbatimin e të gjitha angazhimeve ndërkombëtare dhe kombëtare, duke përfshirë ato që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin. Ky veprim adreson sfidat mjedisore përmes investimeve dhe përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë një integrim më të mirë të agjendës së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike në politikat lokale.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

Sipas kodeve të OECD-së/OBZHE-së për DAC-në gjinore të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si G1.

Ky Veprim do të kontribuojë në objektivin 4 të strategjisë së BE-së për barazinë gjinore 2020–2025: Integrimi gjinor dhe një perspektivë ndërsektoriale në politikat e BE-së, duke i vendosur mundësitë e barabarta midis grave dhe burrave si një pjesë integrale të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të saj.

Kjo nënkupton që veprimi do të nxisë barazinë gjinore dhe do të sigurojë mundësi të barabarta duke fuqizuar NJVV-të për të planifikuar dhe zbatuar veprime për përmirësimin e cilësisë, mbulimit ose aksesit në infrastrukturën dhe shërbimin e qeverisjes vendore që i përgjigjet çështjeve gjinore, duke përfshirë aspektet gjinore. Përveç kësaj, ky Veprim është në përputhje dhe me shtyllën 5 të Planit të

Veprimit Gjinor III të BE-së (GAP III)[28]: "Raportimi dhe komunikimi mbi rezultatet, duke vënë në vend një sistem monitorimi sasior, cilësor dhe gjithëpërfshirës për të rritur llogaridhënien publike, për të garantuar transparencën dhe aksesin në informacion, dhe për të arritur një shtrirje më të mirë të BE-së mbi ndikimin e punës së saj në mbarë botën", të përshtatura sipas kontekstit të vendit dhe të përshtatura posaçërisht për nivelin e qeverisjes vendore.

Ky Veprim do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e zbatimit të ligjit nr. 68/2017, "Për financimin e vetëqeverisjes vendore", veçanërisht duke përdorur buxhetin e përgjegjshëm gjinor si një mjet për integrimin gjinor në të gjitha politikat, planet dhe shërbimet në nivel vendor.

Të drejtat e njeriut

Ky Veprim merr në konsideratë angazhimin e vendit për të zhvilluar më tej agjendën e të drejtave të njeriut në praktikë. Ai do ta mbështesë Shqipërinë në zbatimin e së drejtës së qytetarëve të saj për të pasur një administratë publike efikase dhe të përgjegjshme që u ofron shërbime të gjithë qytetarëve dhe ndërmarrjeve. Mbrojtja e të drejtave të njeriut do të integrohet posaçërisht në aktivitetet që mbështesin hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në bashki, si dhe në aktivitetet e BE-së në bashki që mbrojnë vlerat dhe standardet e BE-së.

Aftësia e kufizuar

Sipas kodeve të OECD-së/OBZHE-së për DAC-në e aftësisë së kufizuar, të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si D1.

Ky veprim do të ndihmojë në mbështetjen e angazhimeve të vendit ndaj të drejtave të njeriut, me fokus në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Duke përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e administratës publike, ky veprim pritet të ndikojë pozitivisht në mënyrën se si funksionon shteti dhe adreson shqetësimet e qytetarëve të tij, përfshirë grupet vulnerabël. Parimet e "Të mos lëmë askënd pas" dhe qasjet e bazuara në të drejta do të integrohen në mënyrë të qartë në zbatimin e çdo aktiviteti të parashikuar. Përveç kësaj, objektivi specifik 1 do të prioritizojë aksesin për të gjithë si një element kritik në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Objektivi specifik 3 do të mbështesë më tej forcimin e kapacitetit administrativ të bashkive duke ndërtuar kapacitetin e tyre dhe duke integruar më mirë parimet e "Të mos lëmë askënd pas" dhe politikat dhe shërbimet publike të bazuara në të drejta.

Demokracia

Mbështetja e investimeve në infrastrukturë dhe vendosja e standardeve të shërbimit kontribuojnë në demokracinë vendore duke garantuar që qytetarët të kenë qasje në shërbime dhe burime bazë, të tilla si uji i pastër, kanalizimet dhe transporti. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët dhe të nxisë një angazhim dhe pjesëmarrje më të gjerë qytetare. Përveç kësaj, duke vendosur standarde të qarta shërbimi, qeveritë lokale mund të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, të cilat mund të ndihmojnë në ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe zyrtarëve të tyre të zgjedhur duke krijuar një sistem qeverisjeje më të përgjegjshëm dhe të barabartë.

Ulja e rrezikut të fatkeqësive

Ky veprim mund të mbështesë forcimin e kapacitetit administrativ të bashkive, në planifikimin e politikave vendore që adresojnë sfidat e uljes së rrezikut nga fatkeqësitë përmes investimeve dhe përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë planifikimin dhe financimin e uljes së rrezikut bazuar në standardet kombëtare dhe vendore përmes angazhimit aktiv të qytetarëve pjesëmarrës.

[28] Shihni: https://international-partnerships.ec.europa.eu/system/files/2021-01/join–2020-17-final_en.pdf

3.4 Rreziqet dhe supozimet

Kategoria	Rreziqet	Probabilitet (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Masat zbutëse
Rreziqet që lidhen me mjedisin e jashtëm	Mungesa e bashkëpunimit midis qeverisë dhe NJVV-ve mund të pengojë zbatimin e nismave të qeverisjes vendore dhe zhvillimit ekonomik.	**Mesatar**	**I lartë**	Mbajtja e kanaleve të qarta dhe të strukturuara të komunikimit, dhe sigurimi i shpërndarjes së barabartë të burimeve
Rreziqet që lidhen me planifikimin, proceset dhe sistemet	Varësia nga financimi i jashtëm mund të jetë e paqëndrueshme dhe të krijojë rreziqe për qëndrueshmërinë afatgjatë.	**Mesatar**	**Mesatar**	Vendosja e mekanizmave për mobilizimin e burimeve vendase dhe ndërtimin e kapaciteteve, si dhe mbështetje teknike
Rreziqet që lidhen me njerëzit dhe organizatën	Zbatimi, mirëmbajtja ose monitorimi i dobët dhe pa marrë parasysh gjininë, mund të çojë në rezultate të paplota ose jo optimale të infrastrukturës dhe shërbimeve.	**Mesatar**	**Mesatar**	Vendosja e planeve të qarta të zbatimit dhe treguesve të performancës dhe gjinisë, sigurimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe ndërtimi i kapaciteteve të NJVV-ve.
Rreziqet që lidhen me planifikimin, proceset dhe sistemet	Mbështetja e pamjaftueshme financiare mund të çojë në zbatim të paplotë ose të pamjaftueshëm të nismave të integrimit në BE dhe të pengojë dialogun politik midis qeverisë vendore dhe qendrore.	**I ulët**	**Mesatar**	Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të financimit, programeve të ndërtimit të kapaciteteve dhe promovimi i dialogut politik me një këndvështrim gjinor.
Rreziqet që lidhen me aspektet e ligjshmërisë dhe rregullsisë	Mungesa e përputhshmërisë me bazën ligjore mund të pengojë efektivitetin e sistemit të menaxhimit të performancës dhe të dëmtojë përgjegjshmërinë dhe transparencën.	**I ulët**	**I lartë**	Garantimi i përputhshmërisë me bazën ligjore, përcaktimi i treguesve të qartë të performancës (dhe gjinisë) dhe zbatimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe vlerësimit.
Rreziqet që lidhen me komunikimin dhe informacionin	Incetivat/stimujt mund të mos jenë në përputhje me nevojat e qytetarëve ose mund të jenë subjekt i manipulimit ose paragjykimeve.	**Mesatar**	**I lartë**	Vendosja e kritereve të qarta, sensitive ndaj gjinisë dhe objektive për skemat e dhënies së fondeve, garantimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe krijimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe vlerësimit.
Rreziqet që lidhen me komunikimin dhe informacionin	Nismat e donatorëve që nuk kanë koherencë dhe janë të fragmentuara mund të mos i adresojnë në mënyrë efektive shkaktarët themelorë të problemeve.	**I ulët**	**Mesatar**	Zhvillimi i një vizioni të përbashkët midis donatorëve dhe Qeverisë së Shqipërisë, nxitja e koordinimit dhe komunikimit, sigurimi i vazhdimësisë dhe monitorimi e vlerësimi i nismave të tjera të projektit.

Supozime të jashtme

Ky Veprim mund të zbatohet duke ndjekur zinxhirin e tij të planifikuar të rezultateve bazuar në supozimet e mëposhtme:

Në nivelin e produktit, supozohet se nëse Qeveria e Shqipërisë përshtat sistemin e menaxhimit të performancës (sensitiv ndaj gjinisë) të funksioneve të qeverisjes vendore me bazën ligjore mbi financat e vetëqeverisjes vendore, planifikimin e buxhetit vendor dhe/ose legjislacionin tjetër sipas nevojës, atëherë mund të forcohet përgjegjshmëria/llogaridhënia dhe transparenca e qeverisë vendore dhe qendrore. Gjithashtu, nëse NJVV-të stimulohen me skema konkurruese dhënie grantesh të bazuara në nivelin e përmbushjes së kërkesave të qytetarëve, atëherë mund të forcohet përgjegjshmëria/llogaridhënia dhe transparenca e qeverisë vendore dhe qendrore.

Gjithashtu, nëse Qeveria e Shqipërisë siguron burimet e duhura financiare për NJVV-të për të përmbushur përgjegjësitë ligjore të mbështetjes për integrim në BE (EUIs) pas përfundimit të mbështetjes financiare të BE-së, atëherë mund të forcohet dialogu politik midis qeverisë vendore dhe qendrore në lidhje me procesin e integrimit të Shqipërisë në BE.

Ky Veprim supozon që qeverisja qendrore, në marrëveshje me qeverisjet vendore, do të vazhdojë të ofrojë bashkëfinancim, i cili do të jetë i zbatueshëm vetëm në skemën e nëngranteve.

Supozimi i fundit është se nëse NJVV-të garantojnë cilësinë e zbatimit të veprimeve, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe monitorimin e shërbimeve që janë objekt i Veprimit, duke përfshirë edhe një këndvështrim gjinor, atëherë cilësia, mbulimi ose aksesimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të qeverisjes vendore mund të përmirësohet dhe të bëhet më e përgjegjshme ndaj aspektit gjinor.

Në nivelin e objektivave specifikë (rezultati), supozohet se nëse Qeveria e Shqipërisë dhe NJVV-të rrisin bashkëpunimin politik, atëherë qeverisja vendore dhe zhvillimi ekonomik vendor mund të përmirësohen, si dhe nëse Reforma e Qeverisjes së Mirë (RAP-i dhe të tjera) vazhdon të mbështetet financiarisht dhe teknikisht, atëherë qeverisja vendore dhe zhvillimi ekonomik vendor mund të përmirësohen.

Në përgjithësi, një numër kushtesh të jashtme që nuk lidhen posaçërisht me procesin efektiv të zinxhirit të rezultateve të Veprimit, por që ndikojnë përgjithësisht në sektorin dhe në zhvillimin e qeverisjes vendore, duhet të merren në konsideratë në perspektivën më të gjerë të RAP-it në Shqipëri.

Mungesa e bashkëpunimit midis partive politike dhe institucioneve qeveritare mund të çojë në mungesë të vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë në politikat dhe proceset e vendimmarrjes në nivel vendor, çka mund të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe qeverisjen vendore. Luhatjet në disponueshmërinë dhe shpërndarjen e fondeve mund të krijojnë pasiguri për qeverisjet vendore, duke e bërë të vështirë për to planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe politikave afatgjata dhe të qëndrueshme që i përgjigjen çështjeve gjinore. Kjo mund të jetë veçanërisht sfiduese përsa i përket Shqipërisë, ku financimi nga organizatat ndërkombëtare dhe donatorët vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e bashkive.

Kufizimet ligjore dhe rregullatore që kufizojnë fushëveprimin e QKZHQQV/NCSDL-së mund të pengojnë gjithashtu përparimin në qeverisjen vendore dhe zhvillimin ekonomik. Për më tepër, korrupsioni dhe dobësia e sundimit të ligjit mund të dëmtojnë efektivitetin e reformave dhe politikave.

Faktorët socialë dhe kulturorë mund të luajnë gjithashtu rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimit të qytetarëve ndaj qeverisjes vendore dhe zhvillimit ekonomik. Kanale mediatike të politizuara dhe joprofesionale mund të çojnë në mosbesim dhe skepticizëm ndaj institucioneve të qeverisjes vendore, duke penguar aftësinë e tyre për të nxitur rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse. Përveç kësaj, mund të ekzistojnë norma dhe besime kulturore që kufizojnë rolin e grave dhe grupeve të tjera të marzhinalizuara në qeverisje dhe zhvillim ekonomik.

Reformat e digjitalizimit kërkojnë përshtatje dhe inovacion nga qeverisjet vendore, të cilat mund të mos jenë të afta të mobilizojnë burimet ose ekspertizën e nevojshme për t'u përshtatur me ndryshime të tilla. Gjithashtu, faktorët mjedisorë si katastrofat natyrore dhe ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në investimet në infrastrukturë, duke krijuar më shumë sfida për disa bashki.

3.5 Matrica e kuadrit logjik tregues

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve:	Treguesit	Standardet referuese	Objektivat	Burimet e të dhënave	Supozime
Ndikimi	Përmirësoi cilësinë, mbulimin dhe aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet e qeverisjes vendore, në përgjigje të nevojave të qytetarëve dhe në funksion të zhvillimit	1 Gjendja aktuale e qeverisjes vendore në Shqipëri. Rritje prej 2% e të ardhurave të veta të qeverisjes vendore, mesatarisht në të gjitha NJVV-të	1 Mesatarisht i përgatitur, 2022 2 15%, 2023	1. Një nivel i mirë përgatitjeje, 2035 2. 30%, 2035	1 Komisioni Evropian, Raporti i Shqipërisë 2035 2 Ministria e Financave, Raporti i buxhetit afatmesëm të bashkive 2035	*Nuk zbatohet*
Rezultati 1	Përmirësoi cilësinë, mbulimin dhe aksesin në infrastrukturën dhe shërbimet e qeverisjes vendore, në përgjigje të nevojave të qytetarëve dhe në funksion të zhvillimit socio-ekonomik.	1.1% e qytetarëve e perceptojnë ofrimin e shërbimit të përgjithshëm publik në nivel 'mjaft të mirë'.	1.1 38%, **Dimër** 2021–2022	1.1 55%, 2030	1.1 Eurobarometër, Dimër 2030–2031	Qeveria e Shqipërisë dhe NJVV-ve rrisin bashkëpunimin politik. Reforma e Mirëqeverisjes (RAP dhe të tjera) vazhdon të mbështetet financiarisht dhe teknikisht.
Rezultati 2	Forcoi kapacitetet e qeverisjes vendore për të përparuar dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit të integrimit evropian përmes një dialogu proaktiv të politikave ndërmjet dy niveleve të qeverisjes, së bashku me një angazhim aktiv dhe pjesëmarrës të qytetarëve.	. 2.1 % e masave të zbatuara të Planit të Veprimit të SKNDQV 2023–2030, OS 5[29] 2.2 Numri i planeve të integritetit të miratuara dhe të zbatuara në nivel bashkie.	**2.1 0%, 2023** **2.2 16 të miratuara dhe shkalla e zbatimit 59%, 2022**	**2.2 100%, 2030** **2.3 Të gjitha dhe të paktën 50%, 2030**	2.1 Shoqata për Autonomi Vendore, Raporti i Studimit të Performancës së Shërbimeve Publike Vendore, 2030 2.2, 2.3 Raportet e monitorimit/Raportet e Rishikimit Afatmesëm të SNDQV 2023–2030	
Produkti 1 lidhur me rezultatin 1	Fuqizoi NJVV-të që të planifikojnë, hartojnë, zbatojnë dhe monitorojnë veprimet për përmirësimin e cilësisë, mbulimit apo aksesit në infrastrukturën dhe shërbimet e qeverisjes vendore, përmes integrimit të aspekteve mjedisore, sociale dhe gjinore, si dhe rritjes së mundësive socio-ekonomike për komunitetet vendore.	1.1.1 Numri i granteve të dhëna për NJVV-të 1.1.2 Përqindja mesatare e shpërndarjes së granteve 1.1.3 Numri total i veprimeve të propozuara nga NJVV-të çdo thirrjeje	1.1.1 18, 2028 1.1.2 85%, 2023 1.1.3 37, 2023	1.1.1 30, 2028 1.1.2 95%, 2028 1.1.3 45, 2028	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Raporti/Dokumenti i Menaxhimit të Programit IPA III	NJVV-të sigurojnë cilësinë e zbatimit të veprimeve, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe monitorimin e shërbimeve që janë objekt i veprimit.
Produkti 1 lidhur me rezultatin 2	Përmirësoi kapacitetet dhe ndërgjegjësimin NJVV-ve për të kontribuar dhe përfituar nga procesi i aderimit në BE, për të kryer në mënyrë efikase funksionet e tyre bazuar në vlerat dhe standardet e BE-së, për të forcuar dialogun, koordinimin dhe bashkëpunimin ndërqeveritar mbi vetëqeverisjen vendore, si dhe për të angazhuar në mënyrë efikase aktorët lokalë dhe komunitetet në procesin e aderimit në BE.	1.2.1 Numri i përgjegjësive të zbatuara nga Njësitë e Integrimit Evropian mesatarisht, në të gjitha bashkitë 1.2.2 Numri mesatar i qytetarëve në të gjitha bashkitë të informuar për vlerat e BE-së dhe procesin, politikat dhe programet e integrimit në BE 1.2.3 Numri i komunave të cilave u janë dhënë grante nga programe të ndryshme kombëtare, transnacionale dhe programe të tjera të financuara nga BE-ja	1.2.1 4, 2023 1.2.2 4200, 2023 1.2.3 100, 2023	1.2.1 9, 2028 1.2.2 9000, 2028 1.2.3 200, 2028	1.2.1 KE, Vlerësimi i Ndërhyrjeve të Portofolit të Qeverisjes Vendore 1.2.2 Bashkitë në Procesin e Integrimit të Shqipërisë në BE, Raporti i Vlerësimit 2028 1.3.1 Raport mbi projektet e financuara nga donatorët, të zbatuara nga qeveritë vendore.	Qeveria e Shqipërisë e përafron sistemin e menaxhimit të performancës së funksioneve të qeverisjes vendore me bazën ligjore mbi financat e vetëqeverisjes vendore, planifikimin e buxhetit vendor dhe/ose legjislacionin tjetër, sipas nevojës. NJVV-të inkurajohen me skema konkurruese grantesh bazuar në nivelin e përmbushjes së kërkesave të qytetarëve.

[29] Nën përgjegjësinë dhe/ose kontributin e NJVV-ve.

4. MARRËVESHJET E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e Financimit

Për të zbatuar këtë Veprim, parashikohet të lidhet një Marrëveshje Financiare me Republikën e Shqipërisë.

4.1 Periudha e parashikuar e zbatimit

Periudha e parashikuar për zbatimin operacional të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 72 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të miratohen nga zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit, duke ndryshuar këtë vendim financimi, kontratat, si dhe marrëveshjet përkatëse.

4.2 Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të sigurojë që rregullat dhe procedurat e përshtatshme të BE-së për ofrimin e financimit për palët e treta të respektohen, duke përfshirë procedurat e rishikimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së.

4.2.1 Menaxhimi indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave

Ky veprim mund të zbatohet në menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave, i cili do të zgjidhet nga shërbimet e Komisionit, duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- subjekti/enti ka dokumentuar përvojë specifike në mbështetjen e qeverive vendore për t'u angazhuar aktivisht në procesin e integrimit në BE;
- subjekti/enti ka dokumentuar kapacitet operativ dhe logjistik, si dhe ekspertizë teknike në qeverisjen vendore të lidhur me BE-në, decentralizimin, zhvillimin socio-ekonomik vendor, menaxhimin e skemave të granteve dhe ndërtimin e kapaciteteve në kontekstin e anëtarësimit në BE;
- entiteti ka kapacitetin për të siguruar bashkëfinancim të mundshëm për veprimin.

Subjekti/enti i besuar mund të zgjidhet si një organizatë e Shtetit Anëtar, agjenci e vendit të tretë donator, agjenci e specializuar e BE-së ose organizatë ndërkombëtare.

4.2.2 Ndryshimet nga mënyra e menaxhimit indirekt në atë të drejtpërdrejtë (dhe anasjellas) për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme

Nëse modaliteti i zbatimit sipas menaxhimit indirekt, siç përcaktohet në seksionin 4.3.1, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave përtej kontrollit të Komisionit, do të përdoret modaliteti i zbatimit me anë të menaxhimit direkt (grant dhe prokurim). Në mënyrë specifike, do të përdoret menaxhimi direkt me anë të prokurimit për të arritur rezultatin 2.

Për të arritur rezultatin 1, në rast të një skenari rezervë, do të përdoret menaxhimi direkt përmes një kontrate granti.

a) Qëllimi i grantit(eve)

Grantet do të kontribuojnë në arritjen e rezultatit 1.

b) Lloji i aplikantëve të synuar

Aplikantët potencialë do të përzgjidhen sipas kritereve të mëposhtme: persona juridikë; organizata jofitimprurëse; organizatë joqeveritare dhe/ose një shoqatë kompetente e autoriteteve nënkombëtare (rajonale ose lokale), organ publik ose organ përkatës i mandatuar i një Departamenti Qeveritar të një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian.

4.3 Fushëveprimi i përshtatshmërisë gjeografike për prokurim dhe grante

Përshtatshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve dhe për sa i përket origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin themelor dhe parashikohet në dokumentet kontraktuale përkatëse, do të zbatohet në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund ta zgjerojë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores së (NDICI/Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar/IFZHBN-së) – Global Europe).

4.4 Buxheti i parashikuar

Komponentët e buxhetit të parashikuar	Kontributi i BE-së	Komponentët e buxhetit të parashikuar
Metodat e zbatimit - shihni seksionin 4.3.1		**Nuk aplikohet**
Rezultati 1. Cilësi, mbulim ose akses më i mirë në infrastrukturë dhe shërbim të qeverisjes vendore dhe **Rezultati** 2. Përgjegjshmëria dhe transparenca e qeverisë qendrore dhe vendore u forcua nëpërmjet dialogut proaktiv mbi politikat midis dy niveleve të qeverisjes, së bashku me angazhimin aktiv pjesëmarrës të qytetarëve, për të rritur llogaridhënien dhe transparencën në përputhje me procesin e aderimit të Shqipërisë në BE.	**10 000 000**	**Nuk aplikohet**
Menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave – shihni seksionin 4.3.1	10 000 000	**Nuk aplikohet**
Menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave	**10 000 000**	**Nuk aplikohet**
Vlerësimi – shihni seksionin 5.2 Auditimi – shihni seksionin 5.3	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	**Nuk aplikohet**
Komunikimi Strategjik dhe Diplomacia Publike – shihni seksionin 6	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	**Nuk aplikohet**
Totali	**10 000 000**	

4.6 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Ministria përgjegjëse për agjendën e decentralizimit dhe koordinimin me qeveritë vendore është subjekti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij Veprimi. Ministria përgjegjëse për Qeverisjen Vendore është përfituesja kryesore e Veprimit. Për sa u përket aspekteve menaxheriale, subjekti/enti i vlerësuar sipas shtyllave, si subjekti/enti i vlerësuar/i besuar, do të ngarkohet me monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Veprimit. Kjo strukturë synon të lehtësojë zbatimin e Veprimit, të optimizojë proceset e vendimmarrjes dhe të sigurojë monitorimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zgjidhjes.

Si pjesë e prerogativës/së drejtës së tij për zbatimin e buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit, Komisioni mund të marrë pjesë në strukturat drejtuese të lartpërmendura të krijuara për të qeverisur zbatimin e Veprimit.

Mund të organizohet një komitet drejtues për të udhëhequr dhe mbikëqyrur zbatimin e këtij Veprimi. Shoqatat e qeverisjes vendore do të luajnë një rol konsultativ dhe do të shërbejnë si përfaqësuese të qeverive vendore në Veprim. Përveç kësaj, akademia dhe organizatat e shoqërisë civile do të ftohen në komitetin drejtues, duke njohur rëndësinë e tyre si palë të interesuara kryesore në nivel lokal.

4.7 Parakushtet

Nuk kërkohen parakushte për zbatimin e këtij Veprimi.

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues do të krijojë një sistem të përhershëm të monitorimit të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin, dhe të hartojë raporte të rregullta progresi (jo më rrallë se një herë në vit) dhe raporte përfundimtare. Çdo raport duhet të ofrojë një përshkrim të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësive të hasura, ndryshimeve të prezantuara, si dhe shkallës së arritjes së produkteve të tij dhe kontributit në arritjen e rezultateve të tij, dhe nëse është e mundur, në momentin e raportimit, edhe kontributin në arritjen e ndikimeve, të matur përmes treguesve përkatës, duke marrë si pikë referimi matricën e kuadrit logjik.

Komisioni mund të kryejë vizita shtesë monitorimi të projektit, si nëpërmjet stafit të vet, ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve të pavarur të rekrutuar drejtpërdrejt nga Komisioni për rishikime të pavarura monitorimi (ose të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për kryerjen e këtyre rishikimeve).

Marrëveshjet për monitorimin dhe raportimin, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizën dhe monitorimin e të dhënave:

Për treguesit e ndikimit, burimet e verifikimit janë caktuar për vitin 2035 dhe të dhënat do të gjenden në Raportin e KE-së për Shqipërinë dhe në raportin e buxhetit afatmesëm të bashkive të lëshuar nga Ministria e Financave.

Për treguesit e rezultatit, burimet e verifikimit janë vendosur në vitin 2030 dhe të dhënat do të prodhohen nga:

- për rezultatin 1: Eurobarometër, dimër 2030–2031 dhe konkretisht në barometrin e Ballkanit, Raporti Analitik i Opinionit Publik, 2030–2031;

- për rezultatin 2: Raporti i Studimit të Performancës së Shërbimeve Publike Vendore, 2030, i lëshuar nga Shoqata për Autonomi Vendore, si dhe nga burime të tjera institucionale si AMVV Agjencia për Shoqërinë dhe Qeverisjen Vendore.

Për treguesit e produktit, burimet e verifikimit janë vendosur në vitin 2028 dhe janë përkatësisht:

- Produkt 1.1: të dhënat e mbledhura nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri në Raportin/Dokumentin e Menaxhimit të Programit IPA III;

- Produkti 1.2: të dhënat e nxjerra nga Vlerësimi i Ndërhyrjeve të Portofolit të Qeverisjes Vendore të lëshuara nga Komisioni Evropian dhe Raporti i Vlerësimit për Bashkitë në Procesin e Integrimit të Shqipërisë në BE, si dhe të dhënat e mbledhura nga Ministria e Financave në Raportin e saj Kombëtar mbi Performancën, si dhe në monitorimet e ndryshme të kryera në nivel bashkiak.

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë dhe numrin e institucioneve të përfshira në zbatimin e këtij Veprimi, si dhe mbulimin e tij territorial, kostoja e mbledhjes së të dhënave mund të kërkojë ndonjë marrëveshje specifike monitorimi për t'u vendosur; megjithatë, shumica e burimeve janë institucionale dhe lehtësisht të gjurmueshme. Si rrjedhojë, nuk duhet të parashikohet ndonjë kosto e konsiderueshme për të monitoruar zbatimin e Veprimit.

5.2 Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e veprimit, do të kryhet një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim përfundimtar për këtë veprim dhe komponentët e tij nëpërmjet konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni.

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet për qëllime mësimore, në veçanti në lidhje me vlerësimin e masës në të cilën Veprimi kontribuon realisht në procesin në vazhdim dhe me qëllim hartimin e ndërhyrjeve pasuese.

Vlerësimi përfundimtar do të kryhet për qëllime llogaridhënieje dhe mësimi në nivele të ndryshme (përfshirë rishikimin e politikave), duke marrë parasysh në veçanti faktin se Veprimi është i integruar në procesin e përgjithshëm të zbatimit të SKNDQV-së dhe reformave të tij përkatëse në nivel lokal.

Komisioni do të formojë një grup reference (GR) të përbërë nga përfaqësues të aktorëve kryesorë në nivelet e BE-së dhe ato kombëtare (përfaqësues të qeverisë, organizatave të shoqërisë civile (sektori privat, OJQ-të etj.), etj.). Nëse çmohet e nevojshme, do të ftohen të bashkohen edhe donatorë të tjerë.

Komisioni do të informojë partnerin zbatues të paktën tre muaj para datave të parashikuara ushtrimin e vlerësimit dhe misionet. Partneri zbatues duhet të bashkëpunojë në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët e vlerësimit dhe, ndër të tjera, t'u ofrojë atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe qasje në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit do të ndahen me vendin partner dhe aktorët e tjerë kyç, duke ndjekur praktikat më të mira të shpërndarjes së vlerësimeve. Partneri zbatues dhe Komisioni do të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e nevojshme, në marrëveshje me vendin partner, do të vendosin bashkërisht për veprimet që do të ndërmerren më tej dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse tregohet, riorientimin e projektit.

Shërbimet e vlerësimit mund të kontraktohen në kuadër të një kontrate kuadër.

5.3 Auditimi dhe verifikimet

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij veprimi, Komisioni, mbi bazën e një vlerësimi të riskut, mund të kontraktojë auditim ose verifikim të pavarur për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual për të informuar audiencat përkatëse për

mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre, duke shfaqur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër mbi financimin, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me veprimet përkatëse. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022 "Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme" (ose në çdo dokument pasues që e zëvendëson atë).

Ky detyrim do të zbatohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse veprimet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve ose subjektet e besuara ose të deleguara, siç janë agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e Shteteve Anëtare të BE-së. Në çdo rast, një referencë ndaj detyrimeve përkatëse kontraktuale duhet të përfshihet në marrëveshjen përkatëse të financimit, në kontratat e prokurimit dhe të granteve, si dhe në marrëveshjet e kontributit.

Për qëllim të rritjes së vizibilitetit të BE-së dhe kontributit të saj në këtë veprim, Komisioni mund të nënshkruajë ose të ketë deklarata ose qëndrime të përbashkëta, si pjesë e së drejtës së tij për zbatimin e buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit. Masat e vizibilitetit dhe komunikimit duhet gjithashtu të nxisin transparencën dhe llogaridhënien mbi përdorimin e fondeve. Duhet të matet efektiviteti i aktiviteteve të komunikimit në ndërgjegjësimin rreth veprimit dhe objektivave të tij, si dhe në financimin e veprimit nga BE-ja.

Partnerët zbatues duhet ta mbajnë Komisionin dhe Delegacionin e BE-së/Zyrën e BE-së plotësisht të informuar për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit para se të zbatohen. Partnerët zbatues do të sigurojnë vizibilitet të mjaftueshëm të financimit të BE-së dhe do të raportojnë mbi veprimet e vizibilitetit dhe komunikimit, si dhe rezultatet e veprimit të përgjithshëm në komitetet përkatëse të monitorimit.

7. QËNDRUESHMËRIA

Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të kësaj ndërhyrjeje, do të zhvillohen dialogë të zgjeruar mbi politikat midis BE-së dhe palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë autoritetet publike qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile. Kjo përpjekje do të mbështetet në supozimin e angazhimit të vazhdueshëm politik për zbatimin e reformave të mirëqeverisjes dhe agjendës së anëtarësimit në BE, si dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve menaxheriale dhe teknike si në nivelin qendror edhe në atë vendor të administratës.

Do të ofrohet gjithashtu asistenca plotësuese për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme brenda institucioneve kryesore që drejtojnë procesin e decentralizimit, duke rritur qëndrueshmërinë e rezultateve të ndërhyrjes. Komponenti i vizibilitetit të ndërhyrjes do të përmirësojë gjithashtu linjat e komunikimit, duke lehtësuar një efekt përhapës që do t'u mundësojë qytetarëve të Shqipërisë ta kuptojnë më mirë procesin e integrimit në BE.

Skema e granteve bashkiake, e cila filloi në vitin 2021, ka një reputacion të mirë për objektivitet dhe integritet, dhe do të institucionalizohet më mirë në sistemet qeveritare nëpërmjet rishikimeve të legjislacionit përkatës. Për të siguruar kalimin e qetë të skemës së granteve bashkiake dhe rritur efektivitetin e saj, është Ministria e Shtetit për Qeverisjen Vendore, nën koordinimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ajo që do të marrë përgjegjësinë për skemën. Menaxhimi i skemës së granteve do të përmirësohet në të gjitha aspektet, duke përfshirë kategoritë ligjore, financiare dhe të garantimit të cilësisë.

Për të siguruar pronësinë mbi procesin dhe rezultatet e reformës, palëve të interesuara do t'u nxitet një frymë pronësie dhe do t'u ofrohet një perceptim i objektivave dhe rezultateve të procesit të reformës. Ky element kyç do të rrisë qëndrueshmërinë e ndërhyrjes.

AL
KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA III
e Vendimit Zbatues të Komisionit për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
Dokumenti i Veprimit për BE-në për Sigurinë Ushqimore

PLANI VJETOR I VEPRIMIT

Ky dokument përbën programin vjetor të punës në kuptimin e nenit 110(2) të Rregullores Financiare, dhe planet dhe masat vjetore dhe shumëvjeçare të veprimit në kuptimin e nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23(3) të Rregullores NDICI/IFZHBN (Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar) – Global Europe.

1. PËRMBLEDHJE

1.1 Tabela përmbledhëse e Veprimit

Titulli	BE-ja për Sigurinë Ushqimore Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
OPSYS *(Sistemi Operacional i Komisionit Evropian për Menaxhimin e Projekteve dhe Kontratave)*	Referenca e biznesit OPSYS: ACT-62390
ABAC *(Sistemi Financiar i Komisionit Evropian)*	Numri i nivelit 1 të angazhimit ABAC: JAD.1354182
Akti themelor	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III)
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	Po Prioriteti: Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Integrimi Evropian
Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	Jo
Nisma Team Europe	Jo
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL	
Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse Prioriteti tematik 3: Bujqësia dhe zhvillimi rural
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ kryesorë: 2 - Të eliminohet uria, të arrihet siguria ushqimore dhe të ushqyerit e përmirësuar dhe të promovohet bujqësia e qëndrueshme OZHQ-të e tjera të rëndësishme dhe, kur është e nevojshme, objektivat: OZHQ 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit
Kodi(et) DAC	Kodi kryesor i DAC: 311 – Bujqësi Nënkodi 1: 31110 - Politika bujqësore dhe menaxhimi administrativ Nënkodi 2: 31192 - Mbrojtja e bimëve dhe mbrojtja pas korrjes dhe dezinfektimi Nënkodi 3: 31195 - Shërbime blegtorale/veterinare Kodi kryesor i DAC: 430 – Multisektorial tjetër

	Nënkodi 1: 43073 - Siguria dhe cilësia e ushqimit			
Kanali kryesor i zbatimit	*12000 - Qeveria Përfituese (12001- Qeveria Qendrore)*			
Synimet	☐ Klima ☐ Gjinia ☐ Biodiversiteti			
Treguesit (nga formulari DAC)	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/mirëqeverisja	☐	☒	☐
	Ndihma për mjedisin	☒	☐	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☒	☐	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, i të sapolindurve dhe i fëmijëve	☒	☒	☐
	Reduktimi i rrezikut të fatkeqësive	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☐	☒	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta kundër shkretëtirëzimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues dhe etiketime të brendshme	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	☐	☒	☐
	Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	PO ☐		JO ☒
	Etiketime:	PO		JO
	Transporti	☐		☒
	Energjia	☐		☒
	Mjedisi dhe qëndrueshmëria ndaj klimës	☐		☒
	Digjitale	☐		☒
	Zhvillimi ekonomik (përfshirë sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike)	☒		☐
	Zhvillimi njerëzor (përfshirë kapitalin njerëzor dhe të rinjtë)	☐		☒
	Rezistenca shëndetësore	☐		☒
	Migrimi dhe lëvizshmëria	☐		☒
	Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural	☒		☐
	Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike	☐		☒
	Të tjera	☒		☐
	Digjitalizimi	☒	☐	☐
	Etiketime:	PO		JO
	Ndërlidhja digjitale	☐		☒
	qeverisje digjitale	☐		☒
	sipërmarrje digjitale	☐		☒
	aftësi/shkrim-lexim digjital	☐		☒
	shërbime digjitale	☐		☒

	Lidhshmëria	☒	☐	☐
	Etiketime: Ndërlidhja digjitale energjia transporti shëndetësia arsim dhe kërkimi	PO ☐ ☐ ☐ ☒ ☐		JO ☒ ☒ ☒ ☐ ☒
	Migrimi	☒	☐	☐
	Reduktimi i pabarazive	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION MBI BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201 Kostoja totale e vlerësuar: 12 500 000 EURO Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së 12 500 000 EURO			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	**Menaxhim indirekt me subjektin/entin që do të zgjidhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.1**			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	Jo më vonë se 31 dhjetor 2025			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit, të prokurimeve dhe kontratave grant	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, me përjashtim të rasteve të listuara në nenin 114(2) të Rregullores Financiare.			
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas përfundimit të Marrëveshjes së Financimit			
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas përfundimit të marrëveshjes së financimit			

1.2 Përmbledhja e Veprimit

Kuadri i Programimit të Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III) për periudhën 2021–2027 përcakton si një nga prioritetet, përafrimin progresiv me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian (BE) në fushën e standardeve përkatëse veterinare, të sigurisë ushqimore dhe fitosanitare (standardet SPS). Theksohet se ende nevojiten përpjekje të mëdha për sigurinë ushqimore, mirëqenien e kafshëve dhe kalimin drejt sistemeve të qëndrueshme ushqimore, duke qenë gjithnjë e më të rëndësishme, duke pasur parasysh përafrimin e nevojshëm me *acquis*-in e sigurisë ushqimore të BE-së dhe Strategjinë e BE-së "Nga ferma në tryezë".[30] që është në thelb të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së[31], duke synuar që sistemet ushqimore të jenë të drejta, të shëndetshme dhe miqësore me mjedisin. Gjithashtu, duhet të ofrojë mbështetje për ndërtimin e institucioneve dhe kështu të ndihmojë në garantimin e zbatimit të standardeve të mirëqeverisjes së një administrate publike moderne në strukturat për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Nevojitet ndihmë e mëtejshme për të forcuar administratat në të gjitha nivelet, me qëllim përmbushjen e kërkesave të aderimit në BE. Kjo përfshin vazhdimin e mbështetjes për përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor të BE-së të standardeve përkatëse të SPS-së, duke përfshirë sistemet e përgjithshme të kontrollit që funksionojnë mirë dhe laboratorët e akreditуar.

Qëllimi i këtij Veprimi është të mbështesë institucionet shqiptare në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë ushqimore, politikave veterinare dhe fitosanitare, të cilat u bënë gjithnjë e më të

[30] Strategjia "Nga Ferma në Tryezë" - Komisioni Evropian (europa.eu)

[31] Marrëveshja e Gjelbër Evropiane - Komisioni Evropian (europa.eu)

rëndësishme pas hapjes së negociatave të pranimit në vitin 2022.

Kjo do të arrihet nëpërmjet përmirësimeve të infrastrukturës fizike (laboratori dhe zyrat rajonale) dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative në këtë sektor.

Këto veprime janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me OZHQ 2: Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i të ushqyerit dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe OZHQ 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

1.3 Përfituesi i Veprimit

Ky Veprim do të realizohet në Shqipëri.

2. ARGUMENTIMI

2.1 Konteksti

Pas hapjes së negociatave të pranimit në qershor 2022, transpozimi, implementimi dhe zbatimi i *acquis* të BE-së u bë çështje me rëndësi të madhe për administratën shqiptare të sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. BE-ja njihet për kërkesat dhe standardet më të larta të sigurisë dhe cilësisë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve agroushqimore; Prandaj, pret që vendet që u është dhënë akses në tregun e saj të përbashkët të zhvillojnë dhe zbatojnë masa ekuivalente me ato të BE-së. Zhvillimi dhe zbatimi i masave të tilla në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare kërkon përafrimin e politikave dhe legjislacionit kombëtar me kërkesat e *acquis* të BE-së dhe një nivel të lartë kompetence të administratës përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit që mbulon fushat e mësipërme. Më konkretisht, kjo kërkon: organe kontrolli të integruara dhe të besueshme, të afta për t'u ofruar siguri konsumatorëve dhe autoriteteve të shteteve anëtare se produktet ushqimore të vendosura në tregun vendas ose të përgatitura për eksport në BE, përmbushin standardet sipas *acquis*; Një shërbim i përgatitur teknikisht dhe shkencërisht, i aftë për të monitoruar situatën në vend dhe i aftë për të zbuluar dhe zhdukur sëmundjet ose për të vepruar në rast të ndonjë incidenti ushqimor; infrastrukturë për administratën në nivel qendror dhe rajonal, duke përfshirë infrastrukturën e nevojshme laboratorike, për të zbuluar dhe konfirmuar epidemitë, pajisje për të kryer kontrolle dhe mjete për regjistrimin dhe raportimin e gjetjeve dhe masat ndjekëse të ndërmarra.

Veprimi do të kontribuojë gjithashtu në prioritetin e Planit Evropian të Investimeve (EIP) "Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Integrimi Evropian", si një hap drejt integrimit më të ngushtë të rajonit me Tregun e Vetëm të BE-së që përpara se të aderojnë në Union. Një nga fushat kryesore të Planit të Veprimit për një Treg të Përbashkët Rajonal (TPR)[32] është zhvillimi i një zone rajonale tregtare që përfshin lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve, duke përfshirë masa ndërsektoriale, të tilla si korsitë e gjelbra, për t'u përshtatur me rregullat dhe standardet në përputhje me BE-në dhe për të ofruar mundësi për kompanitë dhe qytetarët. Duke përmirësuar standardet e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare, vendet e Ballkanit Perëndimor do të përmirësojnë tregtinë në rajon dhe do të krijojnë kushte për të rritur eksportet e tyre në tregun e brendshëm të BE-së. Ky veprim do të kontribuojë në përafrimin me Standardet Sanitare dhe Fitosanitare (SSF) dhe do të kontribuojë në mundësimin e eksportit të produkteve bujqësore dhe ushqimore shqiptare në BE. Përveç kësaj, veprimi kontribuon edhe në misionet *Europe Horizon*, konkretisht në "Marrëveshjen e Tokës për Evropën", ku toka është themeli i sistemeve ushqimore.

Në fushën e sigurisë ushqimore, ka një përmirësim të ndjeshëm në standardet e prodhimit, të kontrollit dhe të gjurmueshmërisë përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor. Siguria e ushqimit që i ofrohet konsumatorit shqiptar është rritur ndjeshëm. Në këtë kuadër, rrjeti i laboratorëve të sigurisë ushqimore është përafruar më shumë me standardet e BE-së. Numri i testeve dhe laboratorëve të akreditуar është rritur.

Megjithatë, aktualisht, Shqipëria nuk është e miratuar për të eksportuar kafshë të gjalla dhe ushqime me origjinë shtazore në BE (me përjashtim të produkteve të peshkut dhe vezëve) dhe eksporti i produkteve të tjera bujqësore i nënshtrohet një sërë kërkesave. Kjo e pengon Shqipërinë të përfitojë plotësisht nga mundësia për të eksportuar në BE sipas kushteve të favorshme të përcaktuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Sistemi i sigurisë

[32] Tregu i Përbashkët Rajonal - Komisioni Evropian (europa.eu)

ushqimore dhe veterinar ka nevojë për konsolidim të mëtejshëm.

Gjithashtu, vendet në rajon po i përshtatin politikat e tyre kombëtare me kërkesat e *acquis* të BE-së sipas kapitullit 12 (siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare), të cilat mund të kenë gjithashtu ndikim në eksportin shqiptar në tregun rajonal. Importet e rritura dhe mungesa e mundësive të eksportit do të ushtrojnë presion shtesë mbi konkurrueshmërinë e sektorit ushqimor në Shqipëri. Për më tepër, integrimi i vonuar i kontrollit të ushqimit vijon të ndikojë në besimin e konsumatorëve shqiptarë në cilësinë dhe sigurinë e produkteve vendase.

Veprimi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027, e cila përcakton Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për përafrimin me *acquis* të BE-së si një nga prioritetet, ndërsa Politika Kombëtare e Sigurisë Agroushqimore përcakton katër prioritete: Forcimin e Kuadrit Legjislativ dhe Administrativ; Rritjen e Efektivitetit të Sistemit të Kontrollit Agroushqimor; Forcimin e Pajtueshmërisë në të gjithë Sektorin Agroushqimor dhe Fuqizimin e Konsumatorit për të marrë vendime të informuara.

Përveç kësaj, sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në BE (2022–2030), ajo thekson objektivat strategjikë të mëposhtëm në fushën e sigurisë ushqimore:

- përgatitja e kuadrit ligjor përkatës, i cili rregullon kontrollet zyrtare, në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor të BE-së (*acquis* e BE-së), në kuadër të një politike kombëtare të konsoliduar;
- rritja e efektivitetit të sistemit të kontrollit agroushqimor;
- fuqizimi i konsumatorit për të marrë vendime të informuara;
- përfundimi i reformës për ristrukturimin e shërbimit veterinar, për ta bërë këtë shërbim plotësisht funksional;
- ndërtimi i kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve kryesore infektive, përfshirë tërbimin, dhe vazhdimin efikas të programit të vaksinimit kundër tërbimit 2020–2022.

Për politikën dhe legjislacionin e sigurisë ushqimore, veterinar dhe fitosanitar, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është institucioni kompetent, ndërsa Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESFF) janë institucione të varura. Këto institucione u krijuan në periudha të ndryshme kohore, duke kontribuar në një ndryshim themelor në sistemin e kontrollit të ushqimit. Megjithatë, nevojat e mëdha për investime, si në infrastrukturë edhe në ndërtimin e kapaciteteve të stafit në selinë qendrore dhe zyrat rajonale për të zbatuar sistemin e integruar dhe të bazuar në risk, janë të dukshme.

Siç pasqyrohet në Raportin e fundit të Komisionit (2023), Shqipëria duhet të përmirësojë kontrollet zyrtare duke miratuar metodologjinë e përmirësuar dhe të trajnojë staf të mjaftueshëm për të zbatuar planet vjetore të inspektimit. Sa i përket politikës veterinare, reforma e sektorit veterinar duhet të përfundojë duke krijuar kapacitetet e nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive, duke përfshirë vlerësime të besueshme të prevalencës së sëmundjeve, analizë të plotë të të dhënave dhe hartimin, planifikimin dhe zbatimin e duhur të sistemeve efektive për parandalimin dhe/ose zhdukjen e sëmundjeve. Në lidhje me hedhjen në treg të ushqimeve, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve me origjinë shtazore, Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht Planin Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve duke përdorur metoda të verifikuara të kontrollit për të garantuar besueshmërinë e rezultateve për speciet dhe produktet përkatëse. Rrjeti laboratorik i Shqipërisë duhet të përmirësohet, duke përfshirë menaxhimin, kapacitetet, akreditimin dhe verifikimin e metodave brenda një kuadri të konsoliduar. Për sa i përket legjislacionit për ushqimin për kafshë apo organizmat e modifikuar gjenetikisht, nuk ka pasur përparim. Legjislacioni për organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ) duhet të miratohet.

Shqipëria ka përfituar ndihmë të konsiderueshme nga BE-ja nëpërmjet programeve IPA në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. Donatorë të tjerë, si: Kooperacioni Italian, Banka Botërore, Kooperacioni Gjerman po kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori, por BE-ja mbetet ende donatori kryesor. Ndihma e jashtme koordinohet nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Struktura aktuale e shërbimeve veterinare është e organizuar si më poshtë:

a) Struktura përgjegjëse për veterinarinë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) luan rol qendror në hartimin e politikave dhe ndarjen e buxhetit për shërbimet veterinare. Ajo është përgjegjëse për harmonizimin e koordinimit institucional dhe komunikimin brenda Shqipërisë dhe me BE-në në fushat e marrëveshjeve sektoriale, tregtare dhe qeveritare. Struktura përgjegjëse për veterinarinë (SPV) brenda Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbulon shërbimin veterinar dhe ka disa detyra të rëndësishme. Detyrat kryesore përfshijnë hartimin e legjislacionit veterinar, hartimin e strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për veprimtaritë veterinare, përgatitjen e programeve për parandalimin, kontrollin dhe eliminimin e sëmundjeve infektive të kafshëve, si dhe hartimin e përmbajtjes teknike të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të fermave dhe kafshëve. SPV-ja përcakton listën e sëmundjeve që duhet të raportohen dhe ka autoritetin për të ndryshuar kufijtë e zonave të mbrojtjes dhe të mbikëqyrjes. SPV-ja informon institucionet shtetërore, institucionet e shëndetit publik dhe palët e tjera të interesuara në vend, Organizatën Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OBSHK), Bashkimin Evropian (BE) dhe organizata të tjera ndërkombëtare mbi situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive të kafshëve në Shqipëri. SPV-ja gjithashtu programon dhe planifikon buxhetin për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, duke u mbështetur në programet e kontrollit dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për planifikimin buxhetor. SPV-ja harton politika dhe strategji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave blegtorale, si dhe monitoron veprimtarinë e AKVMB-së për zbatimin dhe performancën e kontrolleve zyrtare dhe masave të tjera veterinare. Së fundi, SPV-ja përgatit programet vjetore të profilaksisë shtetërore veterinare, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve që kanë pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, bazuar në situatën epidemiologjike në vend.

b) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) në Shqipëri është një agjenci shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve. AKVMB-ja është përgjegjëse për parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, zbatimin e masave të kontrollit dhe programeve të vaksinimit, si dhe për monitorimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore të blegtorisë dhe kafshëve shtëpiake. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve kryen mbikëqyrjen veterinare nëpërmjet monitorimit dhe raportimit të rregullt të sëmundjeve të kafshëve, çka është thelbësore për zbulimin e hershëm dhe reagimin e shpejtë. Në lidhje me shëndetin publik veterinar, AKVMB-ja siguron sigurinë dhe cilësinë e produkteve me origjinë shtazore duke kryer inspektime në faza të ndryshme të prodhimit të kafshëve të gjalla, duke përfshirë ekzaminimet para dhe pas therjes.

Reforma e fundit veterinare e vitit 2021 solli një shtesë prej rreth 400 veterinerësh zyrtarë. Ata janë shpërndarë ndërmjet 4 drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve (DRVMB), sektorëve veterinarë dhe zyrave vendore. Kjo zgjerim i ka afruar veterinerët zyrtarë më pranë fermerëve, duke forcuar zbatimin e strategjive për kontrollin e shëndetit dhe prodhimit të kafshëve të fermës. Çdo veteriner zyrtar është përgjegjës për njësinë(njësitë) administrative brenda zonës së tij të mbulimit. Riorganizimi i shërbimit veterinar ka përmirësuar kontrollin mbi procesin e therjes së kafshëve. Gjithashtu, lëvizja dhe tregtimi i kafshëve të gjalla në tregjet e kafshëve të gjalla, të cilat konsiderohen njësi epidemiologjike dhe burime të mundshme të transmetimit të sëmundjeve infektive, janë përfshirë në masat e kontrollit, ndonëse mbeten kryesisht të parregulluara.

c) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është një pjesë përbërëse e Shërbimit Veterinar dhe është mandatuar si Laboratori Referencë në Republikën e Shqipërisë, duke ofruar më shumë se 250 analiza dhe teste të akredituara. ISUV mbështet shërbimet veterinare me kapacitetet e tij diagnostikuese dhe luan rol qendror në mbikëqyrjen veterinare të sëmundjeve infektive. ISUV shërben si laborator konfirmues për mostrat e dyshimta ose të ankimuara nga laboratorët rajonalë të AKVMB-së dhe laboratorët privatë. Për më tepër, ISUV bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë, institucione kërkimore dhe organizata veterinare për të përmirësuar vazhdimisht metodat e testimit, për

të miratuar teknologji të avancuara dhe për të ruajtur standardet më të larta në praktikat laboratorike. Ky angazhim ndaj ekselencës i mundëson ISUV-it të luajë rol jetik në mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, promovimin e shëndetit publik veterinar dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit të blegtorisë në vend.

d) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Misioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) është të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë gjatë gjithë zinxhirit të tyre, sigurinë e shëndetit të kafshëve dhe bimëve, si dhe të produkteve bimore në pikat e inspektimit kufitar dhe shëndetin e bimëve dhe produkteve bimore të hedhura në treg, përmes kryerjes së aktiviteteve inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 9.9.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", autoriteti kompetent për inspektimin e ngarkesave të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore në pikat e inspektimit kufitar (PIK) është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Pikat e inspektimit kufitar janë miratuar me urdhrin e ministrit nr. 168, datë 24.5.2012, "Për miratimin e pikave të kontrollit kufitar, ku kryhet inspektimi veterinar, fitosanitar dhe ushqimor për njerëzit dhe kafshët në Republikën e Shqipërisë".

- 10 pika të përhershme kontrolli kufitar, të cilat janë miratuar për kalimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore
- pika kontrolli kufitar me njoftim paraprak, të cilat janë miratuar për kalimin e produkteve me origjinë shtazore.

Për të gjitha ngarkesat, inspektorët e AKU-së në pikat e inspektimit kufitar kryejnë kontrollet e mëposhtme:

- kontrolli i dokumentacionit (kryhet kontrolli mbi dokumentet që shoqërojnë produktet e kontrolluara në pikat e inspektimit kufitar. Përfshihen certifikatat veterinare për kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore për çdo kategori produktesh);
- kontrolli i identitetit (verifikohet nëse të dhënat lidhur me dokumentet e ndërmarrjeve përputhen me karakteristikat e ngarkesës);
- kontrolli fizik (verifikohet nëse produkti përputhet me ndryshimet e ndryshme në dokumentacion).

Duhet të krijohet një sistem efektiv inspektimi në pikat e caktuara kufitare në kuadër të aderimit në BE, i udhëhequr nga rregullorja përkatëse e zbatimit të Komisionit. Përveç rivitalizimit të sistemit AKU-net, në përfshihet edhe kryerja e kontrolleve zyrtare *online* në pikat e inspektimit kufitar, gjë që imponon nevojën për përmirësimin e këtyre pikave në aspektin e infrastrukturës, pajisjeve, stafit të trajnuar, sistemeve IT dhe të tjera.

2.2 Analiza e problemit

FUSHA E MBËSHTETJES #1: *Të krijohet kapaciteti për përshtatjen e acquis-it të BE-së në kapitullin 12 - Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare, si dhe të jepet mbështetje në zhvillimin e negociatave të aderimit në kapitullin 12*

Acquisi i BE-së në kapitullin 12 përbëhet nga një numër shumë i madh rregullash, direktivash dhe vendimesh. Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria punon vazhdimisht për përmirësimin e legjislacionit të saj kombëtar në përputhje me kërkesat e *acquis*-it. Megjithatë, *acquis*-i i BE-së është në zhvillim të vazhdueshëm dhe pritet që vendet kandidate të përshtatin *acquis*-in përpara se të anëtarësohen në BE. Në kuadër të IPA II, Projekti për Sigurinë Ushqimore ka hartuar tri ligje kuadër që përshtatin dispozitat e ligjit të shëndetit të kafshëve, ligjit të shëndetit të bimëve dhe Rregullores për Kontrollin Zyrtar të BE-së. Miratimi i këtyre ligjeve është planifikuar për tremujorin e katërt të vitit 2023.

Për më tepër, krijimi i një kuadri të plotë ligjor kërkon shfuqizimin e ligjit për veterinarinë dhe ligjit për blegtorinë, ndryshime në ligjin për ushqimin, si dhe hartimin e dy ligjeve të reja, konkretisht ligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe ligjit për produktet e mbrojtjes së bimëve. Ligjet e reja duhet të shoqërohen me një numër aktesh nënligjore që do ta afrojnë legjislacionin kombëtar shqiptar me *acquis*-in e BE-së. Përvoja nga rajoni tregon se negociatat e aderimit në kapitullin 12 janë një proces jashtëzakonisht kërkues, i cili zbatohet nëpër disa faza të njëpasnjëshme, duke kërkuar mobilizimin e burimeve administrative për përgatitjen dhe përmbushjen e kritereve të hapjes dhe mbylljes, pozicionet negociuese, si dhe aktivitete të tjera të nevojshme sipas procesit të aderimit. Institucionet shqiptare kanë nevojë për mbështetje të konsiderueshme në zhvillimin e negociatave të aderimit në kapitullin 12.

Përshtatja e *acquis*-it të BE-së dhe negociatat e aderimit në kapitullin 12 do të përbëjnë pjesën kryesore të mbështetjes. Brenda këtij komponenti, do t'i jepet vëmendje e veçantë shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe produkteve shtazore në Shqipëri.

Shqipëria ka pasur disa shpërthime sëmundjesh dhe problemet me sëmundjet endemike janë të dukshme. Kjo situatë shkakton: probleme me shëndetin publik në rastet e sëmundjeve zoonotike; humbje ekonomike në nivel fermash dhe shpenzime për kontrollin dhe shuarjen e sëmundjeve; kufizime në tregti dhe lëvizjen e kafshëve të gjalla dhe ushqimeve me origjinë shtazore etj. Mirëqenia e kafshëve është një temë pothuajse e neglizhuar dhe kërkon më shumë vëmendje. Si rrjedhojë, nevojitet mbështetje në lidhje me hartimin dhe zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe kërkesat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, të vendosura nga Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OBSHK).

Në të gjithë territorin e Shqipërisë, një numër i madh kafshësh asgjësohen në mënyrë të papërshtatshme. Po kështu, nënproduktet e thertoreve ruhen pa një trajtim të duhur. E gjithë kjo favorizon përhapjen e sëmundjeve infektive dhe degradimin e mjedisit. Përhapja e sëmundjeve infektive përmes materialit shtazor, karkasave/kërmave të kafshëve, të brendshmeve ose plehut organik, përkatësisht asgjësimi i pamjaftueshëm i nënprodukteve shtazore, përbën kërcënim serioz për shoqërinë dhe kërkon zgjidhje të organizuar të problemeve. Nënproduktet shtazore dhe produktet e tyre që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, nuk janë të rregulluara në Shqipëri. Brenda këtij komponenti do të ofrohet ndihmë në krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbetjeve shtazore për nënproduktet shtazore, si dhe përgatitje për ndërtimin e objekteve të mbetjeve shtazore për të gjitha format e nënprodukteve shtazore, duke përfshirë rregullimet për mbledhjen dhe transportin e tyre, të cilat do të kenë ndikim të madh në uljen e rreziqeve të drejtpërdrejta për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve dhe mjedisin.

FUSHA E MBËSHTETJES #2: *Forcimi i kapaciteteve administrative të inspektorëve të ushqimit, shërbimeve veterinare dhe të shëndetit të bimëve për t'u përballur me kërkesat e acquis-it të BE-së*

Përveç përshtatjes ligjore, një vend kandidat pritet të zbatojë dhe të ushtrojë në mënyrë të duhur rregullat e parashikuara në kapitullin 12. Rezultatet e arritura për të provuar zbatimin efikas të *acquis*-it të BE-së janë kriter kyç në vlerësimin e përparimit në negociatat e anëtarësimit. Vendet kandidate të BE-së duhet të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të qenë të aftë të zbatojnë *acquis*-in e BE-së. Për zbatimin e *acquis*-it në kapitullin 12, Shqipëria duhet të ketë strukturat administrative të përshtatshme për të kryer inspektimin dhe kontrollin e ushqimeve me origjinë shtazore dhe joshtazore, duke përfshirë edhe kapacitet të mjaftueshëm laboratorik.

Shqipëria ka disa kapacitete administrative në MBZHR, AKVMB, AKU, ESFF dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, por është e dukshme se këto institucione ende mungojnë në nivele të mjaftueshme të mbështetjes financiare, operative dhe njerëzore. Këto institucione duhet të forcohen më tej në lidhje me kapacitetet logjistike dhe operative, për të qenë të aftë të kryejnë misionin e tyre në sigurimin e shëndetit publik dhe për t'u përballur me presionet e tregut të përbashkët të BE-së. Degët rajonale të shërbimit kanë nevojë për hapësira të mjaftueshme zyre, infrastrukturë IT dhe duhet të jenë të lëvizshme në gjithë territorin e vendit. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve kërkon programe të vazhdueshme trajnimi dhe edukimi në disa fusha të kapitullit 12.

FUSHA E MBËSHTETJES #3: *Mbështetje për vlerësimin, kategorizimin dhe përmirësimin e subjekteve ushqimore*

Numri total i operatorëve të regjistruar/të miratuar në Shqipëri është 7,176. Rreth 90% e tyre janë në kategorinë e tregtisë me shumicë, pakicë dhe ushqimeve sociale. Pjesa e operatorëve që prodhojnë ushqime me origjinë shtazore është rreth 10%. Në nivel kombëtar, Shqipëria ka 63 thertore të miratuara, 114 fabrika për prerjen dhe përpunimin e mishit, dhe 370 fabrika për përpunimin e qumështit.

Nga numri total i subjekteve, vetëm 43 operatorë janë të miratuar për eksport në BE, shumica prej tyre janë subjekte që prodhojnë produkte peshkimi. Shqipëria nuk ka operatorë të miratuar për eksportin e mishit ose qumështit në tregun e BE-së.

Lista e operatorëve të miratuar nga Shqipëria për eksport në tregun e BE-së[33]

Sektori i Ushqimit	Numri i operatorëve
Stomakë, fshikëza dhe zorrë të trajtuara: vetëm zorrët	4
Vezë dhe produkte vezësh	6
Këmbët e bretkosave dhe kërmijtë	3
Produktet e peshkimit	31
Ushqimi total	**43**

Situata aktuale kufizon ose bllokon eksportin e disa produkteve ushqimore shqiptare në tregun e BE-së dhe ka implikime të drejtpërdrejta në bilancin negativ tregtar të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Eksperienca nga procesi i aderimit tregon se pas zbatimit të kontrollit bilateral, Shqipëria mund të presë të marrë një standard krahasues hapjeje në kapitullin 12. Një nga standardet krahasuese që pritet të merret në vitin 2024 është prezantimi i një klasifikimi të të gjitha subjekteve ushqimore dhe të gjitha subjekteve që trajtojnë nënprodukte shtazore, bazuar në *acquis*-in, i cili do të shërbejë si bazë për një Program Kombëtar të ardhshëm për përmirësimin e subjekteve ushqimore dhe nënprodukteve shtazore.

Shqipëria ka ndërmarrë tashmë disa aktivitete në përgatitjen për kategorizimin e subjekteve. Në kuadër të Projektit IPA II për Sigurinë Ushqimore, janë ndërmarrë hapa fillestarë në procesin e kategorizimit të subjekteve që merren me ushqime me origjinë shtazore. Modeli i projektuar është prezantuar në dokumentin "Procedura për vlerësimin dhe përmirësimin e subjekteve që trajtojnë ushqime me origjinë shtazore", i cili parashikon kategorizimin e subjekteve në njëren prej kategorive të mëposhtme:

- kategoria 1: në përputhje me kërkesat e BE-së;
- kategoria 2: janë konstatuar mospërputhje të vogla që mund të zgjidhen brenda një periudhe të shkurtër (3–6 muaj);
- kategoria 3: janë konstatuar mospërputhje të konsiderueshme ose mospërputhje që mund të zgjidhen brenda një periudhe më të gjatë;
- kategoria 4: janë konstatuar mospërputhje të konsiderueshme (subjekti paraqet rrezik të konsiderueshëm për shëndetin dhe nuk duhet të hedhë produkte në treg; duhet të ndërpresë aktivitetin, sepse nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar; ose është i paaftë të arrijë standardet e BE-së).

Gjithashtu, në kuadër të Projektit për Sigurinë Ushqimore (IPA 2016), janë përgatitur 13 lista kontrolli për kategorizimin e subjekteve që trajtojnë ushqime me origjinë shtazore. Për më tepër, në vitin 2022, 28 inspektorë morën trajnim hyrës mbi kategorizimin e subjekteve dhe 58 inspektorë morën trajnim mbi kërkesat strukturore, operacionale dhe higjienosanitare.

Përparimi i mëtejshëm në kategorizimin dhe përmirësimin e subjekteve ushqimore do të kërkojë asistencë teknike shtesë. Kjo asistencë do të përfshijë trajnime dhe mentorim për inspektorët e caktuar për zbatimin e kategorizimit të subjekteve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve të biznesit ushqimor. Gjithashtu, do të zbatohet një projekt pilot për përmirësimin e subjekteve me synim arritjen e standardeve të BE-së për eksport në tregun e BE-së.

FUSHA E MBËSHTETJES #4: *Forcimi i infrastrukturës laboratorike dhe burimeve njerëzore për të përmbushur kërkesat e akreditimit (përgatitja e projekteve të detajuara sipas nevojave të akreditimit dhe nivelit të sigurisë, punimet e ndërtimit)*

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian, mbështetja fillestare për laboratorët u ofrua përmes projektit IPA 2013 "Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik për sigurinë ushqimore dhe veterinarinë në Shqipëri". Projekti çoi në krijimin e një rrjeti laboratorësh me kosto-efektivitet të lartë, të aftë për të siguruar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve në treg dhe shëndetin e kafshëve, si dhe në rritjen e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorim dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqimit për kafshë, me fokus të veçantë në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnostikës mikrobiologjike në ushqime dhe ushqim për kafshë,

[33] Burimi: DG SANTE; Lista e institucioneve.
https://webgate.ec.europa.eu/tracesnt/directory/publication/establishment/index#!/search?countryCode=AL&sort=country.translation

standardeve të cilësisë ushqimore dhe sëmundjeve të kafshëve, në përputhje me standardet e përmirësuara.

Rrjeti aktual laboratorik kombëtar funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) nëpërmjet këtyre strukturave:

1. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
3. Enti Shtetëror për Farërat dhe Fidanët (ESFF);
4. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) – Fusha e Krujës, e cila ofron shërbime laboratorike si laboratori kombëtar referencë për analizat e produkteve plehërues.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është i akredituar në përputhje me standardin EN ISO 17025:2005. Akreditimi është dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në vitin 2011. ISUV operon në nivel qendror dhe rajonal. Laboratorët qendrorë dhe rajonalë janë përgjegjës për gjurmimin, analizimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve infektive dhe parazitare te kafshët dhe shpendët. Ata janë gjithashtu përgjegjës për testimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe joshtazore. ISUV bashkëpunon me entitete ndërkombëtare për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme epizootike, agjentëve zoonotikë dhe zbulimin e ndotësve që vijnë nga ushqimi.

Laboratorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) klasifikohen në kategorinë C sipas standardit ISO 17025 që do të thotë se përgatitja e kapaciteteve dhe procedurave në përputhje me kërkesat e menaxhimit të këtij standardi ende nuk ka filluar. Laboratorët nuk kanë asnjë parametër të akredituar dhe stafi nuk është trajnuar në standardin ISO 17025:2005. Nuk ekzistojnë procedura të shkruara dhe udhëzime pune.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka 7 laboratorë rajonalë (secili prej tyre përfshin nga 1 deri në 3 departamente funksionale: ushqimor, veterinar dhe shëndet bimor (fitosanitare)). Çdo Departament i testimit të ushqimeve përbëhet nga dy seksione: seksioni fiziko-kimik dhe seksioni mikrobiologjik. Laboratori rajonal i AKU-së në Vlorë ka një degë laboratori të vogël në Sarandë, me dy seksione (fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë), të cilat kryejnë analiza ushqimore.

Laboratori Fiziko-Kimik kryen analiza mbi treguesit cilësorë të produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore, treguesit e etiketimit, si dhe disa tregues analitikë të sigurisë ushqimore. Laboratori Mikrobiologjik kryen analiza mbi sigurinë ushqimore dhe kriteret e higjienës së procesit. Laboratori për Shëndetin dhe Mirëqenien e Kafshëve kryen analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve te kafshët. Laboratori për Mbrojtjen e Bimëve kryen analiza për diagnostikimin e dëmtuesve dhe parazitëve te bimët dhe produktet bimore.

Projekti i propozuar do të ofrojë mbështetje teknike dhe financiare për të lehtësuar përputhjen funksionale me Rregulloren e Përgjithshme të Ushqimit të BE-së (EC 178/2002) dhe një grup rregulloresh të BE-së për mbrojtjen me bazë risku nga sëmundjet dhe dëmtuesit që lidhen me shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe kontrollin zyrtar në të gjithë zinxhirin agroushqimor, sipas Rregullores së Kontrollit Zyrtar të BE-së. Këto dhe rregullore të tjera përbëjnë shtyllën kryesore të kapitullit 12 të *acquis* të BE-së: Politika e Sigurisë Ushqimore, Veterinare dhe Fitosanitare.

Përmirësimi i ndjeshëm i të gjitha këtyre elementeve do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në procesin e harmonizimit të standardeve dhe kërkesave të Shqipërisë me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian që lidhet me shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore dhe shëndetin e bimëve. Gjithashtu, këto do të jenë në përputhje me marrëveshjet dhe standardet e organizatave ndërkombëtare përkatëse, si: Marrëveshja për Masat Sanitare dhe Fitosanitare të Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO-SPS), Kodet Ushqimore të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi (WHO/FAO Codex Alimentarius), Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, Kodet për Kafshët Tokësore dhe Ujore, si dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (IPPC). Kjo do të ndihmojë ndjeshëm në mbështetjen e qasjes "Një shëndet" ("One Health"), e cila ka rëndësi të veçantë për sigurinë e ushqimit dhe ujit, ushqyerjen, kontrollin e sëmundjeve zoonotike, menaxhimin e ndotjes dhe luftimin e rezistencës ndaj antimikrobikëve.

Gjithashtu, kjo do të ndihmojë Shqipërinë të përmbushë kërkesat ndërkombëtare të certifikimit ushqimor, si: GlobalGAP, EurepGAP, HACCP etj. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe AKU-ja kanë ndarë aktivitetet

analitike dhe diagnostikuese midis Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe shtatë laboratorëve të AKU-së. Në parim, ISUV-i do të luajë rolin referues dhe do të mbështesë AKU-në edhe në kryerjen e analizave rutinë ose atyre që kërkojnë ekspertizë të lartë.

Mbajtja e të gjithë laboratorëve në të njëjtin nivel funksional nuk është as e arsyeshme, as me kosto efektive, dhe mund të mos jetë e nevojshme. Për shkak të diversifikimit të prodhimit bujqësor, jo të gjithë laboratorët duhet të kryejnë gamën e plotë të analizave. Si rrjedhojë, është planifikuar përqendrimi i shumicës së analizave, veçanërisht atyre që kërkojnë metoda më të avancuara dhe pajisje të sofistikuara, në tre laboratorë kryesorë (në Fier, Korçë dhe Tiranë), ndërsa laboratorët e tjerë do të merren me analiza rutinë më të thjeshta dhe në shkallë të gjerë.

Tabela përkatëse për ndarjen e analizave sipas laboratorëve specifikë, është përgatitur dhe përfshihet në dokumentacionin shoqërues të projektit.

Fusha e kompetencës së ISUV-së do të mbetet e pandryshuar dhe do të përfshijë sa vijon:

i. shërben si laborator reference për të gjithë laboratorët e AKU-së (në të 3 disiplinat, d.m.th.: sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe shëndetin e bimëve);

ii. kryen analiza më të avancuara që kërkojnë pajisje, metoda dhe kompetencë specifike dhe të sofistikuara (siç janë: biotoksinat detare; mbetjet e barnave veterinare dhe ndotësit në ushqimin me origjinë shtazore; sëmundjet që transmetohen nga ushqimi etj.);

iii. kryen analiza të rralla (p.sh. ASF, FMD, TSE, gjuha blu, tërbimi etj.);

iv. pjesëmarrje në analiza rutinë në shkallë masive (mbështetje për laboratorët e AKU-së), veçanërisht në lidhje me mbetjet e produkteve të mbrojtjes së bimëve në ushqimin me origjinë joshtazore.

Ndarja e punës analitike brenda rrjetit të laboratorëve të AKU-së:

Llojet specifike të analizave	Durrës	Fier	Gjirokastër	Korçë	Tiranë	Shkodër	Vlorë
Mbetjet e produkteve të mbrojtjes së bimëve		x		x			
Dëmtuesit e bimëve – viruset, bakteret, kërpudhat		x		x			
Dëmtuesit e bimëve – insektet dhe nematodat	x	x	x	x	x	x	x
Bruceloza dhe tuberkulozi i gjedhit	x	x		x		x	
Shëndeti i bletëve	x			x			
Analiza veterinare në shkallë masive	x	x	x	x	x	x	x
Zoonozat	x	x	x	x	x	x	x
Parazitët (*Trichinella, Echinococcus, Anisakis*)	x	x	x	x	x	x	x
Mikotoksinat dhe toksinat e bimëve	x	x	x	x	x	x	x
Materiali i destinuar për të rënë në kontakt me ushqimet					x		
Metalet dhe komponimet azotike					x		
Përpunimi i ndotësve					x		

ESFF-ja është një institucion në varësi të MBZHR-së. ESFF ndjek kryerjen e kontrolleve në terren, marrjen e mostrave për analiza laboratorike për çdo material mbjellës dhe shumues, i cili kërkohet të certifikohet. SESS kryen analiza laboratorike, në laboratorin e testimit të farërave, për të gjitha mostrat e marra nga pikat e testimit zonal.

Identifikimi i palëve kryesore të interesuara dhe çështjeve përkatëse institucionale dhe/ose organizative (mandatet, rolet e mundshme dhe kapacitetet) që do të mbulohen nga veprimi.

Sipas këtyre veprimeve të planifikuara, MBZHR-ja do të jetë institucioni kryesor për këtë dokument veprimi, si dhe përfituesi kryesor. Sipas një sërë ligjeve, MBZHR-ja është institucioni kompetent për sigurinë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare përmes zinxhirëve të furnizimit me ushqim nga ferma në tryezë. Me qëllim zbatimin e praktikave të shëndosha të menaxhimit, MBZHR-ja është përgjegjëse për përcaktimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit, të zbatuara nga AKVMB-ja dhe AKU-ja. AKVMB-ja është institucioni ngjitur përgjegjës për zbatimin e politikës veterinare dhe fitosanitare, ndërsa Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përgjegjës për zbatimin e politikës së sigurisë ushqimore.

Përveç kësaj, rrjeti laboratorik që vepron nën MBZHR përfshin ISUV-në (Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë), AKU-në (Autoritetin Kombëtar të Ushqimit) dhe ESFF-në (Entin Shtetëror për Farat dhe Fidanët). Rolet e tyre shpjegohen nën titullin "Analizë e shkurtër e problemit".

Palët kryesore të interesuara të cilave u adresohet ky dokument veprimi janë të gjithë pjesëmarrësit në zinxhirët e furnizimit me ushqim nga ferma në tryezë. Përfshirja e palëve kryesore të interesuara do të bëhet përmes mekanizmave të dialogut dhe konsultimit të krijuar tashmë. Në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, MBZHR-ja ka një program komunikimi të krijuar tashmë, i cili mundëson ofrimin në kohë të informacionit mbi kërkesat e reja në fuqi, periudhat e tranzicionit dhe disponueshmërinë e këshillave në zbatimin e legjislacionit.

2.3 Mësimet e nxjerra

Në vitet e kaluara, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka koordinuar aktivitetet e një numri projektesh të rëndësishme në fushën e sigurisë ushqimore:

- Projekti i IPA 2010 "Rehabilitimi i zyrave dhe laboratorëve rajonalë të AKU-së" (5.2 milionë euro, përfshirë 0.7 milionë euro nga Qeveria e Shqipërisë. Ky projekt u përfundua në tremujorin e parë të vitit 2014. Qëllimi i këtij projekti ishte përmirësimi i efikasitetit të sistemit të sigurisë ushqimore përmes përmirësimit të rrjetit të laboratorëve dhe zyrave rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit).

- Projekti i IPA 2010 "Ndërtimi i Laboratorit Qendror Veterinar në ISUV" (1.4 milionë euro) ka krijuar Laboratorin Qendror Veterinar në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në përputhje me standardet veterinare dhe të shëndetit të kafshëve të BE-së.

- Projekti i IPA 2012 "Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit kundër sëmundjeve zoonotike – faza II" (4.9 milionë euro, përfshirë 0.4 milionë euro nga bashkëfinancimi i Qeverisë Shqiptare) është një vazhdim i projektit IPA 2008 "PAZA-1", duke përfshirë reformën në sektorin veterinar, ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me mbikëqyrjen e sëmundjeve dhe diagnostikimin laboratorik të sëmundjeve zoonotike, monitorimin e vaksinimit kundër tërbimit. Objektivi i përgjithshëm ishte rritja e shëndetit dhe produktivitetit të bagëtive dhe përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit publik në Shqipëri në përputhje me rregulloret e BE-së për kontrollin dhe monitorimin e agjentëve zoonotikë.

- IPA 2013 "Forcimi i laboratorëve të sigurisë ushqimore në Shqipëri (duke përfshirë furnizimet për laboratorët rajonalë të ISUV-së dhe AKU-së) " (4.4 milionë euro, përfshirë 0.4 milion euro nga bashkëfinancimi i Qeverisë Shqiptare) që synon të mbështesë përmirësimin e sistemit laboratorik drejt niveleve të përmirësuara të menaxhimit të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

- IPA 2017 "Furnizimi dhe monitorimi i vaksinimit kundër tërbimit – faza III" (1,067,200 euro). Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte të kontribuonte në zhdukjen e plotë të tërbimit në Shqipëri dhe të sigurohej që zbatimi i vaksinimit oral kundër tërbimit të kryhej në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

- IPA 2020 "Kontrolli dhe zhdukja e tërbimit, përfshirë monitorimin – faza IV" (1,421,000 euro) duke synuar vazhdimin e vaksinimit kundër tërbimit për të siguruar zhdukjen e sëmundjes dhe për të krijuar kapacitete mbikëqyrëse pasive.

- Mbështetje rajonale IPA "Ndërtimi i kapaciteteve të shërbimeve veterinare dhe të shëndetit të bimëve në Ballkanin Perëndimor – ADEWB II dhe PHWB" duke synuar ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve kompetente të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të siguruar një status të favorshëm shëndetësor të kafshëve dhe bimëve për të gjithë rajonin në planin afatgjatë, duke garantuar kështu funksionimin e duhur të tregut të brendshëm që nga momenti që Ballkani Perëndimor është gati të bashkohet me BE-në; të njihen dhe të zbatojnë qasjen "Një Shëndet" në përputhje me *acquis* dhe praktikat më të mira të BE-së.

- PROGRAMI PARAANËTARËSIMI I EFSA-s 2023–2026 Ky është një program që mbështet autoritetet kompetente për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në vendet përfitues të IPA-së dhe është vazhdimësi e programit të paraaderimit 2019–2023.

Fushat e parashikuara të ndërhyrjes janë:

- forcimi i kapaciteteve për vlerësimin dhe komunikimin e rrezikut;

- rritja e bashkëpunimit shkencor dhe aktiviteteve të rrjetëzimit midis vendeve përfituese të IPA-së dhe Shteteve Anëtare dhe AESU-së (Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore);

- rritja e harmonizimit të metodologjive të vlerësimit të rrezikut dhe mbledhjes së të dhënave të IPA-së me ato të AESU-së (Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore);

- përmirësimi i gatishmërisë për çështjet e përbashkëta të sigurisë ushqimore.

Shqipëria ka 48 vëzhgues dhe zëvendës, pjesë të rrjeteve shkencore për vlerësimin e rrezikut në shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve, komunikimin, monitorimin kimik të të dhënave për produktet mjekësore veterinare (PMV), rrjetin për zoonozat, materialet që kanë kontakt me ushqimin, rezistencën ndaj antimikrobikëve, organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), pesticide, nanoteknologji dhe mbikëqyrjen e dëmtuesve.

Për më tepër, janë zhvilluar aktivitete të fokusuara në komunikim dhe rritje të ndërgjegjësimit për sëmundjet dhe rreziqet. Që nga viti 2020 deri tani, janë zhvilluar me sukses 4 fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi për ethet afrikane të derrit, duke pasur ndikim konkret, ku Shqipëria aktualisht është e lirë nga kjo sëmundje.

Mbështetja e donatorëve të tjerë:

- Projekti "Forcimi institucional i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë për menaxhimin e sigurisë ushqimore" financuar nga Agjencia italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim – (2,400,000 euro). Objektivi specifik është forcimi i kapaciteteve të autoriteteve shqiptare për të kryer kontrolle dhe inspektime mbi materialin bimor në kufi dhe operuar në sektorin veterinar".

Rezultati 1: AKU-ja ka rritur kapacitetin e saj për të kryer inspektime efikase të ushqimeve hyrëse në portin e Durrësit

- Identifikimi, projektimi dhe ristrukturimi i një zone dhe ambientesh që do të përdoren si zyra dhe laborator, në portin e Durrësit për inspektime dhe marrjen e mostrave dhe për analizat e para të produkteve të frutave dhe perimeve në hyrje.

- Furnizim me pajisje për marrjen e mostrave dhe inspektimin e ushqimeve në portin e Durrësit (duke përfshirë pajisje të vogla laboratorike, pajisje për lëvizjen e mallrave, orendi dhe pajisje zyre).

- Trajnimi i inspektorëve të AKU-së mbi metodat e marrjes së mostrave dhe kontrollet kufitare dhe teknikëve shqiptarë, mbi analizat e para që mund të kryhen në doganë për produktet e frutave dhe perimeve që hyjnë në vend.

Rezultati 2: Autoritetet shqiptare kanë rritur kapacitetin për të verifikuar nivelet e sigurisë (mbetjet nga pesticidet) në ushqimet me origjinë bimore dhe kanë zhvilluar ekspertizë për diagnostikimin e agjentëve të mundshëm karantinorë

- Laboratorët janë të pajisur për analizën e agjentëve të karantinës dhe mbetjeve të pesticideve.

- Laboratori është i akredituar për analizat.

Rezultati 3: Ministria e Bujqësisë ka një shërbim veterinar të forcuar dhe të riorganizuar përmes vlerësimit të bagëtive dhe kompjuterizimit të të dhënave

- Projekti për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e bujqësisë, i negociuar me Bankën Botërore në mars 2023, synon të financojë 20,30 milionë euro për rritjen e pajtueshmërisë me standardet e sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Më konkretisht, do të financohen investimet e mëposhtme:

i. Ngritja dhe përmirësimi i 6 (gjashtë) postave të inspektimit kufitar ("PIK"). Objektivi i këtij aktiviteti është rritja e kapacitetit të Autoritetit Kompetent për të kryer kontrolle zyrtare (kontrolle dokumentare, identiteti dhe fizike) për kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe joshtazore, bimët dhe produktet bimore, si dhe inputet bujqësore. Projekti do të mbështesë rehabilitimin dhe pajisjen e gjashtë

PIK-eve (në Bllatë, Kakavijë, Kapshticë, Qafë-Botë, Qafë-Thanë dhe Vlorë) nga 13 që janë aktualisht.

ii. Përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe mbështetjes diagnostikuese në fushat e sigurisë ushqimore, analizave veterinare dhe të shëndetit të bimëve. Objektivi i këtij aktiviteti është të rrisë kapacitetin për të kryer në mënyrë më efektive dhe efikase kontrolle fizike, marrjen e mostrave dhe dorëzimin e mostrave në laboratorë, si dhe testime laboratorike të laboratorëve të sigurisë ushqimore, veterinare dhe shëndetit të bimëve, për t'i mundësuar atyre të zbatojnë sistemet dhe metodologjitë e nevojshme të monitorimit për testimin sipas standardeve përkatëse në përputhje me kërkesat e paraaderimit në BE. Në mënyrë specifike, projekti do të mbështesë: (i) asistencë teknike për përgatitjen e projekteve të detajuara dhe mbikëqyrjen për rehabilitimin e laboratorëve sipas nevojës, si dhe çdo instrument të nevojshëm mjedisor dhe social specifik për vendin; (ii) punime civile për rehabilitimin e objekteve; (iii) sigurimin e pajisjeve për inspektime, marrjen e mostrave dhe dorëzimin e mostrave dhe testimin në laboratorë;

iii. Zhvillimi i kapacitetit të magazinimit për mallrat e ndaluara që nuk përmbushin standardet e sigurisë ushqimore, veterinarie ose të shëndetit të bimëve (si mishi, qumështi, vezët, ushqimi me origjinë bimore etj.), projekti do të mbështesë ndërtimin e 4 ambienteve të magazinimit me efikasitet të lartë energjetik që plotësojnë kërkesat specifike të sigurisë dhe mjedisit, të vendosura në ambientet e rrethuara të drejtorive rajonale të AKU-së në Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Këto do të mundësojnë ndalimin dhe magazinimin e mallrave të dyshuara, qoftë në gjendje të ngrirë ose në kushte ftohjeje, duke përmbushur nevojat e AKU-së në mënyrën më të thjeshtë, më të lirë dhe më efektive.

Përafrimi i legjislacionit ka rezultuar të jetë një proces i vështirë dhe kompleks. Kompleksiteti i legjislacionit dhe kërkesat për zbatimin e politikës së sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare të BE-së janë sfida të mëdha për secilin vend kandidat. Në disa aspekte, Shqipëria është tashmë mjaft e përparuar në përafrimin me *acquis* të BE-së. Megjithatë, përshtatja e *acquis* të BE-së në disa fusha nuk ka filluar dhe disa fusha nuk rregullohen nga legjislacioni kombëtar.

Një mësim i përgjithshëm i nxjerrë është se, pavarësisht ndihmës teknike të dhënë për përafrimin me *acquis*-në, vendet vazhdojnë të vuajnë nga zbatimi dhe zbatimi i dobët i ligjeve dhe politikave. Kjo ndodh kryesisht, sepse mbështetja fokusohet në përafrimin teknik (përmbajtjen), por nuk i kushton mjaftueshëm vëmendje cilësisë së dobët të proceseve të hartimit të ligjeve, të cilat përcaktojnë në masë të madhe nëse ligjet e reja mund të zbatohen. Problemet e përbashkëta janë vlerësimet e dobëta të ndikimit (rregullator/tatimor) të ligjeve dhe politikave të propozuara, koordinimi i dobët ndërministror, konsultimet e jashtme (publike) me palët e interesuara, si dhe mungesa e vlerësimit të kostove të zbatimit dhe ndarjes së burimeve të nevojshme.

Është bërë gjithnjë e më e qartë se, ndërsa ndihma e BE-së mund të kontribuojë në ndërtimin e kapaciteteve në një sektor të veçantë, ajo nuk kontribuon gjithmonë në reformën e përgjithshme të administratës publike. Në fakt, ndihma e kaluar e BE-së herë pas here ka ndihmuar në krijimin e "ishujve të shkëlqyer" sektorialë të izoluar, të cilët rrallë janë të qëndrueshëm në mjedisin e përgjithshëm administrativ.

Mësimet kryesore të nxjerra gjatë ndihmës së mëparshme janë se, së pari dhe më kryesorja, institucionet përfitues duhet të kenë të gjitha strukturat dhe infrastrukturën e nevojshme në vend për të përfituar maksimalisht nga projektet e ndihmës. Pasi të krijohen kapacitetet institucionale dhe administrative, ato duhet të ruhen gjatë gjithë procesit të negociatave të aderimit. Përndryshe, rreziku i humbjes së "kujtesës institucionale" rritet, duke penguar procesin e reformës së nevojshme.

Shtetet e vogla si Shqipëria vuajnë nga mungesa e stafit në institucionet e tyre, duke u përballur me sfida të mëdha në përafrimin e politikave kombëtare me politikat e BE-së. Kjo është veçanërisht e dukshme në kapitujt e mëdhenj dhe kërkues, siç është kapitulli 12. Numri i kufizuar i stafit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) përbën një sfidë të madhe për transpozimin dhe koordinimin e duhur të zbatimit të rregullave dhe standardeve të përafruara me ato të BE-së.

Gjithashtu, në lidhje me fushën veterinare, zinxhiri i komandës së autoritetit kompetent veterinar në Shqipëri mbetet i fragmentuar, pasi Shefi i Shërbimit Veterinar Kombëtar (CVO), sipas pozitës aktuale në strukturën organizative të shërbimit veterinar, nuk ka fuqi ekzekutive dhe kontakt të drejtpërdrejtë me Institutin e Sigurisë

Ushqimore dhe Veterinare (laboratori referencë) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (organi përgjegjës për kontrollet zyrtare).

Përvoja e mëparshme ka treguar se planifikimi buxhetor dhe disponueshmëria e buxhetit janë gjithashtu thelbësore për të mundësuar kushtet e përshtatshme për zbatimin e një veprimi. Për laboratorin, inspektimet dhe shërbimet e tjera në AKVMB, AKU dhe ISUV, është e nevojshme që të ketë një buxhet të disponueshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve, prokurimin e reagjentëve dhe materialeve të tjera të konsumueshme, kryerjen e testeve dhe ndarjen e buxhetit për testimin e aftësisë.

Pajtueshmëria me standardet e sigurisë ushqimore, shëndetit të bimëve, veterinare dhe të cilësisë është e rëndësishme, duke pasur parasysh rolin përkatës të sektorit të prodhimit ushqimor dhe rritjen e rekomanduar të prodhimit të produkteve agroushqimore me vlerë të lartë, si dhe tendencën në rritje të eksporteve agroushqimore. Megjithatë, pajtueshmëria në Shqipëri është e kufizuar dhe më shpesh e arritshme vetëm nga prodhuesit më të mëdhenj, më të pajisur dhe më të informuar. Kjo çon në integrim të ulët të tregut (eksportit), veçanërisht për fermerët e vegjël. Implikimet në kosto dhe konkurrueshmëri të mangësive në sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve mund të jenë të konsiderueshme dhe mund të çojnë në ndërprerje të tregjeve ushqimore dhe pengesa për eksportet agroushqimore. Investimet e ardhshme dhe përpjekjet për forcimin institucional duhet të adresojnë mekanizmat e dobët të pajtueshmërisë dhe kontrollit që lidhen me sigurinë ushqimore, standardet veterinare, sanitare dhe fitosanitare, dhe të ulin kostot e transaksioneve që lidhen me aksesin në treg dhe përfshirjen.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1 Logjika e ndërhyrjes

Objektivi/(objektivat) /(ndikimi/ndikimet) e përgjithshëm i këtij veprimi është:

1. Të mbrojë shëndetin dhe interesat e konsumatorëve duke iu afruar politikave të sigurisë ushqimore të BE-së për të garantuar nivelin më të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe standardeve të shëndetit të bimëve.

Objektivat (rezultatet) specifikë të këtij veprimi janë:

1. Kuadër i forcuar legjislativ dhe administrativ për sigurinë ushqimore, fushën veterinare dhe fitosanitare dhe kontrollet zyrtare;

2. Kapacitete të përforcuara administrative të institucioneve përkatëse për t'u përballur me inspektimin e sigurisë ushqimore, shërbimet veterinare dhe të shëndetit të bimëve sipas kërkesave të BE-së.

3. Kapacitete të përforcuara për të vlerësuar, kategorizuar dhe përmirësuar stabilimentet ushqimore;

4. Kontrolle zyrtare të përmirësuara, kapacitet laboratorik dhe menaxhim i sigurisë ushqimore bazuar në rrezik.

Rezultatet që do të ofrohen nga ky veprim që kontribuojnë në objektivat (rezultatet) specifikë përkatës, janë:

Rezultatet që kontribuojnë në rezultatin 1 (ose objektivin specifik 1):

Rezultati 1.1: Ligjet, aktet nënligjore dhe strategjitë kuadër që lidhen me kapitullin 12 të përgatitura;

Rezultati 1.2: Kapacitetet e ngritura për menaxhimin dhe zbatimin e nënprodukteve shtazore (ABP);

Rezultati 1.3: Efektivitet i përmirësuar në zbulimin, luftimin dhe kufizimin e madhësisë së një shpërthimi të sëmundjeve të kafshëve dhe dëmtuesve të bimëve në përputhje me standardet e BE-së.

Rezultatet që kontribuojnë në rezultatin 2 (ose objektivin specifik 2):

Rezultati 2.1: Kapacitete të përmirësuara të shërbimeve ushqimore, veterinare dhe fitosanitare sipas kërkesave të *acquis* të BE-së;

Rezultati 2.2: Kapacitete të përmirësuara të shërbimeve të sigurisë ushqimore dhe veterinare për hartimin dhe zbatimin e planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve (NRMP);

Rezultati 2.3: Krijimi i planeve të kontrollit për ndotësit dhe mbetjet e pesticideve në përputhje me kërkesat e BE-së;

Rezultatet që kontribuojnë në rezultatin 3 (ose objektivin specifik 3):

Rezultati 3.1: Kapacitete të përmirësuara për drejtimin e kategorizimit të objekteve ushqimore;

Rezultati 3.2: Kapacitete të përmirësuara për përmirësimin e objekteve ushqimore në përputhje me kërkesat e BE-së;

Rezultatet që kontribuojnë në rezultatin 4 (ose objektivin specifik 4):

Rezultati 4.1: Kapacitete të përforcuara laboratorike për të përmbushur kërkesat e akreditimit/miratimit;

Rezultati 4.2: Pajisje të përmirësuara në laboratorët e sigurisë ushqimore, veterinare, shëndetit të bimëve dhe farërave.

3.2 Aktivitete treguese

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 1.1

- Mbështetje në përgatitjen e ligjeve të mëposhtme:
- ligji "Për produktet e mbrojtjes së bimëve";
- ligji "Për organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ)";
- ligji "Për materialin mbjellës";
- ligji "Për mirëqenien e kafshëve";
- ndryshimi i ligjit kombëtar për veterinarinë;
- ligji për ushqimin;
- ligji për ushqimin e kafshëve.
- Mbështetje në përgatitjen e akteve legjislative (akteve nënligjore) që lidhen me kapitullin 12.
- Mbështetje në përgatitjen e planit shumëvjeçar për monitorimin e mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore të përgatitura;
- Mbështetje në përgatitjen e pilotimit të monitorimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar në nivelin e fermerëve, pikave të grumbullimit dhe përpunuesve.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 1.2

- Mbështetje për hartimin e strategjisë për menaxhimin e nënprodukteve shtazore (NPSH);
- Mbështetje në përgatitjen e Planit Shumëvjeçar të Veprimit dhe Planit të Emergjencës për menaxhimin e nënprodukteve shtazore (NPSH);
- Mbështetje në përgatitjen e akteve legjislative që lidhen me NPSH-në;
- Trajnim për veterinerët zyrtarë në stabilimentet e NPSH-ve;
- Pilotimi i kategorizimit, trajtimit dhe asgjësimit të NPSH-ve (kat. 1+ kat. 2);
- Aktivitete të organizuara për ndërgjegjësimin publik;

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 1.3

- Mbështetje për përgatitjen e strategjisë shumëvjeçare, planit të veprimit për zhdukjen e sëmundjeve zoonotike (sëmundjet e listës së kategorisë A);
- Mbështetje në përgatitjen e planit shumëvjeçar të kontrollit për dëmtuesit;
- Mbështetje për zbatimin dhe përmirësimin e planeve të emergjencës për të gjitha sëmundjet e kërkuara të kafshëve sipas legjislacionit të BE-së për shëndetin e kafshëve;
- Mbështetje për zbatimin dhe përmirësimin e planeve të emergjencës për dëmtuesit karantinorë;
- Krijimi i 6 zonave të mbrojtura nga dëmtuesit;
- Mbështetje në përgatitjen e planeve të mbikëqyrjes për BSE-në (Encefalopatia Spongiforme Bovike) dhe TDE (Encefalopatitë Spongiforme të Transmetueshme);

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 2.1:

- Trajnimi i stafit përkatës mbi zbatimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri në përputhje me *acquis* të BE-së*;*
- Mbështetje për përgatitjen e Strategjisë së Kualifikimit Profesional në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor dhe përmirësimin e kurrikulave dhe/ose shkollave të arsimit profesional bujqësor;

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 2.2:

- Mbështetje në hartimin e Planit të Zbatimit të Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve (PKMM));
- Trajnimi i stafit përgjegjës për PKMM-në;

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 2.3

- Mbështetja e krijimit të planeve të kontrollit për ndotësit dhe mbetjet e pesticideve në përputhje me kërkesat e BE-së;

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 3.1:

- Mbështetje për përfundimin e planit kombëtar për kryerjen e vlerësimit dhe kategorizimit në të gjitha institucionet ushqimore në të gjithë Shqipërinë dhe përcaktimin e atyre që duhet të përmirësohen;
- Rritja e ndërgjegjësimit për operatorët e biznesit ushqimor (OBU) mbi kategorizimin e institucioneve ushqimore dhe përgatitjen e planeve të veprimit bazuar në kategori.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 3.2:

- Mbështetje pilot për përgatitjen e planeve të përmirësimit për objektet ushqimore që hyjnënë kategorinë e rrezikut të lartë;
- Mbështetje për vlerësimin e planeve të veprimit të përgatitura nga OBU-të, monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit të përmirësimit.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 4.1

- Mbështetja e akreditimit të laboratorëve rajonalë të NFA-së me standardin ISO;

- Mbështetja e akreditimit të Laboratorit të Entit Shtetëror të Farave;

- Mbështetja e akreditimit të metodave të reja laboratorike në fushën e mbetjeve të barnave veterinare, analizimit të aditivëve dhe shëndetit të kafshëve për ISUV;

- Mbështetja e metodave të ndryshme të validimit të analizave laboratorike për vezë/peshk/qumësht/gjalpë/salsiçe/ushqim/drithëra/nënprodukte shtazore/produkte me origjinë bimore/molusqe;

- Trajnimi i stafit të laboratorëve.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 4.2

- Vlerësimi dhe përmirësimi i kushteve të postave të inspektimit kufitar për të kryer kontrolle zyrtare dhe përmbushur standardet ndërkombëtare

- Hartimi i një metodologjie për planin e bazuar në rrezik të kontrolleve zyrtare në PIK në përputhje me rregulloren e BE-së.

- Ngritja dhe forcimi i qendrave të parashikimit-sinjalizimit për të forcuar kapacitetet e monitorimit të saktë të sëmundjeve dhe shpërthimeve të dëmtuesve;

- Blerja e pajisjeve për përmirësimin e laboratorëve (AKU, ISUV, Laboratori i Entit të Farave)

3.3 Integrimi

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti

Veprimi i propozuar nuk adreson në mënyrë specifike treguesit e ndryshimeve klimatike apo të biodiversitetit, as për sa i përket zbutjes apo përshtatjes, por përmbush këto objektiva në mënyra të ndryshme, të tilla si forcimi i rregulloreve për sigurinë ushqimore dhe sistemeve të tjera për ruajtjen e ushqimeve në zona të prekura nga temperaturat e larta; promovimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore me synim mbrojtjen e biodiversitetit në ekosistemet bujqësore dhe kontributi në tregtinë e qëndrueshme të specieve bimore ose shtazore me vlerë dhe produkteve të nxjerra prej tyre.

Konsideratat mjedisore do të pasqyrohen në mënyrë të duhur në të gjitha aktivitetet e financuara nga IPA-ja. Ndërkohë që ndryshimet klimatike kanë ndikim në shfaqjen e sëmundjeve shtazore dhe dëmtuesve të bimëve, dhe në veçanti përhapjen e tyre, ky veprim nuk kontribuon drejtpërdrejt në ndryshimet klimatike. Përmirësimi i shëndetit veterinar dhe përmirësimi i laboratorëve do të përfshijnë masa për përshtatje me standarde më të larta të qëndrueshmërisë mjedisore (p.sh. mbetjet shtazore). Mbetjet e rrezikshme mund të përbëjnë kërcënim për shëndetin e njeriut ose për mjedisin nëse nuk menaxhohen siç duhet. Ndërtimi i sistemit për mbledhjen e nënprodukteve shtazore do të çojë në trajtimin e sigurt dhe efektiv të mbetjeve të rrezikshme, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Megjithatë, ky veprim do të ketë ndikim të kufizuar të drejtpërdrejtë në mjedis.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

Sipas kodeve për çështjet gjinore DAC të OBEZH-së (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si G0. Kjo nënkupton që ky dokument veprimi do të thotë që projekti/programi është shqyrtuar sipas shënuesit gjinor, por nuk është gjetur se synon barazinë gjinore. Megjithatë, aktivitetet në këtë dokument veprimi do të zbatohen në përputhje me të gjitha parimet kryesore të integrimit gjinor.

Në këtë kuptim, veprimi i propozuar do të ofrojë një mundësi për gratë e kualifikuara që të përfshihen në ato aktivitete që tradicionalisht zbatohen nga burrat, p.sh. shërbimet e inspektimit, auditimi i fabrikave të përpunimit të ushqimit etj.

Në shpalljet për vende pune dhe në të gjitha institucionet e përfshira, ky veprim do të synojë të sigurojë përfaqësim të barabartë gjinor, të përcaktuar si jo më pak se 30% në çdo institucion, nivel drejtues dhe organ të emëruar. Të drejtat e barabarta të tyre në Shqipëri janë të garantuara nga ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri". Sipas këtij ligji, barazia gjinore nënkupton pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat, pozicione të barabarta mes tyre, mundësi dhe shanse të barabarta për të gëzuar të drejtat dhe përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar në mënyrë të barabartë nga arritjet e zhvillimit të saj.

Bizneset në pronësi të grave do të kenë përparësi për të përfituar nga ky Veprim; gratë që janë të punësuara në ferma dhe biznese do të trajtohen me prioritet gjatë përzgjedhjes për të marrë pjesë në trajnimet e ofruara nga ky Veprim. Gratë do të inkurajohen në mënyrë të veçantë që të ndjekin programet e trajnimit dhe do të kenë gjithashtu avantazh në skemat e trajnimit të trajnerëve dhe rolet drejtuese në funksionimin e zyrave rajonale të AKVMB-së dhe AKU-së.

Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve ofrojnë mundësinë për monitorimin e numrit të individëve/inspektorëve të trajnuar, të ndarë sipas gjinisë.

Gjatë gjithë zbatimit të këtij Veprimi, do të kryhet analiza gjinore për të garantuar integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha aktivitetet, të tilla si planet, fushata promocionale, zhvillimi i politikave, vlerësimet ose vlerësimet. Perspektiva gjinore do të lehtësojë aksesin e barabartë në burime dhe mundësi dhe do të nxisë pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit.

Konsiderata të tjera, nëse janë të rëndësishme

Shqetësimet/problematikat e minoriteteve dhe grupeve të cenueshme do të pasqyrohen në të gjitha aktivitetet, veçanërisht kur bëhet fjalë për shërbimet publike, çështjet legjislative dhe zhvillimin socio-ekonomik. Do të respektohen mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi.

3.4 Rreziqet dhe supozimet

Kategoria	Rreziku	Probabiliteti (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (i lartë/ mesatar/i ulët)	Masat zbutëse
Politike	Rreziku 1: Mbështetje e pamjaftueshme nga angazhimi politik ndaj procesit të integrimit në BE	**Mesatar**	**I ulët**	Ky rrezik mund të zbutet nëpërmjet zbatimit të vazhdueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.
Korrupsion/Mashtrim	Rreziku 2: Kuadri ligjor dhe rregullator nuk zbatohet në mënyrë efektive	**Mesatar**	**I ulët**	Rreziku i korrupsionit dhe mashtrimit mund të zbutet përmes dialogut të vazhdueshëm politik të nivelit të lartë me Qeverinë mbi zbatimin e masave të kapitujve 23 dhe 24 për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit.
Mjedisi i jashtëm	Rreziku 3: Koordinimi dhe bashkëpunimi i palëve të interesuara është reduktuar gjatë proceseve të hartimit të ligjeve dhe politikave, përgatitjes së buxhetit, zbatimit dhe rishikimit të strategjive sektoriale që përfshijnë palë të ndryshme të interesuara.	**Mesatar**	**Mesatar**	Garantimi i dialogut të vazhdueshëm politik në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian
Njerëzit dhe organizata	Rreziku 4: Mungesa e menaxhimit të njohurive dhe aftësive të kapaciteteve institucionale, e përkeqësuar nga flukset e larta të personelit	**Mesatar**	**I lartë**	Hartoni politika institucionale të Burimeve Njerëzore me mbajtësit e detyrave dhe planeve shumëvjeçare për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë buxhetimin e bazuar në performancë.
Mjedisi i jashtëm	Rreziku 5: Përkeqësimi i situatës socio-ekonomike që çon në kufizime financiare/buxhetore dhe disponueshmëri të kufizuar të fondeve, gjithashtu për shkak të luftës në Ukrainë	**I lartë**	**I lartë**	Forcimi i koordinimit të donatorëve dhe qeverisë në sektor

Supozime të jashtme

Rezultati 1

- Qeveria shqiptare, në përputhje me procesin e aderimit në BE, e konsideron sigurinë ushqimore një përparësi.

- Stabiliteti ekonomik dhe politik ruhet.

Rezultati 2

- Dispozita të mjaftueshme për mbajtjen e stafit administrativ nga buxheti kombëtar.
- Gatishmëri individuale dhe institucionale për t'u përshtatur me ndryshimet për një menaxhim më efektiv dhe efikas të politikave dhe programeve sektoriale.

Rezultati 3

- Operatorët e biznesit ushqimor të gatshëm për të bashkëpunuar.
- Mbështetje financiare e ofruar përmes IPARD/buxhetit kombëtar për përmirësimin e institucioneve.

Rezultati 4

- Qeveria ndan burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur një aktivitet optimal laboratorik të kryer në përputhje me detyrat dhe ngarkesën e punës së planifikuar.

3.5 Matrica treguese e kuadrit logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit [të paktën një tregues për rezultatin e pritshëm	Standardet referuese (2023)	Objektivat (2030)	Burimet e të dhënave	Supozime
Ndikimi	Të mbrojë shëndetin dhe interesat e konsumatorëve duke iu afruar politikave të sigurisë ushqimore të BE-së për të garantuar nivelin më të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe standardeve të shëndetit të bimëve.	Numri i konsumatorëve/qytetarëve të prekur nga sëmundjet me origjinë ushqimore, si dhe gjendja shëndetësore e kafshëve dhe bimëve;		Reduktimi me të paktën 30%	Raporti i shëndetit publik	*Nuk aplikohet*
Rezultati 1	Kornizë legjislative dhe administrative e forcuar për sigurinë ushqimore, fushën veterinare dhe fitosanitare dhe kontrollet zyrtare;	1.1 Niveli i përputhshmërisë me *acquis* në kapitullin 12.	1.1 32%	1.1 70%	Raportet vjetore të KE-së Raportet e auditimit të KE-së Raportet e shqyrtimit të KE-së Raportet e monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE)	Qeveria shqiptare, në përputhje me procesin e aderimit në BE, e konsideron sigurinë ushqimore një përparësi. Stabiliteti ekonomik dhe politik ruhet. Stafi administrativ i mjaftueshëm është i garantuar. Legjislacioni në lidhje me të drejtat dhe rolin e shoqërisë civile dhe konsumatorëve, është në fuqi.
Rezultati 2	Kapacitete të forcuara administrative të institucioneve përkatëse për t'u përballur me inspektimin e sigurisë ushqimore, shërbimet veterinare dhe të shëndetit të bimëve sipas kërkesave të BE-së.	2.1 Progresi i bërë në zbatimin e rregullave dhe standardeve të harmonizuara me rregullat e BE-së;	2.1 Përparim modest	2.1 Kapitulli 12 hapet për negociata	Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raportet e auditimit të KE-së Raportet e monitorimit të PKIE-së	Dispozita të mjaftueshme për mbajtjen e stafit administrativ nga buxheti kombëtar Gatishmëri individuale dhe institucionale për t'u përshtatur me ndryshimet për një menaxhim më efektiv dhe efikas të politikave dhe programeve sektoriale Fluks i vazhdueshëm i transferimit të njohurive
Rezultati 3	Kapacitete të forcuara për të kategorizuar dhe përmirësuar lokalet ushqimore;	3.1 Numri i stabilimenteve të miratuara për eksport në BE; 3.2 Numri i stabilimenteve ushqimore me mospërputhje është ulur	3.1 43 (2022) 3.2 Pika bazë që duhet të vendoset gjatë veprimit	3.1 (85) 3.2 Ulja e numrit të stabilimenteve ushqimore jokonsistente me 30% në krahasim me bazën.	Raportet e MBZHR-së, AKVMB-së dhe AKU-së Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raportet e auditimit të KE-së	
Rezultati 4	Kontrolle zyrtare të përmirësuara, kapacitet laboratorik dhe menaxhim i sigurisë ushqimore bazuar në rrezik.	4.1 Niveli i përputhshmërisë së laboratorëve me kërkesat e BE-së	4.1 I papërcaktuar	4.1 85%	Raportet e MBZHR-së Raportet e auditimit të KE-së Raportet e shqyrtimit të KE-së	Qeveria ndan burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur një aktivitet optimal laboratorik të kryer në përputhje me detyrat e saj dhe ngarkesën e punës të planifikuar.

Produkti 1 i lidhur me rezultatin 1	1.1 Ligjet kuadër, aktet nënligjore dhe strategjitë që lidhen me kapitullin 12, të përgatitura	1.1.1 Ligji "Për produktet e mbrojtjes së bimëve", i përgatitur; 1.1.2 Ligji "Për organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ)", i përgatitur; 1.1.3 Ligji "Për materialin mbjellës", i përgatitur; 1.1.4 Ligji "Për mirëqenien e kafshëve", i përgatitur; 1.1.5 Ligji për Veterinarinë, i përgatitur; 1.1.6 Ligji për ushqimin, i përgatitur; 1.1.7 Ligji për ushqimin e kafshëve, i përgatitur; 1.1.8 Numri i akteve legjislative (akteve nënligjore) të përgatitura. 1.1.9 Plani shumëvjeçar për monitorimin e mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore, i përgatitur; 1.10.10 Pilotimi i monitorimit të cilësisë së qumështit të papërpunuar	1.1.1 -1.1.7 (0) 1.1.8 (0) 1.1.9 (0) 1.1.10 (0)	1.1.1 -1.1.7 (7) Ligji i ri i përgatitur; 1.1.8 (100) 1.1.9 (1) 1.10.12 (3) Niveli i fermës, pikat e grumbullimit dhe përpunuesit.	Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raporti i Shqyrtimit Raportet e shqyrtimit të KE-së Raportet e auditimit të KE-së Raportet e monitorimit të PKIE-së	Gatishmëria politike për përaftim të mëtejshëm me standardet e BE-së Gatishmëria individuale dhe institucionale për t'u përshtatur me ndryshimet për një menaxhim më efektiv dhe efikas të politikave dhe programeve sektoriale Koordinim efektiv i veprimeve nga palët e ndryshme të interesuara Dispozita të mjaftueshme për të mbajtur stafin administrativ nga buxheti kombëtar
Produkti 2 i lidhur me rezultatin 1	1.2 Kapacitete të ngritura për menaxhimin dhe zbatimin e nënprodukteve shtazore (NPSH)	1.2.1 Strategjia + Plani shumëvjeçar i Veprimit + Plani i emergjencës për menaxhimin e NSHP-ve, të përgatitura. 1.2.2 Numri i akteve legjislative,= të përgatitura. 1.2.3 Numri i veterinerëve zyrtarë të trajnuar në stabilimentet e NSHP-ve. 1.2.4 Pilotimi i kategorizimit, trajtimit dhe asgjësimit të NSHP-ve (kat. 1 + kat. 2) 1.2.5 Numri i aktiviteteve të organizuara për ndërgjegjësimin publik.	1.2.1 (0) 1.2.2 (0) 1.2.3 (0) 1.2.4 (0) 1.2.5 (0)	1.2.1 (1) 1.2.2 (2) 1.2.3 (250) 1.2.4 (3) 1.2.5 (3)	Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raporti i Shqyrtimit Raportet e shqyrtimit të KE-së Raportet e auditimit të KE-së Raportet e monitorimit të PKIE-së	
Produkti 3 i lidhur me rezultatin 1	1.3 Efektivitet i përmirësuar në zbulimin, luftimin dhe kufizimin e madhësisë së një shpërthimi të sëmundjeve të kafshëve dhe dëmtuesve të bimëve në përputhje me standardin e BE-së;	1.3.1 Strategji shumëvjeçare dhe plan veprimi për eliminimin e sëmundjeve zoonotike të përgatitur (sëmundjet e listës së kategorisë A); 1.3.2 Plan kontrolli shumëvjeçar për dëmtuesit, i përgatitur; 1.3.3 Numri i planeve të emergjencës, të zhvilluara/përmirësuara për të gjitha sëmundjet e kërkuara të kafshëve sipas ligjit të BE-së për Shëndetin e Kafshëve; 1.3.4 Numri i planeve të emergjencës, të	1.3.1 10% (2022) 1.3.2 (0) 1.3.3 5 (2025)[34] 1.3.4 12 (2025)[35]	1.3.1 75% (2030) 1.3.2 (1) 1.3.3 (10) 1.3.4 6 (18)	Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raporti i Shqyrtimit Raportet e shqyrtimit të KE-së Raportet e auditimit të KE-së Raportet e monitorimit të PKIE-së	

[34] Sipas Dokumentit të Veprimit për "Ndërtimin e kapaciteteve të shërbimeve veterinare dhe të shëndetit të bimëve në Ballkanin Perëndimor"/Plani shumëvjeçar i veprimit shumëvendësh në favor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për vitet 2021–2022/IPA III/2021/NEAR>SANTE/16 - 3.6. Kuadri logjik për VEPRIM MODALITETIN/ Produkti 1/Rezultati 2

[35] Sipas Dokumentit të Veprimit për "Ndërtimin e kapaciteteve të shërbimeve veterinare dhe të shëndetit të bimëve në Ballkanin Perëndimor" / Plani shumëvjeçar i veprimit shumëvendësh në favor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për vitet 2021–2022 / IPA III/2021/NEAR>SANTE/16 - 3.6. Kuadri logjik për VEPRIM MODALITETIN/ Produkti 1/ rezultati 3

		zhvilluara/përmirësuara për dëmtuesit e karantinës; 1.3.5 Krijimi i zonave të mbrojtura nga dëmtuesit; 1.3.6 Planet e survejimit për BSE-në dhe TSE-në, të përgatitura.	1.3.5 (0) 1.3.6 (0)	1.3.5 (6 fusha) 1.3.6 (2)		
Produkti 1 i lidhur me rezultatin 2	2.1 Kapacitete të përmirësuara të shërbimeve ushqimore, veterinare dhe fitosanitare sipas kërkesave të *acquis* të BE-së;	2.1.1 Numri i stafit të trajnuar për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri në përputhje me *acquis* të BE-së; 2.1.2 Strategjia e Kualifikimit Profesional, e përgatitur; 2.1.3 Numri i kurrikulave për të përgatitur	2.1.1 0 2.1.2 (0) 2.1.3 (0)	2.1.1 350 2.1.2 (1) 2.1.3 (2)	Raportet e MBZHR-së, AKVMB-së dhe AKU-së Raportet e auditimit të KE-së	
Produkti 2 i lidhur me rezultatin 2	2.2 Kapacitete të përmirësuara të shërbimeve të sigurisë ushqimore dhe veterinare për hartimin dhe zbatimin e planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve (PKMM).	2.2.1 Plani i Zbatimit të PKMM-së i hartuar; 2.2.2 Numri i stafit të trajnuar për PKMM-në;	2.2.1 (0) 2.2.2 (0)	2.2.1 (2 vite) 2.2.2 (50)	Plani Vjetor i PKMM-së i dorëzuar te DG SANTE Drejtoria e Përgjithshme* për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore	
Produkti 3 Rezultati 2	2.3 Vendosja e planeve të kontrollit për ndotësit dhe mbetjet e pesticideve në përputhje me kërkesat e BE-së;	2.3.1 Sistemi i Farmakovigjilencës funksional	2.3.1 (0)	2.3.1 (1)	Raporti Vjetor për DG SANTE	
Produkti 1 i lidhur me rezultatin 3	3.1 Kapacitete të përmirësuara për drejtimin e kategorizimit të objekteve ushqimore;	3.1.1 Numri i inspektorëve të trajnuar; 3.1.2 Numri i institucioneve të vlerësuara dhe të kategorizuara dhe që duhet të ishin përmirësuar	3.1.1 (28) inspektorë u trajnuan për vlerësimin e institucioneve; (58) inspektorë morën trajnim hyrës mbi kërkesat strukturore, operative dhe higjienike. 3.1.2 (0)	3.1.1 200 inspektorë të trajnuar 3.1.2 50	Raportet e MBZHR-së, AKVMB-së dhe AKU-së Raportet vjetore të Komisionit Evropian Raportet e auditimit të KE-së Raportet sipas shqyrtimit	Një numër i mjaftueshëm stafi është caktuar për të kryer kategorizimin e institucioneve. Operatorët e biznesit ushqimor janë të gatshëm të bashkëpunojnë. Mbështetje financiare e ofruar përmes IPARD/buxhetit kombëtar për përmirësimin e institucioneve.
Produkti 2 i lidhur me rezultatin 3	3.2 Kapacitete të përmirësuara për përmirësimin e objekteve ushqimore në përputhje me kërkesat e BE-së;	3.2.1 Numri i institucioneve që do të përmirësohen;	3.2.1 (0) Ky tregues do të përcaktohet pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe kategorizimit.	3.2.1 3 (800)		
Produkti 1 i lidhur me rezultatin 4	4.1.1 Numri i laboratorëve rajonalë të AKU-së të akredituar me normën ISO; 4.1.2 Laboratori i Entit Shtetëror të Farave të Akredituar	4.1.1 Numri i laboratorëve rajonalë të AKU-së të akredituar me normë ISO; 4.1.2 Laboratori i Entit Shtetëror të Farave i akredituar. 4.1.3 Numri i metodave të reja të akredituara laboratorike në fushën e mbetjeve të barnave veterinare, analizimit të aditivëve dhe shëndetit të kafshëve për ISUV;	4.1.1 (0) 4.1.2 (0) 4.1.3 (0)	4.1.1 (7) 4.1.2 (1) 4.1.3 (3) Tri fusha që lidhen me mbetjet e barnave veterinare, analizimin e aditivëve dhe		Strategjia për rrjetin e laboratorëve është miratuar. Rolet dhe përgjegjësitë e laboratorëve janë përcaktuar qartë.

		4.1.4 Numri i metodave të validuara të analizave të ndryshme laboratorike për vezë/peshk/qumësht/gjalpë/salçiçe/ushqim/drithëra/nënprodukte shtazore/produkte me origjinë bimore/molusqe të treguara për Programin Kombëtar të Monitorimit të Rrezikut (PKMR) 4.1.5 Stafi i laboratorit i trajnuar dhe i përgatitur për të kryer një sërë analizash laboratorike të caktuara	4.1.4 (0) 4.1.5 (0)	shëndetin e kafshëve. 4.1.4 (15) 4.1.5 (75)		
Produkti 2 Rezultati 4	4.2 Pajisje të përmirësuara në laboratorët e sigurisë ushqimore, veterinare, shëndetit të bimëve dhe farërave;	4.2.1 Numri i Postave të Inspektimit Kufitar të përmirësuara për të kryer kontrolle zyrtare dhe për të përmbushur standardet ndërkombëtare; 4.2.2 Ngritja dhe forcimi i qendrave të parashikimit-sinjalizimit 4.2.3 Numri i analizave të reja të kryera në laboratorët e mbështetur nga projekti 4.2.4 Pajisjet e blera për përmirësimin e laboratorëve [36]	4.2 7[37] 4.2.2 (0) 4.2.3 (0) 4.2.4 0[38]	4.2.1 (13) 4.2.2 (6) 4.2.3 (250) 4.2.4 (2) laboratorë të përmirësuar		

4. MARRËVESHJET ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e Financimit

Për të zbatuar këtë veprim, parashikohet të lidhet një marrëveshje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2 Periudha treguese e zbatimit

Periudha treguese e zbatimit operativ të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 72 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes së financimit.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të miratohen nga zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit duke ndryshuar këtë vendim financimi dhe kontratat e marrëveshjet përkatëse.

4.3 Metodat e zbatimit

Komisioni do të garantojë që të respektohen rregullat dhe procedurat e duhura të BE-së për ofrimin e financimit për palët e treta, duke përfshirë procedurat e shqyrtimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së[34].

4.3.1 Menaxhim indirekt me një entitet të vlerësuar sipas shtyllave

Ky veprim mund të zbatohet në menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllës, i cili do të zgjidhet duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- kapacitet i provuar i subjektivitetit për zbatimin e projekteve të ngjashme në lidhje me kompleksitetin, kapacitetet teknike dhe menaxheriale në fushën e sigurisë ushqimore, me referencë të veçantë në hartimin e politikave dhe prokurimin e pajisjeve teknike për të qenë në përputhje me *acquis* të BE-së;
- njësia e besuar duhet në mënyrë ideale të bashkëpunojë për këtë veprim me një autoritet publik të një shteti anëtar të BE-së ose organizatë që trajton sigurinë ushqimore;
- përvoja, në zbatimin e projekteve në kontekstin e negociatave të aderimit në BE, konsiderohet avantazh;
- përvoja në rajon, veçanërisht në Shqipëri, konsiderohet një vlerë e shtuar;

[34] Harta e Sanksioneve të BE-së. Ju lutem vini re se harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve rrjedh nga aktet ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare (FZ). Në rast mospërputhjeje midis akteve ligjore të botuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni i FZ-së do të ketë përparësi.

- kapaciteti financiar dhe gatishmëria për të ofruar bashkëfinancim (vlerë e shtuar).

4.3.2 Ndryshimet nga mënyra e menaxhimit indirekt në atë të drejtpërdrejtë (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme

Nëse modaliteti i zbatimit nën menaxhim indirekt, siç përcaktohet në seksionin 4.3.1, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, modaliteti i zbatimit me anë të granteve nën menaxhim të drejtpërdrejtë do të përdoret sipas sa vijon:

a) Qëllimi i grantit/granteve

Granti do të kontribuojë në arritjen e të gjitha objektivave specifikë të këtij Veprimi.

b) Lloji i aplikantëve të synuar

Subjekti/enti mund të jetë një lloj specifik organizate, të tillë si departamenti qeveritar, organi publik ose organi përkatës i mandatuar i një departamenti qeveritar ose autoriteti i organit publik të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian në fushat që lidhen me këtë veprim.

4.4 Fusha e zbatimit të kritereve gjeografike për prokurim dhe grante

Përshtatshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve dhe për sa i përket origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin bazë dhe përcaktohet në dokumentet përkatëse kontraktuale, do të zbatohet, në bazë të dispozitave të mëposhtme:

Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund ta zgjerojë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores së IFZHBN (Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar) -Global Europe).

4.5 Buxheti tregues

Komponentët e buxhetit tregues	Kontributi i BE-së (shuma në EURO)	Kontributi tregues i palës së tretë (EURO)
Metodat e zbatimit – shihni seksionin 4.3.1		**Nuk aplikohet**
Rezultati 1, 2, 3, 4 i përbërë nga	**12 500 000**	**Nuk aplikohet**
Menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave – shihni seksionin 4.3.1	12 500 000	Nuk aplikohet
Vlerësimi – shihni seksionin 5.2 **Auditimi** – shihni seksionin 5.3	Mund të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk aplikohet
Komunikimi strategjik dhe diplomacia publike – shihni seksionin 6	Mund të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk aplikohet
Totali	**12 500 000**	

4.6 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Përfituesit kryesorë të Veprimit do të jenë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë, Agjencia Kombëtare për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve, Agjencia për Qendrën e Transferimit të Teknologjisë dhe çdo institucion tjetër sipas kërkesës së MBZHR-së do të mbështesin zbatimin e projektit.

Do të ngrihet një komitet drejtues i projektit (KDP), që do të drejtojë zbatimin e projektit. KDP-ja do të përfshijë përfaqësues nga palët kryesore të interesuara, si dhe nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA) dhe Delegacioni i BE-së. KDP-ja do të monitorojë nga afër përmbushjen e objektivit të projektit dhe rezultatet e tij. KKIPA-ja do të ketë rolin e monitorimit të përmbushjes së objektivave në nivelin e Veprimit dhe do të koordinojë monitorimin e tij në kontekstin e Komitetit Sektorial të Monitorimit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

Si pjesë e prerogativës së tij të zbatimit të buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit, Komisioni Evropian mund të marrë pjesë në strukturat e qeverisjes së mësipërme të ngritura për të qeverisur zbatimin e veprimit.

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues duhet të krijojë një sistem të përhershëm monitorimi të

brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin dhe të hartojë raporte të rregullta progresi (jo më pak se vjetore) dhe raporte përfundimtare.

Çdo raport duhet të japë një përshkrim të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësive të hasura, ndryshimeve të prezantuara, si dhe shkallës së arritjes së produkteve të tij dhe kontributit në arritjen e rezultateve të tij, dhe nëse është e mundur në kohën e raportimit, kontributit në arritjen e ndikimeve të tij, të matura nga treguesit përkatës, duke përdorur si referencë matricën e kuadrit logjik (për modalitetin e projektit).

Komisioni mund të ndërmarrë vizita shtesë monitorimi të projektit si nëpërmjet stafit të tij ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve të pavarur të rekrutuar direkt nga Komisioni për rishikime të pavarura të monitorimit (ose të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e rishikimeve të tilla).

Marrëveshjet për monitorimin dhe raportimin, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizën dhe monitorimin e të dhënave:

MBZHR, si përfitues kryesorë, do të ndjekin arritjen e treguesve dhe rezultateve të përcaktuara brenda veprimit. Ata do të kenë përgjegjësinë për të mbledhur të dhënat në lidhje me treguesit dhe për të raportuar në kohë te KKIPA-ja, për të informuar rregullisht KKIPA-ja dhe palët e interesuara përkatëse mbi zbatimin e treguesve, si dhe për të ndjekur zbatimin e aktiviteteve përkatëse dhe për të njoftuar për çdo vonesë dhe arsyet që i kanë shkaktuar këto vonesa. Siç përshkruhet në seksionin 4.6 më sipër, monitorimi i përgjithshëm i zbatimit të veprimit do të kryhet në nivelin e Komitetit të Monitorimit Sektorial për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe në nivelin e Komitetit Drejtues të Projektit. Institucionet përkatëse do të përdorin mjetin e monitorimit të orientuar drejt rezultateve në raportimin mbi performancën dhe rezultatet, duke iu referuar kritereve të rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, qëndrueshmërisë, dhe do të ofrojnë informacion bazë që mund të shfrytëzohet për të orientuar monitorimin/vlerësimin/auditimin e ardhshëm dhe vendimet e menaxhimit në nivelin e veprimit.

KKIPA-ja do të jetë përgjegjës në nivel kombëtar për të monitoruar, shqyrtuar dhe vlerësuar progresin në zbatimin e treguesve të përcaktuar brenda matricës së kuadrit logjik të veprimit dhe për të komunikuar informacionin me shërbimet e Komisionit Evropian.

Sistemet statistikore dhe të monitorimit, si dhe cilësia e të dhënave zyrtare në fushën e politikave të mbuluara, janë vlerësuar.

5.2 Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e veprimit, do të kryhet(n) vlerësim(e) përfundimtar(e) për këtë veprim ose komponentët e tij nëpërmjet konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni.

Komisioni do të formojë një grup referencë (GR) i përbërë nga përfaqësues nga aktorët kryesorë në nivelin e BE-së dhe kombëtar (përfaqësues nga qeveria, organizata të shoqërisë civile – sektori privat, OJQ-të etj.). Nëse çmohet e nevojshme, do të ftohen edhe donatorë të tjerë për t'u bashkuar. Komisioni do t'i informojë partnerin zbatues të paktën tre muaj përpara për datat e parashikuara për ushtrimin e vlerësimit dhe misionet. Partneri zbatues duhet të bashkëpunojë në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët e vlerësimit, dhe, ndër të tjera, t'u ofrojë atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe qasje në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit do të ndahen me vendin partner dhe palët e tjera të interesuara kryesore duke ndjekur praktikën më të mirë të shpërndarjes së vlerësimit. Partneri zbatues dhe Komisioni do të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e nevojshme, në marrëveshje me vendin partner, do të vendosin së bashku për veprimet pasuese që do të ndërmerren dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse specifikohet, riorientimin e projektit.

Shërbimet e vlerësimit mund të kontraktohen sipas një kontrate kuadër.

5.3 Auditimi dhe verifikimet

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij veprimi, Komisioni, në bazë të një vlerësimi të rrezikut, mund të kontraktojë auditim ose verifikim të pavarur për një ose disa kontrata ose marrëveshje.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual për të informuar audiencat përkatëse për mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre duke shfaqur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të

shkurtër financimi, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me veprimet përkatëse. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022 *Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme* (ose çdo dokument pasardhës).

Ky detyrim do të zbatohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse veprimet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve ose subjektet e besuara ose të deleguara, të tilla si agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e Shteteve Anëtare të BE-së. Në secilin rast, një referencë për detyrimet përkatëse kontraktuale duhet të përfshihet në marrëveshjen përkatëse të financimit, kontratat e prokurimit dhe grantit, si dhe marrëveshjet e kontributit.

Me qëllim rritjen e vizibilitetit të BE-së dhe kontributit të saj në këtë veprim, Komisioni mund të nënshkruajë ose të hyjë në deklarata ose deklarata të përbashkëta, si pjesë e prerogativës së tij të zbatimit të buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Unionit. Masat e vizibilitetit dhe komunikimit duhet gjithashtu të nxisin transparencën dhe llogaridhënien mbi përdorimin e fondeve. Duhet të matet efektiviteti i aktiviteteve të komunikimit në ndërgjegjësimin rreth veprimit dhe objektivave të tij, si dhe në financimin e veprimit nga BE-ja.

Partnerët zbatues duhet ta mbajnë Komisionin dhe Delegacionin e BE-së/Zyrën e BE-së plotësisht të informuar për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit para zbatimit. Partnerët zbatues do të sigurojnë vizibilitet të mjaftueshmëm të financimit të BE-së dhe do të raportojnë mbi veprimet e vizibilitetit dhe komunikimit, si dhe rezultatet e veprimit të përgjithshëm, te komitetet përkatëse të monitorimit.

7. QËNDRUESHMËRIA

Qëndrueshmëria e aktiviteteve të projektit përtej periudhës së zbatimit pritet të jetë e lartë. Aktivitetet e projektit po e mbështesin Shqipërinë për të ndërtuar kapacitetin e MBZHR-së dhe institucioneve përkatëse për t'u bërë në përputhje me kërkesat e BE-së paraaderimit. Rritja e kapacitetit të institucioneve, si dhe krijimi i sistemeve të kërkuara, do ta ndihmojë Shqipërinë të ketë akses në fondet e ardhshme të BE-së për zhvillimin bujqësor dhe rural në kuadër të Instrumentit për Asistencën Paraaderimit.

Aktivitetet marrin në konsideratë dhe plotësojnë aktivitete të tjera të vazhdueshme që mbështesin Shqipërinë në rritjen e kapacitetit të saj institucional për të zbatuar kërkesat e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. Përmbushja e këtyre kërkesave do të vazhdojë të jetë kritike në planin afatgjatë si për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit bujqësor ashtu edhe për përmbushjen e standardeve të negociatave të pranimit në BE.

Kapacitetet e përmirësuara për të transpozuar, zbatuar dhe zbatuar rregullat dhe standardet në përputhje me *acquis* të BE-së do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin dhe përshpejtimin e negociatave të pranimit me BE-në, i cili është qëllimi përfundimtar i Qeverisë së Shqipërisë dhe do të përmirësojë performancën ekonomike të sektorit ushqimor në Shqipëri. Si rrjedhojë, Veprimi do të kontribuojë në progresin dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura në kuadër të reformave të procesit të pranimit në BE, të mbështetura nga IPA III.

Veprimet do të kenë ndikim në sistemin kombëtar të sigurisë ushqimore, veterinar dhe fitosanitar. Do të ndihmojnë në sigurimin e të njëjtit nivel kontrolli dhe mbrojtjeje për produktet ushqimore që shiten brenda territorit të Shqipërisë. Ndikimi i drejtpërdrejtë i pritur i veprimit do të jetë ulja e incidencës dhe sëmundjeve ushqimore. Veprimi i propozuar pritet gjithashtu të ketë një ndikim të gjerë në shëndetin e konsumatorëve në Shqipëri.

Ai do të rrisë konkurrencën e produkteve shqiptare në tregun e brendshëm të BE-së dhe tregjet në rajon.

Trajnimet që janë pjesë integrale e këtij Veprimi do të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e stafit të administratës, stafit të inspektimit dhe laboratorit, veterinerëve në terren dhe palëve të tjera të interesuara, në një numër fushash në kapitullin 12. Ky komponent i ndërtimit të kapaciteteve do të kontribuojë në qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura.

AL
KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA IV
Vendimi Zbatues i Komisionit për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
Dokument i Veprimit të BE-së për Mbrojtjen e Pyjeve

PLANI VJETOR I VEPRIMIT

Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës në kuptimin e nenit 110(2) të Rregullores Financiare, dhe planet dhe masat vjetore dhe shumëvjeçare të veprimit sipas nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23(2) të Rregullores NDICI (Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar) - Global Europe

1. PËRMBLEDHJE

1.1 Tabela përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE për Pyjet** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
OPSYS *(sistemi operacional i Komisionit Evropian për menaxhimin e projekteve dhe kontratave)*	Referenca e biznesit OPSYS: ACT-62391
ABAC *(sistem financiar i Komisionit Evropian)*	Numri i nivelit 1 të angazhimit ABAC: JAD.1354182
Akti themelor	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III)
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI) Nismat Kryesore Ekonomike dhe të Investimeve	Jo
Nisma Team Europe	Jo
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL	
Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 3 – Agjenda e Gjelbër dhe Lidhja e Qëndrueshme Prioriteti Tematik 1 i IPA III: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike (Dritarja 100% 3).
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)	OZHQ-ja kryesore: –Qëllimi 13 – Të ndërmerren masa urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe pasojat e tyre OZHQ-të e tjera të rëndësishme dhe, kur është e nevojshme, synimet –Qëllimi 11- Qytetet dhe vendbanimet njerëzore të bëhen gjithëpërfshirëse, të sigurta, të qëndrueshme dhe rezistente. –Qëllimi 15 – Jeta në Tokë: Të mbrohen, të rikuperohen dhe të promovohen përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore, të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme pyjet, të luftohet shkretëtirëzimi, të ndalet dhe të luftohet degradimi i tokës dhe të ndalohet humbja e biodiversitetit.

Kodi(et) DAC	312 Pylltaria, 31220 Zhvillimi i pylltarisë			
Kanali kryesor i zbatimit	Qeverisja Qendrore -12001			
Synimet	☒Klima ☐ Gjinia ☒ Biodiversiteti			
Treguesit (nga formulari DAC)	**Objektiv i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/mirëqeverisja	☐	☒	☐
	Ndihma për mjedisin	☐	☐	☒
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☒	☐	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, i të saposalindurve dhe i fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i rrezikut të fatkeqësive	☐	☒	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☐	☐	☒
	Lufta ndaj shkretëtirëzimit	☐	☒	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☐	☐	☒
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
Tregues dhe etiketime të brendshme	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	EIP/PEI	☒	☐	☐
	Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	PO ☐		JO ☒
	Etiketime:	PO		JO
	Transporti	☐		☒
	Energjia	☐		☒
	Mjedisi dhe qëndrueshmëria ndaj klimës	☒		☐
	Digjitale	☐		☒
	Zhvillimi ekonomik (përfshirë sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike)	☐		☒
	Zhvillimi njerëzor (përfshirë kapitalin njerëzor dhe të rinjtë)	☐		☒
	Rezistenca shëndetësore	☐		☒
	Migrimi dhe lëvizshmëria	☐		☒
	Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural	☒		☐
	Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike	☐		☒
	Të tjera	☐		☒
	Digjitalizimi	☒	☐	☐
	Etiketime:	PO		JO
	lidhshmëri digjitale	☐		☒
	qeverisje digjitale	☐		☒
	sipërmarrje digjitale	☐		☒
	aftësi/shkrim-lexim digjital	☐		☒
	shërbime digjitale	☐		☒
		☐		☒
	Lidhshmëria	☒	☐	☐

	Etiketime: lidhshmëri digjitale energji transport shëndetësi arsim dhe kërkim	PO ☐ ☐ ☐ ☐ ☐		JO ☒ ☒ ☒ ☒ ☒
	Migrimi	☒	☐	☐
	Reduktimi i pabarazive	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION MBI BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201 Kostoja totale e vlerësuar: 13 000 000 EURO Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së: 13 000 000 EURO			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	Menaxhim indirekt me subjektin (et) që do të zgjidhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.1			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor 2025			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit, të prokurimeve dhe kontratave grant	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, me përjashtim të rasteve të listuara në nenin 114(2) të Rregullores Financiare.			
Periudha indikative [e zbatimit operacional]	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas lidhjes të Marrëveshjes së Financimit			

1.2 Përmbledhja e Veprimit

Pyjet në Shqipëri janë një burim thelbësor për njerëzit që varen nga to si burim i një game të gjerë mallrash dhe shërbimesh, elemente kyç për infiltrimin e ujit dhe kontrollin e erozionit, dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Pyjet shqiptare janë gjithashtu tejet të pasura me biodiversitet. Megjithatë, për shkak të kërkesës në rritje për lëndë drusore dhe produkte pyjore, si dhe praktikave aktuale të menaxhimit pyjor, pyjet vazhdojnë të përballen me degradim, ndërhyrje të paligjshme, ndotje, humbje të habitateve dhe biodiversitetit, si dhe me zgjerimin e zonave urbane. Pavarësisht të gjitha reformave të ndërmarra ndër vite, ky sektor përballet me shumë sfida përpara. Veprimi do të përqendrohet në sektorin pyjor në Shqipëri duke mbështetur menaxhimin dhe administrimin e pyjeve në Shqipëri, përmirësuar legjislacionin përkatës dhe kapacitetin administrativ të institucioneve përgjegjëse, duke zbatuar masa të ripyllëzimit, duke përmirësuar kështu përshtatjen dhe zbutjen e klimës, duke përmirësuar mbrojtjen e biodiversitetit dhe gjeneruar përfitime të shumta socio-ekologjike për vendin.

Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) i këtij veprimi është përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe kontributi në veprimet dhe politikat kundër ndryshimeve klimatike për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët. Në ndjekje të këtij objektivi të përgjithshëm, objektivat (rezultatet) kryesorë specifikë të pritshme të Veprimit të propozuar janë: (i) përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe përafrimi i kuadrit ligjor të sektorit pyjor në Shqipëri me *acquis*-në e BE-së; dhe (ii) rritja e mbulimit pyjor dhe kapaciteteve të thithjes së karbonit për Shqipërinë.

Veprimi është në përputhje me prioritetet e identifikuara për financim në kuadër të Dritares IPA III 3 – Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme për prioritetin tematik 1: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës dhe ka një ndikim të

drejtpërdrejtë në sjelljen e standardeve të mbrojtjes së mjedisit dhe politikave të ndryshimeve klimatike të Shqipërisë në përputhje me kërkesat dhe prioritetet e politikave të BE-së dhe gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në treguesin përkatës: Emetimet e gazit serrë.

Ky veprim është i lidhur drejtpërdrejt me OZHQ 13 – Veprimi për klimën, por gjithashtu synon OZHQ 11 – Bërja e qyteteve më të mira për të gjithë dhe OZHQ 15 – Jeta në Tokë.

Edhe pse objektivi kryesor i Veprimit është mbështetja e mbrojtjes së mjedisit dhe kontributi në veprimet dhe politikat kundër ndryshimeve klimatike, aktivitetet e parashikuara të projektit synojnë gjithashtu përmirësimin e zhvillimit të pjesëmarrjes/mirëqeverisjes në sektorin mjedisor, si dhe adresimin e çështjes të uljes së rrezikut nga fatkeqësitë dhe përmirësimin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përgjithësi. Gjithashtu, Veprimi është i lidhur ngushtë me shënuesit e Rios pasi kontribuon në diversitetin biologjik dhe luftën kundër shkretëtirëzimit, por edhe për aktivitetet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për sa u përket shënuesve të brendshëm, Veprimi kontribuon qartë në Mjedis dhe rezistencë ndaj klimës dhe pjesërisht në Bujqësi, siguri ushqimore dhe zhvillim rural.

1.3 Përfituesi i Veprimit

Veprimi do të zbatohet në Shqipëri

2. Argumentimi

2.1 Konteksti

Shqipëria është një vend kandidat për në BE që hapi negociatat për aderim në BE në korrik 2022, dhe për këtë arsye, ekziston një nevojë e mëtejshme për të përafruar politikën e saj me prioritetet e BE-së. Veprimi i propozuar është ngushtësisht i lidhur me procesin e aderimit të Shqipërisë, por njëkohësisht ndjek edhe objektivat strategjikë të vendosur në nivel politikash kombëtare që lidhen me menaxhimin e pyjeve.

Në Shqipëri, pyjeve dhe rolit të tyre në shoqëri, mjedis dhe ekonomi nuk u është kushtuar vëmendja dhe rëndësia e duhur gjatë tri dekadave të fundit dhe vazhdimisht kanë qenë larg opinionit publik dhe agjendës politike, përveç rasteve të zjarreve masive apo ndjeshmërive të krijuara nga dëmet në zona me vlera të veçanta. Shqipëria konsiderohet si një vend i pasur në sipërfaqe pyjore për frymë (0.4 hektar/frymë dhe përbën një nga vendet me biodiversitet të lartë në Evropë.

Dokumenti i Politikave për Pyjet 2030 përcakton se Shqipëria "është e pasur me sipërfaqe pyjore, por e varfër në vëllimin e drurit" për shkak të një strukture të pabarabartë për klasat e moshës, e dominuar kryesisht nga pyje të reja, si rezultat i një presioni të lartë dhe praktikave të paqëndrueshme të menaxhimit gjatë 60 viteve të fundit. Pyjet mbulojnë më shumë se 50% të sipërfaqes totale të tokës në Shqipëri, duke përfaqësuar ende një sektor shumë të rëndësishëm për mbijetesën e ekonomisë lokale dhe thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Fondi pyjor në Shqipëri është rreth 1.3 milionë hektarë (46% e territorit), me një vëllim prej 57.7 milionë m^3. Sipas sistemit të menaxhimit, pyjet shqiptare ndahen në: (i) pyje të larta që mbulojnë 32.4% të sipërfaqes pyjore dhe 73.4% të vëllimit të drurit; (ii) dushkajë (korije me dushqe) që mbulojnë 46.2% të sipërfaqes pyjore dhe 17.4% të vëllimit; dhe (iii) shkurre që mbulojnë 21.4% të sipërfaqes pyjore dhe 9.2% të vëllimit.

Sektori i pyjeve në Shqipëri ka qenë objekt i reformave të thella ligjore, institucionale dhe qeverisjes. Proceset e decentralizimit përfshijnë një sërë institucionesh dhe grupe ekzistues dhe të rinj interesi. Politika pyjore bazohet në: (i) transferimin gradual të përgjegjësive për menaxhimin e burimeve natyrore te qeverisja vendore (procesi i decentralizimit); (ii) forcimin e rolit të publikut dhe shoqërisë civile në menaxhimin e burimeve natyrore; (iii) zhvillimin e pylltarisë komunitare, duke transferuar të drejtën e përdorimit deri te përdoruesit përfundimtarë.

Industria e përpunimit të drurit në Shqipëri përbëhet nga **tri duzina kompani** të mëdha dhe rreth 400 ndërmarrje të vogla dhe të mesme të prodhimit të orendive (NVM), të shpërndara në të gjithë vendin. Prodhuesit vendas përdorin si lëndë të parë materiale vendase, ashtu edhe të importuara në procesin e prodhimit. Prodhimi i orendive bazohet kryesisht në përdorimin e paneleve të drurit dhe MDF-së; një tregues që përcakton se struktura e orendive ka pësuar ndryshime të konsiderueshme gjatë dekadave të fundit. Aktualisht, industria e përpunimit të drurit plotëson një pjesë të konsiderueshme të nevojave të tregut vendas shqiptar me produkte druri. Megjithëse eksportet janë me rëndësi të veçantë për vendin, vetëm 15% e këtyre produkteve eksportohen. Së fundi, është në

rritje numri i ndërmarrjeve që merren me prodhimin e paletave për energji nga mbetjet drusore.

Si rrjedhojë, është e rëndësishme që Shqipëria të fillojë një sërë aktivitetesh më sistematike që do të sjellin përparim në këtë sektor dhe do të garantojnë menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Njëkohësisht, Veprimi do të mbështesë aspiratat e Shqipërisë për t'u përfshirë në një "Agjendë të Gjelbër për Ballkanin Perëndimor", duke adresuar çështjet mjedisore, siç theksohet në Strategjinë e Ballkanit Perëndimor në lidhje me "Angazhimin e shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor", duke u përqendruar në nevojën për "përafrimin me *acquis*-in e BE-së, krijimin ose forcimin e institucioneve përkatëse dhe sigurimin e kapaciteteve për zbatim, qoftë në aspektin e rregullave të tregut të vetëm, politikës sociale, *acquis*-së së energjisë dhe transportit apo së drejtës mjedisore të BE-së". Për të përmbushur kriteret e aderimit, Shqipëria është plotësisht e angazhuar për të zbatuar objektivat e "Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor", duke propozuar kështu Veprimin që lidhet ngushtë me shtyllën 6 "Biodiversiteti: mbrojtja dhe restaurimi i ekosistemeve" dhe gjithashtu rekomandimin e saj për të përafruar politikat kombëtare me Strategjinë e BE-së për Pylltarinë dhe Biodiversitetin për vitin 2030. Për më tepër, Veprimi është në përputhje me prioritetet e përcaktuara në kuadrin e IPA III, dritarja tematike III - Agjenda e Gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme që synon adresimin e sfidës globale të përmirësimit të mjedisit dhe garantimin e ruajtjes së tij për brezat e ardhshëm, duke u përqendruar në ndalimin e degradimit mjedisor dhe promovimin e ruajtjes së ekosistemeve tokësore dhe detare. Gjithashtu, Veprimi do të kontribuojë në shfrytëzimin e potencialit të sektorëve për të kontribuar në uljen e emetimeve të gazrave serrë dhe thithjen e karbonit në një mënyrë të qëndrueshme dhe një pjesë e tij do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve administrative në administratën shqiptare, për të qenë më të përgatitur për të ndërmarrë masa ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, Veprimi është në përputhje me strategjitë e tjera të BE-së dhe angazhimet strategjike të ndërmarra në nivel të BE-së, siç janë Rezoluta Ministeriale e Bratislavës 2021, Konferenca Ministeriale e Pyjeve të Evropës, Deklarata e Sofjes dhe Plani i Veprimit të zbatimit të saj, shtylla V: Nxitja e ruajtjes së ekosistemeve dhe biodiversitetit, si dhe në mënyrë të tërthortë edhe me shtyllën I: Klima, energjia, lëvizshmëria, si dhe me Strategjinë e Pyjeve të BE-së për vitin 2030 që synon të kapërcejë sfidat dhe të shfrytëzojë potencialin e pyjeve për të ardhmen tonë, duke respektuar plotësisht parimin e subsidiaritetit, provave më të mira shkencore të disponueshme dhe kërkesave për përmirësimin e kuadrit rregullator.

Veprimi është i lidhur drejtpërdrejt me Kuadrin Negociues të Zgjerimit të BE-së, duke kryer aktivitete që do të synojnë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *Acquis*-në e BE-së në lidhje me rregulloret e FLEGT/ZLPQT-së *(Zbatimi i ligjit pyjor, qeverisja dhe tregtia)* dhe EUTR/RRBED *(Rregullorja e Bashkimit Evropian për Drurin)* brenda kapitullit 27, si dhe synojnë përmirësimin e kapaciteteve për të luftuar zjarret në pyje, duke kontribuar kështu në përmirësimin e nënsektorit të mbrojtjes civile, gjithashtu pjesë e kapitullit 27. Veprimi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit 2022–2030 (VKM nr. 88, datë 22.2.2023), e cila ka objektiva për vitin 2030 në mbrojtjen e natyrës " përafrimi i plotë i acquis-së së BE-së për natyrën dhe biodiversitetin, si dhe përmirësim të statusit të specieve dhe habitateve të rrezikuara". Gjithashtu, siç përcaktohet në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2023–2025 (VKM nr. 112, datë 1.3.2023), është prioritet "përafrimi i legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së dhe nxjerrja e akteve nënligjore të kërkuara nga ligji nr. 57/2020, "Për pyjet"; koordinimi dhe unifikimi i praktikave më të mira në pylltari me njësitë e vetëqeverisjes vendore; si dhe pyllëzimi i zonave të degraduara nëpërmjet kthimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe i operatorëve që punojnë në sektor". Gjithashtu, Veprimi do të trajtojë rekomandimin në përmbajtje të Raportit të KE-së për Shqipërinë në vitin 2023, i cili theksoi se: "Shqipëria ende nuk garanton në nivel të mjaftueshëm zbatimin e ligjeve për pyjet dhe prerjen e drurëve: pavarësisht një moratoriumi për prerjen e drurëve, kjo praktikë vazhdon të jetë pa kontroll. Ndjekjet penale të zjarrvënësve ose personave të tjerë që shkaktojnë zjarre në pyje janë të rralla, duke pasur parasysh numrin e lartë të zjarreve të qëllimshme dhe të aksidentale në vitin 2022. Nuk është raportuar asnjë dënim për këto raste.

Si rrjedhojë, Veprimi është në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin në BE 2022–2024 ku përcaktohet se: "Në fushën e pyjeve, sfida dhe

prioriteti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM-së) mbeten: (i) Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, për pyjet; (ii) Koordinimi dhe unifikimi i praktikave më të mira në fushën e pyjeve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe (iii) Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që operojnë në fondin pyjor."

Për sa i përket legjislacionit kombëtar dhe kuadrit strategjik, Shqipëria ka një kuadër ligjor relativisht të ri në lidhje me pylltarinë, të cilit ende i mungojnë aktet nënligjore të nevojshme për të qenë plotësisht i zbatueshëm dhe funksional. Ligji nr. 57/2020[35], "Për pyjet" rregullon strukturën institucionale, kompetencat dhe shërbimet që duhen ofruar në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe angazhimet ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë merr përsipër.

Në vitin 2019 u krijua **Agjencia e re Kombëtare e Pyjeve**[36], e cila po forcon gjithnjë e më shumë rolin e saj si institucioni kryesor që merret me pyjet.

Në vitin 2018, Qeveria e Shqipërisë miratoi "Dokumentin e Politikës për Pyjet në Shqipëri 2019–2030"[37], i cili ofron një perspektivë dhjetëvjeçare për sektorin e pyjeve dhe konsiderohet si themeli i qeverisjes në sektorin e pyjeve që përcakton qëllimet afatgjata, orientimet kryesore të politikave, masat e zbatimit, prioritetet dhe realizueshmërinë e tyre, si dhe planifikimin e zbatimit të dokumentit të politikës.

Aktivitetet e propozuara me Veprimin janë plotësisht në përputhje me Dokumentin e Politikave për Pyjet të lartpërmendur, i cili përfshin 4 objektiva strategjikë për sektorin:

- QS nr. 1 "Administratë efektive";
- QS nr. 2 "Organizim funksional";
- QS nr. 3 "Përdorim i qëndrueshëm";
- QS nr. 4: "Shërbime cilësore".

Gjithashtu, në lidhje me ndryshimet klimatike bazuar në Komunikimin e Tretë Kombëtar ndaj UNFCCC/ KKBNK-së (Kuadri i Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike), parashikohen masat e mëposhtme për sektorin pyjor:

- Përmirësimi i teknologjisë së shfrytëzimit të pyjeve dhe djegies së drurit. Përmes kësaj mase, efikasiteti aktual i përdorimit të drurit pritet të përmirësohet nga 40% në 86% gjatë një periudhe prej 35 vitesh (2015–2050) me një normë prej 1.3% në vit.

- Rritja e sipërfaqes pyjore. Për të përdorur pyjet në mënyrë të qëndrueshme, duke pasur parasysh rritjen vjetore të pyjeve kombëtare, është jashtëzakonisht e rëndësishme të investohet në mbjellje të reja pyjore. Duke marrë parasysh rrethanat aktuale kombëtare të sektorit pyjor, sasia e sipërfaqes pyjore që do të mbillet në vit duhet të jetë 500–1000 hektarë.

Në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, ekzistojnë dy politika dhe masa që lidhen me pylltarinë, përkatësisht: (i) (G-LF1/ PTGJ 1) Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit në pyje dhe kullota; dhe (ii) (G-LF2/PTGJ 2) Menaxhimi pyjeve në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Menaxhimi i pyjeve ka qenë objekt i ndërhyrjes së BE-së dhe donatorëve të tjerë që vlen të përmendet.

Veprimi do të jetë në sinergji të ngushtë me veprimin e ardhshëm të BE-së për Natyrën (i financuar përmes IPA III, viti programues 2021). Ky veprim përfshin përgatitjen e planit të menaxhimit për zonat e mbrojtura, përditësimin e listës kombëtare të habitateve, rritjen e kapaciteteve zbatuese për mbrojtjen e natyrës dhe zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë, të cilat janë të lidhura ngushtë me disa nga aktivitetet e BE-së për pyjet. Një tjetër nismë e ardhshme që do të jetë në sinergji me Veprimin është mbështetja nga IPARD/ IAPZHR *(Instrumenti i Asistencës së Paraaderimit për Zhvillimin Rural)* që lidhet me masën 11. – Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve. Kjo mbështetje e ardhshme do të synojë disa aktivitete pyjore, masa menaxhimi dhe mbrojtje nga zjarri që do të koordinohen me BE-në për pyjet gjatë periudhës së ardhshme.

Donatorët e shumtë (BNRZH; FGM; SBNZH dhe MTM) nëpërmjet Projektit të Shërbimeve Mjedisore (2015–2021) mbështetën praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të tokës dhe rritjen e përfitimeve monetare dhe jomonetare për komunitetet në zona të caktuara të Projektit.

[35] https://qbz.gov.al/eli/ligj/2020/04/30/57/d0417cc8-815c-4332-ab24-ad62624bb34b;q=57%2F2020

[36] https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/07/17/570/00710bca-3ce5-4991-b5b0-b3eb5ab3c93e;q=570

[37] https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/31/814/703d3504-454f-447a-a534-74348881004f;q=814

Komponentët në të cilët u përqendrua projekti ishin: i) inventari i pyjeve dhe kullotave; ii) regjistrimi i pyjeve dhe kullotave; iii) sistemi i informacionit; dhe iv) prezantimi i konceptit të pagesës për shërbimet mjedisore.

Projekti Forcimi i kapaciteteve në Mbrojtjen Kombëtare të Natyrës – përgatitja për rrjetin Natura 2000, i financuar nga IPA-II (2015–2019), u zbatua me objektivin për të parandaluar dëmtimin dhe humbjen e biodiversitetit në Shqipëri, nëpërmjet menaxhimit të përmirësuar të zonave të mbrojtura në vend dhe gjithashtu për të forcuar mbrojtjen e biodiversitetit nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura.

Qeveria Suedeze ka financuar programin "Mbështetja e negociatave shqiptare në mjedis, kapitulli 27" (MNSHM27) – faza II (2021–2024) që synon të forcojë kapacitetin dhe aftësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë dhe institucioneve të tjera për t'u përgatitur për negociatat e kapitullit 27 të BE-së, të cilat filluan në prill 2018 dhe aktualisht po zbatojnë fazën e dytë deri në prill 2024. Programi përfshinte përgatitjen për shqyrtimin e kapitullit 27 dhe Planifikimin Strategjik për Negociatat e Kapitullit 27.

2.2 Analiza e problemit

Analizë e shkurtër e çështjes

Prioriteti për Shqipërinë është përshtatja e plotë e të gjithë *acquis*-së së BE-së në legjislacionin kombëtar. Vlerësimi tregon një nivel të caktuar përshtatjeje, por zbatimi është në fazën fillestare. Nuk janë përcaktuar plane dhe/ose data specifike në nivel kombëtar për arritjen e përshtatjes dhe zbatimit të plotë, duke përfshirë zbatimin, i cili vazhdon të jetë i dobët, ndërsa inspektimet nuk janë efektive. Legjislacioni duhet të zhvillohet në mënyrë që të garantojë vlerësimin e duhur të çdo plani dhe/ose projekti që mund të ketë ndikim të rëndësishëm mbi zonat e ruajtjes, dhe të merren të gjitha masat kompensuese të nevojshme për të garantuar koherencën e përgjithshme me nisma si FOREST EUROPE ***(menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve*** *në Evropë),* Natura 2000 *(rrjet ekologjik i zonave të mbrojtura),* Direktiva për Habitatet *(për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit)* etj. Gjithashtu, bazuar në ligjin për pyjet, është e nevojshme të hartohen disa akte nënligjore dhe dokumente udhëzuese për të mbështetur zbatimin dhe forcimin e legjislacionit pyjor. Për më tepër, legjislacioni duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë e autoriteteve dhe institucioneve kompetente që janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për pyjet, si dhe të forcojë kapacitetet e tyre institucionale, në mënyrë që të mund të ushtrojnë siç duhet detyrat e ngarkuara. Zbatimi i menaxhimit të pyjeve është në një fazë të hershme që është rezultat i kapacitetit të ulët të administratës kombëtare dhe lokale, nivelit të ulët të të kuptuarit të praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, komunikimit të dobët me komunitetet lokale dhe palët e interesuara, pajisjeve të pamjaftueshme teknike dhe të tjera të nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve (MQP). Si rezultat, është rritur prerja e paligjshme e pyjeve dhe përdorimi i tyre jo i qëndrueshëm, përfshirë zjarret lokale në pyje dhe degradimin e pyjeve. Gjithashtu, planet e menaxhimit pyjor nuk janë zhvilluar për të gjitha zonat, çka kërcënon zbatimin e legjislacionit. Si pasojë, të gjitha këto çështje duhet të trajtohen për të garantuar një menaxhim më të mirë dhe të qëndrueshëm të pyjeve, si dhe për të rritur perceptimin e publikut dhe palëve të interesuara mbi përfitimet e pyjeve në shoqëri, ekonomi, mjedis dhe ndryshime klimatike. Monitorimi i pyjeve dhe mbajtja e të dhënave të detajuara ende nuk po zhvillohet siç duhet, megjithatë janë vërejtur disa përmirësime në lidhje me krijimin e inventarit pyjor. Megjithatë, për shkak të kapacitetit të ulët, mbajtja e inventarit, monitorimi dhe raportimi mbeten ende prapa.

Shqipëria po përballet me sfida të tilla si ndryshimi i klimës, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, mbrojtja e biodiversitetit dhe mjedisit, të cilat identifikohen gjithashtu si sfida globale. Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve (MQP-ja) mbron biodiversitetin dhe rrit ruajtjen e pyjeve, produktivitetin, aftësinë e rigjenerimit, vitalitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre, duke ruajtur funksionet përkatëse ekologjike, ekonomike dhe sociale në harmoni me ekosistemet e tjera tokësore. Ndryshimi i klimës dhe humbja e biodiversitetit janë çështje urgjente dhe me rëndësi të madhe në ditët e sotme. Ndikimet negative në pyje nga stuhitë, zjarret, thatësirat, dëmtuesit dhe sëmundjet po bëhen më të rënda për shkak të ndryshimeve klimatike, duke

ndikuar në aftësinë e pyjeve për të përmbushur funksionet e tyre të shumëfishta[38].

Palët e interesuara përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare (administrata publike, Konfederata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Blegtorisë, organizatat joqeveritare mjedisore, sektori privat, FOREST EUROPE, BE, BNRN, OUB, FKBP etj.) kanë identifikuar nevojën për veprime urgjente për të ruajtur dhe përmirësuar gjendjen shëndetësore të pyjeve, për shkak të rolit të tyre të shumëfishtë për brezat e ardhshëm. Gjithashtu, Shqipëria duhet të zbatojë objektivat e KDB-së, KKBNK-së dhe Marrëveshjes së Parisit, ku është Palë. Masat pyjore dhe kontrolli i zjarreve janë ndër prioritetet kryesore të përshtatjes në Kontributin Kombëtar i Caktuar (2021).

NDC/KKC-ja përfshin gjithashtu pyllëzimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve si masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike[39]. Zhvillimi i mëtejshëm i burimeve të rinovueshme të bazuara në pyje në produkte inovative me bazë biologjike dhe produkte druri jetëgjatë, si dhe produkte pyjore jodrusore dhe shërbime të tjera të ekosistemit që ofrojnë pyjet e shëndetshme dhe të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, mund të japin kontribute të rëndësishme në zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Hulumtimi mbi biodiversitetin e pyjeve është ende në fazat fillestare. Një sasi e vogël financimi sigurohet nga **MTE-ja** për institucionet kërkimore për mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave mbi biodiversitetin specifik dhe ekologjik në pyje. Kapacitetet shkencore në fushat e specializuara (menaxhimi i përshtatjes së pyjeve, hartografia dhe vëzhgimi në distancë, menaxhimi i rasteve të rrezikut etj.) janë të kufizuara në institucionet shtetërore kërkimore. Zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (MQP-së) do të kërkojë gjithashtu një financim të mjaftueshëm. Deri tani, menaxhimi i pyjeve dhe përgjithësisht aktivitetet e ruajtjes së natyrës financohen kryesisht nga kontributet e donatorëve. Është e nevojshme të eksplorohen dhe të zhvillohen instrumente të duhura financiare për të mundësuar zbatimin e kërkesave të legjislacionit kombëtar për pyjet dhe të atij të lidhur me Bashkimin Evropian (p.sh. PSHE). Financimi i pamjaftueshëm është një nga arsyet kryesore përse Planet e Menaxhimit të Pyjeve nuk zbatohen plotësisht dhe në përgjithësi kthehen në dokumente të vjetruara pas një periudhe kohe. Si rrjedhojë, në një masë të caktuar, Veprimi duhet të kontribuojë në sigurimin e një burimi të qëndrueshëm financimi për sektorin e pyjeve.

Fatkeqësisht, sektori i pylltarisë në Shqipëri është ende larg të qenit i kënaqshëm dhe kërkon shumë punë për të arritur standardet e Bashkimit Evropian në fushën e pylltarisë dhe për të përmbushur kërkesat e aderimit. Me synimin për të përmirësuar dhe rehabilituar pyjet e degraduara dhe për të reduktuar ndërhyrjet në sipërfaqet pyjore të dëmtuara si rezultat i shfrytëzimit intensiv, prerjeve të paligjshme dhe dëmtimeve të tjera, qeveria shqiptare miratoi ligjin nr. 5/2016, "Për shpalljen e moratoriumit mbi pyjet në Republikën e Shqipërisë". Objekt i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të shfrytëzimit të drurit në fondin pyjor publik dhe/ose privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndalimi i tregtimit të produkteve të tij, ndalimi i eksportit të drurit të papërpunuar, të materialeve të ndërtimit, të druve të zjarrit, si dhe të qymyrit të drurit. Prerjet e paligjshme të pyjeve mbeten një problem i vazhdueshëm në Shqipëri. Shkaqet kryesore të kësaj dukurie janë: (i) roli i autoriteteve publike (përfshirja apo bashkëfajësia e zyrtarëve shtetërorë dhe përdorimi i paligjshëm i burimeve), (ii) niveli i lartë i varfërisë, veçanërisht në zonat e thella rurale, dhe (iii) mungesa e alternativave të tjera për gjenerimin e të ardhurave në këto zona. Ka nevojë për përmirësimin e zbatimit të Strategjisë së Pyjeve të miratuar, e cila aktualisht ndodhet në fazat e hershme të zbatimit. Gjithashtu, shumë zona pyjore paraqesin rrezik të lartë për zjarre, pasi janë të

[38] Kontributi Kombëtar i Rishikuar dhe Caktuar për Ndryshimet Klimatike të Shqipërisë, 2021, f. 49-50: Temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit që kanë pushtuar vendin kanë çuar në dëmtime të konsiderueshme të pyjeve nga zjarret masive në pyje. Frekuenca e zjarreve dhe dëmet e shkaktuara prej tyre janë rritur vitet e fundit. Gjatë periudhës 2011–2019, u identifikuan rreth 760 zjarre në pyje, duke djegur një sipërfaqe prej 337,800 hektarë të pyjeve shqiptare. Shkalla e shpyllëzimit për shkak të zjarreve shkaktoi një reduktim prej 22% të sipërfaqes pyjore gjatë 12 viteve.

[39] Kontributi Kombëtar i Rishikuar për Ndryshimet Klimatike i Shqipërisë, 2021, f. 27: Bazuar në rrethanat kombëtare, dhe duke marrë parasysh tendencat aktuale, potenciali për zonat e pyllëzimit vlerësohet në 300 hektarë në vit. Në vitin 2030, zbatimi i kësaj mase lejon një ulje të emetimeve vjetore të vlerësuara në -7 kilotonë ekuivalent CO_2 krahasuar me skenarin BAU/BSZ "Biznesi si zakonisht".

paarritshme për ndërhyrje parandaluese. Aktivitetet për pyllëzim dhe ripyllëzim janë shumë të kufizuara, për shkak se mungon një qendër kombëtare për prodhimin dhe përkujdesjen e fidanëve pyjorë, si dhe mungojnë burimet financiare të dedikuara. Shqipëria është angazhuar për të siguruar kapjen e karbonit përmes pyllëzimit; si rrjedhojë, ky aktivitet duhet të konsolidohet me qëllim krijimin e pyjeve afatgjata dhe të qëndrueshme. Planifikimi i pyllëzimit në përgjithësi është përgjegjësi e qeverisjes vendore, por nuk zbatohet në mënyrë efektive për shkak të kapaciteteve të kufizuara të institucioneve përkatëse.

Analiza e palëve të interesuara

Bazuar në analizën e situatës aktuale, palët kryesore të interesuara që do të përfshihen në zbatimin e Veprimit, duke përfshirë përshkrimin e mandatit dhe rolit të tyre, si dhe kapacitetet që kanë, janë si më poshtë:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është institucioni qendror përgjegjës për hartimin e politikave dhe rregullimin në lidhje me mjedisin dhe ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, si dhe zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Gjithashtu, MTM-ja është institucioni drejtues në grupin negociues për kapitullin 27 dhe, si i tillë, është përgjegjës për raportimin ndaj Komisionit Europian (KE-së) mbi progresin e përgjithshëm në temat që lidhen me mjedisin dhe që janë të rëndësishme për procesin e aderimit në BE. Për më tepër, MTM-ja koordinon aktivitetet me institucione të tjera të përfshira në zbatimin e *acquis*-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR-ja) është institucioni qendror përgjegjës për politikat qeveritare dhe legjislacionin që lidhen me bujqësinë, zhvillimin rural, veterinarinë, ushqimin dhe sigurinë ushqimore, peshkimin, akuakulturën, pemëtarinë dhe pyjet përkatëse. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e fondit IPARD/IPZHBZR-së, i cili përfshin, ndër të tjera, Masën 11: Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP-ja) është një agjenci në varësi të MTE-së përgjegjëse për menaxhimin e sektorit të pyjeve në nivel kombëtar. Ajo zbaton legjislacionin në fushën e pyjeve, merr masa për ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve, si dhe për përdorimin e qëndrueshëm dhe multifunksional të burimeve në fondin kombëtar pyjor, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është një agjenci në varësi të MTE-së përgjegjëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, nëpërmjet menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura me interes kombëtar dhe ndërkombëtar, mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit, edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit publik për zonat e mbrojtura dhe mbështetjes së aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda këtyre zonave.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është një agjenci në varësi të MTE-së me funksionin përgjegjës për: a) Sigurimin e performancës mjedisore; b) Kërkimin dhe njohuritë mjedisore; c) Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe dhënien e lejeve; si dhe d) Inspektimin tematik dhe kontrollin për përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe kushtet mjedisore.

Bashkitë/qeverisjet vendore (QV) janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve komunale aty ku ushtrojnë autoritetin në nivel lokal.

Akademia (universitetet) luan/jnë rol të rëndësishëm për kërkimin, zhvillimin dhe edukimin, duke përfshirë shkencat pyjore dhe shkencat biologjike dhe mjedisore.

Organizatat joqeveritare luajnë rol të rëndësishëm në komunikimin me komunitetin lokal, duke përcjellë shqetësimet e tyre te qeveria lokale dhe qendrore dhe duke marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e avokimit dhe mbikëqyrjes që lidhen me sektorin pyjor.

2.3 Mësimet e nxjerra

Një pjesë e mbështetjes së kaluar në sektorin mjedisor në Shqipëri u përqendrua në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të politikëbërësve për të zbatuar politika dhe legjislacion në përputhje me acquis-në e BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe pylltarisë. Nga projektet e mëparshme të zbatuara në sektorin e pylltarisë u nxorën disa mësime të nxjerra, të cilat theksuan nevojën e vazhdueshme për mbështetje në mjedisin e përgjithshëm dhe përmirësime në mjedisin legjislativ dhe institucional për të shfrytëzuar efektet pozitive të ndërhyrjeve të ndryshme mbështetëse.

Projektet e kaluara që kanë mbështetur Shqipërinë në pylltari kanë treguar se për zbatimin me sukses të ndërhyrjeve, është e nevojshme të

identifikohen palët e interesuara në fazën e hershme të zbatimit të Veprimit dhe të përcaktohet niveli i tyre i ndikimit. Më pas, duhet të zhvillohen mekanizma për angazhimin e tyre, në mënyrë që të ndërtohet pronësia e secilit palë të interesuar, në veçanti autoriteteve lokale dhe komuniteteve lokale. Përfshirja e OJQ-ve përkatëse për veprimin tregoi përfitime për të garantuar qëndrueshmëri dhe ofroi një bazë të fuqishme për të filluar aktivitete shtesë nga donatorë të tjerë. Organizimi i aktiviteteve kombëtare me pjesëmarrjen e personave politikë të nivelit të lartë do të kontribuojë në tërheqjen e vëmendjes së tyre mbi veprimin. Zhvillimi i një sërë veprimesh dhe mekanizmash për financim të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm dhe bashkëfinancim të burimeve të disponueshme për të mbështetur më tej potencialin e madh që sektori pyjor shqiptar do të ndihmonte në garantimin e angazhimit afatgjatë të autoriteteve përkatëse kombëtare dhe lokale.

Veprimi i propozuar do të bazohet në përvojën dhe kapacitetet e zhvilluara nga projektet e tjera të donatorëve të përmendura në seksionin 2.1, duke mbështetur më tej MTE-në në zbatimin e aktiviteteve që lidhen me kapitullin 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike". Gjithashtu, Veprimi i propozuar përfshin aktivitete që do të adresojnë një numër boshllëqesh në zbatimin e nënkapitullit të natyrës të BE-së, të përcaktuara tashmë në Planin e Veprimit të zhvilluar nga SANE27.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1 Logjika e ndërhyrjes

Logjika e ndërhyrjes

Objektivi i përgjithshëm i Veprimit të propozuar është përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe kontributi në veprimet dhe politikat kundër ndryshimeve klimatike për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët. Objektivat specifikë të Veprimit janë: përmirësimi si i kapaciteteve administrative ashtu edhe i përafrimit të kuadrit ligjor të sektorit pyjor në Shqipëri me *acquis*-në e BE-së, si dhe rritja e mbulimit pyjor dhe kapaciteteve të thithjes së karbonit për Shqipërinë.

Duhet të pritet që, pasi të jetë përgatitur analiza e nivelit aktual të përshtatjes dhe legjislacionit kryesor dhe dytësor të BE-së për pyjet, i cili lidhet drejtpërdrejt me ligjin për pyjet, si dhe plani i zbatimit të *acquis*-së, përshtatjes të *acquis*-ë të BE-së për pyjet dhe legjislacioni tjetër i nevojshëm për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve produkti 1) do të përmirësohet ndjeshëm. Për më tepër, kuadri i përmirësuar rregullator do të plotësohet me aktivitete të ndërtimit të kapaciteteve, të lidhura me vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese për menaxhimin e pyjeve, përgatitjen e një plani trajnimi me module specifike dhe pajisje trajnimi, të cilat duhet të kontribuojnë në përmirësimin e kapacitetit administrativ dhe aftësive për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, mbledhjen e të dhënave dhe raportimin (produkti 2).

Nëse protokolli për monitorimin dhe raportimin e të dhënave të pyjeve përgatitet dhe jepet mbështetje e vazhdueshme për llogaritjen e emetimeve dhe heqjeve në sektorin e pyjeve, si dhe për raportimin nga komunat dhe institucionet e tjera, atëherë llogaritja e emetimeve dhe heqjeve nga pyjet në përputhje me PTNPTP-së dhe *acquis*-në përkatëse (produkti 3) do të përmirësohet.

Nëse përgatitja e planeve të menaxhimit të pyjeve për 10 zona të mbrojtura dhe bashki, duke përfshirë planet e ripyllëzimit dhe masat prioritare, do të jetë e mundur, atëherë kjo do të mundësojë menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave pyjore me plane menaxhimi (produkti 4).

Nëse zbatohen masa specifike prioritare, blihen dhe përdoren pajisje që lidhen me MQP-në dhe krijohet një strukturë qendrore kujdesi e menaxhuar nga Agjencia Kombëtare Pyjore, atëherë mund të zbatohet pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore prioritare dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për MQP-në (produkti 5).

Nëse një pjesë e aktiviteteve synon të ofrojë mbështetje financiare për bashkitë përmes Thirrjes për Propozime për financimin e aktiviteteve që lidhen me pyllëzimin dhe luftën kundër zjarreve në pyje, atëherë pritet që një sërë masash të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve të zbatohen siç duhet (produkti 6).

Nëse zbatohen aktivitete që lidhen me ndërgjegjësimin publik, atëherë kjo fushatë do të konsiderohet e realizuar me sukses (produkti 7).

Nëse legjislacioni përgatitet dhe përputhet me *acquis*-në të BE-së, kapacitetet administrative dhe raportuese të agjencisë dhe të qeverive lokale përmirësohen, planet e menaxhimit të pyjeve përgatiten dhe fushata e ndërgjegjësimit publik zbatohet, atëherë kapacitetet administrative dhe kuadri ligjor për sektorin e pylltarisë forcohen (produkti 1).

Ky rezultat bazohet në supozimin se bashkitë dhe institucionet qendrore kanë kapacitete të konsoliduara njerëzore dhe financiare për të përmbushur detyrimet e raportimit, bashkitë dhe AKP-ja janë të hapura ndaj përgatitjes dhe zbatimit të planeve të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve komunale dhe se nuk ka ndryshime në shkallë të gjerë në kuadrin legjislativ kombëtar dhe të BE-së që lidhen me sektorin e pylltarisë.

Nëse mbështetet procesi i llogaritjes së emetimeve dhe heqjeve nga pyjet në përputhje me standardet përkatëse, përgatiten dhe zbatohen planet e menaxhimit të pyjeve, realizohet pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore me përparësi, zbatohet skema e granteve për masat e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, përfshirë parandalimin e zjarreve dhe erozionit, si dhe zhvillohet një fushatë ndërgjegjësimi publike, atëherë do të rritet mbulimi pyjor dhe kapaciteti i tyre për kapjen e karbonit (rezultati 2).

Ky rezultat bazohet në supozimin se ekzistojnë kapacitete në MTE dhe AKM për të zbatuar procedurat për llogaritjen e emetimeve, AKP-ja dhe AKM-ja po ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për zbatimin e aktiviteteve të pyllëzimit/ripyllëzimit, AKP-ja është e përkushtuar dhe ka staf të mjaftueshëm për të mbështetur zbatimin e skemës së granteve, ka kapacitete të mjaftueshme për të thithur dhe zbatuar grantet në nivel lokal nga bashkitë, OJQ-të dhe palët e tjera të interesuara, dhe komunitetet lokale janë të gatshme të marrin pjesë dhe të përfshihen.

Nëse kapacitetet administrative dhe kuadri ligjor përmirësohen dhe mbulimi me pyje rritet, atëherë cilësia e mjedisit do të përmirësohet dhe Shqipëria do të përshpejtojë rrugën drejt një ekonomie me karbon të ulët. Kjo bazohet në supozimin se qeveria është e angazhuar teknikisht dhe financiarisht në avancimin e zbatimit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Planit të Veprimit përkatës dhe do të jetë në gjendje të zbatojë objektivat që vijnë nga angazhimet e reja globale dhe rajonale.

Rezultatet që do të ofrohen nga ky veprim që kontribuojnë në objektivat specifikë përkatës janë:

Objektivi specifik 1: Kapacitetet administrative dhe përputhja e kuadrit ligjor në sektorin pyjor në Shqipëri me acquis-në e BE-së janë përmirësuar

Produkti 1 (që ndikon në objektivin specifik 1): *Acquis* i BE-së për pylltarinë e harmonizuar dhe legjislacion tjetër i përgatitur

Veprimi i propozuar do të fillojë me vlerësimin e nivelit aktual të përshtatjes dhe zbatimit të acquis-së pyjore të BE-së dhe do të përgatisë një plan për përshtatje që do të përfshijë minimalisht kërkesat nga rregulloret RRBED dhe ZLPQT, si dhe PTNPTP në lidhje me pylltarinë, duke identifikuar gjithashtu autoritetin kompetent, palët e interesuara, kostot dhe afatin kohor të zbatimit të tyre. Veprimi duhet të mbështesë zhvillimin e legjislacionit parësor dhe dytësor, si dhe instrumentet ligjore për të mbështetur zbatimin e legjislacionit pyjor nga autoritetet përkatëse kombëtare dhe lokale (AKP, AKZM/PRVP, AKM dhe bashkitë). Analiza gjinore në sektor do të mundësojë përgatitjen e legjislacionit të ndjeshëm ndaj gjinisë. Aktivitetet janë të përshtatura për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në të gjitha diversitetet.

Produkti 2 (që ndikon në objektivin specifik 1): Kapaciteti dhe aftësitë administrative për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të përmirësuara

Veprimi duhet të ofrojë mbështetje për të forcuar kapacitetin administrativ për menaxhimin e pyjeve në nivel kombëtar dhe lokal, duke vlerësuar kapacitetin aktual administrativ dhe teknik të autoriteteve kombëtare dhe lokale për MQP-në, i cili do të pasohet nga vlerësimi i nevojave për trajnim dhe vlerësimi i nevojave teknike/pajisjeve.

Subjekti/enti zbatues duhet të përgatisë një plan trajnimi dhe një Strategji me Plan Veprimi për forcimin e kapaciteteve administrative në nivel kombëtar dhe lokal për MQP-në. Gjithashtu, me qëllim forcimin e kapaciteteve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në institucionet përgjegjëse, Veprimi duhet të përgatisë specifikimet teknike të pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme së bashku me strategjinë e prokurimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të legjislacionit kombëtar, zbatimin, monitorimin dhe mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

Duhet të përqendrohet vëmendja tek Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia Kombëtare e Zonave të

Mbrojtura (AKZM)/Planet rajonale të veprimit për pyjet (PRVP), si dhe autoritetet lokale. Trajnime do t'u ofrohen autoriteteve përkatëse dhe grupeve të tjera përkatëse, si për shembull mbledhësit e produkteve jodrusore të pyjeve, sipas planit të trajnimit dhe Strategjisë.

Objektivi specifik 2: Rritja e mbulimit pyjor dhe kapaciteteve të thithjes së karbonit për Shqipërinë

Produkti 3 *(që ndikon në objektivin specifik 2):* Mbështetet procesi i llogaritjes së emetimeve dhe heqjeve/eliminimeve nga pyjet në përputhje me *PTNPTP*-në dhe *acquis*-në përkatëse.

Menaxhimi i pyjeve ekzistuese ofron gjithashtu një portofol të pasur opsionesh, duke përfshirë ruajtjen dhe përmirësimin e kapacitetit aktual për thithjen e CO_2, si dhe përdorimin e produkteve prej druri për të reduktuar emetimet në sektorë të tjerë përmes zëvendësimit material dhe energjetik. Rregullorja PTNPTP sjell një ndryshim të rëndësishëm drejt harmonizimit të metodave të raportimit dhe llogaritjes, pasi ajo i referohet *"llogaritjes bazuar në tokë"*. Veprimi do të mbështesë përgatitjen e një vlerësimi për të identifikuar opsionet më të mira për zbatimin e Rregullores PTNPTP për Shqipërinë. Më pas, do të përgatitet një qasje llogaritjeje e nivelit referues për menaxhimin e pyjeve, e cila do të prezantojë nivelin referues të pyjeve (FRL) që përfaqëson vlerën kontraktuale të emetimeve dhe heqjeve/eliminimeve që do të ndodhnin në tokën pyjore të menaxhuar në mungesë të ndonjë ndryshimi të ardhshëm në praktikat e menaxhimit, krahasuar me periudhën referuese. Do të ofrohet mbështetje për Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP-në), Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM-në) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM-në) për të garantuarzbatimin e rregullores PTNPTP, duke përfshirë ndihmë në krijimin e sistemit të nevojshëm të llogaritjes – platforma elektronike – me trajnime dhe pajisje IT dhe të tjera. Sistemi i llogaritjes do të mbështetet me trajnime të mjaftueshme për stafin përkatës nga MTM-ja, AKP-ja, AKZM-ja, MBZHR-ja dhe bashkitë, për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të tij. Veprimi do të zhvillojë një skemë për kompensimin e karbonit përmes aktiviteteve të pyllëzimit që do të sigurojë burime për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për marrjen e masave për ruajtjen e pyjeve.

Produkti 4 (që ndikon në objektivin specifik 1 dhe 2): Planet e menaxhimit të pyjeve dhe mbështetja e zbatimit të tyre, të përgatitura.

Ky aktivitet do të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të pyjeve (PME) në Shqipëri. MTE-ja ka miratuar tashmë standarde për përmbajtjen e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe pyjet komunale. Megjithatë, ende mungon një metodologji e konsoliduar për hartimin e planeve të menaxhimit adaptues ndaj ndryshimeve klimatike. Duhet të kryhet monitorim i vazhdueshëm për të testuar efektivitetin e PME-së ekzistuese. Mësimet e nxjerra nga monitorimi duhet të përdoren për të shqyrtuar përshtatshmërinë e qëllimeve dhe politikave të menaxhimit. Ky cikël reagimesh mund të çojë në përshtatje të përmbajtjes dhe metodologjisë fillestare për PME-në. Veprimi do të mbështesë rishikimin/hartimin e 10 planeve të menaxhimit të pyjeve në zonat e mbrojtura, duke përfshirë 10 plane të tjera për pyjet në komuna, bazuar në përmbajtjen dhe metodologjinë e rishikuar. Veprimi do të ofrojë mbështetje në vend gjatë përgatitjes së planeve të menaxhimit të pyjeve (PME), duke identifikuar sfidat dhe objektivat kryesorë që duhen arritur me PME-në e re. Gjithashtu, do të përgatitet plani kombëtar i pyllëzimit/ripyllëzimit për të zbutur degradimin dhe fragmentimin e pyjeve, erozionin dhe përmbytjet, përfshirë parandalimin e rrezikut të zjarreve në pyje dhe do të tregohen masat prioritare. Synimi i roleve gjinore dhe preferencave të sjelljes së komunitetit lokal, si dhe palëve të tjera të interesuara, mund të jetë një shtyllë kyçe në tranzicionin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, prandaj, ky aspekt duhet të merret në konsideratë gjatë hartimit të planeve të menaxhimit të pyjeve. Bazuar në kriteret e zhvilluara për të trajtuar zonat dhe çështjet më të cenueshme, Veprimi do të përgatisë një listë të masave prioritare të përfshira në SMP që do të zgjidhen për zbatim. Një pjesë e masave do të lidhet me krijimin e njësisë së kujdesit për pyllëzimin që do të sigurojë pyllëzim të qëndrueshëm; si dhe zonat për pyllëzim do të zgjidhen brenda zonave të mbrojtura. Gjatë përzgjedhjes së zonave prioritare për pyllëzim, përparësi do t'i jepet promovimit të ruajtjes së biodiversitetit pyjor dhe rritjes së mundësisë së thithjes së karbonit, si dhe atyre zonave që janë potenciale për zhvillim rural dhe turizëm, duke mundësuar kështu zhvillimin e qëndrueshëm në zona dhe ndërveprimin me komunitetet lokale. Për

secilën nga masat e përzgjedhura do të zhvillohen plane për zbatim, të cilat do të përfshijnë minimalisht kostot, pajisjet e nevojshme, kohëzgjatjen, mjetet e zbatimit dhe skicat e projektimeve kur është e nevojshme. Një pjesë e masave të përzgjedhura do të synohet të zbatohet përmes skemës së granteve.

Produkti 5 (që ndikon në objektivin specifik 2): Pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore prioritare dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për MQP të zbatuar

Bazuar në zonat prioritare të përzgjedhura për pyllëzim dhe planet e zhvilluara për zbatim, brenda këtij veprimi do të zbatohen aktivitete të lidhura drejtpërdrejt me krijimin e një objekti kujdesi pyjor brenda AKP-së. Do të ofrohen të gjitha pajisjet teknike dhe trajnimet e nevojshme për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm të objektit. Përshtatja e pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike dhe restaurimi i pyjeve do të kërkojë gjithashtu sasi të mëdha të materialit riprodhues të përshtatshëm pyjor. Do të merret në konsideratë rreziku i zjarreve në pyje për shkak të rritjes së temperaturës dhe ndryshimeve klimatike, duke i bërë kështu rreziqe të tilla më pak të besueshme. Kjo nënkupton përpjekje për të siguruar dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme - bazuar në parimet ekologjike – burimet gjenetike nga të cilat varet një pylltari më e qëndrueshme ndaj klimës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet aftësisë së sektorit të fidanishteve të pemëve për të siguruar sasi të mjaftueshme të materialeve të përshtatshme riprodhuese pyjore të nevojshme për përshtatjen dhe restaurimin e pyjeve dhe ndryshimet klimatike. Agjencia Kombëtare Pyjore krijon dhe drejton një fidanishte pemësh me mbështetjen e këtij Veprimi, e cila do të kontribuojë drejtpërdrejt në aktivitetet e pyllëzimit/ripyllëzimit. Për më tepër, do të zbatohen aktivitete për pyllëzimin/ripyllëzimin e zonave të zgjedhura prioritare, siç përfshihen në planet e zbatimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të kontrollit të erozionit kur ai mund të parandalohet nga aktiviteti i pyllëzimit. Gjithashtu, këto aktivitete do të përdorin specie pemësh vendase, prejardhje dhe varietete ose ekotipe që janë përshtatur mirë me kushtet e vendit dhe të përcaktuara në planin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave dhe që gjithashtu, kur është e mundur, mund të përmirësojnë statusin e specieve për ato të rëndësishme për biodiversitetin. Në VKM-në nr. 814 të datës 31.12.2018 "Strategjia Pyjore", brenda 11 viteve, Qeveria është angazhuar të përmbysë trendin pozitiv në pyje, duke synuar një rritje neto vjetore prej rreth 1 milion m^3 në vit, ose rreth 20% më shumë se rritja aktuale neto vjetore e pyjeve shqiptare. Si rrjedhojë, aktivitetet e pyllëzimit/ripyllëzimit duhet të jenë në përputhje me këtë politikë dhe do të rrisin tokën e mbuluar me pyje me një minimum prej 7000 hektarë të rimëkëmbur deri në vitin 2030. Bashkëpunimi me AKP-në, AKZM-në, autoritetet lokale dhe komunitetin lokal do të kryhet edhe gjatë pyllëzimit. Të gjitha aktivitetet për pyllëzimin do të bëhen në bashkëpunim me autoritetet lokale, OJQ-të dhe komunitetet lokale, dhe do të përfshijnë gjithashtu AKP-në dhe AKZM-në. Do të vendoset infrastruktura e nevojshme për menaxhimin e pyllit të ri dhe sigurimin e zhvillimit të tij, siç është sistemi i ujitjes dhe rrugët hyrëse dhe pajisjet për parandalimin e pyjeve. Për çdo pyllëzim do të llogaritet potenciali për thithjen e karbonit dhe afati kohor. Aktiviteti i fundit do të lidhet me blerjen e pajisjeve të nevojshme për menaxhimin e pyjeve, siç tregohet në specifikimet teknike. Do të ofrohet trajnim për stafin që do të përdorë pajisjet, duke përfshirë AKP-në, AKZM-në dhe autoritetet lokale.

Produkti 6 (që ndikon në objektivin specifik 2): Skema e granteve për zbatimin e masave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve, duke përfshirë parandalimin e zjarreve në pyje dhe erozionit, e zbatuar.

Për masat prioritare të përzgjedhura, do të hartohet një udhëzues për aplikantët dhe dokumentet përkatëse për një thirrje për propozime që synojnë zbatimin e aktiviteteve të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në nivel lokal. Një pjesë e aktiviteteve do t'i kushtohet pyllëzimit/ripyllëzimit të zonave të menaxhuara nga bashkitë, ndërsa një pjesë tjetër do t'i kushtohet parandalimit të zjarreve në pyje, duke zvogëluar kështu rrezikun që zjarret paraqesin për njerëzit dhe mjedisin, i cili po rritet për shkak të faktorëve të shumtë, përfshirë ndryshimet klimatike. Eliminimi i rrezikut të zjarreve nuk është i mundur, por mund të ndërmerren masa të shumta për menaxhimin dhe reduktimin e këtyre rreziqeve. Do të ofrohet gjithashtu mbështetje për zhvillimin e aplikacioneve nga potencialët përfitues, duke përfshirë edhe asistencë gjatë zbatimit dhe menaxhimit të granteve. Përfituesi do të zbatojë skemën e granteve bazuar në politikën inteligjente

për parandalimin e zjarreve në pyje, me qëllim garantimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve aktuale dhe të ardhshme të rreziqeve nga zjarret, si dhe ndërtimin e një sistemi me pesë elemente të ndërthurura: rishikim dhe analizë, reduktim të rrezikut, përgatitje, reagim dhe rikuperim (5R-të). Për të garantuar qëndrueshmërinë, kriteret për përzgjedhjen e përfituesve do të lidhen me aktivitete që kontribuojnë në thithjen dhe kompensimin e karbonit, biodiversitetin, mbrojtjen, qëllimet për parandalimin e zjarreve dhe masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, do të ofrohen disa pajisje për menaxhimin e MQP-së.

Produkti 7 (që ndikon në objektivin specifik 1 dhe 2): Fushatat e ndërgjegjësimit publik që synojnë komunitetet lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të zbatuara.

Pjesëmarrja aktive e komuniteteve lokale është një komponent kritik për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve që do të sigurojë shfrytëzimin e sigurt të produkteve pyjore jodrusore dhe për aktivitete rurale dhe turistike. Brenda këtij veprimi, së pari do të vlerësohet niveli aktual i ndërgjegjësimit dhe njohurive publike në lidhje me MQP-së.

Më pas, bazuar në planin e hartuar, përfituesi do të zbatojë një fushatë që do të fillojë duke promovuar të kuptuarit e prioriteteve të menaxhimit, pikat e forta të një komuniteti dhe mundësitë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve (MQP), që do të gjenerojë skenarin më të mirë kosto-përfitim për të dyja palët, MQP-në dhe komunitetin lokal. Ministria dhe Agjencia në bashkëpunim do të zhvillojnë një fushatë gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirëse për të inkurajuar komunitetin lokal të ndërmarrë ndërveprime më të qëndrueshme me zonat pyjore. OJQ-të do të kenë rol aktiv gjatë zbatimit të fushatës dhe do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e një pjese të aktiviteteve të parashikuara të fushatës. Në fund të fushatës do të matet niveli i ndërgjegjësimit dhe do të krahasohet me nivelin fillestar të ndërgjegjësimit të komunitetit lokal për MQP-në. Një hap drejt MQP-së mund të projektohet për të inkurajuar barazinë gjinore dhe për të ndikuar në sjelljen e njerëzve ndaj MQP-së dhe produkteve pyjore jodrusore.

3.2 Aktivitete treguese

Produkti 1: (që ndikon në objektivin specifik 1): Legjislacioni i pyjeve i pajtueshëm me *acquis*-in e BE-së dhe legjislacioni tjetër, i përgatitur.

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt përfshijnë:

A.1.1 Vlerësimin e nivelit aktual të përshtatjes dhe zbatimit të legjislacionit pyjor të BE-së;

A.1.2 Zhvillimin e legjislacionit parësor dhe dytësor për të përshtatur plotësisht legjislacionin pyjor të BE-së;

A.1.3 Përgatitja e Planit të Zbatimit të RRBED-së, ZLPQT-së dhe PTNPTP-së.

Produkti 2 (që ndikon në objektivin specifik 1): *Kapaciteti administrativ dhe aftësitë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të përmirësuara*

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt përfshijnë:

A.2.1 Vlerësimin e kapacitetit administrativ dhe teknik të autoriteteve kombëtare dhe lokale për MPQ-në;

A.2.2 Zhvillimin e planit të trajnimit dhe strategjisë me plan veprimi për forcimin e kapacitetit administrativ në nivel kombëtar dhe lokal për MPQ-në;

A.2.2 Përgatitjen e një specifikimi teknik të pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për MPQ-në;

A.2.3 Ofrimin e trajnimit për MPQ-në për autoritetet kompetente dhe palët e interesuara përkatëse.

Produkti 3 (që ndikon në objektivin specifik 2): *Procesi i kontabilitetit të emetimeve dhe heqjeve/ largimeve nga pyjet në përputhje me PTNPTP-në dhe acquis përkatëse, i mbështetur*

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt, përfshijnë:

A.3.1 Përgatitjen e protokollit për monitorimin dhe raportimin e të dhënave pyjore;

A.3.2 Mbështetjen e procesit të llogaritjes së emetimeve dhe heqjeve/largimeve në sektorin pyjor;

A.3.3 Mbështetjen e raportimit nga bashkitë dhe institucionet e tjera për të dhënat e kërkuara nga sektori pyjor.

Produkti 4 (që ndikon në objektivin specifik 1 dhe 2): Planet e menaxhimit të pyjeve dhe mbështetja e zbatimit të tyre, të përgatitura

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt përfshijnë:

A.4.1 Përgatitjen e 10 planeve të menaxhimit të pyjeve në zonat e mbrojtura;

A.4.2 Përgatitjen e 10 planeve të menaxhimit të pyjeve komunale;

A.4.3 Përgatitjen e planit kombëtar të pyllëzimit/ripyllëzimit;

A.4.4 Zhvillimin e një liste masash prioritare për zbatimin e planeve të menaxhimit të pyjeve me plane zbatimi.

Produkti 5 (që ndikon në objektivin specifik 2): Pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore prioritare dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për MQP-të, janë zbatuar

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt përfshijnë:

A.5.1 Zbatimin e masave specifike prioritare të përfshira në planet e menaxhimit të pyjeve;

A.5.2 Blerjen e pajisjeve për MQP-në;

A.5.3 Ngritjen e njësisë qendrore të kujdesit pyjor brenda AKP-së.

Produkti 6 (që ndikon në objektivin specifik 2): Skema e granteve për zbatimin e masave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve, duke përfshirë parandalimin e zjarreve në pyje dhe erozionit, është zbatuar.

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt përfshijnë:

A.6.1 Përgatitjen e udhëzimit për aplikimin për grant për zbatimin e aktiviteteve të menaxhimit të pyjeve;

A.6.2 Zbatimin e pyllëzimit/ripyllëzimit të zonave të menaxhuara nga bashkitë përmes skemës së granteve;

A.6.3 Zbatimin e aktiviteteve për parandalimin e zjarreve në pyje përmes skemës së granteve.

Produkti 7 (që ndikon në objektivin specifik 1 dhe 2): Fushatat e ndërgjegjësimit publik që synojnë komunitetet lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të zbatuara

Aktivitetet e pritshme që kontribuojnë në këtë produkt, përfshijnë:

A.7.1 Zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

3.3 Integrimi

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti

Ndërhyrjet që do të zbatohen në kuadër të Veprimit, do të kenë ndikime pozitive mjedisore, pasi synojnë rritjen e kapacitetit të palëve të interesuara kombëtare për të planifikuar dhe zbatuar masa për të mundësuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Aktivitetet e zbatuara do të jenë të dizajnuara për të përmirësuar kushtet mjedisore në afatshkurtër dhe afatgjatë në pyje dhe habitatet e tyre. Nuk ka aktivitete që mund të kenë ndonjë ndikim negativ në mjedis, duke përfshirë klimën ose duke rritur ndjeshmërinë ndaj fatkeqësive. Programi i monitorimit dhe vlerësimit të projektit do të adresojë të gjitha shqetësimet dhe mundësitë mjedisore.

Duke promovuar dhe mbështetur MQP-në, ky veprim do të adresojë në mënyrë indirekte disa nga çështjet në qëndrueshmërinë mjedisore dhe do të përmirësojë qëndrueshmërinë e përgjithshme të vendit ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Projekti parashikon angazhimin e konsulencave ndërkombëtare që do të thotë se do të ketë udhëtime ndërkombëtare. Projekti po shqyrton kompensimin e karbonit për këto udhëtime duke kërkuar që konsulentët të kompensojnë udhëtimin e tyre me disa ndërhyrje pozitive (duke mbështetur mbjelljen e pemëve).

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

Zonat pyjore konsiderohen si vende ku burrat janë më të pranishëm. Gjithashtu, përdorimi i produkteve pyjore bëhet kryesisht nga burrat. Gratë nuk janë shumë të lidhura me pyjet, vetëm me aktivitetin e korrjes së bimëve të vogla. Si rrjedhojë, analiza gjinore është shumë e rëndësishme të kryhet në fillim të zbatimit të veprimit. Barazia gjinore: pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave në aktivitetet e projektit – do të merret në konsideratë në secilin aktivitet të Veprimit. Integrimi gjinor në aktivitetet e projektit duhet të konsiderohet si një mjet mbështetjeje për përmbushjen e objektivave të veprimit. Çdo aktivitet, kur zbatohet, duhet të integrohet nga ana gjinore, duke treguar kështu masa për të rritur balancën gjinore dhe paanshmërinë. Vendimet e palëve të interesuara në lidhje me aktivitetet e programit, do të merren vetëm me një përfaqësim të balancuar të gjinive.

Perspektiva gjinore duhet të përfshihet për të lehtësuar aksesin e barabartë në burime dhe mundësi; për të nxitur pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit, duke prezantuar mjete të ndjeshme ndaj gjinisë; për të nxitur mundësi të barabarta përmes aktiviteteve ekonomike, përfshirë bujqësinë, turizmin, pylltarinë dhe projektet e infrastrukturës. Veprimi duhet të marrë në konsideratë një vlerësim bazë të nevojave, i cili duhet të propozojë metodologjinë dhe rekomandimet konkrete për veprimet gjinore. Veprimi është në përputhje me

EU GAP III të BE-së dhe Strategjinë për Barazinë Gjinore 2021–2030 për Shqipërinë - objektivi që lidhet me promovimin dhe mbështetjen e sipërmarrjes së grave dhe të rinjve në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë ide inovative që synojnë ekonominë e gjelbër dhe digjitalizimin. Analiza gjinore do të zhvillojë më tej disa nga këto çështje në kontekstin e Shqipërisë, në mënyrë që menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve (MQP) dhe fushatat informuese të hartohen në përputhje me to, si dhe informacioni të arrijë në mënyrë efektive te burrat, gratë dhe fëmijët.

Sipas kodeve të OECD-së për çështjet gjinore DAC të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si G0. Kjo nënkupton që gjinia do të integrohet, por nuk do të ketë asnjë komponent specifik që lidhet me gjininë.

Të drejtat e njeriut

Veprimi i propozuar duhet të analizojë dhe integrojë perspektivën e të drejtave në procesin e planifikimit, duke u bazuar në legjislacionin ekzistues të BE-së dhe Shqipërisë, por duke marrë parasysh standarde më progresive. Në aktivitetet e projektit parashikohet një konsultim dhe pjesëmarrje e gjerë pa diskriminim, me kohë dhe buxhet të alokuar brenda procesit të planifikimit. Theksohet veçanërisht rëndësia e identifikimit dhe përfshirjes së grupeve vulnerabël brenda analizës së palëve të interesuara dhe orarit të konsultimeve, me referencë në Qasjen Bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDN). Disa aktivitete do të mbështesin një partneritet gjithëpërfshirës me organizatat lokale për të siguruar fuqizimin dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të njerëzve, duke përfshirë grupet më vulnerabël dhe të marzhinalizuara, me qëllim zgjerimin e pronësisë së tyre demokratike mbi politikat dhe nismat zhvillimore që ndikojnë në jetën e tyre.

Ndjeshmëria ndaj konflikteve, paqja dhe qëndrueshmëria

Zgjidhja e konflikteve: veçanërisht në komunitetin e bazuar në pylltari, ka interesa konkurruese midis grupeve të njerëzve dhe, varësisht nga konteksti, interesat e ndryshme dhe shkaqet e tyre mund të çojnë në një shpërthim dhune. Meqenëse projekti po punon në sektorin e pylltarisë dhe me palë të ndryshme të interesuara, në disa raste interesa konfliktuale, ka një mundësi të ulët që veprimi të kontribuojë në rritjen e tensioneve midis grupeve të ndryshme në nivel lokal, pasi planet e propozuara të menaxhimit adaptiv dhe të qëndrueshëm të pyjeve do të zhvillohen mbi një metodologji pjesëmarrëse. Nisur nga përvojat e mëparshme, disa shembuj përfshijnë përballjen midis komuniteteve lokale dhe grupeve të konservimit me zhvilluesit e hidrocentraleve brenda zonave të mbrojtura ose vendeve të përcaktuara si zona sensitive. Këto janë situata tepër sfiduese, të cilat zbuten përmes bashkimit të njerëzve në dialogë me shumë palë të interesuara, trajnime në ndërlidhje dhe negociata, si dhe gjetjes dhe mbështetjes së zgjidhjeve alternative. Krijimi i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në zona sensitive do të kontribuojë në ndryshime strukturore, duke ofruar mundësi për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike lokale që kontribuojnë në ruajtjen e natyrës, në vend që të shkaktojnë degradim mjedisor dhe konflikte shoqërore.

Ulja e rrezikut të fatkeqësive

Një objektiv i rëndësishëm i veprimit është rritja e kapaciteteve lokale për të pyllëzuar tokën e degraduar dhe për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme pyjet e tyre. Programi do të ofrojë stimuj për të rritur gatishmërinë e komuniteteve rurale për t'u angazhuar në aktivitete pyjore. Skema e stimujve do të ofrojë mbështetje financiare dhe për ndërtimin e kapaciteteve me objektivin për të: (i) rritur mundësitë formale të punësimit për popullsinë vendase në pyllëzim dhe menaxhim të pyjeve; (ii) rritur furnizimin me produkte pyjore jodrusore për popullsinë rurale,

3.4 Rreziqet dhe supozimet

Kategoria	Rreziku	Probabiliteti (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Masat zbutëse
Kat. 1	Koordinimi i dobët sektorial mund të pengojë progresin, pasi zbatimi i disa	Mesatar	I lartë	MTE (AKM, AKP, AKZM) kanë një mandat të qartë për politikën e ruajtjes së natyrës, menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe transpozimin e legjislacionit.

	aktiviteteve mbështetet në koordinimin ndërinstitucional ndërmjet MTE-së dhe institucioneve të tjera si MBZHR-ja dhe bashkitë.			Qëllimi i tyre është të përfshijnë bashkitë në fazat e hershme të procesit dhe të garantojnë angazhimin e tyre ndaj Veprimit. Gjithashtu, MTE-ja duhet të krijojë një grup koordinues veprimi të përbërë nga përfaqësues të palëve të interesuara përkatëse që do të sigurojë shkëmbim të rregullt të informacionit mbi politikat, dialog të qëndrueshëm dhe menaxhim të njohurive, në veçanti midis niveleve qendrore dhe nënkombëtare.
Kat. 3	Angazhim/mbështetje e kufizuar nga komunitetet lokale.	Mesatar	Mesatar	Do të hartohet një plan angazhimi i palëve të interesuara për të garantuar angazhimin dhe mbështetjen. Veprimi do të angazhojë në mënyrë aktive komunitetet lokale gjatë zbatimit me komunikim të synuar.
Kat. 5	Ndarja e kufizuar e të dhënave dhe informacionit midis institucioneve mund të rrezikojë vendimmarrjen.	I lartë	Mesatar	Në fillim të zbatimit të veprimit do të kryhet një hulumtim plotësues për të mbledhur të gjitha të dhënat e disponueshme dhe do të organizohet në mënyrë sistematike. Teknologjitë e informacionit do të zbatohen ose përdoren gjatë gjithë projektit, të cilat i përshtaten më së miri kontekstit lokal dhe nuk kufizojnë transferimin dhe komunikimin e informacionit. Një platformë e bazuar në internet do të krijohet gjatë projektit për të ndarë të dhëna dhe informacione.
Kat. 3	Kapaciteti i kufizuar absorbues, mungesa e burimeve njerëzore për të kryer proceset teknike dhe organizative, si dhe ndërrimi i shpeshtë i stafit mund të pengojnë ndikimin e masave të ndërtimit të kapaciteteve.	Mesatar	Mesatar	Përfaqësues alternativë brenda institucioneve do të rekomandohen që në fillim për të garantuar vazhdimësi të mjaftueshme të aderimit. Do të hartohen udhëzime teknike në anglisht dhe shqip për zbatimin e legjislacionit pyjor. Këto udhëzime do të udhëzojnë stafin e ri që përfshihet në veprim dhe atë të riun që do të përgatitet më vonë. Veprimi do të iniciojë bashkëpunimin dhe do të nxisë shkëmbimin ndërmjet institucioneve kombëtare dhe instituteve ndërkombëtare kërkimore.

Supozime të jashtme

Projekti bazohet në supozimet e jashtme si në vijim:

Në terma të përgjithshëm politikë, qeveria është e angazhuar teknikisht dhe financiarisht për të avancuar zbatimin e Agjendës së Gjelbër dhe planit përkatës të veprimit, duke qenë kështu në gjendje të zbatojë objektivat që rezultojnë nga angazhimet e reja globale dhe rajonale. Gjithashtu, supozohet se Shqipëria mbetet më e angazhuar drejt rrugës së BE-së dhe ndjek dinamikën e zhvillimit në sektorin mjedisor dhe barrën financiare përkatëse, megjithëse nuk mund të garantojë që Qeveria do t'i përmbahet të gjitha angazhimeve të marra.

Lidhur me kapacitetin e institucioneve, supozohet se ministria, agjencitë dhe bashkitë që kanë përgjegjësi për sektorin pyjor në Shqipëri, do të mbajnë kapacitete të mjaftueshme dhe të duhura njerëzore dhe financiare për të zbatuar legjislacionin, për të përmbushur detyrimet e raportimit dhe për të zbatuar planet e menaxhimit. Ngarkesa e shtuar e punës pasohet me një numër të mjaftueshëm personeli të caktuar në përputhje me planet e veprimit të miratuara për ndërtimin e kapaciteteve. Gjithashtu, supozohet se bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha palëve të interesuara përkatëse mbahen në një nivel të kënaqshëm.

Një supozim i rëndësishëm i jashtëm vazhdon të jetë se zhvillimi ekonomik është i qëndrueshëm (pa krizë ekonomike dhe financiare). Gjithashtu, supozohet se bashkitë dhe shoqëria civile do të jenë në gjendje të përfshihen në skemën e granteve dhe mbështetjen financiare të ofruar për menaxhimin e pyjeve dhe zbatimin e masave prioritare.

Autoritetet shqiptare duhet të përfundojnë krijimin dhe plotësimin e duhur të stafit të katër agjencive rajonale pyjore nën Agjencinë Kombëtare Pyjore, siç parashikohet në VKM-në nr. 570, 7.7.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare Pyjore", neni III.1.b. deri në fillimin e programit.

3.5 Matrica e kuadrit logjik tregues

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Treguesit	Synimet	Burimet e të dhënave	Supozime
Ndikimi	Përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe kontributi në veprimet dhe politikat kundër ndryshimeve klimatike për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët.	Emetimet e gazeve serrë (GHG/EGS) nga LULUCF/PTNPTP) (në kT CO_2e)	01319 (2016)	598 (2030)	Raporti Kombëtar i Kontributit të Caktuar	*Nuk aplikohet*
Rezultati 1	Kapacitetet administrative dhe përafrimi i kuadrit ligjor në sektorin pyjor në Shqipëri me atë të BE-së janë përmirësuar.	1.1 Përafrimi i legjislacionit të BE-së në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe pylltarinë	1.1. Pjesor (2022)	1.1. I plotë (2030)	Raporti Vjetor i Progresit i KE-së	Qeveria është e angazhuar teknikisht dhe financiarisht në avancimin e zbatimit të Agjendës së Gjelbër dhe Planit përkatës të Veprimit
Rezultati 2	Mbulimi pyjor dhe kapacitetet e thithjes së karbonit për Shqipërinë janë rritur	2.1 Emetimet e gazrave serrë ulen me mbështetjen e BE-së	Shqipëria (2025): 0	Shqipëria (112.5% e rezultateve përfundimtare të vitit 2020) (2030)	Agjencia Evropiane e Mjedisit	
Produkti 1 lidhur me rezultatin 1:	1. *Acquis* e BE-së për Pylltarinë është harmonizuar dhe legjislacioni tjetër është përgatitur.	1.1 Numri i akteve ligjore zbatuese që lidhen me sektorin e pylltarisë	10 (2022)	50 (2028)	Fletorja Zyrtare	Nuk ka ndryshime në shkallë të gjerë në kuadrin legjislativ kombëtar dhe të BE-së që lidhen me sektorin e pylltarisë
Produkti 2 lidhur Rezultatin 2	2. Kapaciteti administrativ dhe aftësitë për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve dhe mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, të përmirësuara	2.1 Numri i raporteve komunale	2.1. 0 Raportime nga bashkitë (2021)	2.1. 61 Raportimi i Komunës (2028)	Sistemi i raportimit i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP)	Bashkitë dhe institucionet qendrore kanë kapacitete të konsoliduara njerëzore dhe financiare për të përmbushur detyrimet e raportimit
Produkti 3 lidhur me rezultatin 2	3. Procesi i llogaritjes së emetimeve dhe heqjeve/largimeve nga pyjet në përputhje me Rregulloren PTNPTP dhe *acquis*-in përkatës të BE-së, është mbështetur.	3.1. Të dhënat standarde të emetimeve dhe heqjeve/ largimeve 3.2. Numri i personave të trajnuar për llogaritjen e emetimeve dhe heqjeve/ largimeve	3.1. I padisponueshëm (2022) 3.2 0 (2022)	3.1 I disponueshëm (2028) 3.2 30 (2028)	Të dhënat e raportimit të KKKBNK-së Raportet e AKP-së	Ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme në MTE dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të zbatuar procedurat për llogaritjen e emetimeve. Ekzistojnë fonde dhe kapacitete teknike të mjaftueshme në dispozicion për mirëmbajtjen e platformës elektronike.

Produkti 4 lidhur me rezultatin 1 dhe 2	4. Planet e menaxhimit të pyjeve dhe mbështetja e zbatimit të tyre, të përgatitura	4.1. Numri i bashkive që kanë plane MQP me masa përshtatjeje 4.2 Numri i trajnimeve për zbatimin e planeve të MQP-së	4.1. 9 Bashkia me plane të MQP-së (2022) 4.2 0 Trajnime të dedikuara (2022)	4.1 19 Bashkitë me plane të MQP-së (2028) 4.2 20 trajnime (2028)	4.1. Raportet e bashkisë 4.2 Raportet e trajnimit	Bashkitë dhe AKP-ja janë të hapura ndaj përgatitjes dhe zbatimit të planeve të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve komunale.
Produkti 5 lidhur me rezultatin 2	5. Pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore prioritare dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve (MQP), i zbatuar	5.1. Tokë e pyllëzuar/ripyllëzuar me mbështetjen e BE-së 5.2. Numri i qendrave për prodhimin e fidanëve pyjorë	5.1. 4 km² (2022) 5.2 0 (2022)	5.1. 8 km² (2028) 5.2 1 (2028)	Raporti i AKP-së	AKP-ja dhe AKZM-ja po ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për zbatimin e aktiviteteve të pyllëzimit/ripyllëzimit
Produkti 6 lidhur me rezultatin 2	6. Skema e granteve për zbatimin e masave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve, duke përfshirë parandalimin e zjarreve në pyje dhe erozionit, është zbatuar.	6.1 Numri i km² të pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme me mbështetjen e BE-së	6.1 0 (2025)	6.1 6 Për t'u përcaktuar (baza dhe objektivat për t'u përcaktuar pas publikimit të thirrjeve për propozime dhe dhënies së nëngranteve)	Raportet e zbatimit të granteve	AKP-ja është e përkushtuar dhe ka staf të mjaftueshëm për të mbështetur zbatimin e skemës së granteve. Ka kapacitete të mjaftueshme për të thithur dhe zbatuar grantet në nivel lokal nga palët e interesuara përkatëse.
Produkti 7 lidhur me rezultatin 1 dhe 2	7. Fushatat e ndërgjegjësimit publik që synojnë komunitetet lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të zbatuara	7.1 Numri i personave të arritur nga fushatat mbi MQP-në.	7.1. 0 (2022)	7.1. 150.000 (2028)	Raporti i monitorimit të Strategjisë së Komunikimit	Komunitetet lokale janë të gatshme të marrin pjesë dhe të përfshihen në fushatën e ndërgjegjësimit.

4. MARRËVESHJET ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e Financimit

Për të zbatuar këtë veprim, parashikohet të lidhet një marrëveshje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2 Periudha treguese e zbatimit

Periudha treguese e zbatimit operativ të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 72 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes së financimit.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të miratohen nga zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit, duke ndryshuar këtë vendim financimi dhe kontratat e marrëveshjet përkatëse.

4.3 Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të sigurojë që të respektohen rregullat dhe procedurat e duhura të BE-së për ofrimin e financimit për palët e treta, duke përfshirë procedurat e shqyrtimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së.

4.3.1 Menaxhimi indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllave

Ky veprim mund të zbatohet në menaxhim indirekt me një subjekt/ent të vlerësuar sipas shtyllës, i cili do të zgjidhet duke përdorur kriteret e mëposhtme:

i. mandati i subjektit të besuar që mbulon natyrën e veprimit;

ii. përvoja e subjektit të mundshëm në sektor; përvoja specifike në kuadrin rregullator të sektorit do të konsiderohej një aset;

iii. kapaciteti operacional/ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxheriale, duke përfshirë edhe në nivel lokal;

iv. efektiviteti i kostos së propozimit;

v. kapaciteti dhe gatishmëria e subjektit për të ofruar bashkëfinancim të mundshëm (vlerë e shtuar);

vi. përvoja në sektorin e mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;

vii. përvoja në menaxhimin e skemave të granteve.

Zbatimi i aktiviteteve mund të ndahet midis subjekteve/enteve të besuara, ku një nga subjektet/entet e besuara do të zbatojë produktet 1, 2, 3, 4 dhe 7, duke i përqendruar aktivitetet në forcimin e fushës së politikave dhe kapacitetet administrative përkatëse në sektorin pyjor. Grupi tjetër i aktiviteteve do të përqendrohet në rezultatin 5 dhe rezultatin 6, të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e mbulimit më të gjerë të pyjeve tokësore dhe potencialit për emetimet e karbonit. Më konkretisht, subjekti/enti i besuar do të jetë përgjegjës për zbatimin e masave specifike prioritare për pyllëzimin/ripyllëzimin e përfshirë në planet e menaxhimit të pyjeve dhe përmirësimin e praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për MQP-në duke krijuar një strukturë qendrore të kujdesit pyjor brenda AKP-së. Lidhur me një pjesë të aktiviteteve që lidhen me pyllëzimin/ripyllëzimin e zonave të menaxhuara nga bashkitë, subjekti/enti i besuar do të zbatojë duke hapur një thirrje për propozime për aplikantët që duhet të zbatojnë aktivitete të menaxhimit të pyjeve.

4.3.2 Ndryshimet nga mënyra e menaxhimit indirekt në atë të drejtpërdrejtë (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme

Nëse modaliteti i zbatimit nën menaxhim indirekt, siç përcaktohet në seksionin 4.3.1, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, modaliteti i zbatimit me anë të granteve nën menaxhim të drejtpërdrejtë do të përdoret sipas sa vijon:

a) Qëllimi i grantit/granteve

Granti do të kontribuojë në arritjen e të gjitha objektivave specifikë të këtij Veprimi.

b) Lloji i aplikantëve të synuar:

Subjekti/enti mund të jetë një organizatë joqeveritare; departament qeveritar, organ publik ose organ përkatës i mandatuar i një departamenti qeveritar ose autoriteti të organit publik të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian në fushat që lidhen me këtë veprim.

4.4 Fusha e përshtatshmërisë së kritereve gjeografike për prokurim dhe grante

Përshtatshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve dhe për sa i përket origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin bazë dhe përcaktohet në dokumentet përkatëse kontraktuale, do të zbatohet, në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund ta zgjerojë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose të mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores së IFZHBN-së (Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar) – Global Europe).

4.5 Buxheti tregues

Komponentët e buxhetit tregues	Kontributi i BE-së (shuma në EURO)	Kontributi tregues i palës së tretë (EURO)
Metodat e zbatimit – shihni seksionin 4.3		Nuk aplikohet
Produkti 1. Transpozimi i *acquis* të BE-së për Pylltarinë dhe legjislacionit tjetër të nevojshëm për të garantuar MPQ-në. Produkti 2. Kapacitet dhe aftësi të përmirësuara administrative për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbledhjen dhe raportimin e të dhënave. Produkti 3. Mbështetje për emetimet kontabël dhe heqjet/largimet nga pyjet në përputhje me PTNPTP-në dhe *acquis*-in përkatëse. Produkti 4. Zhvillimi i planeve të menaxhimit të pyjeve dhe mbështetja e zbatimit të tyre.	**2 590 000**	Nuk aplikohet

Produkti 7. Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik që synojnë komunitetet lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, i përbërë nga		
Menaxhim indirekt me entitet/et të vlerësuara sipas shtyllave - shih seksionin **Error! Reference source not found.**	2 590 000	Nuk aplikohet
Rezultati 5. Pyllëzimi/ripyllëzimi i zonave pyjore prioritare dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit dhe kapacitetit teknik për MPQ-në Rezultati 6. Skema e granteve për zbatimin e masave të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, duke përfshirë parandalimin e zjarreve në pyje dhe erozionit i përbërë nga	**10 100 000**	**Nuk aplikohet**
Menaxhim indirekt me subjektet/entet e vlerësuara sipas shtyllave - shihni seksionin **Error! Reference source not found.**	10 100 000	Nuk aplikohet
Vlerësimi – krahasoni seksionin 5.2 **Auditimi** – krahasoni seksionin 5.3	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk aplikohet
Komunikimi strategjik dhe diplomacia publike – shihni seksionin 6	Do të mbulohet nga një vendim tjetër	Nuk aplikohet
Kontingjencat	310 000	
Totali	**13 00 000**	

4.6 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Veprimi do të mbështetet në një sërë partnerësh, siç janë autoritetet kombëtare në nivel qendror dhe lokal, organizatat ndërkombëtare, agjencitë dhe organizatat e shteteve anëtare, organizatat e shoqërisë civile, institucionet financiare ndërkombëtare dhe të zhvillimit në objektiva ku ato kanë një vlerë të shtuar të qartë, duke u bazuar në përvojën e arritur dhe mësimet e nxjerra.

Veprimi do të ketë një komponent në nivel kombëtar, duke u përqendruar në hartimin dhe përmirësimin e politikave kombëtare për krijimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, dhe një komponent në nivel rajonal dhe lokal që përqendrohet në mbështetjen e përpjekjeve të bashkive me aktivitete pyllëzimi/ripyllëzimi në zonat e mbrojtura.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) do të jetë Përfituesja kryesore e Veprimit. Përfituesi përfundimtar i veprimit do të jetë Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Për shkak të përfshirjes së ngushtë të palëve të tjera të interesuara kombëtare, MTE do të bashkëpunojë dhe koordinohet ngushtë me Agjencinë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si dhe bashkitë gjatë zbatimit të veprimit.

Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA) brenda SASPAC-ut ka mandatin për koordinimin e përgjithshëm të programimit të IPA-s dhe do të jetë homologu kryesor i Komisionit Evropian për procesin e përgjithshëm të planifikimit strategjik, koordinimit të programimit, monitorimit të zbatimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA III.

Për koordinimin e përgjithshëm të politikave dhe asistencës, Qeveria e Shqipërisë ka një strukturë organizative ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili vepron si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për planifikimin e integruar të politikave publike. Më 22 tetor, urdhri i Kryeministrit (nr. 157) 2018 rishikoi grupet e menaxhimit të politikave të integruara (GMPI) dhe strukturat e komiteteve drejtuese sektoriale të lidhura për zbatimin e një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale për të menaxhuar dhe koordinuar politikat e fushave prioritare dhe sektorëve me rëndësi të veçantë, si dhe programimin ndërsektorial përmes formimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial/ndërsektorial. Komitetet drejtuese sektoriale (KSD) ofrojnë bashkëpunim në nivelin drejtues, brenda sektorëve me rëndësi të veçantë për reformat dhe koordinimin ndërinstitucional. Grupet tematike (GT) ofrojnë bashkëpunim në nivel teknik, duke përfshirë edhe me partnerët e zhvillimit, brenda sektorëve specifikë të fushës përkatëse prioritare.

KSD për Mjedisin, Klimën dhe Menaxhimin e Mbetjeve mblidhet nën drejtimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe shërben gjithashtu si një nga shtatë komitetet e monitorimit sektorial të IPA-

s. Ai do të mbikëqyrë zbatimin e përgjithshëm të veprimit. Do të kryhet koordinim specifik me bashkitë pjesëmarrëse dhe partnerët e tjerë zbatues, për të siguruar dialogun mbi politikat dhe menaxhimin e njohurive midis niveleve qendrore dhe nënkombëtare të qeverisjes. INSTAT, si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor që merret me statistikat zyrtare, do të informohet siç duhet për mbështetjen e ofruar nga ky program për institucione të tjera për të prodhuar të dhëna dhe statistika në sektorin pyjor (si AKZM-ja dhe AKP-ja). OSHC-të gjithashtu do të konsultohen gjatë zbatimit të këtij veprimi.

Për çdo kontratë të financuar në kuadër të Veprimit, do të krijohet një Komitet Drejtues i Projektit (KDP) që do të drejtojë zbatimin e projektit. KDP-ja do të përfshijë përfaqësues nga palët kryesore të interesuara, si dhe nga KIPAK dhe DBE. KDP-ja do të monitorojë nga afër përmbushjen e objektivit të projektit dhe rezultatet e tij. Detyrat specifike të KDP-së do të jenë: të shqyrtojë progresin dhe të miratojë raportet e zbatimit të Veprimit; të diskutojë çdo çështje të hapur që lidhet me zbatimin e Veprimit; të miratojë kërkesat për financim dhe të shqyrtojë e të marrë vendime në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e përgjithshme të Veprimit, të diskutojë së bashku çdo pikë kritike, rrezik ose pengesë në zbatimin e projektit dhe të propozojë e diskutojë zgjidhjet në rast problemesh. KD-ja do të takohet në intervale të rregullta, të paktën çdo tremujor, për të mbikëqyrur zbatimin e planit të projektit dhe, kur është e nevojshme, mbi baza *ad-hoc*.

KIPAK do të ketë rolin e monitorimit të përmbushjes së objektivave në nivelin e Veprimit.

Si pjesë e prerogativës së tij të zbatimit të buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit, Komisioni mund të marrë pjesë në strukturat e qeverisjes së mësipërme të ngritura për të rregulluar zbatimin e veprimit.

4.7 Parakushtet

Nuk aplikohet

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues duhet të krijojë një sistem të përhershëm monitorimi të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin dhe të hartojë raporte të rregullta progresi (jo më pak se vjetore) dhe raporte përfundimtare.

Çdo raport duhet të ofrojë një përshkrim të saktë të zbatimit të veprimit, vështirësive të hasura, ndryshimeve të prezantuara, si dhe shkallës së arritjes së rezultateve të tij (rezultatet dhe produktet e drejtpërdrejta) të matura nga treguesit përkatës, duke përdorur si referencë matricën e kuadrit logjik (për modalitetin e projektit) dhe listën e strategjisë, politikës ose planit të veprimit të reformës së partnerit (për mbështetjen buxhetore). Komisioni mund të ndërmarrë vizita shtesë monitorimi të projektit si përmes stafit të tij ashtu edhe përmes konsulentëve të pavarur të rekrutuar direkt nga Komisioni për rishikime të pavarura të monitorimit (ose të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e rishikimeve të tilla).

Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizën dhe monitorimin e të dhënave:

Veprimi do t'i nënshtrohet monitorimit nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, si dhe nga Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (NJQFK) dhe Përfituesi Përfundimtar në nivel kombëtar.

KKIPA-ja, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme mbi zbatimin e Asistencës IPA në vend, do të monitorojë zbatimin e veprimit dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuar. Autoriteti Kontraktues përkatës do të monitorojë zbatimin e aktiviteteve në nivel kontrate. MTE-ja, si pjesë e strukturës operative, do të ndjekë arritjen e treguesve dhe rezultatet e përcaktuara brenda Veprimit. MTE-ja do të informojë rregullisht KKIPA-ja dhe palët e interesuara përkatëse mbi zbatimin e treguesve. MTE-ja do të ndjekë zbatimin e aktiviteteve përkatëse dhe do të njoftojë për çdo vonesë dhe arsyet e vonesave të tilla.

Në përputhje me rregullat dhe procedurat e Komisionit Evropian të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, do të organizohet një Komitet i Përbashkët Monitorimi IPA, me pjesëmarrjen e KKIPA-së, institucioneve përfituese, autoritetit menaxhues dhe organeve ndërmjetëse, si dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri, për të shqyrtuar veprimet dhe progresin që lidhen me IPA-n. Puna e Komitetit të Monitorimit IPA do të mbështetet nga puna e Komitetit të Monitorimit Sektorial, i cili do të sigurojë procesin e monitorimit në nivel sektori. Rezultatet e monitorimit do të përdoren në procesin e hartimit të politikave për të

propozuar rregullime të programit dhe veprime korrigjuese.

Institucionet përkatëse duhet të përdorin mjetin e monitorimit të orientuar drejt rezultateve në raportimin mbi performancën dhe rezultatet e Veprimit. Ai duhet t'i referohet katër kritereve (përkatësisë, efikasitetit, efektivitetit, qëndrueshmërisë). Ky ushtrim mund të ofrojë informacion bazë që mund të shfrytëzohet për të orientuar monitorimin/vlerësimin/auditimin e ardhshëm dhe vendimet e menaxhimit në nivel veprimi. Një kornizë monitorimi e performancës për sektorin ende nuk është zhvilluar. Do të nevojitet mbështetje e mëtejshme për të forcuar kapacitetet analitike të ministrive, për të zhvilluar dhe zbatuar mjete monitorimi të politikave në përputhje me Udhëzimet e OECD/OBZHE-DAC/KAZH dhe për të përmirësuar strukturat dhe proceset për marrjen dhe komentimin e raporteve të monitorimit.

5.2 Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e veprimit, do të kryhet një vlerësim(e) afatmesëm *ex-post* për këtë veprim ose fushat e mbështetjes nëpërmjet konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet për qëllime mësimore, si dhe për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve të propozuara në lidhje me përshtatjen e ligjeve dhe përmirësimin e menaxhimit adaptiv të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e natyrës, duke siguruar kështu bazën për planifikimin e aktiviteteve të mëtejshme për menaxhimin e menaxhimit të pyjeve të qëndrueshëm, mbrojtjen e natyrës dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike në Shqipëri në fazën tjetër që do të mbështetet nga IPA III.

Vlerësimi *ex-post* do të kryhet për qëllime llogaridhënieje dhe mësimi në nivele të ndryshme (përfshirë rishikimin e politikave), duke marrë parasysh në veçanti përshtatjen e ligjeve për të trajtuar prerjen e paligjshme të pyjeve dhe tregtinë e lidhur me të, si dhe zbatimin e planit adaptues të menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike, biodiversitetit miqësor bazuar në përputhje me Strategjinë e re Pyjore të BE-së 2030.

Vlerësimi i këtij veprimi mund të kryhet individualisht.

Komisioni duhet të informojë partnerin zbatues të paktën tre muaj para datave të parashikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues duhet të bashkëpunojë në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët e vlerësimit dhe, ndër të tjera, t'u ofrojë atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe qasje në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit duhet të ndahen me vendin partner dhe palët e tjera të interesuara kryesore duke ndjekur praktikën më të mirë të shpërndarjes së vlerësimit. Partneri zbatues dhe Komisioni duhet të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e përshtatshme, në marrëveshje me vendin partner, të vendosin së bashku për veprimet pasuese që duhen ndërmarrë dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse tregohet, riorientimin e projektit.

Shërbimet e vlerësimit mund të kontraktohen sipas një kontrate kuadër shërbimi.

5.3 Auditimi dhe verifikimet

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij veprimi, Komisioni, në bazë të një vlerësimi të rrezikut, mund të kontraktojë auditim ose verifikim të pavarur për një ose disa kontrata ose marrëveshje.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual për të informuar audiencat përkatëse për mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre duke shfaqur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër financimi, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me veprimet përkatëse. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022 *Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme* (ose çdo dokument pasardhës).

Ky detyrim do të zbatohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse veprimet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve ose subjektet e besuara ose të deleguara, siç janë agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e Shteteve Anëtare të BE-së. Në secilin rast, një referencë për detyrimet përkatëse kontraktuale duhet të përfshihet në marrëveshjen përkatëse të financimit, kontratat e prokurimit dhe grantit, si dhe marrëveshjet e kontributit.

Rritja e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve në Shqipëri është një aspekt i

rëndësishëm për arritjen e objektivit të përgjithshëm të Veprimit. Gjithashtu, Veprimi do të mbështesë autoritetet përgjegjëse për komunikim efektiv të cilësive të veçanta të zonës së mbrojtur që u ofrohet vizitorëve potencialë.

Gjithashtu, Veprimi do të përhapë gjerësisht midis qytetarëve shqiptarë se ndihma e BE-së mbështet ndjeshëm mbrojtjen e pyjeve në Shqipëri. Përhapja e informacionit do të kontribuojë që qytetarët të kuptojnë më mirë vlerën e shtuar të fondeve të BE-së dhe përfitimet e zbatimit të objektivave të mbrojtjes së pyjeve të BE-së.

Strategjia e Komunikimit të Veprimit do të zbatohet në mënyrë efektive nëpërmjet organizimit të fushatave publike, ngjarjeve promovuese dhe të vizibilitetit, materialeve promovuese, përdorimit të mediave sociale, hartimit të spoteve televizive dhe shprehjes publike të mesazheve kryesore në lidhje me mbrojtjen e pyjeve. Megjithatë, të gjitha palët e interesuara e pranojnë se për shkak të natyrës së tij dhe rëndësisë së Veprimit për cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë, ai kërkon një qasje më strategjike në lidhje me komunikimin dhe vizibilitetin, në vend të zbatimit të masave dhe aktiviteteve *ad-hoc* të publicitetit.

Gjithashtu, një pjesë e veprimit synon zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik që synojnë komunitetet lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve që do të zbatohet si pjesë e rezultatit 7. Fushata do të promovojë perceptimin e prioriteteve të menaxhimit, pikat e forta të një komuniteti dhe mundësitë për MQP-në që do të gjenerojë skenarin më të mirë kosto-përfitim për të dyja palët, MVF-në dhe komunitetin lokal.

7. QËNDRUESHMËRIA

Parakushti më i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e rezultateve të Veprimit është bashkëpunimi dhe marrëdhënia e mirë midis ekipeve të Programit dhe përfituesve përfundimtarë të projektit gjatë zbatimit të veprimeve. Duke marrë parasysh hartimin e aktiviteteve, të cilat prezantojnë një qasje të përfshirjes së palëve të ndryshme të interesuara të lidhura me MQP-në si nga sektori qeveritar ashtu edhe nga ai joqeveritar, pritet që pronësia mbi rezultatet që duhen arritur, të mbrohet. Një pronësi më e madhe duhet të kontribuojë në sigurimin e rezultateve të qëndrueshme që do të ruhen në planin afatgjatë. Bazuar në sa më sipër, do të jetë me rëndësi themelore të sigurohet një përmirësim i vazhdueshëm i stafit të menaxhimit të pyjeve, si dhe një sistem i mirëmbajtjes së çdo infrastrukture, pajisjesh dhe mjetesh transporti të ofruara nga Programi.

Qëndrueshmëria e veprimit mund të ndikohet nga niveli i pjesëmarrjes dhe pronësisë së procesit të zbatimit nga përfituesit kryesorë. Duke pasur parasysh që programi do të ofrojë një sërë ligjesh për përshtatjen e legjislacionit dhe aktivitetesh për ndërtimin e kapaciteteve, është thelbësore të sigurohet një transferim i duhur i njohurive dhe aftësive të zhvillimit duke përdorur një sërë teknikash trajnimi, duke përfshirë punëtori, trajnime në vendin e punës, vizita shkëmbimi, ngjarje demonstruese etj. Programi do të krijojë bashkëpunim të ngushtë me përfituesit kryesorë (MTE, AKP, AKZM, AKM) për të garantuar fluks të kufizuar të stafit dhe për të rritur motivimin e stafit. Është e rëndësishme që temat e mbuluara nga aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të jenë të dobishme për aktivitetet e përditshme të monitorimit dhe menaxhimit të stafit. Qëndrueshmëria e aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve do të përmirësohet duke ofruar materiale të detajuara trajnimi dhe mjete të dokumentuara.

Për skemën e granteve pritet që kjo skemë të jetë një hap fillestar që do të ndiqet në të ardhmen nga përfituesi. Përdorimi i çerdhes së menaxhuar nga Agjencia do të ulë koston dhe do të mundësojë që në të ardhmen skema të mund të mbështetet nga skema qeveritare, të ardhurat nga përdorimi i pyjeve dhe skema e ardhshme e kompensimit të karbonit.

Për të garantuar qëndrueshmëri dhe përsëritje të proceseve për shqyrtimin dhe/ose zhvillimin e planeve të reja të menaxhimit për zonat e mbrojtura, kërkohet pjesëmarrja aktive e stafit nga institucionet e përfituesve. Mjetet dhe procedurat e përdorura në proces duhet të detajohen me kujdes dhe të dokumentohen për përdorim të mëtejshëm nga përfituesit.

Zhvillimi dhe zbatimi i duhur i një sistemi të monitorimit të performancës është një garanci për qëndrueshmërinë e përgjithshme të përpjekjeve për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Është me rëndësi të madhe që institucionet përkatëse shqiptare të pranojnë dhe të marrin pjesë nga afër në zhvillimin e sistemit dhe ta zbatojnë atë gjerësisht brenda kohëzgjatjes së veprimit.

Për më tepër, zbatimi i masave për zbutjen e prerjeve të paligjshme të pyjeve dhe rehabilitimi i habitateve/ekosistemeve të degraduara, si dhe zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë, do t'u ofrojë përfituesve përvojë të dobishme, duke treguar nivelin e përpjekjeve që do të kërkohen për të zbatuar masa të tilla në të ardhmen. Pjesëmarrja e plotë në procesin e zhvillimit të dokumentacionit të tenderimit, si dhe gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të këtyre punimeve, do t'u ofrojë kapacitete të dobishme institucioneve dhe do të garantojë qëndrueshmëri të punimeve të kryera.

Pjesëmarrja dhe komunikimi efektiv me palët e tjera të interesuara (shoqëria civile, komunitetet lokale, bashkitë) do të përforcojë gjithashtu qëndrueshmërinë e veprimeve të zbatuara dhe do të ofrojë mbështetje afatgjatë për përpjekjet mbi ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

AL
KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA V
Vendimi Zbatues i Komisionit për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
Dokumenti i Veprimit për BE-në për Punësim dhe Përfshirje Sociale

PLANI VJETOR I VEPRIMIT

Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës në kuptimin e nenit 110(2) të Rregullores Financiare, dhe planet dhe masat vjetore dhe shumëvjeçare të veprimit sipas nenit 9 të Rregullores IPA III dhe nenit 23(2) të Rregullores NDICI (Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar) – Global Europe.

1. PËRMBLEDHJE

1.1 Tabela përmbledhëse e Veprimit

Titulli	BE për punësim dhe përfshirje sociale Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
OPSYS *(sistemi operacional i Komisionit Evropian për menaxhimin e projekteve dhe kontratave)*	Referenca e biznesit OPSYS: ACT-62392
ABAC *(sistem financiar i Komisionit Evropian)*	Numri i nivelit 1 të angazhimit ABAC: JAD.1354182
Akti themelor	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III)
Plani Ekonomik dhe i Investimeve (PEI)	Po Zhvillimi njerëzor 100%
Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	Jo
Nisma Team Europe	Jo
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL	
Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse Prioriteti Tematik 1: Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, dhe shëndetësia (100%)

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)	**OZHQ kryesorë**: **OZHQ** 10: Pabarazitë e reduktuara **OZHQ** të tjera të rëndësishme: **OZHQ** 1: Asnjë varfëri; **OZHQ** 4: Arsim cilësor; **OZHQ** 5: Barazi gjinore; **OZHQ** 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike; **OZHQ** 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta			
Kodi(et) DAC	16010 – Mbrojtje sociale (50%) 16011 - Politika, planifikimi dhe administrimi i shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe mirëqenies (25%) 16015 - Shërbimet sociale (përfshirë zhvillimin e të rinjve dhe gratë + fëmijët) 16020 – Krijimi i vendeve të punës (25%) 11330 – Trajnim profesional (25%)			
Kanali kryesor i zbatimit	12000 – Qeveria përfituese			
Synimet	☐ Klima ☒ Gjinia ☐ Biodiversiteti			
Treguesit (nga formulari DAC)	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/mirëqeverisja	☐	☒	☒
	Ndihma për mjedisin	☒	☐	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, i të sapolindurve dhe i fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i rrezikut të fatkeqësive	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☐	☒	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta ndaj shkretëtirëzimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues dhe etiketime të brendshme	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	EIP/ **PEI**	☐	☒	☐
	Nismat kryesore ekonomike dhe të investimeve	PO ☐		JO ☒
	Etiketime:	YES		NO
	Transporti	☐		☒
	Energjia	☐		☒
	Mjedisi dhe qëndrueshmëria ndaj klimës	☐		☒
	Digjitale	☒		☐
	Zhvillimi ekonomik (përfshirë sektorin privat, tregtinë dhe mbështetjen makroekonomike)	☒		☐
	Zhvillimi njerëzor (përfshirë kapitalin njerëzor dhe të rinjtë)	☒		☐
	Rezistenca shëndetësore	☐		☒
	Migrimi dhe lëvizshmëria	☒		☐
	Bujqësia, siguria ushqimore dhe zhvillimi rural	☐		☒

	Sundimi i ligjit, qeverisja dhe reforma e administratës publike	☒		☐
	Të tjera	☐		☐
	Digjitalizimi	☐	☒	☐
	Etiketime:	PO		JO
	lidhshmëri digjitale	☐		☒
	qeverisje digjitale	☐		☒
	sipërmarrje digjitale	☐		☒
	aftësi/shkrim-lexim digjital	☒		☐
	shërbime digjitale	☒		☐
	Lidhshmëria	☐	☒	☐
	Etiketime:	PO		JO
	lidhshmëri digjitale	☐		☒
	energji	☐		☒
	transport	☐		☒
	shëndetësi	☐		☒
	arsim dhe kërkim	☒		☐
	Migrimi	☐	☒	☐
	Reduktimi i pabarazive	☐	☐	☒
	COVID-19	☒	☐	☐

INFORMACION MBI BUXHETIN	
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201 Kostoja totale e vlerësuar: 28 000 000 EURO Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së: 28 000 000 EURO nga të cilat - 24 000 000 EURO për mbështetje buxhetore - 4 000 000 EURO për mbështetje plotësuese
MENAXHIMI DHE ZBATIMI	
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	**Menaxhim direkt nëpërmjet:** - Mbështetjes buxhetore – kontratës së performancës të reformës sektoriale - Prokurimit
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor 2025
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit, të prokurimeve dhe kontratave grant	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, me përjashtim të rasteve të listuara në nenin 114(2) të Rregullores Financiare.
Periudha indikative [e zbatimit operacional]	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vjet pas lidhjes të Marrëveshjes së Financimit

Përmbledhja e Veprimit

Veprimi synon të ofrojë mbështetje për prioritetet e Qeverisë drejt avancimit të politikave të tregut të punës dhe reformave të mirëqenies sociale që nxisin mundësi të barabarta, punë të denjë dhe mirëqenie të popullsisë. Objektivi kryesor i veprimit është të zgjerojë mbulimin, përfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj goditjeve të masave të mbrojtjes sociale dhe tregut të punës, duke përfshirë kategoritë në rrezik përjashtimi.

Objektivat specifikë lidhen me: (i) përmirësimin e sistemeve të qeverisjes dhe instrumenteve të ofrimit të shërbimeve për vende pune më të mira dhe punësim të fuqisë punëtore, duke përfshirë zhvillimin e aftësive për të rinjtë dhe të rriturit, në përputhje me Agjendën Evropiane të Aftësive[40] dhe Zonën Evropiane të Arsimit; dhe (ii) përmirësimin e përshtatshmërisë së masave të mbrojtjes sociale dhe aksesit dhe cilësisë së masave të integruara të kujdesit social.

Këta objektiva u përgjigjen drejtpërdrejt sfidave strukturore me të cilat përballet aktualisht vendi. Shqipëria përjetoi një rimëkëmbje të shpejtë ekonomike pas dy tronditjeve të njëpasnjëshme (tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID-19), pjesërisht falë paketave stimuluese të politikave dhe ringjalljes së sektorëve të udhëtimit, ndërtimit dhe aktiviteteve të industrisë nxjerrëse. Investimet private, konsumi dhe shpenzimet publike nxitën rritjen, ndërsa borxhi publik mbeti i lartë. Rritja e inflacionit dhe lufta kundër Ukrainës rrezikojnë perspektivën ekonomike dhe të varfërisë në vitin 2022.

Mbajtja e ritmit të reformave në këto rrethana mbetet sfiduese. Punësimi dhe aftësitë mbeten shumë të rëndësishme në agjendën e politikave, me pranimin e gjerë se rritja e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, rritja e punësimit dhe përfshirja sociale janë thelbësore për rritjen e produktivitetit të Shqipërisë dhe rritjen gjithëpërfshirëse afatgjatë. Gjatë viteve 2021 dhe 2022, qeveria ka vijuar përpjekjet për realizimin e reformave strukturore, me synim rritjen e konkurrueshmërisë dhe avancimin e zhvillimit gjithëpërfshirës, nëpërmjet forcimit të institucioneve të tregut të punës dhe përmirësimit të aksesit të të gjithë kërkuesve të punës ndaj mundësive të punësimit. Ristrukturimi institucional i tregut të punës dhe i institucioneve për zhvillimin e aftësive ka përparuar gradualisht, megjithëse vijojnë të evidentohen mospërputhje midis kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon sektorin dhe ndikimit konkret që këto reforma kanë te përfituesit fundorë.

Situata e tregut të punës së grupeve të marzhinalizuara është veçanërisht sensitive dhe forcimi i sistemeve të mbrojtjes sociale krahas masave në tregun e punës, është thelbësor për të siguruar një rritje të qëndrueshme. Shpenzimet publike sociale të Shqipërisë në mbrojtjen sociale janë ndër më të ulëtat në Evropë (9.1% e PBB-së në vitin 2022, Programi i Reformës Ekonomike (PRE) i janarit 2023[41]).

Financimi për masat në tregun e punës mbetet i kufizuar, duke siguruar mbulim vetëm për një pjesë të vogël të personave joaktivë, të papunë dhe të papunësuar në mënyrë të plotë. Përfitimet nga mbrojtja sociale janë relativisht të mirësynuara (PRE, janar 2023), por shpenzimet për programin e asistencës sociale mbeten të kufizuara pavarësisht rritjeve të fundit, ndërsa një përqindje e lartë e popullsisë në rrezik varfërie mbetet e pambuluar. Reformat për të adresuar dobësitë e sistemit të mbrojtjes sociale, qasjen dhe mbulimin e pabarabartë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për grupet më të cenueshme, nivelet e larta të punësimit të pasigurt/informal, polarizimin e tregut të punës dhe një sistem arsimor dhe formimi profesional që nuk i përgjigjet nevojave të sektorit privat për sa i përket cilësisë apo përputhjes me tregun e punës, janë tashmë edhe më të rëndësishme dhe kërkojnë nxitje të shtuar. Rritja e inovacionit dhe e aftësive të të rinjve dhe të rriturve, si dhe zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit të integruar të kujdesit social, janë konsideruar të njihen si masa kryesore të reformës në PRE 2023–2025.

Veprimi është i lidhur me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 (në përgatitje e sipër); të dyja këto në kuadër të strategjisë ombrellë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030. Vizioni dhe objektivat e politikave të

[40] Axhenda Evropiane e Aftësive - Punësimi, Çështjet Sociale dhe Përfshirja - Komisioni Evropian (europa.eu)

[41] *Programet e Reformave Ekonomike 2023 të Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Turqisë dhe Kosovës: Pasqyrimi i Komisionit dhe vlerësimet sipas vendeve – Komisioni Evropian (europa.eu)**

përcaktuara në dy strategjitë janë të harmonizuara me kërkesat për integrimin e vendit në BE, rekomandimet sektoriale dhe progresin e zbatimit, duke marrë parasysh udhëzimet e politikave të dhëna nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të Programit të Reformave Ekonomike (PRE)[42] Planin e lartpërmendur Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, si dhe vlerësime të tjera përkatëse të kryera. Në veçanti, Veprimi është i lidhur me dritaren 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse e Planit Ekonomik dhe të Investimeve (PEI); Prioritetin tematik: arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, dhe shëndetësia. Ai kontribuon drejtpërdrejt në objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) 10: Zvogëlimi i pabarazive; si dhe në OZHQ të tjera të rëndësishme, përfshirë OZHQ 1: Pa varfëri; SDG 4: Arsimi cilësor; OZHQ 5: Barazia gjinore; OZHQ 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike; OZHQ 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.

1.3 Përfituesi i Veprimit

Veprimi do të zbatohet në Shqipëri

2. Argumentimi

2.1 Konteksti

Shqipëria ka vazhduar të ruajë fokusin e përgjithshëm në agjendën e reformave të BE-së, pavarësisht sfidës për të përballuar pasojat ekonomike dhe sociale të tronditjes së trefishtë nga tërmeti i vitit 2019, pandemisë dhe luftës së agresionit rus kundër Ukrainës (Raporti i Komisionit 2023). Konferenca e parë Ndërqeveritare me Shqipërinë u mblodh në mesin e vitit 2022, duke hapur zyrtarisht procesin e shqyrtimit.

Më 15 shtator 2021, miratoi Instrumentin e Asistencës së Paraaderimit 2021–2027 (IPA III). IPA III ka një buxhet prej 14.2 miliardë euro për të mbështetur zbatimin e reformave që lidhen me procesin e aderimit të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës[43], Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Turqisë. Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor paraqet një paketë të konsiderueshme investimesh që mobilizon rreth 30 miliardë euro për rajonin gjatë shtatë viteve të ardhshme.

Përgjigja Strategjike e Shqipërisë IPA III (2022) përcakton sesi Shqipëria planifikon të përdorë Asistencën Financiare IPA III për të kontribuar në objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të përcaktuar në Kuadrin e Programimit IPA III. Reformat prioritare, të cilat identifikohen si më të rëndësishmet për të adresuar objektivat kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe integrimit me Bashkimin Evropian rrjedhin nga dokumentet kryesore strategjike trevjeçare që përditësohen çdo vit, përkatësisht Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (2023–25) dhe Programi i Reformës Ekonomike (2023–2025)[44]. Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian është dokumenti kryesor i politikave që mbulon periudhën 2023–2030[45].

Rregullorja IPA III përcakton objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të instrumentit dhe pesë dritare dhe prioritete tematike. Brenda prioritetit tematik 1 "Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, dhe shëndetësia" përfshihen këta nënsektorë: arsimi (në të gjitha nivelet), rinia, sporti, punësimi, arsimi dhe formimi profesional, mbrojtja dhe përfshirja sociale, si dhe strehimi social dhe shëndeti publik. Ky kuadër strategjik është plotësisht koherent me prioritetet e "Investimit në një të ardhme digjitale" dhe "Investimit në kapitalin njerëzor" sipas **Planit Ekonomik dhe të Investimeve (PEI) për Ballkanin Perëndimor.**

Ndërhyrja është në përputhje me Zonën Evropiane të Arsimit (2021–2030)[46], e cila përcakton prioritetet për të përmirësuar cilësinë, barazinë, përfshirjen dhe suksesin për të gjithë në arsim dhe formim, për ta bërë të nxënit gjatë gjithë jetës dhe lëvizshmërinë një realitet për të gjithë, si dhe për të mbështetur tranzicionet e gjelbra dhe digjitale në

[42] Komisioni Evropian (KE, 2022), Programi i Reformave Ekonomike i Shqipërisë (2022–2024), Vlerësimi i Komisionit, 21 qershor 2022

[43] Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (IJC/GJND) mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

[44] https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Economic-Reform-Programme–2023–2025.pdfhttps://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Economic-Reform-Programme–2023–2025.pdf

[45] https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538 http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/538

[46] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021G0226(01)&from=EN

dhe përmes arsimit dhe formimit. Për më tepër, është në koherencë me Planin e Veprimit për Arsimin Digjital 2021–2027, i cili përcakton një vizion të përbashkët për arsim digjital cilësor, gjithëpërfshirës dhe të arritshëm në Evropë dhe synon të mbështesë përshtatjen e sistemeve të arsimit dhe formimit të Shteteve Anëtare me epokën digjitale.

Strategjia e BE-së për Ballkanin Perëndimor (**Një perspektivë e besueshme zgjerimi për angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor**)[47] synon të inkurajojë një angazhim të duhur nga të gjitha nivelet e qeverisjes, partnerët socialë dhe shoqëria civile. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur konkurrueshmërinë e sektorëve strategjikë në vend dhe për të adresuar papunësinë e lartë, veçanërisht te të rinjtë. Integrimi i romëve (dhe egjiptianëve) në shoqëri, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre të plotë në arsim dhe tregun e punës, ka rëndësi të veçantë dhe do të jetë prioritet kyç.

Programi i Reformës Ekonomike (PRE) parashikon masa për të përmirësuar punësimin e punëkërkuesve më të papunë në nevojë nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit të orientuara më mirë. Përmirësime të mëtejshme, veçanërisht për ata që ndodhen në kufijtë e tregut të punës, varen nga përmirësimi i politikave aktive të punësimit dhe ofrimi i shërbimeve sociale cilësore. PRE thekson rëndësinë e analizës së tregut të punës, institucionalizimit të nevojave dhe përshtatjes së masave aktive të tregut të punës (PG 5.2) dhe zbatimin e programit të garancisë për të rinjtë për mbështetje të të rinjve që nuk ndjekin shkollën dhe nuk janë të punësuar (PG 5.1).

PRE përmban disa masa reformash që janë relevante në kuadër të prioritetit tematik 1, duke përfshirë trajnimet dhe punësimin e mësuesve, përmirësimin e cilësisë dhe mbulueshmërisë së arsimit dhe formimit profesional (VET/AFP-së) (masa e reformës 1); përmirësimin e mundësive të punësimit për punëkërkuesit më në nevojë dhe të papunë (masa e reformës 2); dhe rritjen e mbulueshmërisë dhe përshtatshmërisë së sistemit të kujdesit social të integruar për të ulur pjesën e popullsisë në rrezik varfërie (në kuadër të masës së reformës 4).

Për më tepër, prioritetet sektoriale janë pjesë e rëndësishme e kuadrit strategjik afatgjatë të vendit të përcaktuar në **Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022–2030 (**NSDEI**/ SKZHIE 2022–2030)**. Ky kuadër strategjik gjithëpërfshirës paraqet udhëzime dhe përcakton prioritetet për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit në rrugën e tij drejt integrimit në BE, duke përfshirë lidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm për të arritur qëllimet e Agjendës 2030, duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2021–2030. **Punësimi dhe përfshirja sociale trajtohen në shtyllën e tretë të SKZHEI-së 2022–2030, Kohezioni Social, i cili përqendrohet në zhvillimin e burimeve njerëzore si kapitali më i vlefshëm në vend, duke synuar ofrimin e shërbimeve publike bazë për të gjithë, luftën kundër varfërisë dhe nxitjen e punësimit, forcimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe mbështetjen e të gjithë individëve në nevojë.**

Dy strategjitë kryesore që lidhen me këtë **AD** janë **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (SKPA)** dhe **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (SKMS)**. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) janë ministritë kryesore përgjegjëse për zbatimin e strategjisë përkatëse sektoriale.

Strategjia e re e Punësimit dhe Aftësive (NEPS) 2023–2030[48] e çon këtë vizion përpara me objektiva më ambiciozë, që lidhen me avancimin e agjendës së aftësive dhe politikave të tregut të punës. Një nga masat kryesore të NEPS-së së re (2023–2030), sipas objektivit të politikës 2[49] është një "tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së garancisë rinore". Një Plan Veprimi i Garancisë Rinore u lançua në vitin 2022 dhe u miratua në vitin 2023 me NEPS-në 2023–2030, duke u angazhuar për ofrimin e mundësive për punësim, trajnim ose arsim për çdo të ri NEET (15–29 vjeç) brenda katër muajve nga identifikimi i tyre, në përputhje me

[47] Balkans_BorchureA5_V7.indd (europa.eu)

[48] VKM nr. 173, datë 24.3.2023.

[49] Objektivi i politikës 2 i SKMS 2023–2030 synon "mundësimin e punësimit të denjë për gratë dhe burrat nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës".

rekomandimet e KE-së. Garancia rinore do të mundësojë një përshtatje më të madhe me *acquis*-i dhe politikat sociale të BE-së, si pjesë e procesit të vazhdueshëm të integrimit evropian, duke përfshirë Shtyllën e të Drejtave Sociale. Ajo përfshin një angazhim për t'u ofruar të rinjve vende pune të denja dhe arsim cilësor, në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së #8 (Puna e denjë dhe rritja ekonomike) dhe #4 (Arsimi cilësor).

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (SKMS) 2020–2023 kombinon politika dhe programe specifike që synojnë ofrimin e ndihmës sociale/ndihmës ekonomike (NE), shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe masave për të zgjeruar ofrimin e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët, familjet dhe të moshuarit. Strategjia synon lehtësimin e varfërisë, duke siguruar akses në shërbime sociale për individët në nevojë. Për mbrojtjen sociale është zhvilluar një strategji e re, por ende nuk është miratuar plotësisht.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (SKMS) është i frymëzuar nga qëllimet e përgjithshme të "Europa 2020" për arritjen e një rritjeje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe nga Shtylla Evropiane etë Drejtave Sociale.

Qeveria e Shqipërisë (QSH) ka vendosur prej kohësh masa ndërinstitucionale dhe organizative operacionale për menaxhimin e zbatimit të një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Që nga viti 2018, është formuar një mekanizëm menaxhimi sektorial/ndërsektorial për të menaxhuar dhe koordinuar politikat në fushat prioritare, përkatësisht grupet e menaxhimit të politikave të integruara (GMPI). GMPI-ja e punësimit dhe Politikave Sociale përbëhet nga dy grupe pune tematike: a) punësimi dhe aftësitë; dhe b) mbrojtja sociale dhe përfshirja.

Analiza e problemit

Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale[50] përqendrohet në: (i) mundësi të barabarta dhe akses në tregun e punës; (ii) kushte të drejta pune; dhe (iii) mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale. Një zbatim efektiv i shtyllës kërkon angazhime të konsiderueshme në lidhje me burime të mjaftueshme financiare, mjeteve të qeverisjes të përcaktuara qartë dhe një plan veprimi ambicioz, por realist[51] të cilat janë të gjitha të rëndësishme për pranimin e Shqipërisë në BE.

Implikimet e financave publike në sektorin e përfshirjes sociale për zbatimin e një programi SBS duhet të trajtohen nga një këndvështrim sistemik dhe alokues. Strategjitë e llogaritura me kosto janë të vendosura, të pasqyruara në programet buxhetore vjetore dhe afatmesme, dhe udhëzimet e politikave po ndiqen gjerësisht. Megjithatë, zbatimi i politikave dhe ritmi i reformave ndikohen nga mospërputhjet midis qëllimeve dhe objektivave të politikave dhe alokimeve financiare; nevoja për mekanizma të qëndrueshëm financimi dhe alokime strategjike të burimeve në fushat kryesore të politikave të përfshirjes sociale përtej planeve kohore vjetore dhe afatmesme. Kalimi i financimeve për shërbime dhe sisteme të reja kërkon nivele të larta të qëndrueshmërisë dhe koordinimit midis institucioneve të ndryshme që mbulojnë tregun e punës, mbrojtjen sociale, si dhe rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse në tërësi.

Palët kryesore të interesuara dhe çështjet përkatëse institucionale dhe organizative: mandatet, rolet e mundshme dhe kapacitetet

Ndërhyrja e propozuar synon masa të lidhura me përfshirjen sociale që bien nën përgjegjësinë e të paktën dy ministrive të ndryshme të linjës: MEKI dhe MSHMS-ja ka pa dyshim mandatin më të qartë në fushën e përfshirjes sociale. Megjithatë, me rikonfigurimin e përgjegjësive financiare dhe administrative për punësimin, aftësitë dhe politikën sociale, secila nga dy ministritë sektoriale menaxhon pjesë të konsiderueshme të buxhetit të përgjithshëm

50 Komisioni Evropian (KE, 2017a), Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale – Ndërtimi i një Bashkimi Evropian më të drejtë dhe më gjithëpërfshirës, e nënshkruar nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni në Samitin Social për Punë dhe Rritje të Drejtë në Gothenburg, Suedi, më 17 nëntor 2017. E aksesuar në: https://ec.europa.eu/commission/publications/european-pillar-social-rights-booklet_en.

51 Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (KESE, 2018), Zbatimi i Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale: çka nevojitet për të garantuar një ndikim pozitiv social, https://www.eesc.europa.eu/en/our-work/publications-other-work/publications/implementing-european-pillar-social-rights-what-needed-guarantee-positive-social-impact https://www.eesc.europa.eu/en/our-work/publications-other-work/publications/implementing-european-pillar-social-rights-what-needed-guarantee-positive-social-impact.

të sektorit.[52] Kjo justifikon nevojën për të zhvilluar një instrument të fortë koordinimi për menaxhimin e dialogut të brendshëm për të lehtësuar bashkëpunimin dhe koordinimin midis ministrive dhe agjencive përgjegjëse për aspekte të ndërlidhura të politikave dhe përmirësuar lidhjet midis fazave të ndryshme të ciklit të politikave, ciklit të buxhetit dhe rezultateve të menaxhimit të financave publike.

Ekziston një nevojë e qartë për të lidhur përmbajtjen dhe fokusin e programeve të veçanta me strukturat qeverisëse që përmirësojnë vendimmarrjen gjatë gjithë ciklit buxhetor me sisteme të menaxhimit financiar publik që përqendrohen në rezultate; me qëllim sigurimin e sinergjive dhe shmangien e mbivendosjeve midis rezultateve të programit në të gjitha institucionet e ndryshme.

Politikat e tregut të punës, arsimit dhe formimit profesional udhëhiqen nga MEKI dhe bëjnë pjesë në departamentin e ri të punësimit dhe aftësive, i cili ka përgjegjësi për hartimin e politikave dhe mbikëqyrjen e politikave strategjike dhe hartimin e programeve.

Është gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional me tri institucionet kryesore, përkatësisht Agjencinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) – përgjegjëse për zbatimin e politikave publike që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive dhe Agjencinë Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) – përgjegjëse për zhvillimin e standardeve të kualifikimit dhe sigurimin e cilësisë në AFP dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës (ISHP) - përgjegjës për zbatimin e Kodit të Punës (KP) dhe për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social që janë në kompetencë të MSHMS-së. AKPA-ja është agjencia ekzekutive përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe për menaxhimin e përditshëm të ofruesve publikë të AFP-së.

Përfshirja dhe mbrojtja sociale drejtohet nga MSHMS-ja si institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave në fushën e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit social. Shërbimi Social Shtetëror (SHSS) është agjencia ekzekutive përgjegjëse për menaxhimin e programeve me ndihmë financiare dhe të shërbimeve të kujdesit social[53], si dhe për përcaktimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe kompetencave të stafit në nivel kombëtar. Qeverisjet vendore kanë rol parësor në krijimin dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit social për personat në nevojë[54], por nuk kanë autoritet të drejtpërdrejtë në menaxhimin e programeve të mbrojtjes sociale me pagesa financiare (personat në nevojë (PN) dhe aftësi të kufizuara).

Megjithatë, qeverisjet vendore kanë përgjegjësinë për të menaxhuar procesin e aplikimeve, si dhe për të ndjekur kontaktet me aplikantët dhe/ose përfituesit përmes kontrolleve të rastësishme. Qeverisjet vendore kanë përgjegjësinë për hartimin dhe miratimin e planeve të kujdesit social për të udhëhequr ofrimin e shërbimeve sociale. Të 61 bashkitë kanë hartuar dhe miratuar planet e tyre sociale vendore. Disa nga këto plane janë duke u rishikuar aktualisht me mbështetjen e partnerëve të ndryshëm, pasi periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Megjithatë, shërbimet e kujdesit social mbeten të kufizuara në furnizim dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në territor. Shërbimet janë të përqendruara në zonat kryesore urbane dhe pasqyrojnë kufizime në burime dhe kapacitete. Sfida vazhdojnë të mbeten për forcimin e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore në vlerësimin, planifikimin, buxhetimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social. Qasjet e bazuara në komunitet në shërbimet e kujdesit social janë forcuar dhe janë shfaqur lloje më të ndryshme të ofrimit të

[52] Programet e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale të MSHPS-së përbëjnë 48% të buxhetit total të sektorit (përfshirë përfitimet financiare) ndërsa programet për punësimin dhe aftësitë përbëjnë 8% të buxhetit të sektorit, siç është përcaktuar këtu.

[53] Shërbimet e kujdesit social janë ndërhyrje jofinanciare që u ofrohen individëve, familjeve dhe komuniteteve për të ndihmuar në reduktimin e varfërisë, lehtësimin e rreziqeve, përmirësimin e përfshirjes dhe integrimit, dhe për të jetuar jetë të plota dhe të kënaqshme. Në nivel individual, shërbimet e kujdesit social në Shqipëri janë përcaktuar për të shërbyer për të rriturit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara; familjet që kanë problem në marrëdhënien e tyre martesore; për të reduktuar pengesat për në tregun e punës; të moshuarit dhe të dobët; individët me sëmundje afatgjata dhe kronike; fëmijët dhe të rriturit që vuajnë nga dhuna fizike ose abuzim seksual; të rinjtë dhe të rriturit me probleme abuzimi me drogë dhe substanca narkotike; fëmijët të cilët janë privuar nga kujdesi prindëror, të keqtrajtuar nga familjet e tyre ose në konflikt me ligjin.

[54] Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore në Shqipëri", neni 24.

shërbimeve, duke përfshirë fusha të tilla si mbështetja psikologjike, rritja e ndërgjegjësimit dhe avokimit. Me kalimin e viteve, numri i bashkive të mbuluara nga shërbimet e kujdesit social (publike dhe jopublike) ka pësuar gjithashtu rritje. MSHMS raporton se, që nga viti 2022, ekzistojnë 250 qendra publike të kujdesit social nga të cilat 80 janë rezidenciale dhe 170 janë qendra ditore. Megjithatë, të paktën dy bashki (Libohova dhe Himara) nuk ofrojnë asnjë shërbim të kujdesit social[55].

Në përgjithësi, në nivel ministrie dhe agjencie ekzekutive ekziston nevoja për të forcuar kapacitetet për monitorimin, vlerësimin dhe zbatimin e strategjive përkatëse sektoriale, strategjive të tjera sektoriale ndërsektoriale dhe planeve të veprimit.

Struktura e Departamentit të Përgjithshëm për Punësim dhe Aftësi (ish-MF-ja deri në janar 2024, aktualisht MEKI), u rishikua gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, duke shtuar më shumë burime në Drejtorinë e Përgjithshme për Punësim dhe Aftësi.[56] Në MSHMS, Drejtoria për Zhvillimin e Politikave për Mbrojtjen Sociale (DZHPMS) mbikëqyr zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Bashkërendimi i përgjithshëm midis MSHMS-së, MEKI-t dhe institucioneve të tyre të varësisë ka nevojë të forcohet si për qëllime planifikimi, ashtu edhe për buxhetim.

GMIP-ja për punësim dhe aftësi është mbledhur rregullisht. Vëmendje iu kushtua diskutimit të progresit të reformave qeveritare në sektorin e punësimit dhe mbrojtjes sociale. Grupet tematike përkatëse janë mbledhur rregullisht dhe kanë miratuar disa dokumente strategjike të politikave, si në sektorin e punësimit ashtu edhe atë të mbrojtjes sociale, duke përfshirë raportimin vjetor të progresit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, draftin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, Raportin Vjetor të SKPA-së 2021 dhe Garancinë Rinore.

2.3 Mësimet e nxjerra

Pas gati tri dekadash tranzicioni të zgjatur, Shqipëria është tashmë një vend me të ardhura të mesme, i cili përballet me sfida të vazhdueshme të politikave ekonomike dhe sociale. Disa partnerë zhvillimi janë të fokusuar në çështjet që lidhen me punësimin dhe mbrojtjen sociale në Shqipëri. Ndërhyrjet e partnerëve të zhvillimit në lidhje me fushat kryesore të politikave të përfshira në këtë dokument politikash, si pjesë e një kuadri më të gjerë politikash, janë përmbledhur dhe përshkruar më poshtë.

BE-ja u ka ofruar mbështetje të konsiderueshme autoriteteve shqiptare përmes mbështetjes buxhetore sektoriale, me Programin IPA 2020 të BE-së për Përfshirjen Sociale (në vazhdim), i cili synon si shërbimet e punësimit ashtu edhe ato të kujdesit social; dhe programin IPA 2015 të BE-së për Punësimin dhe Aftësitë, i përfunduar në vitin 2019. Përmes programit aktual IPA II MBS të BE-së për Përfshirjen Sociale 2020–24, BE-ja është angazhuar në një dialog politik më të strukturuar me Qeverinë e Shqipërisë mbi mbrojtjen sociale. Programi IPA 2022 të BE-së për Rininë, i udhëhequr nga ministri i Shtetit për Rininë, ka ndërhyrje që kontribuojnë në mirëqenien dhe aktivizimin e të rinjve. Programi IPA 2021 i BE-së për Inovacionin (faza 2) synon të forcojë ekosistemin e inovacionit dhe të nxisë krijimin e bizneseve të reja në Shqipëri, duke kontribuar kështu në konkurrueshmëri, rritje dhe punësim.

Asistenca e mëparshme e IPA-s u fokusua në reformat kyçe institucionale dhe ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të punësimit dhe aftësive, kryesisht nëpërmjet ndihmës për modernizimin e sistemit të AFP-së. Përveç kësaj, një numër projektesh kanë rritur ndjeshëm kapacitetin e bashkive dhe OSHC-ve për të adresuar barazinë gjinore dhe të drejtat e pakicave. BE-ja luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve për të advokuar dhe ofruar shërbime për popullatat në rrezik përjashtimi në kuadër të **Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të**

[55] Shihni progresraportin e SKMS-së 2022, qershor 2023, në https://shendetesia.gov.al/wp content /uploads/ 2023/11/ENGLISH_SP-monitoring-report_final-version.pdf. Ky progresraport gjithashtu nxjerr në pah disa mospërputhje në të dhënat e raportuara nga MSHSP-ja dhe SHSSH-ja. Drafti i ri i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2024–2030 raporton se kishte pesë bashki që nuk ofronin asnjë shërbim të kujdesit social në vitin 2023.

[56] Departamenti i Përgjithshëm i Politikave për Punësim, Aftësi dhe Sigurime Shoqërore i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të rritet në 30 punonjës në staf, nga 10 punonjës në staf që ka aktualisht. E njëjta strukturë është konfirmuar edhe në kuadër të MEKI-it.

Drejtat e Njeriut, programit të Instrumentit të Ndihmës për Shoqërinë Civile dhe Median (CSF&M/ NSHC&M) dhe programit të **Demokracisë Rajonale Vendore (DRV)**, si dhe përmes një numri projektesh rajonale**.**

Sektori i punësimit dhe aftësive ka përfituar nga mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit që kanë kontribuar në ngushtimin e hendekut financiar për shkak të fondeve të kufizuara publike, kanë prezantuar praktika të reja dhe kanë përmirësuar burimet njerëzore – të gjitha këto janë ndërmarrë në kuadër të zbatimit të strategjisë së SKPAS-së (2014–2020). Mbështetësit kryesorë në sektor janë Delegacioni i BE-së përmes mekanizmave të ndryshëm të financimit, duke përfshirë 50.65 milionë euro nga Programi i vazhdueshëm IPA 2020 MBS për Përfshirjen Sociale të financuar nga BE-ja, dhe 30 milionë euro nga Programi IPA 2017 MBS të BE-së për Punësimin.

Partnerët e tjerë kryesorë që kontribuojnë në këtë sektor pasohen nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC/BZZH) – Zhvillimi i Aftësive për Punësim (i zbatuar nga UNDP-ja), Aftësi për Punë (i zbatuar nga Swiss Contact) dhe Krijimi i Tregut të Punës në Funksionim për të Rinjtë (RISI Albania); Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (GIZ/BGJZH) që përqendrohet në migrim, zhvillimin e aftësive dhe punësim, dhe Programi BMZ *(Programi BMZ – Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)*– 'Fondi Rajonal i Sfidave' (kredi), dhe zhvillimi i infrastrukturës (i financuar nga SDC/BZZH), si dhe Bashkëpunimi Italian për Zhvillim.

Për sa i përket përfshirjes sociale, BE-ja ka ofruar mbështetje për të nxitur përfshirjen sociale të pakicave dhe grupeve të tjera të pafavorizuara, në veçanti të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Kjo është realizuar përmes ndërhyrjeve të përshtatura me fushëveprim të kufizuar në kuadër të programit kombëtar të veprimit ose, si alternativë, përmes veprimeve specifike të financuara nga Instrumenti i Shoqërisë Civile dhe Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut. BE-ja ka zbatuar, nëpërmjet UNDP-së, programin e promovimit të mirëqeverisjes dhe fuqizimit të romëve në nivel lokal (ROMACTED/PQMFRNV) të menaxhuar nga Këshilli i Evropës, dhe programin ROMA Integration 2020 (Program i integrimit të komunitetit rom) të menaxhuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) dhe projekte të tjera rajonale. Luftimi i diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të pafavorizuara (përfshirë LGBTI-në, pakicat dhe romët) është pjesë e Mekanizmit Horizontal të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës.

Banka Botërore, nëpërmjet një Projekti për **Modernizimin e Ndihmës Sociale** prej 48 milionë dollarësh amerikanë, ka mbështetur reformat në programet e ndihmës financiare dhe të aftësisë së kufizuar, me fokus në përmirësimin e barazisë dhe aksesit për të varfrit, rritjen e kapaciteteve, thjeshtimin e proceseve komplekse të aplikimit dhe krijimin e sistemeve të informacionit të menaxhimit. **Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim** është partner kyç në këtë sektor nëpërmjet mbështetjes drejt një programi të përfshirjes sociale, "Mos lër askënd pas" (2022–2026), i zbatuar nëpërmjet One UN në Shqipëri. Një numër partnerësh zhvillimi, përfshirë Bashkëpunimin zviceran, suedez, italian për Zhvillim dhe USAID-in, ofrojnë mbështetje financiare dhe teknike për një sërë OJQ-sh që përqendrohen te personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik, romët dhe egjiptianët. Secili prej këtyre programeve, përveç një programi zviceran për Zhvillim për reformën e aftësisë së kufizuar, vlerësohet në më pak se 0.5 milion euro. **Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim** (GIZ/BGJZH) ka një program rajonal për Ballkanin Perëndimor – Të drejtat sociale të grupeve të pafavorizuara – i cili synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor dhe po punon me bashki partnere të zgjedhura në Shqipëri. Megjithatë, duhet theksuar se meqëparashikohet një rol më i madh i autoriteteve vendore, do të ishte e rëndësishme që të gjitha këto ndërhyrje dhe mbështetje, përfshirë ato të parashikuara nga ky Veprim, të jenë të harmonizuara sipas një kuadri të përbashkët dhe të çojnë në rezultate cilësore dhe të qëndrueshme në të gjithë vendin.

Ky Veprim mund të çojë në harmonizimin dhe konsolidimin e mbështetjes nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit, si dhe të çojë në ndryshime të prekshme. Megjithatë, GMIP-ja për punësim dhe aftësi ofron një mundësi për të përmirësuar mekanizmat e koordinimit të donatorëve dhe mund të luajë një rol në rritjen e pronësisë së përfituesve mbi procesin e pranimit dhe harmonizimin gradual të ndërhyrjeve të donatorëve. Sektorët horizontalë si punësimi dhe aftësitë dhe

sektori social kanë nevojë për forma të përmirësuara të koordinimit të donatorëve. Megjithatë, bashkëpunimi midis donatorëve nuk mund të kompensojë mangësitë në angazhimin politik, drejtimin dhe konsensusin brenda qeverisë, i cili duhet të jetë forca kryesore lëvizëse në forcimin e një pronësie të tillë. Forcimi i mekanizmave të koordinimit të donatorëve duhet të jetë në përputhje me angazhimin e qeverisë për të rritur përgjegjësinë dhe pronësinë e saj mbi zbatimin e programit dhe në të njëjtën kohë të garantojë qëndrueshmëri. Një nga çështjet më të rëndësishme të ndihmës në fushat e përfshirjes sociale lidhet me pronësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve dhe tendencën e partnerëve të zhvillimit për të zgjedhur dhe mbrojtur "projektet e preferuara" ose për të zgjedhur popullata "të veçanta", pa i kushtuar shumë vëmendje zhvillimit të sistemeve. Përqendrimi në "projekte", pa i kushtuar vëmendje të duhur qëndrueshmërisë së sistemeve, do të thotë humbje e lartë, mungesë trashëgimie dhe ndikim të dobët. Pronësia mbi programet dhe projektet individuale nga përfituesit përfundimtarë është e rëndësishme dhe në rastin e punimeve dhe furnizimeve, kërkohet mirëmbajtje e duhur.

Ky është edhe më shumë problematik në rastin e punësimit, aftësive dhe mbrojtjes sociale, ku po krijohen një numër institucionesh të reja dhe ku bashkitë po luajnë role më strategjike dhe qendrore në ofrimin e shërbimeve. Këto ndryshime kërkojnë mbështetje shtesë në rekrutimin e stafit dhe kostot e mirëmbajtjes për godinat dhe sistemet e reja të IT-së. Për të garantuar qëndrueshmëri, është e nevojshme që kosto të tilla të mbulohen plotësisht nga buxheti i shtetit brenda PBA-së (Programi Buxhetor Afatmesëm).

Për projektet e pavarura të asistencës teknike, faktorët kryesorë që ndikojnë në impakt dhe qëndrueshmëri janë mungesa e përfshirjes politike dhe e burimeve njerëzore dhe financiare për vazhdimin e zbatimit të masave të reformës pas përfundimit të projekteve të asistencës teknike.

Një nga mangësitë kryesore është që ndihma kthehet në zëvendësim dhe nuk nxit përpjekje për zgjerimin ose përmirësimin e alokimit të burimeve kombëtare. Për më tepër, duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje zhvillimit të legjislacionit në përputhje me të gjitha procedurat kombëtare të cilat janë të rëndësishme për zgjerimin e mbulimit dhe gjithëpërfshirjes së shërbimeve publike thelbësore. Si rrjedhojë, koordinimit ndërministror dhe përafrimit me kuadrin buxhetor afatmesëm duhet t'i jepet përparësi shumë më e lartë. Një program me qasje të shumëfishtë që ndërthur mbështetjen buxhetore sektoriale me asistencën teknike, ka më shumë gjasa të arrijë këtë synim.

2.4 Fushat shtesë të vlerësimit

2.4.1 Politika publike

Prioritetet për këtë Veprim përcaktohen në përputhje me politikat e Qeverisë së Shqipërisë, siç përcaktohen në shtyllën 2 (Rritja e qëndrueshme ekonomike, ndërlidhja dhe rritja e gjelbër) dhe shtyllën 3 (Kohezioni social) të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030. Lidhur me ofrimin e shërbimeve të integruara, SKZHIE 2022–2030 ka përfshirë qëllimin e mëposhtëm: "çdo individ dhe familje shqiptare, siç janë kategoritë në nevojë, do të ketë akses të barabartë dhe do të përfitojë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit social, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitucionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit social" (SKZHIE 2022–2030, faqe 133).

Sipas kapitullit të mbrojtjes sociale, SKZHIE 2022–2030 thekson gjithashtu masat prioritare të lidhura me luftimin e pabarazive dhe diskriminimit ndaj pakicave etnike, LGBTIQ-së dhe popullatave të tjera të prirura ndaj diskriminimit. Gjithashtu, ajo thekson rëndësinë e ruajtjes së parimeve të barazisë gjinore dhe luftimit të dhunës me bazë gjinore përmes forcimit të mekanizmave të referimit për dhunën në familje dhe ofrimit të shërbimeve të përshtatshme.

Këto standarde politike janë përcaktuar gjithashtu në një sërë dokumentesh politikash, të cilat miratojnë një qasje ndërsektoriale drejt përfshirjes sociale, siç është Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2020–2030), i cili përqendrohet në ofrimin e mundësive të aksesit dhe riintegrimit për këto komunitete në fushat e punësimit dhe aftësive, mbrojtjes sociale dhe arsimit gjithëpërfshirës; b) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026; c) Plani i Veprimit për Lezbikët, Homoseksualët, Biseksualët, Transgjinorët (LGBT) 2021–2027 dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Strategjia Kombëtare për të Rinjtë. Prioritetet e përcaktuara në këtë Veprim të BE-së pasqyrohen në Programin e Reformës

Ekonomike (PRE) 2023–2025, i cili i jep përparësi "Rritjes së mbulimit dhe përshtatshmërisë së sistemit të integruar të kujdesit social për të zvogëluar pjesën e popullsisë në rrezik varfërie". Bazuar në PRE, Qeveria e Shqipërisë do të financojë reformat në fushën e mbrojtjes sociale me një mesatare prej 250 milionë euro në vit për periudhën 2023–2025, e cila është 10% më e lartë se në vitin 2022 dhe mbi 20% më e lartë mbi bazë vjetore krahasuar me periudhën para pandemisë. Prioritetet për asistencë lidhen gjithashtu drejtpërdrejt me politikat specifike të përfshirjes sociale të përcaktuara në Strategjitë Sektoriale, në veçanti, Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030 dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale. Drejtimet kryesore të politikave, siç përcaktohen nga strategjitë kryesore, janë:

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030 u përfundua në fund të vitit 2022 dhe synon të avancojë ndikimin e rëndësishëm pozitiv që u gjenerua si në aspektin e rezultateve të punësimit edhe drejt modernizimit të sistemit të arsimit dhe trajnimit profesional në vend gjatë dekadës së fundit. SKPA-ja thekson angazhimin e saj për të ofruar punësim cilësor dhe trajnim gjatë gjithë jetës për të gjithë, duke u bazuar në progresin aktual në qeverisjen dhe sistemet e tregut të punës dhe duke forcuar kapacitetet për të ofruar shërbime për të gjithë, veçanërisht për ata që janë më larg tregut të punës. Strategjia synon të integrojë politikat ekonomike, arsimore, profesionale dhe të sipërmarrjes së bashku nëpërmjet një plani veprimi dhe duke unifikuar punësimin dhe arsimin dhe trajnimin profesional për t'iu afruar kërkesave të tregut të punës, si dhe ofron fokus të shtuar në mundësitë e të nxënit gjatë gjithë jetës. Strategjia përmban dy shtylla kryesore ose qëllime politike: (i) zhvillimi i aftësive dhe përputhja më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim; dhe (ii) mundësimi i punësimit të denjë për gratë dhe burrat nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Strategjia u hartua në vitin 2022 nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke u bazuar në një proces të gjerë konsultimi me palët e interesuara kryesore institucionale, si dhe palët e tjera të interesuara, përfshirë partnerët socialë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit. Miratimi i saj përfundimtar nga Këshilli i Ministrave u arrit më 24 mars 2023.

Strategjia i vendos njohuritë dhe aftësitë në qendër të modelit ekonomik dhe pret të shkaktojë ndikim pozitiv në rritjen afatgjatë duke nxitur mundësi të mira punësimi përmes politikave më efektive të tregut të punës dhe duke siguruar një AFP cilësore për të rinjtë, të rriturit, gratë dhe burrat, në veçanti, duke kontribuar në transformimin digjital të vendit dhe agjendën e rritjes së gjelbër; ndërsa ul mundësitë për punësim informal dhe shkallët e punësimit informal në sektorët jashtë bujqësisë. Strategjia përbëhet nga 16 masa prioritare që përqendrohen në zhvillimin e një oferte AFP-je më të rëndësishme dhe fleksibël, duke përfshirë mekanizma të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë; nxitjen e mundësive gjithëpërfshirëse të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe masa lehtësuese, të tilla si njohja e të nxënit të mëparshëm dhe përmirësimi i qeverisjes dhe shërbimeve të bazuara në të dhëna dhe digjitale në ofrimin e shërbimeve të trajnimit dhe punësimit.

Përveç kësaj, Qeveria e Shqipërisë i ka dhënë përparësi sistemit të dyfishtë të arsimit profesional. Modeli është duke u pilotuar (2024–2025), duke përfshirë pesë profile profesionale[57], për nxënësit e klasës së 12-të në dhjetë shkolla, dhe një profil pas shkollës së mesme.[58] Normat e mësimdhënies dhe shpërndarja e instruktorëve përcaktohen nga kurrikula të miratuara.[59] Rolet për mentorët, koordinatorët e shkollave dhe monitorimin e praktikave (*intership*-eve) janë përcaktuar sipas VKM-së nr. 691, me rregullore të mëtejshme në pritje. Për të siguruar gatishmërinë, janë trajnuar bizneset dhe mësuesit e përshtatur me profilet.

SKPA 2023–2030 përqendrohet në aspekte të rëndësishme të përfshirjes sociale: përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimit për grupet e pafavorizuara duke përdorur ekosistemet e tregut të punës dhe fokus të veçantë në aktivizimin e të rinjve (garancia rinore); rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, si dhe integrimin e përfituesve të programeve të

[57] Arte kulinarie, pritje, multimedia, shërbime autoelektrike dhe instalime. Do të prezantohet gjithashtu një profil pasuniversitar në menaxhimin e akomodimit.

[58] Në Kamzë, Vlorë, Lezhë, Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Elbasan.

[59] Udhëzimi nr. 25, datë 1.9.2024, i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

mirëqenies në tregun e punës përmes masave dhe programeve të përshtatura. Ajo i përgjigjet sfidave kryesore që lidhen me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, duke marrë parasysh pjesëmarrjen relativisht të ulët të grave në tregun e punës, si dhe propozon masa për të adresuar pabarazitë dhe disavantazhet për grupe specifike vulnerabël, siç janë pakicat etnike (romët dhe egjiptianët).

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e SKPA-së 2023–2030 është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), së cilës iu caktua përgjegjësia për çështjet e punësimit dhe të punës që prej krijimit të saj në janar 2024, duke i marrë këto përgjegjësi nga ish-Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).[60] Kryhet monitorim vjetor i zbatimit të SKPA-së dhe performanca në dy operacione të njëpasnjëshme të mbështetjes buxhetore në terren ka qenë e suksesshme dhe ka kontribuar në ecuri pozitive në arritjen e objektivave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive. Shqipëria ka zhvilluar një program të garancisë rinore, i cili aktualisht është në fazë pilot dhe pritet të zbatohet në fund të viteve 2024/2025. Vendi gjithashtu ka miratuar Deklaratën e Osnabrück dhe ka hartuar një Plan Veprimi për zbatimin e saj në vitin 2022. SKPA 2023–2030 ka një kosto të vlerësuar 75.5 miliardë lekë (afërsisht 650 milionë euro), nga të cilat 67 për qind financohet nga buxhetit publik dhe 10 për qind nga programet ndërkombëtare të zhvillimit.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030 është gjithashtu e lidhur ngushtë me prioritetet e zhvillimit të vendit të përcaktuara në SKZHIE-në 2022–2030 dhe të përfshira në shtyllën e saj të dytë "Agjenda për rritje të qëndrueshme ekonomike, ndërlidhje dhe rritje të gjelbër". Ajo është në përputhje me Planin e Investimeve Ekonomike për Ballkanin Perëndimor dhe ndjek objektiva në pajtim me Agjendën e Aftësive të BE-së për të forcuar konkurrueshmërinë e qëndrueshme, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, si dhe me parimet e përfshirjes sociale të përcaktuara në Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020–2023 (SKMS)[61] synon reformimin e politikave të mbrojtjes sociale nëpërmjet transformimit të skemës së ndihmës sociale (NE) në një skemë aktive që mundëson riintegrimin social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjen dhe sigurimin e riintegrimit të fëmijëve në familje dhe komunitet, duke i kushtuar kujdes të veçantë jetimëve socialë dhe biologjikë, dhe duke siguruar ofrimin e shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. Një nga prioritetet është sigurimi i financimit të nevojshëm për grupet në fjalë nëpërmjet Fondit Social. SKMS-ja thekson gjithashtu nevojën për të vendosur lidhje dhe integruar më mirë politikat aktive të punësimit me politikat e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale. Tre objektivat kryesorë strategjikë të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS), janë: **A) Zbutja dhe ulja e varfërisë**, me fokus në modernizimin e sistemit të ndihmës ekonomike (NE), përfshirë administrimin e regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit; forcimin e kapaciteteve menaxhuese në nivel kombëtar dhe vendor; përmirësimin e përzgjedhjes së përfituesve, si dhe transformimin e saj në një program riintegrimi social nëpërmjet masave të aktivizimit në tregun e punës. **B) Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara**, me fokus në reformimin dhe përzgjedhjen më të mirë të skemës së përfitimeve në para për personat me aftësi të kufizuara, bazuar në sistemin e vlerësimit biopsikosocial; rritjen e transparencës, duke përfshirë krijimin e sistemeve të informacionit menaxherial; forcimin e sistemeve të monitorimit dhe inspektimit, si dhe ngritjen e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të plotësuar përfitimet në para. **C) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror** bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale përcakton prioritetet e reformës për periudhën 2020–2023 në fushën e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ajo integron masa për fuqizimin dhe mbështetjen e personave që jetojnë në varfëri, personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, grave, të moshuarve, të rinjve, pakicave etnike dhe kategorive të tjera të cenueshme. Vizioni

[60] Aktualisht Ministria e Financave (MF).

[61] SKMS-ja është rishikuar dhe zgjeruar për të mbuluar periudhën 2020–2023 dhe ruan objektivat kryesorë të përcaktuar në këtë Veprim të BE-së. Strategjia e rishikuar është miratuar nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM), më 24 dhjetor 2019.

i përgjithshëm është ndërtimi i një sistemi mbrojtjeje sociale për të luftuar pabarazitë socio-ekonomike me politika dhe mekanizma për të mbrojtur të gjithë individët vulnerabël ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegrimit social, të kombinuara me skema punësimi.

SKMS-ja iu nënshtrua një rishikimi afatmesëm në vitin 2019, në bazë të të cilit fushëveprimi i tij u zgjerua deri në fund të vitit 2023. Në vitin 2023, MSHMS-ja- si institucioni kryesor ka nisur një proces për hartimin e SKMS-së së re 2024–2030. Drejtimi kryesor strategjik që do të udhëheqë përgatitjen e dokumentit të ri të politikave është përcaktuar në SKZHIE 2022–2030 dhe PRE 2023–2025. Disa nga drejtimet e politikave të përfshira në këto dokumente, synojnë:

- vlerësimin e përshtatshmërisë së përfitimeve të ndihmës sociale dhe pagës minimale bazuar në të dhënat e anketës së të ardhurave dhe nivelit të jetesës (AANJ) dhe krijimin e një mekanizmi transparent për rishikimin e tyre (PRE 2023–2025);

- krijimin e mekanizmave efektivë për aktivizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e individëve që përfitojnë ndihmë sociale (PRE 2023–2025 dhe SKZHIE 2022–2030);

- përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve dhe përfitimeve të përqendruara te klienti, të aksesueshme dhe të përballueshme, si dhe garantimi i aksesit në shëndetësi, arsim, drejtësi dhe të gjitha aspektet e jetës publike (PRE 2023–2025 dhe SKZHIE 2022–2030);

- zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të kujdesit social përmes mekanizmit financiar të Fondit Social Kombëtar, si dhe decentralizimin e plotë dhe transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime të bazuara në komunitet. (PRE 2023–2025 dhe SKZHIE 2022–2030).

Është vënë re përparim në lidhje me zbatimin e politikave dhe besueshmërisë së dy strategjive kryesore, të përmbledhura më poshtë.

Progresi në lidhje me zbatimin e SKMS-së 2020–2030

Objektivi strategjik A (zbutja dhe ulja e varfërisë):

Numri i individëve që jetojnë nën pragun e rrezikut të varfërisë ka rënë nga 681,000 në vitin 2018 në 622,705 në vitin 2021. Në vitin 2022, rreth 64,000 familje përfituan nga skema e ndihmës ekonomike. Ka pasur përparim në kalimin e përfituesve të ndihmës ekonomike në punësim. Në vitin 2022, 2,501 individë u punësuan në AKPA dhe 1,077 individë u regjistruan në trajnime profesionale nga skema e NE-së. Pavarësisht sfidave, niveli i varfërisë së fëmijëve u vlerësua në 28.5% në vitin 2021.

Objektivi strategjik B (përmirësimi i personave me aftësi të kufizuara dhe cilësisë së jetës së tyre):

Zbatimi i një qasje të re vlerësimi uli numrin e përgjithshëm të përfituesve me 27%, duke sjellë një kursim prej 20% të buxhetit në vitin 2022. Indeksimi i pagesës për aftësinë e kufizuar me 7.5% në vitin 2022 ofroi mbështetje të mëtejshme financiare për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi strategjik C (zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social):

Numri i personave që marrin shërbime të kujdesit social është rritur ndjeshëm nga 10,000 përfitues në vitin 2019 në 42,553 në vitin 2021. Që nga viti 2022, ekzistojnë 250 qendra publike të kujdesit social, të cilat përfshijnë qendra rezidenciale dhe ditore, duke ofruar shërbime thelbësore për ata që kanë nevojë. Krijimi i Agjencisë për Garantimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore dhe të Kujdesit Social siguron cilësinë e shërbimeve, duke reflektuar një angazhim për të ofruar standarde të larta të kujdesit. Shërbimet e integruara socio-shëndetësore janë vendosur në 50 qendra shëndetësore në të gjithë territorin. Numri i shërbimeve sociale u rrit me 46% në vitin 2022 krahasuar me vitin 2020, me 13 shërbime të specializuara të ofruara në rrethe të ndryshme.

Në të tre objektivat strategjikë, rezultatet e arritura përfaqësojnë një hap pozitiv, duke reflektuar angazhimin dhe progresin e bërë në arritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike për popullatat vulnerabël.

Progresi në lidhje me zbatimin e SKPA-së:

Qëllimi 1 i politikës: Zhvillimi i aftësive dhe përputhja me tregun e punës

Objektivi strategjik 1.1: Zvogëlimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet. Fokusi kryesor i Shqipërisë është të zvogëlojë mospërputhjen e aftësive në tregun e punës. Kjo përfshin përshtatjen dhe zgjerimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional (AFP), bazuar në informacionin e tregut të punës dhe analizat e nevojave për aftësi. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) u lidh me sukses me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), duke rritur njohjen dhe përputhshmërinë. Për më tepër, janë krijuar Komitetet Sektoriale të Aftësive,

veçanërisht në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), për të punuar mbi vlerësimet e nevojave për aftësi, duke garantuar që programet e AFP-së të jenë në përputhje me kërkesat e industrisë. Në vitin 2022, 2,238 kompani bashkëpunuan me shkollat e AFP-së dhe 1,732 nënshkruan marrëveshje të dedikuara për mësimin në vendin e punës. Studimi gjurmues në vitin 2022 tregoi se 57.5% e të diplomuarve të AFP-së gjetën punë që përfaqëson një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar. Kultura e punës e ofruesve publikë të AFP-së aktualisht përfshin procese vetëvlerësimi, të cilat mbulojnë të pesë fushat e cilësisë, dhe u prezantua një platformë digjitale ( ) për të monitoruar zbatimin. Shqipëria po ndjek në mënyrë aktive zhvillimin e një sistemi AFP-je të garantuar në cilësi nëpërmjet një modeli gjithëpërfshirës akreditimi.

Objektivi strategjik 1.2: Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune. Shqipëria synon të rrisë nivelin e aftësive të individëve në moshë pune. Ajo ka bërë përparim të konsiderueshëm në përshtatjen e programeve të AFP-së dhe zgjerimin e mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës. U zhvillua një Plan Kombëtar Zbatimi (PKZ) për Deklaratën e Osnabruck-ut, duke u përqendruar në tranzicionet e gjelbra dhe digjitale. Rregullorja mbi njohjen e të nxënit paraprak, e miratuar në fund të vitit 2021, krijon një mjedis pozitiv për përmirësimin e aftësive. Shqipëria njeh potencialin e ofruesve privatë të AFP-së dhe po shqyrton mundësitë për të kanalizuar fondet publike në tregjet e formimit joformal. Ligji për nxitjen e punësimit u ndryshua në vitin 2023 për të mundësuar vënien në funksionim të Fondit të Punësimit Social dhe skemës së garancisë rinore.

Qëllimi 2 i politikës: Mundësi të denja punësimi

Objektivi strategjik 2.1: Ndërmjetësimi dhe ofrimi i programeve efektive dhe gjithëpërfshirëse që mbështetin punësimin. Shqipëria e ka diversifikuar portofolin e saj të masave aktive të tregut të punës (MATP) për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse për punësimin. Në vitin 2022, 4,344 punëkërkues përfituan nga tetë MATP të ndryshme, ku 53% prej tyre ishin gra. Skema e garancisë rinore është integruar në Planin Kombëtar, duke u përqendruar në aksesueshmëri dhe ndërgjegjësim. AKPA-ja po përmirëson sistemin e IT-së për shërbimet e punësimit për të mbështetur nismën e garancisë rinore. Është krijuar një mekanizëm referimi për të aktivizuar përfituesit e programit të ndihmës sociale/NE. Është prezantuar menaxhimi i integruar i çështjeve (MIR), duke ofruar shërbime sociale dhe punësimi të përshtatura për komunitetet e marzhinalizuara. Aksesi fizik në shërbimet e tregut të punës për personat me aftësi të kufizuara është përmirësuar dhe zbatimi i këtij modeli është në vazhdim.

Objektivi strategjik 2.2: Sigurimi i punës së denjë për të gjithë dhe kudo. Shqipëria është e përkushtuar për të siguruar punë të denjë në të gjithë vendin. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHS) po konsolidon vazhdimisht strukturën e tij dhe po përmirëson inspektimin e punës. Një "platformë ndërgjegjësimi" inkurajon bashkëpunimin me sektorin privat, ndërsa listat e kontrollit të përshtatura sipas sektorëve kanë rritur efikasitetin e procesit të inspektimit. Po zhvillohen inspektime të bazuara në vlerësimin e riskut dhe po merren masa për të adresuar çështjet e diskriminimit me bazë gjinore. Paga minimale është rritur gradualisht, me rritjen më të fundit në 40,000 lekë në prill 2023. Ky fokus në kushtet e denja të punës kontribuon në një mjedis pune më të sigurt dhe në përputhje me standardet ligjore për punonjësit.

Për sa i përket financimit, kuadri strategjik për programet e mbështetjes buxhetore në Shqipëri është i përllogaritur dhe i mirintegruar në kuadrin e buxhetit afatmesëm. SKAPA 2019–2022 fillimisht u vlerësua me një kosto prej 17.5 miliardë lekësh ose 142.7 milionë eurosh, kryesisht të financuara përmes tri programeve buxhetore në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Strategjia e re e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, e miratuar në fillim të vitit 2023, ka një kosto të përllogaritur prej rreth 640 milionë eurosh për 8 vitet, me shumicën e rritjeve të buxhetit të planifikuara për periudhën 2025–2030.

Alokimet buxhetore për sektorin e punësimit pritet të mbeten të qëndrueshme në një mesatare prej 6.1 miliardë lekë në vit për periudhën 2023–2025. Ndërsa financimi për programet aktive të tregut të punës nuk pritet të rritet ndjeshëm, programi i garancisë rinore parashikohet të financohet përmes mbështetjes së BE-së dhe burimeve të buxhetit të shtetit. Megjithatë, ka pasur probleme me thithjen e fondeve në sektorin e punësimit dhe AFP-së, me një shpenzim të pandryshuar gjatë viteve të fundit.

Në sektorin e mbrojtjes sociale, SKMS 2020–2023 me një kosto prej 24.8 miliardë lekë (202 milionë euro) dhe u financua përmes programit buxhetor të mbrojtjes sociale në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Alokimet buxhetore të sektorit të mbrojtjes sociale u rritën krahasuar me parashikimet para pandemisë. Shpenzimet për ndihmat me vlerë monetare përbëjnë mbi 95% të programit total, dhe programi i ndihmës sociale pati një rritje të shpenzimeve për shkak të rregullimeve në shumat e përfitimeve në vitin 2022. Shpenzimet për përfitimet e aftësisë së kufizuar mbetën relativisht të qëndrueshme, ndërsa shpenzimet për shërbimet e kujdesit social mbetën modeste. Ato u rritën pak në vitin 2020 dhe 2022 në rreth 18 miliardë lekë dhe parashikohet të zbresin në 17 miliardë lekë në vitin 2023. Kjo rënie nuk është shoqëruar me një rritje të përpjesëtuar të shpenzimeve për shërbime.

Për më tepër, financimi për shpenzimet kapitale në shërbimet e kujdesit social, është alokuar në buxhetin e vitit 2023. Megjithatë, parashikueshmëria dhe qëndrueshmëria e shërbimeve të financuara përmes Fondit Social mbeten të paqëndrueshme. Ndikimi i Fondit Social ë kombinimin e financimit të shërbimeve të kujdesit social është minimal, pavarësisht alokimeve vjetore të buxhetit. Shpenzimet për shërbimet e kujdesit social mbeten tejet modeste në rreth 900 milionë lekë në vit, të cilat përfshijnë shpenzimet për institucionet e kujdesit social të menaxhuara nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), si dhe shpenzimet për Fondin Social. Që nga fillimi i funksionimit të tij në fund të vitit 2019 dhe deri në fund të vitit 2022, Fondi Social ka paguar vetëm rreth 137 milionë lekë për të mbështetur mbi 20 shërbime sociale në nivel bashkie, përveç financimit të programeve që janë tashmë në vazhdim, të zbatuara nëpërmjet këshillave të qarqeve. Ndikimi i Fondit Social në përzierjen e financimit të shërbimeve të kujdesit social është i papërfillshëm, pavarësisht ndarjeve vjetore të buxhetit midis 150 dhe 200 milionë lekë.

Në përfundim, politika në fjalë çmohet si mjaftueshëm e rëndësishme dhe e besueshme për të mundësuar arritjen në masë të konsiderueshme të objektivave të kontratës së mbështetjes buxhetore. Si rrjedhojë, kjo politikë mund të mbështetet nga Komisioni përmes kontratës së propozuar të mbështetjes buxhetore.

2.4.2 Politika makroekonomike

Ekonomia shqiptare tregoi qëndrueshmëri dhe u rimëkëmb shpejt pas tkurrjes gjatë vitit 2020 si pasojë e pandemisë COVID-19. Rimëkëmbja ekonomike ishte e ndjeshme, me një normë mesatare rritjeje prej 8.9% gjatë vitit 2021. Kjo prirje pozitive vazhdoi edhe gjatë vitit 2022, pavarësisht tronditjeve globale të shkaktuara nga lufta në Ukrainë, e cila solli rritje të kostove, pasiguri për investitorët dhe shtim të presioneve inflacioniste. Ritmi i rritjes u ngadalësua gjatë vitit 2022, me një vlerësim paraprak për rritjen totale të vitit prej 4.8% (INSTAT, 2023)[62], më i lartë se parashikimet fillestare të FMN-së dhe Bankës Botërore. Rritja ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 u moderua, në një rritje vjetore prej 2.8% dhe 3.3% përkatësisht në tremujorin e parë dhe të dytë. Ajo do të vazhdojë të mbështetet nga konsumi i fortë privat, pasuritë e paluajtshme, si dhe shërbimet, në veçanti turizmi. Ndërsa qeveria planifikon të kufizojë shpenzimet në përputhje me planet e konsolidimit fiskal, kostot më të larta të ofrimit të shërbimeve publike pritet të krijojnë presion shtesë mbi rritjen. Në vitin 2022, ekonomia shqiptare u ndikua ndjeshëm nga rritja e inflacionit të brendshëm – kryesisht e shkaktuar nga inflacioni i importuar. Norma e inflacionit arriti kulmin në shtator 2022, me 8.1%, krahasuar me nivelin prej 3.7% në janar 2022, e nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe naftës. Norma e inflacionit filloi të ulet në vitin 2023, me inflacionin mesatar vjetor gjatë tremujorit të dytë të 2023 që arriti në 4.6%, duke rënë me 1.9 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e parë, e mbështetur nga normat më të dobëta të inflacionit global dhe vlerësimi i kursit të këmbimit.

Normat e inflacionit pritet të kthehen në objektivin e Bankës së Shqipërisë (BSH) prej 3% deri në mes të vitit 2024, pasi çmimet e mallrave ndërkombëtarë stabilizohen, shtrëngohen dhe rritja ngadalësohet dhe rritja ngadalësohet, megjithëse presionet inflacioniste të brendshme mbeten të larta të nxitura nga rritja e pagave dhe kushtet e tregut të punës. Çmimet e larta për produktet thelbësore, në veçanti ushqimet, do të rëndojnë konsumin privat këtë vit (NJIE, tremujori i tretë (TM3) i vitit 2023).

[62] INSTAT, Rritja Ekonomike Tremujore, 30 mars 2023. https://www.instat.gov.al/al/

Kursi i këmbimit të lekut ndaj euros pësoi një rënie të shpejtë gjatë vitit 2023. Në korrik 2023, kursi i këmbimit të lekut shqiptar ishte 12% më i lartë se një vit më parë. Kurset e këmbimit filluan të stabilizohen në shtator, rreth niveleve të reja të arritura gjatë gjysmës së parë të vitit. Vlerësimi i monedhës vendase luajti një rol kyç në mbajtjen e normave të inflacionit më të ulëta dhe përmirësimin e bilanceve të pagesave në ekonomi. Politika monetare ka qenë e kujdesshme, duke marrë parasysh kurset e këmbimit dhe politikën e konsolidimit fiskal të ndjekur nga qeveria. Banka e Shqipërisë e ngriti normën bazë të politikës monetare me 25 pikë përqindje në 3 për qind në maj 2023, pas pesë ngritjeve të njëpasnjëshme në vitin 2022. Borxhi publik u ul më tej në më pak se 65% të PBB-së në vitin 2022 nga 73.2% e vlerësuar në vitin 2021. Në tremujorin e parë të vitit 2023, borxhet publike u vlerësuan në 63.3% të PBB-së (MF), të mbështetura nga mbështetur nga vlerësimi i kursit të këmbimit. Deficiti buxhetor (3.2% e PBB-së) dhe raporti i borxhit publik vazhduan të ulen në vitin 2022, por hapësira fiskale mbetet e kufizuar, duke rritur ndjeshmërinë e vendit ndaj goditjeve të jashtme. Bilanci buxhetor ishte pozitiv në tre tremujorët e parë të vitit 2023, me 52 miliardë lekë ose rreth 2.4% të PBB-së, vlera më e lartë e regjistruar ndonjëherë, duke pasqyruar të ardhura më të larta dhe shpenzime të kujdesshme për shkak të pasigurisë përpara. Shpenzimet për investime ranë me 9.6% krahasuar me vitin e kaluar, duke pasqyruar shpenzime më të ulëta të planifikuara dhe të zbatuara për Fondin e Rindërtimit.

Shpenzimet totale të buxhetit u rritën në 426 miliardë LEK, ose një rritje prej 3.6% nga viti në vit, e nxitur kryesisht nga rritja e pagave në sektorin publik dhe shpenzimet e qeverisjes vendore. Të ardhurat fiskale u rritën me 12% në tre tremujorët e parë të vitit 2023 për shkak të rritjes së fuqishme ekonomike, inflacionit të rritur, përpjekjeve për formalizim dhe rritjes së të ardhurave nga taksat mbi fitimin dhe taksat mbi të ardhurat personale. Të ardhurat nga TVSH-ja kontribuuan me 1.2 pikë përqindjeje në rritjen totale. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin gjeneruan kontributin e dytë më të lartë në rritjen totale. Flukset e investimeve të huaja direkte (IHD) në vitin 2022 arritën në nivelin prej 1.3 miliardë euro, duke qenë ndjeshëm më të larta (33%) krahasuar me vitin e kaluar. Në qershor 2023, Shqipëria emetoi një Eurobond me afat maturimi 5 vjeçar me vlerë 600 milionë Euro.

Shqipëria vazhdoi procesin e fiskalizimit dhe veprimet për të luftuar informalitetin. Rishikimet e buxhetit të tetorit 2023 rialokuan fondet e tepërta në projekte me performancë pozitive, duke synuar në veçanti përfundimin e Programit të Rindërtimit, si dhe mbështetjen e skemave të subvencioneve në sektorin e bujqësisë. Parametrat makroekonomikë vazhdojnë të synojnë nivele konstante të defiçitit publik dhe një ulje të borxhit publik.

Shqipëria mbeti e përkushtuar ndaj politikave të orientuara drejt stabilitetit, por disa dobësi në qeverisjen ekonomike vazhdojnë. Në Programin e saj të Reformës Ekonomike 2023–2025, ajo konfirmoi angazhimin e saj për t'u rikthyer në rrugën e konsolidimit fiskal para COVID-19 sapo të lejojë rimëkëmbja ekonomike dhe nënvizoi planin e saj për të arritur një bilanc parësor pozitiv në vitin 2024.

Në përfundim, autoritetet po ndjekin një politikë makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit dhe kriteri i pranueshmërisë është përmbushur.

2.4.3 Menaxhimi i financave publike

Reformat në menaxhimin e financave publike (MFP) janë në vazhdim, dhe vlerësimet e përgjithshme për MFP-në tregojnë një prirje pozitive, e konfirmuar edhe nga analizat e fundit. Megjithatë, reformat në disa fusha të MFP-së janë ndikuar nga pandemia e COVID-19, si dhe nga disa ndryshime politike dhe institucionale, përfshirë edhe kufizimet në kapacitete.

Vlerësimi i MPQM-së për parimet e administratës publike i nëntorit 2021, arrin në përfundimin se për MFP-në trajektorja e përgjithshme është në rritje, me rezultatin e MFP-së që është përmirësuar nga 2.7/5 në vitin 2017 në 3.3/5 në vitin 2021. Performanca në Shqipëri tani është mbi mesataren rajonale. Shumica e përmirësimeve kanë qenë në transparencën dhe gjithëpërfshirjen e raportimit të buxhetit, kuadrin operativ të auditimit të brendshëm; dhe kuadrin institucional dhe ligjor për prokurimin. Sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme në zbatimin e plotë, veçanërisht në auditimin e brendshëm, si dhe në konkurrueshmërinë dhe transparencën e prokurimeve. Një Strategji gjithëpërfshirëse e MFP-së (2019–2022) ishte në fuqi, me raportim të rregullt mbi ecurinë e saj. Strategjia e re pasuese e MFP-së është në proces dhe drafti i parë ka përfunduar në

janar 2024, duke integruar gjithashtu reformat e kërkuara në kuadër të procesit të aderimit në BE.

Kjo strategji plotësohet nga plane shtesë, duke përfshirë një Plan Veprimi të KBFP-së 2021–2022, një Strategji Afatmesme Borxhi 2022–2024 dhe një Strategji Kombëtare për Prokurimin Publik. Një Strategji Afatmesme e të Ardhurave (SAA) është në proces përgatitjeje, por ende nuk është miratuar. Shqipëria mbetet e hapur për vlerësime diagnostikuese me një IVDAT (Instrumenti i Vlerësimit Diagnostikues/Identifikues të Administratave Tatimore) të dytë të përfunduar së fundi, dhe një SHPPF të re (me rishikim të aspekteve të MFP-së që lidhen me ndryshimet klimatike) në përgatitje e sipër.

Gjatë dy viteve të fundit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) ka forcuar kapacitetet e saj për parashikimin makroekonomik dhe fiskal. Pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë e programit të buxhetit afatmesëm dhe lidhjet mes dokumentacionit të buxhetit dhe planifikimit, progresi është i ngadaltë dhe metodat dhe sistemet e reja (SIMFA, SPZI) nuk janë zbatuar ende plotësisht. Ndërtimi i kapaciteteve vazhdon, veçanërisht në nivelin e qeverisjes vendore, për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGJ), por pa e zgjeruar këtë qasje në programet e reja të buxhetit. Njësia e Rrezikut Fiskal, e krijuar në vitin 2019, ka zgjeruar gradualisht fushëveprimin e funksioneve të saj të monitorimit dhe raportimit, megjithëse mbulimi mbetet i paplotë. Monitorimi i Ndërmarrjeve Publike (NP) u zgjerua në vitin 2021, duke shtuar sektorin e ujit dhe një përzgjedhje kompanish të tjera, përveç sektorit të energjisë.

Procesi i vendimmarrjes dhe menaxhimit për investimet publike kërkon forcim, duke përfshirë një rol më të fortë rregullator nga Ministria e Financave në vlerësimin dhe miratimin e projekteve, duke përfshirë koncesionet dhe PPP-të dhe menaxhimin e riskut fiskal. Procedurat e menaxhimit të investimeve publike duhet të forcohen më shumë brenda Procesit të Kuadrit Buxhetor Afatmesëm dhe të ofrohet informacion i qartë mbi pasojat fiskale të projekteve. Procedurat e reja për menaxhimin e investimeve publike, të miratuara në fillim të vitit 2022, i kanë adresuar pjesërisht këto çështje.

Në lidhje me mobilizimin e të ardhurave vendore, të ardhurat tatimore patën një rimëkëmbje të konsiderueshme pas COVID-19, me të ardhura më të larta sesa parashikimet në vitet 2021, 2022 dhe gjysmën e parë të vitit 2023. Edhe pse po rriten përsëri, raporti i të ardhurave/PBB mbetet më i ulët se në vendet e ngjashme, dhe duhet të ndërmerren përpjekje të koordinuara për të rritur të ardhurat dhe shmangur reformimin e sistemit tatimor në mënyrë të shpërndarë.

BE-ja dhe FMN-ja kanë mbështetur fuqimisht një Strategji Afatmesme të të Ardhurave për ta arritur këtë. Një draft është përgatitur, por miratimi është shtyrë për shkak të kontekstit të ndërlikuar ekonomik. Në politikën tatimore, potenciali i rëndësishëm tatimor mund të arrihet përmes uljes së përjashtimeve dhe përafrimit të pragjeve të tatimeve të ndryshme.

Shqipëria është nënshkruese e konventave ndërkombëtare për BEPS-në/EBTZHF-në dhe shkëmbimin e informacionit, dhe paraqet rregullisht raporte për vlerësime nga kolegët. Ajo filloi shkëmbimin automatik të informacionit për qëllime tatimore në vitin 2020. Shqipëria vazhdon të jetë "në listën gri" nga FATF/TFVF (Task-Forca e Veprimit Financiar), për mangësi strategjike në kuadrin e saj kundër pastrimit të parave. Një plan veprimi është në proces zbatimi për arritjen e heqjes nga kjo listë, por ende mbeten disa veprime të pazbatuara. Një regjistër i pronësisë së përfituesve është krijuar në vitin 2021, si dhe një regjistër i centralizuar i llogarive bankare.

Për periudhën e ardhshme, strategjia e reformës së MFP-së do të duhet të zbatohet dhe rinovohet më tej. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë menaxhimit të rreziqeve të MFP-së, përfshirë:

Një zbatim më të mirë të kuadrit ekzistues për buxhetimin afatmesëm dhe vjetor, përfshirë përfshirjen më të gjerë të Parlamentit në rishikimet e buxhetit edhe kur nuk kërkohen akte normative. Zbatim i vazhdueshëm i rregullave fiskale, kur situata ekonomike e lejon. Reflektim i perspektivës së ndryshuar të tregjeve financiare në strategjinë e re të borxhit.

Përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve fiskale, veçanërisht ato që lidhen me ndërmarrjet publike në sektorin e energjisë; rritje e transparencës dhe parandalim i grumbullimit të detyrimeve të prapambetura në dritën e rreziqeve të vazhdueshme inflacioniste; monitorim i rreziqeve fiskale që lidhen me PPP-të, si dhe ato që rrjedhin nga skema të

ndryshme të garancisë sovrane për kreditë për kompanitë.

Si përfundim, strategjia e reformës së menaxhimit të financave publike është mjaftueshëm e rëndësishme dhe e besueshme, duke përfshirë edhe mobilizimin e të ardhurave të brendshme, dhe kriteri i pranueshmërisë është përmbushur.

2.4.4 Transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit

Transparenca buxhetore është përmirësuar në lidhje me sasinë dhe rëndësinë e informacionit si në nivel qendror edhe në atë vendor me zbatimin e reformave të MFP-së që nga viti 2014. Ligji organik i buxhetit përcakton dokumentet e buxhetit që duhet të publikohen dhe afatet kohore përkatëse, ndërsa ligji për institucionin e lartë të auditimit (ISA) përcakton kërkesat për auditime të jashtme dhe parashikon dispozita të mjaftueshme për pavarësi. Qeveria aktualisht publikon të gjitha dokumentet kryesore të buxhetit në një afat kohor në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përmirësimi i transparencës buxhetore dhe mbikëqyrjes së buxhetit janë objektiva të dedikuar të përfshirë në Strategjinë e MFP-së.

I gjithë dokumentacioni i buxhetit i parashikuar për vitin 2021 u publikua në kohën e duhur. Buxheti i vitit 2022 (propozimi i buxhetit të ekzekutivit dhe buxheti i miratuar) u publikua në kohën e duhur në faqen e internetit të MFE-së dhe në formë të shtypur në Fletoren Zyrtare, ndërsa propozimi i buxhetit të ekzekutivit për vitin 2023 u publikua më 20 tetor 2022. Si rrjedhojë, kërkesat për nivelin fillestar të mbështetjes buxhetore janë përmbushur, pasi si propozimi i buxhetit të Ekzekutivit edhe buxheti i miratuar janë publikuar brenda afatit ligjor

Anketa e Indeksit të Buxhetit të Hapur (IBH) që mbulon vitin 2021 i dha Shqipërisë një vlerësim prej 52/100, në përputhje me rezultatet e vitit 2019 dhe një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitet 2015 dhe 2017. IBH-ja zbuloi se të gjitha dokumentet e kërkuara të buxhetit ishin publikuar, por raporti i auditimit ishte vonuar (pjesërisht i shkaktuar nga ndikimi i COVID-19 në punën e auditimit).

Shqipëria vlerësohet pozitivisht për cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e deklaratës parabuxhetore dhe buxhetit të miratuar, por ka hapësirë për përmirësim në shqyrtimin e saj gjashtëmujor dhe buxhetin e qytetarëve. Shqipëria merr një vlerësim relativisht të ulët për pjesëmarrjen e publikut, kryesisht për shkak të mungesës së konsultimeve formale publike gjatë miratimit të buxhetit (zhvillohen konsultime gjatë hartimit) dhe në programimin e auditimit të jashtëm.

Si MFE-ja ashtu edhe Institucioni i Lartë i Auditimit kanë reaguar duke organizuar konsultime më formale me shoqërinë civile në vitin 2021 dhe 2022. Për sa i përket mbikëqyrjes së buxhetit, Shqipëria ka marrë 67 nga 100 pikë, me rezultate të mira për mbikëqyrjen legjislative dhe atë të auditimit (përkatësisht 64 dhe 72 pikë). Vlerësimi arrin në përfundimin se Parlamenti i Shqipërisë ofron mbikëqyrje të mjaftueshme të buxhetit.

Kalendari i përgatitjes dhe raportimit të buxhetit u respektua në vitet 2021 dhe 2022. Qeveria ka vazhduar të përdorë akte normative për të bërë ndryshime relativisht të rëndësishme në buxhet, të cilat u miratuan nga Parlamenti *ex post*. Këto përfshijnë përshtatjen e buxhetit në lidhje me COVID-19, si dhe përfshirjen e disa masave sociale në përgjigje të krizës energjetike në vitin 2022.

Ministria e Financave ka përmirësuar gjithashtu raportimin financiar, duke përfshirë raportimin e zgjeruar mbi rreziqet fiskale që rrjedhin nga NP-të, qeverisja vendore dhe PPP-të. Kjo përfshin raporte ose raportime specifike të integruara në dokumentacionin e buxhetit. Përmbajtja dhe mbulimi i deklaratës së rrezikut fiskal dhe dokumentacionit mbështetës mund të përmirësohen ende. Duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm fiskal të krizës së energjisë, raportimi mbi NP-të – veçanërisht ato që veprojnë në sektorin e energjisë – duhet të ruhet dhe të përmirësohet.

Në vitin 2021, Institucioni i Lartë i Auditimit (ISA) arriti të rifillojë programin e rregullt të auditimeve, pas një ngadalësimi në vitin 2020 për shkak të COVID-19. U përfunduan 158 auditime (nga 120 të planifikuara). Në program u shtuan disa auditime tematike të lidhura me shpenzimet për COVID-19 dhe tërmetin. U shënua progres në objektivin për të rritur përqindjen e auditimeve financiare dhe të performancës. Auditimi i qeverisjes vendore u rrit me 45 auditime të kryera në vitin 2021 (krahasuar me 12 në vitin 2020). Kjo ndodhi pjesërisht për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që vendos auditimin vjetor të të gjitha bashkive. Për këtë qëllim, u miratua një rritje e buxhetit të ISA-së nga Kuvendi. ISA-ja ka një sistem për të ndjekur pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të saj dhe raportoi një ulje të lehtë prej 1% në pranim dhe një rritje prej 8% në zbatimin

e rekomandimeve. Pavarësia e ISA-së është përmirësuar ndjeshëm që nga viti 2017 (MPQM, 2021), megjithëse kapaciteti i saj institucional duhet të zgjerohet. Në dhjetor 2022, ISA-ja miratoi Strategjinë e Zhvillimit 2023–2027, me masa që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe nxitjen e pavarësisë.

Gjithashtu, u ndërmorën disa hapa të rëndësishëm për të përmirësuar transparencën në lidhje me shpenzimet për COVID-19 dhe shpenzimet pas tërmetit, të cilat mund të japin mësime të dobishme për shpenzimet emergjente që lidhen me krizën energjetike. Fillimisht, për shkak të natyrës së jashtëzakonshme, shpenzimet për tërmetin dhe COVID-19 u mbajtën pjesërisht jashtë proceseve të rregullta buxhetore. Në vitin 2021, raportimi dhe mbikëqyrja e këtyre shpenzimeve u integruan në proceset e zakonshme të përgatitjes dhe raportimit buxhetor (u përfshinë në buxhetin e vitit 2022, si dhe në raportin e zbatimit të buxhetit për vitin 2020).

Në përfundim, dokumentacioni përkatës buxhetor është publikuar dhe kriteri i pranueshmërisë është përmbushur.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

Veprimi konsiston në një kontratë për reformë sektoriale për të zgjeruar mbulimin, gjithëpërfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj goditjeve të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi. Ai bazohet në progresin e arritur gjatë viteve të kaluara dhe synon të mbështesë vendin për të përballuar sfidat që burojnë nga ndryshimet strukturore në kontekstin global ekonomik dhe të tregut të punës, drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe force punëtore më të kualifikuar.

3.1 Logjika e ndërhyrjes

Objektivi i përgjithshëm (rezultatet) i këtij veprimi është që të zgjerojë mbulimin, përfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj goditjeve të masave të mbrojtjes sociale dhe tregut të punës, duke përfshirë kategoritë në rrezik përjashtimi.

Objektivi(at) specifik(ë), (rezultatet) e këtij veprimi janë:

1. Promovimi i zhvillimit të aftësive dhe punësimit duke përmirësuar arsimin, trajnimin dhe integrimin në tregun e punës, në veçanti për kategoritë e disavantazhuara (përfituesit e ndihmës sociale, personat me aftësi të kufizuara, migrantët, komunitetet rome dhe egjiptiane dhe gratë).

2. Përmirësimi i përshtatshmërisë së masave të mbrojtjes sociale, aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel lokal.

(Produktet) e nxitura që do të ofrohen nga ky veprim, të cilat kontribuojnë në objektivat specifikë përkatës (rezultatet), janë:

1.1 Sistemet e qeverisjes dhe të ofrimit të shërbimeve përmirësohen për të lehtësuar rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës, duke përfshirë përfituesit e ndihmës sociale dhe të personave me aftësi të kufizuara, të rinjtë, gratë, burrat dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi.

1.2 Ofrohen programe më të rëndësishme të arsimit dhe formimit profesional (AFP) me fokus në cilësinë, të mësuarit gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës dhe përshkueshmërinë e sistemit.

2.1 Rritja e shtrirjes dhe përshtatshmërisë së masave të mbrojtjes sociale.

2.2 Ngritja e një sistemi funksional dhe të integruar të shërbimeve cilësore të kujdesit social dhe komunitar në nivel lokal.

Produktet e drejtpërdrejta që do të ofrohen nga ky veprim, të cilat kontribuojnë në produktet përkatëse të nxitura, janë:

1.1.1 Kapacitete të përmirësuara teknike dhe organizative në MPQM, për të ofruar këshillim të intensifikuar në punë dhe mbështetje për kategoritë më larg tregut të punës.

1.1.2 Kapacitete të përmirësuara të sistemit të inteligjencës së aftësive për të përmirësuar vendimmarrjen e bazuar në prova në sektorin e punësimit dhe AFP-së.

1.2.1 Oferta e larmishme dhe fleksibël e AFP-së për të zgjeruar mundësitë e të nxënit gjatë gjithë jetës nëpërmjet aksesit më të mirë në format digjital dhe të kombinuar, si dhe skema financimi.

1.2.2 Ofruesit dhe mësuesit e AFP-së të aftësuar për të ofruar aftësi relevante për punët e së ardhmes, duke përfshirë transformimin digjital dhe punët e gjelbra,

2.1.1 Programet e mbrojtjes sociale, të rishikuara për të rritur mbulimin dhe efektivitetin.

2.2.1 Infrastruktura njerëzore dhe rregullatore e shërbimeve të kujdesit social, e përmirësuar.

2.2.2 Mbështetje për ngritjen e shërbimeve të integruara inovative të ofruara.

3.2 Aktivitete treguese

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 1.1:

- ndihmë teknike për proceset e brendshme të biznesit në NAES dhe modele të ndryshme shërbimesh për punësim (duke përfshirë shërbimin digjital, celular të punësimit etj.);
- mbështetje e zbatimit të Fondit Social të Punësimit (nëpërmjet mbështetjes plotësuese);
- përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve të fuqisë punëtore në nivel lokal dhe qendror për të garantuar cilësi të mirë të ofrimit të punësimit, shërbimeve të AFP-së dhe sociale, aftësive për punonjësit socialë dhe personelin tjetër në institucionet e AFP-së, si dhe shërbimeve rajonale/lokale dhe kombëtare të punësimit;
- ofrimi i ndihmës teknike për zgjerimin dhe funksionalizimin e sistemit të inteligjencës së aftësive (observatori i tregut të punës), duke përfshirë vlerësimin dhe hartimin e zgjidhjeve për ndërveprimin e të dhënave;
- rishikimi, ristrukturimi i programeve të promovimit të punësimit (PPP-të)/masave aktive të tregut të punës (MATP-së) dhe zgjerimi i gamës dhe fushëveprimit të programeve të ofruara dhe që udhëzojnë më të prekshmit. Modelet/procedurat ende duhet të konsolidohen në nivel rajonal dhe të përfshihen në nivel lokal;
- ndërtimi i kapaciteteve për hartimin e politikave, buxhetimin dhe monitorimin në MFE.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 1.2:

- riadaptimi i paketave të aftësive dhe kualifikimeve të AFP-së të përshtatura për ekonominë e gjelbër dhe transformimin digjital, bazuar në vlerësimin e analizës së hendekut të aftësive;
- përshtatja e paketave të kualifikimeve të AFP-së me KEK-un;
- mbështetje për institucionalizimin dhe zgjerimin e procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm (NNM-së), pas garancisë së fazës pilotuese (përmes mbështetjes plotësuese);
- mbështetje për zhvillimin, zbatimin dhe njohjen e mikrokredencialeve në të gjitha institucionet, bizneset, sektorët dhe kufijtë;
- studimi i fizibilitetit për përfshirjen e llogarive individuale të të nxënit;
- ndërtimi i kapaciteteve dhe rishikimi i funksioneve të garantimit të cilësisë, inspektimit dhe planifikimit për AFP-në;
- ndërtimi i kapaciteteve për hartimin e politikave, buxhetimin dhe monitorimin në MFE.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 2.1:

- kryerje e vlerësimeve të rreziqeve me të cilat përballen grupe të ndryshme të popullsisë dhe analizimi i ndikimeve të tyre të mundshme të rreziqeve klimatike, ngjarjeve të fatkeqësive natyrore, cenueshmërisë sociale dhe kushteve ekonomike në komunitete;
- vlerësimi i hendekut midis nevojave dhe ofrimit aktual të shërbimeve sociale;
- zhvillimi i një koncepti të qëndrueshëm dhe efikas në përdorimin e burimeve për një kornizë ndërsektoriale të (MSA-së) që modifikon nismat aktuale të mbrojtjes sociale për të adresuar ndikimet e lidhura me fatkeqësitë, me theks të veçantë në mbështetjen e grupeve më të cenueshme dhe krijimin e mekanizmave efikasë të koordinimit midis strukturave qeveritare për të siguruar një qasje të bashkërenduar të MSA-së;
- vlerësimi dhe ngritja e një mekanizmi të llogaridhënies sociale mbi të drejtat dhe detyrimet e partnerëve të përfshirë, përfshirë mekanizmat e apelimit.

Aktivitetet që lidhen me rezultatin 2.2:

- mbështetje për zbatimin e legjislacionit dhe zhvillimi i udhëzimeve të praktikave në fushën e kujdesit social për agjencitë zbatuese që kanë përgjegjësi për ofrimin dhe garantimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social;
- zhvillim aftësish në menaxhimin e rasteve dhe praktika të tjera bashkëkohore në punën me nevojat specifike të grupeve të ndryshme, nëpërmjet asistencës teknike;
- përmirësimi i koordinimit dhe zbatimit të politikave në nivel lokal, si dhe i partneriteteve midis bashkive dhe shoqërisë civile në ofrimin, monitorimin dhe vlerësimin e standardeve ekzistuese dhe të reja të shërbimeve;
- **mbështetje për zbatimin e praktikave kombëtare dhe lokale për kontraktimin e ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë manuale dhe modele (termat e referencës, përshkrimet e shërbimeve, treguesit e çmimit, treguesit e cilësisë së shërbimit, treguesit e performancës, kontratat model etj.);**
- **rritja e disponueshmërisë, aftësive dhe kapaciteteve të fuqisë punëtore në fushën sociale, si në nivel vendor ashtu edhe qendror,**

për të garantuar cilësi të mirë në ofrimin e shërbimeve sociale;

- **vlerësim dhe mbështetje për konsolidimin e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit (NJVNR), për të forcuar praktikat e menaxhimit të informacionit, referimin e rasteve dhe monitorimin e vlerësimin e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor;**

- **mbështetje për forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore në lehtësimin dhe zbatimin e duhur të procedurave të prokurimit publik për shërbimet e kujdesit social, përfshirë përshtatje shtesë/udhëzime mbi kuadrin rregullator nëse është e nevojshme;**

- krijimi i mekanizmave dhe platformave për të gjeneruar dhe mbështetur masa praktike që nxisin bashkëpunimin ndërbashkiak në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve;

- mbështetje për hartimin dhe zbatimin e shërbimeve të reja të integruara të kujdesit shëndetësor, kujdesit afatgjatë dhe shërbimeve sociale;

- asistencë teknike për trajnime mbi qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar për ofruesit e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet e përgjithshme (të lidhura me të gjitha produktet)

Aktivitetet kryesore për të zbatuar paketën e mbështetjes buxhetore janë dialogu mbi politikat, transferimi financiar, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.

- angazhimi në dialogun politik rreth kushteve dhe prioriteteve të reformës qeveritare, verifikimi i kushteve, objektivave dhe pagesës së mbështetjes buxhetore;

- transferimi i 24 milionë eurove në vendin përfitues gjatë viteve fiskale 2025, 2026 dhe 2027 nëpërmjet disbursimeve me këste fikse dhe të ndryshueshme;

- mbështetje e vazhdueshme për të përforcuar kapacitetet institucionale të Qeverisë për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS-në), Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë (SKPA-në) dhe masat plotësuese;

- përmirësimi i koordinimit të donatorëve përmes dialogut të rregullt dhe ndërtimi i kapaciteteve për strategjitë e mbrojtjes sociale dhe punësimit dhe aftësive nëpërmjet ndihmës plotësuese;

- forcimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale dhe Punësimit dhe Aftësive;

- monitorimi i rregullt i kritereve të pranueshmërisë për mbështetje buxhetore;

- transparencë e shtuar dhe konsultime publike me aktorët e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara kryesore në sektor, siç janë bizneset private dhe partnerët socialë;

- komunikimi dhe vizibiliteti i mbështetjes buxhetore.

Rezultatet e pritshme të asistencës teknike plotësuese, janë:

- monitorim i mirë i zbatimit të mbështetjes buxhetore;

- rritje e ndërgjegjësimit mbi strategjitë dhe politikat e SKPA-së dhe SKMS-së;

- kapacitete të përmirësuara teknike dhe organizative në MEKI/AKPA dhe AKAFKP dhe MSHMS/SHSS dhe bashki;

- krijimi i një kuadri premtues për masa mbështetëse efektive dhe efikase në fushën e mbrojtjes sociale dhe tregut të punës.

3.3 Integrimi

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i klimës dhe biodiversiteti

Në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit, ndryshimit të klimës dhe biodiversitetit, është e qartë se ndryshimi i klimës paraqet sfida të mëdha për Shqipërinë. Rritja e temperaturave, thatësirat, përmbytjet, rritja e nivelit të detit dhe ngjarje të tjera ekstreme të motit jo vetëm që ndikojnë në jetesën e individëve, por ushtrojnë gjithashtu presion mbi ekonominë kombëtare dhe lokale të Shqipërisë. Pavarësisht nëse këto sfida janë të përsëritura apo të izoluara, objektivat kryesorë janë mbrojtja e njerëzve nga pasojat e ndryshimeve klimatike dhe adresimi i shkaqeve të tyre themelore. Në këtë kuadër, është thelbësore të zbatohen masa që jo vetëm riaftësojnë punëtorët dhe mbështesin të papunët, por gjithashtu lehtësojnë një tranzicion drejt ekonomive më të gjelbra në Shqipëri. Një mjet i fuqishëm në arritjen e këtyre qëllimeve është mbrojtja sociale, e cila mund të mbrojë popullatat në rrezik më të lartë nga vështirësitë e lidhura me klimën dhe ata që preken negativisht nga kalimi drejt praktikave më të qëndrueshme. Sigurimi që këto grupe të cenueshme të kenë qasje në mbrojtje të përshtatshme sociale, është thelbësor në zbutjen e humbjeve të të ardhurave dhe aseteve, si dhe në ruajtjen e kapitalit

të komunitetit që mbështet jetesën dhe aktivitetet e tyre ekonomike. Për më tepër, veprimet që synojnë ofrimin e mbrojtjes sociale mund të shërbejnë edhe si mundësi për të nxitur prodhim dhe konsum më të qëndrueshëm, duke adresuar njëkohësisht shkaqet themelore të ndryshimeve klimatike dhe degradimit mjedisor. Prezantimi i nismave të reja për përfshirje sociale në nivel bashkiak, duke përfshirë shërbimet e kujdesit social dhe mbështetjen e punësimit, plotëson përpjekjet për të ulur varfërinë duke nxitur dhe mundësuar një kujdes më të madh mjedisor. Në përpjekjen për qëndrueshmëri mjedisore, është e domosdoshme të kryhet një vlerësim i hollësishëm gjatë zbatimit të Veprimit për gjurmën mjedisore dhe klimatike të operacioneve, duke identifikuar fushat ndikimet më të mëdha negative. Përfshirja e stafit në vlerësimet pjesëmarrëse do të jetë thelbësor për të garantuar përfshirje të gjerë në përpjekjet tona të gjelbërimit.

Për më tepër, integrimi i masave për gjelbërim në planet e punës dhe matja e kujdesshme e ndikimit të tyre janë thelbësore për matjen e progresit dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së nismave të zbatuara. Veprimi i referohet masave për gjelbërimin e operacioneve të operatorëve publikë dhe privatë që zbatojnë programet dhe projektet[63], e bashkëpunimit të BE-së, të tilla si përcaktimi i kritereve mjedisore për prokurimin dhe nxitja e parimeve të ekonomisë rrethore, të cilat udhëheqin më tej përpjekjet tona drejt praktikave më të përgjegjshme ndaj mjedisit. Këta hapa jo vetëm që përputhen me angazhimet ndërkombëtare, por edhe fuqizojnë palët tona të interesit për të kontribuar në mënyrë domethënëse për një të ardhme më të qëndrueshme.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

Sipas kodeve të OECD-së/OBZHE-së për DAC-në gjinore të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si G1[64].

Kjo nënkupton që çështjet gjinore duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të modaliteteve të ndryshme (MBS-së dhe AT-së) duke pasur në vëmendje nevojat e grupeve vulnerabël, përfshirë gratë dhe vajzat si përfituese të barabarta të këtij programi. Çështjet gjinore janë të integruara në të gjithë treguesit e performancës. Kjo do të sigurojë rritje të aksesit dhe mundësive të barabarta në mbrojtje sociale, trajnim/formim dhe mundësi punësimi. Sipas anketës së fuqisë punëtore[65], gratë kanë më pak gjasa të marrin pjesë në tregun e punës. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore është 69.1%, ndërsa për burrat ky tregues është 80.7%. Shkalla e pjesëmarrjes së burrave në fuqinë punëtore është 11.6 pikë përqindjeje më e lartë se e grave. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për gratë është rritur me 5.9 pikë përqindjeje dhe për burrat është rritur me 3.0 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2021[66]. Përveç kësaj, dhuna në familje mbetet një sfidë në vend, pavarësisht disa përparimeve. Ekziston një nevojë e fuqishme për të rritur përpjekjet në ofrimin e shërbimeve mbrojtëse, rehabilituese dhe riintegruese, si dhe aksesin për viktimat/të mbijetuarat e dhunës dhe në veçanti për grupet më vulnerabël të grave, siç janë gratë që vuajnë nga dhuna në familje, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet rome dhe egjiptiane dhe gratë në zonat rurale[67].

Disa nga aktivitetet në kuadër të ndërhyrjeve do të rrisin kapacitetet për integrimin gjinor sipas standardeve të cilësisë së BE-së, dhe veçanërisht në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet lidhjeve midis prioriteteve sektoriale të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe planifikimit buxhetor afatmesëm (PBA). Për më tepër, disa nga rezultatet e pritshme synojnë drejtpërdrejt uljen e varfërisë dhe përjashtimit social te gratë dhe burrat, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës dhe në programet e AFP-së.

Kjo do të kontribuojë në garantimin e barazisë dhe aksesit të grave në shërbimet sociale si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Kjo do të ulë barrierat dhe do të rrisë aksesin në periferi të zonave të varfra dhe do të ulë pabarazitë midis zonave rurale dhe urbane si një çështje e rëndësishme në punësim, aftësi dhe kujdes social. Për më tepër, integrimi i arsimit me tregun e punës përmes shkollave të AFP-

63 Këshilla të shpejta: Projekti i Gjelbërimit dhe Zyra Menaxhuese | Capacity4dev (europa.eu).

65 INSTAT (2023) Anketa e Fuqisë Punëtore, tremujori i 4-t i vitit 2022. https://www.instat.gov.al/media/11343/quarterly-labour-force-survey-q4–2022.pdf.

66 Po aty.

67 Përmbledhje gjinore – Shqipëria. UN Women /OKB për gratë dhe UNDP/PKBZH (2020).

së do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e mundësive të punësimit për gratë. Gjithashtu, kuadri i monitorimit dhe vlerësimit për programin përfshin të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe tregues gjinorë për një shqyrtim mbi efektivitetin e masave për të dyja gjinitë. Gjatë zbatimit të Veprimit, do të garantohen mundësi të barabarta. Burimet njerëzore, planet strategjike dhe politikat do të pasqyrojnë praktikat bashkëkohore të punës dhe do të marrin në konsideratë çështjet gjinore dhe mundësitë e barabarta.

Të drejtat e njeriut dhe aftësia e kufizuar

Sipas kodeve të OECD-së/OBZHE-së për DAC-në e personave me aftësi të kufizuara të identifikuara në seksionin 1.1, ky veprim është etiketuar si D1. Mbështetja për grupet vulnerabël të qytetarëve gra dhe burra, përfshirë pakicat kombëtare, është një nga sektorët tradicionalë të aktivitetit të OSHC-ve dhe të mbështetjes së BE-së në Shqipëri. Organizatat aktive në këto fusha kanë qenë kryesisht të përfshira në formulimin e Dokumentit të Veprimit dhe do të jenë ndër përfitueset e komponentëve të ndërtimit të kapaciteteve. Krijimi i shkollave të AFP-së si qendra multifunksionale do të shërbejë edhe për qëllimin e lidhjes së këtyre grupeve me mundësitë e tyre të arsimit dhe punësimit në komunitetin lokal. Krijimi i kurrikulave të reja me fokus të veçantë në përfshirjen sociale është pjesë e aktiviteteve. Ky veprim i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave dhe mundësimit të aksesit në drejtësi të grupeve specifike, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të varfrit, banorët e zonave rurale, të moshuarit, fëmijët, romët dhe egjiptianët, dhe veçanërisht gratë ndër ta, si dhe fëmijët në rrezik përjashtimi nga shkolla për shkak të aftësive të kufizuara, ngacmimit, abuzimit fizik dhe seksual dhe radikalizimit.

Ulja e rrezikut të fatkeqësive

Ky veprim synon të përmirësojë kuadrin kombëtar të mbrojtjes sociale duke nxitur qëndrueshmërinë në dy fusha kryesore: (i) mbështetjen e zbatimit të kuadrove kombëtare të politikave për punësimin, aftësitë dhe mbrojtjen sociale në kontekstin e uljes së rrezikut nga fatkeqësitë (URRF-Në) dhe konsideratave të ndryshimeve klimatike; dhe (ii) krijimin e një kuadri gatishmërie për sektorin. Gjithashtu, synon të integrojë mbrojtjen sociale adaptive (MSA-në), e cila synon të përfshijë konsideratat e ndryshimeve klimatike dhe rrezikut nga fatkeqësitë në hartimin dhe zbatimin e sistemeve të mbrojtjes sociale. Kjo qasje i bën ato më sensitive ndaj goditjeve dhe streseve, duke siguruar në fund të fundit mirëqenien e popullatave vulnerabël, veçanërisht në rajonet e ndjeshme ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësive natyrore. MSA-ja përfshin masa të tilla si forcimi i rrjeteve të sigurisë sociale, zgjerimi i programeve të ndihmës sociale dhe sigurimi i aksesit në shërbime thelbësore për ata që kanë nevojë. Brenda këtij kuadri, adresimi i hendekut të financimit prej rreth 15.8 milionë euro për mandatet e pafinancuara në shërbimet e kujdesit social në kontekste të decentralizuara është i domosdoshëm për një reagim dhe mbështetje efektive. Për të forcuar gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit të mbrojtjes sociale dhe komuniteteve, Veprimi përfshin një sërë veprimesh. Ai përfshin rekomandimin e zhvillimit të një kuadri emergjence për mbrojtjen sociale për t'iu përgjigjur nevojave në zhvillim të komuniteteve vulnerabël në kontekstin e uljes së rrezikut nga fatkeqësitë (URRF-së) dhe ndryshimeve klimatike. Përveç kësaj, synon të përmirësojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS-në) duke krijuar një kornizë konceptuale për mbrojtjen sociale që integron konsideratat e klimës dhe fatkeqësive. Ky kuadër do të udhëheqë politikat dhe planet operacionale me një qasje gjithëpërfshirëse të ciklit të jetës ndaj mbrojtjes sociale, punësimit, aftësive dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës brenda kontekstit të URRF-së. Gjithashtu, ky kuadër do të ndihmojë në vlerësimin e vlerës së skemave të mbrojtjes sociale në përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe përshtatjen ndaj klimës. Përveç rritjes së burimeve dhe përmirësimit të kapacitetit, ekziston nevoja për informacion në kohë reale në lidhje me nevojat e individëve të prekur dhe shërbimet që ata marrin. Kjo platformë informacioni mund të zhvillohet bazuar në Sistemin ekzistues të Menaxhimit të Informacionit (SMI) për shërbimet e kujdesit social, duke e bërë funksionalizimin e SMI-së një komponent thelbësor të sistemit kombëtar të mbrojtjes sociale dhe integrimin e tij me punësimin, aftësitë, klimën dhe konsideratat e fatkeqësive brenda kontekstit të URRF-së. Veprimi thekson rëndësinë e përmirësimit mbështetjes dhe masave politike të bazuara në prova për komunitetet, duke u pajtuar me strategjitë kombëtare (SKZHIE-në, SKPA-në, SKMS-në) të cilat do të monitorohen nga afër gjatë

gjithë zbatimit. Së fundi, sistemi i reagimit ndaj mbrojtjes sociale do të përpiqet për një integrim më të balancuar të shërbimeve të mbështetjes me para në dorë dhe kujdesit brenda kuadrit të URRF-së dhe përshtatjes ndaj klimës. Zgjerimi i programeve ekzistuese të parave në dorë dhe futja e programeve të reja do të jetë prioritare, duke nxitur diskutimet midis politikëbërësve dhe palëve të interesuara kryesore për të përmirësuar mbulimin dhe përshtatshmërinë në kontekstin e URRF-së dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës.

Çështje të tjera

3.4 Rreziqet dhe supozimet

Supozohet që autoritetet shqiptare (Qeveria e Shqipërisë, Parlamenti) do të sigurojnë angazhimin e tyre të plotë për të punuar drejt arritjes së objektivave të programit, si dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e tyre. MEKI, si institucioni kryesor për koordinimin e palëve të interesuara në sektor, do të operojë një strukturë koordinimi për monitorimin e rregullt të strategjive kyçe dhe zbatimin e planeve të veprimit, si dhe çdo përditësim të nevojshëm.

Kategoria	Rreziqet	Probabiliteti (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Masat zbutëse	Kategoria
Makroekonomike	Kriza ekonomike mund të çojë në borxh më të lartë publik, zbatim të ngadaltë të reformave sociale dhe rritje të hendekut të varfërisë midis grupeve të ndryshme.		Mesatar	Mesatar	- Koordinim i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë (FMN, BB, vendet anëtare të BE-së) për të rënë dakord për një përgjigje afatshkurtër deri afatmesme.
Menaxhimi i Financave Publike dhe transparenca e buxhetit	Masat e reagimit ndaj krizave nuk janë pjesë e mekanizmit dhe raportimit të rregullt të buxhetit.		I ulët	Mesatar	- Delegacioni i BE-së (DBE) të promovojë pavarësinë dhe rolin e Institucionit Suprem të Auditimit, duke përfshirë një kërkesë për një auditim të performancës mbi masat emergjente të zbatuara në vitet 2022–2023. - Delegacioni i BE-së (DBE) të angazhohet në një dialog të rregullt politik duke vëzhguar nivelin e transparencës së masave të emergjencave dhe llogaridhënies. - Delegacioni i BE-së (DBE) të përfshijë në dialogun e tij të rregullt politik Institucionin e Lartë të Auditimit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Politike	Rreziku i paqëndrueshmërisë sociale të shkaktuar nga kostot e larta të jetesës që çojnë në paqëndrueshmëri qeveritare.		I ulët	Mesatar	- Delegacioni i BE-së (EUD) të mbështesë Qeverinë në zbatimin e strategjisë së saj të komunikimit të jashtëm, duke informuar aktorët publikë mbi natyrën e krizës dhe masat e marra për të lehtësuar barrën ekonomike mbi shtresat më të cenueshme.
Qeverisja					
	Vonesë në hartimin dhe miratimin e Planit të ri të SKMS-së 2024–2027 dhe Planeve të Veprimit shoqërues		I ulët	Mesatar	Dialog i vazhdueshëm me MEKI-n dhe MSHS-në për të siguruar që strategjitë të bien dakord.
	Mungesa e angazhimit, mbështetjes politike dhe përgjegjësisë për të zgjeruar mbulimin e shërbimeve të kujdesit social dhe mundësive të punësimit për të rinjtë, gratë dhe burrat në Shqipëri.		Mesatar	Mesatar	Dialog i vazhdueshëm mbi politikat në kontekstin e Mbështetjes së BE-së për zbatimin e SKPA-së, SKMS-së dhe përgatitjes së PBA-së, duke përfshirë prioritetet në funksion të agjendës së aderimit në BE. Veprimi është hartuar në konsultime shumë të ngushta dhe të detajuara me përfaqësues të Qeverisë së Shqipërisë, me bashkitë, shoqërinë civile dhe partnerët e zhvillimit, si për të identifikuar prioritetet, ashtu edhe për të arritur konsensus mbi opsionet realiste për arritjen e rezultateve.
	Lidhja e dobët midis objektivave të politikave dhe alokimeve financiare për zbatimin e SKPA-së, SKMS-së dhe mungesa e një perspektive afatmesme mund të ndikojnë		Mesatar	I lartë	Instrumentet e parashikuara (mbështetja buxhetore dhe asistenca teknike) do të kontribuojnë në uljen dhe adresimin e disa prej rreziqeve që paraqesin mandatet e pafinancuara. Për më tepër, harmonizimi midis politikave,

	negativisht në aftësinë e palëve të interesuara për të përmbushur mandatet e tyre dhe për të arritur rezultate.				planifikimit dhe procesit vjetor të buxhetimit do të ndihmojë gjithashtu në uljen e këtij rreziku.
	Kapacitet i kufizuar përthithës dhe mungesë burimesh njerëzore për të kryer proceset e reformës teknike dhe organizative		Mesatar	I lartë	Mbështetja përmes kapaciteteve të vazhdueshme dhe të propozuara plotësuese në punësim dhe aftësi do të ndihmojë në uljen e këtij rreziku. Përveç kësaj, asistenca teknike në kuadër të këtij Veprimi dhe veprimet e partnerëve të tjerë të zhvillimit do ta ulin më tej këtë rrezik.
	Koordinimi i dobët sektorial midis institucioneve të nivelit qendror dhe midis nivelit qendror dhe atij vendor pengon zbatimin dhe progresin. Kompleksiteti i reformave teknike dhe organizative nuk mund të menaxhohet në mënyrë efektive nga institucioni udhëheqës, për shkak të ndërveprimit horizontal midis mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive.		Mesatar	I lartë	GMIP-ja për Punësim dhe Aftësi, e kryesuar nga ministri i MEKI-it, ekziston dhe mblidhet rregullisht për të koordinuar reformën aktuale në punësim dhe aftësi. MSHMS-ja është anëtare e GMIP-së, dhe përfaqësuesit MSHMS-së janë pjesë e grupeve tematike.

Supozime të jashtme

- Dialogu i vazhdueshëm politik ndërmjet BE-së dhe Qeverisë do të nxisë angazhimin e vazhdueshëm për zbatimin në kohë dhe efektiv të strategjive dhe do të identifikojë boshllëqet dhe mangësitë, si dhe do të mbështesë ato.

- Vlerësimi i performancës dhe dialogu politik do të vëzhgojnë nga afër që alokimet buxhetore të jenë në përputhje me rregullat e brendshme fiskale, të jenë transparente dhe të garantohet llogaridhënia.

- Qeveria është e angazhuar në ndjekjen e objektivave të politikave që lidhen me këtë Veprim dhe kontekstin më të gjerë strategjik, të cilat gjithashtu kontribuojnë drejtpërdrejt në zbutjen e efekteve të inflacionit në rritje dhe ndikimeve të varfërisë të shkaktuara nga lufta në Ukrainë.

3.5 Matrica e kuadrit logjik tregues

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve:	Treguesit	Niveli bazë (vlera dhe viti)	Objektivat deri në fund të kontratës së mbështetjes buxhetore (vlera dhe viti)	Burimet e të dhënave [1 për tregues]
Ndikimi Tregues i Politikës	Për të zgjeruar mbulimin, përfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj goditjeve të masave të mbrojtjes sociale dhe tregut të punës, duke përfshirë kategoritë në rrezik përjashtimi	Shkalla e punësimit të popullsisë nga 15 deri në 64 vjeç, e ndarë sipas gjinisë Shkalla e rrezikut të varfërisë (SHRRV)	TM4 i vitit 2022: 56.3[73] 22% (AANJ 2021)	60% (Për t'u përcaktuar) 20% 20(Për t'u përcaktuar)	INSTAT AFP INSTAT AANJ
Rezultatet e pritshme të Politikës	1. Përfshirja sociale është rritur përmes përmirësimit të aftësive, punësimit dhe riintegrimit social të kategorive të pafavorizuara 2. Përshtatshmëria e masave të mbrojtjes sociale, aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel vendor janë përmirësuar	1.1 Hendeku gjinor në punësim (15 – 64) 1.2 Pjesëmarrja e të rriturve në trajnime 2.1 Ndikimi i transfertave sociale (duke përjashtuar pensionet) në uljen e varfërisë 2.2 Përqindja e popullsisë që merr paketën bazë të shërbimeve të kujdesit social	1.2. 13.1% (2021) 1.2 0.7% (2021) 2.1 12.7% (2021) 2.2. 11,5% (2021)	1.1. 12.5% (Për t'u përcaktuar) 1.2 3.5% (Për t'u përcaktuar) 2.1 18% (Për t'u përcaktuar) 2.2 20 % (Për t'u përcaktuar)	1.1 INSTAT AFP 1.2. INSTAT / AFP 2.1. INSTAT AANJ 2.2. Të dhënat administrative të MSHSS-së, SSSH-së

[73] Do të përditësohet më 24.5.2023 pas publikimit të AFP 2022.

Produktet e nxitura	1.1. Sistemet e qeverisjes dhe të ofrimit të shërbimeve janë përmirësuar për të lehtësuar rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës, duke përfshirë përfituesit e NE-së dhe PAK-ut, të rinjtë, gratë, burrat dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi 1.2 Ofrohen programe më të rëndësishme të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP-së) me fokus në cilësinë, mësimin gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës dhe ndërvepruesshmërinë e sistemit. 2.1 Zgjerim i mbulimit dhe përmirësim i përshtatshmërisë së masave të mbrojtjes sociale 2.2 Është krijuar një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve cilësore të kujdesit social dhe komunitar	1.1.1 Përfituesit e rritur të PNP-ve[74] që i përkasin komuniteteve të disavantazhuara 1.2.1 Shpenzimet operacionale të AFP-ve dhe qendrave të trajnimit janë rritur 1.2.2 Përqindja e nxënësve në sistemin e dyfishtë të AFP-së nga numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e AFP-së 2.1.1 Përqindja e fëmijëve në rrezik për varfëri që përfitojnë nga masat e mbrojtjes sociale të fokusuara te fëmijët 2.2.1 Përqindja e shërbimeve të kujdesit social të ofruara në nivel lokal dhe rajonal, sipas tipologjisë, të mbështetura përmes Fondit Social [75]	1.1.1 1,249 individë (2022 për t'u përcaktuar) 1.2.1 361.3 milionë lekë (VF 2023) 1.2.2 0 (2023–2024 viti akademik) 2.1.1. 0 (Nuk ka përfitime për fëmijë) 2.2.2 54 (2023, 39 shërbime lokale dhe 15 shërbime rajonale)	1.1.1. Një rritje prej 15% krahasuar me rezultatin e vitit të kaluar 1.2.1 75% më e lartë se niveli bazë 1.2.2 15% 2.1.1 70% (Viti 2027) 2.2.1 84 (ose 30 shërbime të kujdesit social mbi nivelin bazë deri në vitin 2027)	1.1.1 Të dhënat administrative të MEKI-it, AKPA-së 1.2.1 Të dhënat administrative të MEKI-it, AKPA-së; Të dhënat e thesarit 1.2.2 Të dhënat administrative të MEKI-it, AKPA-së 2.1.1 Të dhëna administrative të MSHMS-së/INSTAT AANJ 2.1.1 Të dhëna administrative të MSHMS-së/SSSH-së

[74] Vetëm PNP-të sipas ligjit të nxitjes së punësimit, bazuar në numrin e përfituesve të PNP-ve nga grupet e cenueshme, duke përjashtuar punëkërkuesit nën moshën 29 vjeç.

[75] Ligji për shërbimet e kujdesit social (121/2016, neni 8) përcakton tipologjinë kryesore të shërbimeve sociale si: (i) shërbime parasociale; (ii) shërbime në qendrat komunitare, duke përfshirë qendrat e zhvillimit; (iii) shërbime në qendrat rezidenciale, duke përfshirë strehimoret; (iv) shërbime sociale për situata emergjente; (v) shërbime të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror; (vi) shërbime të specializuara; (vii) shërbim këshillimi telefonik ose *online*.

Produktet e Drejtpërdrejta	1.1.1 Kapacitete të përmirësuara teknike dhe organizative në SKPA për të ofruar këshillim të intensifikuar për punësim dhe mbështetje për kategoritë më të marzhinalizuara nga tregu i punës.	1.1.1.1 Përqindja e punëkërkuesve që përdorin shërbimet digjitale të punësimit	1.1.1.1 40% e punëkërkuesve të kategorisë 1 dhe 10% e kategorisë 2 dhe 3 (2022)	1.1.1.1 60% e kategorisë 1 dhe 14% e pjesës tjetër (Viti për t'u përcaktuar)	1.1.1.1 Të dhënat administrative të AKPA-së
		1.1.1.2 Përqindja e ndërmjetësimeve të lehtësuara nga zyrat e punës, sipas gjinisë dhe kategorisë	1.1.1.2 7,624 ndërmjetësime (2021)	1.1.1.2 Për t'u përcaktuar	1.1.1.2 Të dhënat administrative të AKPA-së
			1.1.2 0 (2022)		1.1.2 Të dhënat administrative
	1.1.2 Kapacitete të përmirësuara të sistemit të informacionit mbi aftësitë për të forcuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna në sektorin e punësimit dhe të arsimit dhe formimit profesional (AFP)	1.1.2. Përqindja e produkteve të gjeneruara rregullisht nga sistemi i inteligjencës së aftësive		1.1.2 Për t'u përcaktuar	të MFE-së/AKPA-së
		1.2.1.1 Përqindja e Analizave Kombëtare dhe Rajonale të Nevojave për Aftësi (ANA)	1.2.1.1 Nuk kryhen ANA të rregullta	1.2.1.1 ANA kombëtare dhe rajonale çdo dy vjet	1.2.1.1 Raportet e Monitorimit të Planit Kombëtar të Zbatimit të Deklaratës së Osnabrukut
	1.2.1 Ofrimi i diversifikuar dhe fleksibël e arsimit dhe formimit profesional (AFP) për të zgjeruar mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes aksesit më të mirë në format digjital dhe të kombinuar, si dhe skemave të financimit.	1.2.1.2 Përqindja e nxënësve dhe të rriturve që përdorin mësimin online dhe të kombinuar të ofruar nga ofruesit e AFP-së	1.2.2 Për t'u përcaktuar	1.2.2 Për t'u përcaktuar	1.2.1.2 Të dhënat administrative të AKPA-së
		1.2.2 Kapacitetet e mësuesve të AFP-së dhe stafit mbështetës rriten përmes trajnimit dhe mbështetjes së kapaciteteve			1.2.2 Të dhënat administrative të AKAFPK-së
	1.2.2 Ofruesit dhe mësuesit e AFP-së janë aftësuar për të ofruar aftësi të përshtatshme për punët e së ardhmes, përfshirë transformimin digjital dhe punët e gjelbra.		2.1.1 Nuk ka masa adaptive të mbrojtjes sociale	2.1.1 Kuadri dhe sistemet për MS-në adaptive janë krijuar	2.1.1 Të dhënat administrative
	2.1.1 Programet ekzistuese të mbrojtjes sociale janë rishikuar për të adresuar goditjet e lidhura me	2.1.1 Kriteret e përshtatshmërisë dhe opsionet e politikave të përcaktuara për masat adaptive të mbrojtjes sociale përmes vlerësimeve të rrezikut	2.2.1.1 25 Shërbime (për t'u përcaktuar)	2.2.1.1 Për t'u përcaktuar	të MSHMS-së/raportet e monitorimit të SKMS-së, kuadri rregullator

	fatkeqësitë, me vëmendje të veçantë ndaj popullatave më të cenueshme. 2.2.1 Infrastruktura njerëzore dhe rregullatore e shërbimeve të kujdesit social është përmirësuar. 2.2.2 Mbështetje për ngritjen e një modeli inovativ të shërbimeve të integruara të ofruara në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor.	dhe cenueshmërisë 2.2.1.1 Funksionet organizative, proceset e biznesit, monitorimi dhe vlerësimi; financimi dhe planifikimi i fuqisë punëtore për shërbimet e kujdesit social janë të përcaktuara. 2.2.1.2. Praktikat e garantimit të cilësisë në shërbimet sociale publike dhe private janë forcuar (Shërbimet e inspektimit janë forcuar, metodologjia e re është zhvilluar, përshkrimet e punës janë rishikuar, mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes janë krijuar në nivel lokal dhe kombëtar). 2.2.2 Numri i qendrave të kujdesit shëndetësor parësor që ofrojnë model të integruar të kujdesit social dhe shëndetësor	2.2.1.2 Për t'u përcaktuar 2.2.2 50 Shërbime (2022)	2.2.1.2 Për t'u përcaktuar 2.2.2 150 shërbime (për t'u përcaktuar)	2.2.1.1 Të dhënat administrative të MSHMS-së/raportet e monitorimit të SKMS-së 2.2.1.2 Të dhënat administrative të MSHMS-së/raportet e monitorimit të SKMS-së 2.2.2 Të dhënat administrative të MSHMS-së/raportet e monitorimit të SKMS-së
	Hapësira financiare e përmirësuar për zbatimin e objektivave të SKMS-së dhe SKPA-së	% e transheve/késteve të disbursuara në kohë dhe në përputhje me shumën e rënë dakord në KRS. Shuma e hendekut financiar të SKMS-së dhe SKPA-së (bazuar në PBA 2024–26).	Përqindja e disbursimeve nga KRS-ja që janë përfunduar sipas planit	100% e disbursimeve të KRS-së janë përfunduar sipas planit. Tendencë në ulje	Raportet e disbursimit të KRS-së
	Dialog politik i vazhdueshëm me Qeverinë e Shqipërisë për zbatimin e strategjisë së reformës së SKMS-së dhe SKPA-së	Numri i dialogëve teknikë/strategjikë të nivelit të lartë për politikat për të diskutuar dhe shqyrtuar zbatimin e strategjisë SKPA dhe SKMS, duke u fokusuar në kriteret e ndryshueshme për lirimin e transheve dhe në ruajtjen e rëndësisë/besueshmërisë së përgjithshme, si dhe përparimin e kënaqshëm në zbatimin e Strategjive.	4 takime vjetore të GMPI-së 8-10 takime vjetore *ad-hoc* (programim, monitorim)	4 takime vjetore të GMPI-së 10-12 takime vjetore *ad-hoc* (programim, monitorim)	Raporti Vjetor për Shqipërinë Raportet vjetore për zbatimin e Strategjisë dhe Planeve të Veprimit të SKMS-së, SKPA-së Raportet e disbursimit të KRS-së
	Koordinim i përmirësuar i donatorëve	Numri i takimeve për koordinim	Takime të rregullta të koordinimit me donatorët	Takime të rregullta të koordinimit me donatorët (2-4	Matrica e donatorëve, raportet mbi koordinimin e

			(2-4 takime në vit	takime në vit	donatorëve
	Sisteme të përforcuara të monitorimit dhe vlerësimit për zbatimin e strategjisë	Shkalla në të cilën është vendosur një rishikim vjetor i progresit Shkalla në të cilën rekomandimet e sistemit të monitorimit merren parasysh në procesin e vendimmarrjes	Monitorimi vjetor kryhet mbi bazën e një kuadri vlerësimi të performancës, duke përfshirë përparimin në raport me indikatorët e përcaktuar, analizën dhe rekomandimet	Monitorimi vjetor kryhet mbi bazën e një kuadri vlerësimi të performancës, duke përfshirë përparimin në raport me indikatorët e përcaktuar, analizën dhe rekomandimet	Raportet vjetore të monitorimit të strategjisë SKPA dhe SKMS
	Kapacitet i përmirësuar për koordinim dhe monitorim të zbatimit të strategjisë	Numri i takimeve koordinuese të lehtësuara dhe të organizuara në mbështetje të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve Numri i stafit teknik të trajnuar në sekretariatin teknik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / të ndara sipas gjinisë	Katër herë në vit 7	Katër herë në vit 15	Raporti i monitorimit të projektit AT; raportet e takimeve; raportet e trajnimit/lista e pjesëmarrjes
	1. Monitorim i mirë i zbatimit të MB-së	Numri i misioneve të pavarura të monitorimit të organizuara Numri i raporteve të monitorimit të përgatitura Cilësia dhe përmbushja në kohë e kërkesave për pagesë	1 në vit 1 çdo vit Kërkesat për pagesë janë të plota dhe dorëzohen në përputhje me grafikun tregues të pagesave.	2 në vit 1 çdo vit Kërkesat për pagesë janë të plota dhe dorëzohen në përputhje me grafikun tregues të pagesave.	Raportet e Misionit të Pavarur të Monitorimit. Dosja e pagesave të DBE-së që verifikon kushtet dhe progresin e zbatimit/ MEKI.

4. MARRËVESHJET E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e Financimit

Për të zbatuar këtë Veprim, parashikohet të lidhet një Marrëveshje Financiare me Republikën e Shqipërisë.

4.1 Periudha e parashikuar e zbatimit

Periudha e parashikuar për zbatimin operacional të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet e përshkruara në seksionin 3 dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është 72 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të miratohen nga zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit, duke ndryshuar këtë vendim financimi, kontratat, si dhe marrëveshjet përkatëse.

4.2 Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore

4.2.1 Argumentimi për shumat e alokuara për mbështetje buxhetore

Shuma e alokuar për komponentin e mbështetjes buxhetore është 24 000 000 euro dhe për mbështetje plotësuese është 4 000 000 euro. Kjo shumë bazohet në madhësinë e financimit në sektor, koston e strategjive, hendekun e financimit të vlerësuar në mënyrë indikative dhe nivelin e vlerësuar të financimit kombëtar i cili çmohet mjaftueshëm inkurajues për të mbështetur reformën.

4.2.2 Kriteret për disbursimin e mbështetjes buxhetore

a) Kushtet.

Kushtet e përgjithshme për disbursimin e të gjitha transheve janë si më poshtë:

- Progres i kënaqshëm në zbatimin e SKPA-së dhe SKMS-së dhe besueshmëria dhe rëndësia e vazhdueshme e tyre ose e politikës pasuese.

- Mbajtja e një politike makroekonomike të besueshme dhe të rëndësishme të orientuar drejt stabilitetit ose progresi i bërë drejt rivendosjes së ekuilibrave kryesorë.

- Progres i kënaqshëm në zbatimin e reformave për të përmirësuar menaxhimin financiar publik, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, dhe rëndësia dhe besueshmëria e vazhdueshme e programit të reformës.

- Progres i kënaqshëm në lidhje me disponueshmërinë publike të informacionit buxhetor të arritshëm, në kohë, gjithëpërfshirës dhe të shëndoshë.

b) Treguesit e performancës për disbursimin që mund të përdoren për transhet e ndryshueshme mund të fokusohen në prioritetet e mëposhtme të politikave:

- Efektivitet i përmirësuar i masave të tregut të punës;

- Sistem më fleksibël, më i rëndësishëm dhe më i depërtueshëm i AFP-së;

- Mjaftueshmëri dhe mbulim më i gjerë i përfitimeve të mbrojtjes sociale;

- Krijimi i një sistemi funksional dhe të integruar të shërbimeve cilësore të kujdesit social dhe komunitar në nivel lokal.

Treguesit dhe objektivat e performancës të zgjedhur që do të përdoren për disbursimin e transheve të ndryshueshme do të zbatohen për gjithë kohëzgjatjen e veprimit.

c) Modifikime

Treguesit e përzgjedhur të performancës dhe objektivat përkatës që do të përdoren për disbursimin e transheve të ndryshueshme do të zbatohen gjatë gjithë periudhës së veprimit. Megjithatë, në raste të justifikuara, vendi partner dhe Komisioni mund të bien dakord për ndryshime të treguesve ose për rishikime në rritje/ulje të objektivave. Këto ndryshime duhet të autorizohen me shkrim paraprakisht ose, në rastin më të vonë, deri në fund të tremujorit të parë të periudhës së shqyrtimit që zbatohet për treguesit dhe objektivat.

Në raste të jashtëzakonshme dhe/ose të justifikuara siç duhet, për shembull kur ngjarje të papritura, goditje të jashtme ose rrethana të ndryshuara e bëjnë treguesin ose objektivin të pavlefshëm dhe të paparashikueshëm, një tregues kësti variabël mund të përjashtohet. Në këto raste, shuma përkatëse mund të rialokohet te treguesit e tjerë të këstit variabël të po atij viti ose të transferohet në këstin variabël të vitit pasardhës (në përputhje me peshën fillestare të treguesve). Gjithashtu, mund të vendoset që një tregues të rivlerësohet në vitin pasues kundrejt objektivit fillestar, nëse ka pasur një prirje pozitive dhe autoritetet nuk e kanë arritur objektivin për shkak të faktorëve jashtë kontrollit të tyre. Përdorimi i kësaj dispozite duhet të kërkohet nga vendi partner dhe të miratohet me shkrim nga Komisioni.

d) Vlerat themelore

Në rast të një përkeqësimi të ndjeshëm të vlerave themelore, disbursimet e mbështetjes buxhetore mund të pezullohen, zvogëlohen ose anulohen, në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së financimit.

4.2.3 Detajet e mbështetjes buxhetore

Kalendari dhe profili i mëposhtëm i disbursimit i propozuar për veprimin janë tregues. Kalendari dhe profili aktual i disbursimit do të përcaktohen në marrëveshjen e financimit dhe mund të mbeten objekt i ndryshimeve.

Shuma e plotë e mbështetjes buxhetore është e ndarë në pesë transhe fikse dhe katër transhe variabël.

Mbështetja buxhetore ofrohet si mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore e pacaktuar për thesarin kombëtar. Kreditimi i transfertave në EURO të disbursuara në LEK, do të kryhet me kurset e këmbimit përkatës, në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së financimit.

4.3 Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të sigurojë që rregullat dhe procedurat përkatëse të BE-së për ofrimin e financimit ndaj palëve të treta të respektohen, duke përfshirë procedurat e shqyrtimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së.[68]

4.3.1 Menaxhimi i drejtpërdrejtë (prokurimi)

[68] Harta e sanksioneve të BE-së. Ju lutem vini re se harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve buron nga aktet ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare (FZ). Në rast mospërputhjeje midis akteve ligjore të botuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni i FZ-së do të ketë përparësi.

Do të mbulohen fushat e mëposhtme:

Mbështetje për institucionet përgjegjëse për përfshirjen sociale dhe punësimin për menaxhimin e proceseve të reformës, zbatimin dhe zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore, mekanizmat e financimit në nivel lokal dhe qendror, përforcimin e koordinimit të donatorëve për sektorin, mbështetje për komunikimin dhe vizibilitetin dhe forcimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale dhe Punësimit dhe Aftësive.

Monitorimi dhe shqyrtimi i përputhshmërisë për zbatimin e reformave të punësimit, AFP-së dhe mbrojtjes sociale dhe programit KRS, për të mbështetur përpilimin e të dhënave/informacionit, gjetjen e fakteve dhe dokumentimin për të ndihmuar në marrjen e vendimeve mbi disbursimin e transheve.

4.4 Fushëveprimi i përshtatshmërisë gjeografike për prokurim

Përshtatshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe origjinës së furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin themelor dhe përcaktohet në dokumentet përkatëse kontraktuale, do të zbatohet në bazë të dispozitave të mëposhtme:

Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund ta zgjerojë përshtatshmërinë gjeografike në bazë të urgjencës ose mungesës së shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet kur zbatimi i rregullave të përshtatshmërisë do ta bënte realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores (NDICI/ Instrumenti për Fqinjësinë, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar/IFZHBN-së) - Global Europe).

4.5 Buxheti i parashikuar

Komponentët e buxhetit të parashikuar	Kontributi i BE-së (shuma në EURO)	Kontributi tregues i palës së tretë (EURO)
Mbështetje buxhetore - shihni seksionin 4.3	**24 000 000**	**Nuk aplikohet**
Rezultati 1. Përfshirja Sociale u rrit nëpërmjet përmirësimit të aftësive, punësimit dhe riintegrimit social të kategorive të pafavorizuara;	14 000 000	**Nuk aplikohet**
Rezultati 2. Përmirësohet përshtatshmëria e masave të Mbrojtjes Sociale, aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel lokal**;**	10 000 000	**Nuk aplikohet**
Metodat e zbatimit – shihni seksionin 4.4		**Nuk aplikohet**
Prokurimi (menaxhim i drejtpërdrejtë) – shihni seksionin 4.4.1	**4 000 000**	**Nuk aplikohet**
Vlerësimi – shihni seksionin 5.2 Auditimi – shihni seksionin 5.3	Për t'u mbuluar nga një vendim tjetër	**Nuk aplikohet**
Komunikimi Strategjik dhe Diplomacia Publike – shihni seksionin 6	Për t'u mbuluar nga një vendim tjetër	**Nuk aplikohet**
Totali	**28 000 000**	**Nuk aplikohet**

4.6 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Qeveria e Shqipërisë ka vendosur masa organizative ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI-së), i cili vepron si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për planifikimin e integruar të politikave publike duke siguruar një shpërndarje efektive të burimeve financiare. GPMI-ja për punësimin dhe aftësitë (e quajtur më parë GPMI-ja për punësimin dhe politikat sociale) u krijua fillimisht si një projekt pilot në vitin 2015 dhe më pas u rishikua në vitin 2018[69]. Në gusht 2023, arkitektura e GMPI-së u rishikua nëpërmjet një urdhri të ri të Kryeministrit[70]. GMPI-ja "Zhvillimi i kapitalit njerëzor" është përgjegjëse për fushat e punësimit, aftësive dhe mbrojtjes sociale, së bashku me arsimin, kujdesin shëndetësor, kulturën dhe sportet. Ky GMPI kryen gjithashtu rolin e monitorimit sektorial të Sektorit IPA për Arsimin, Punësimin dhe Politikat Sociale, për kapitujt 2, 3, 19, 25, 26 dhe 28 të *acquis*-it të BE-së dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ-të). GMPI-ja përbëhet nga dy grupe tematike: (i) punësimi dhe aftësitë; dhe (ii) mbrojtja dhe përfshirja sociale.

[69] Urdhri i Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018.

[70] Urdhri i Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023.

Funksioni i GMPI-së për zhvillimin e kapitalit njerëzor është të udhëzojë dhe koordinojë institucionet e përfshira në sektor për hartimin e politikave të informuara, bashkëpunimin dhe përdorimin e një kuadri të bazuar në rezultate për të zhvilluar dhe zbatuar reformat kryesore qeveritare. GMPI-ja ka mbështetur dialogun dhe ndërveprimin e rregullt me partnerët e zhvillimit dhe integrimit. Palët kryesore të interesuara institucionale të përfshira në procesin e menaxhimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së veprimit përmes GMPI-së, dhe fushat tematike përkatëse janë Zyra e Kryeministrit (ZKM-ja), Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI); më parë nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MEF-së),[71] Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorit privat, si dhe bashkitë. Zëvendësministri i MEKI-t që mbulon Punësimin dhe Aftësitë ofron udhëheqje të përgjithshme politike për sektorin e punësimit dhe aftësive. Në nivel donatorësh, grupi i punës për Punësimin dhe AFP-në, i bashkëdrejtuar nga Delegacioni i BE-së dhe SDC/ZZHB (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim), është mjaft aktiv dhe mblidhet rregullisht.

GMPI-ja për zhvillimin e kapitalit njerëzor (më parë punësimi dhe aftësitë) është mbledhur rregullisht, rreth katër herë në vit, duke diskutuar progresin e reformave qeveritare në sektorin e punësimit dhe atë social. Palët e interesuara, duke përfshirë grupet e përfituesve të të drejtave, siç janë organizatat e të rinjve dhe të grave, ftohen të kontribuojnë në këto diskutime sipas nevojës. Dialogu i vazhdueshëm politik me fokus në përmirësimin e koordinimit sektorial do të kontribuojë, ndër të tjera, në një ndjekje më të mirë të zbatimit të politikave, përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të sektorit, transparencës dhe llogaridhënies, me qëllim koordinimin dhe angazhimin me institucionet kryesore dhe organizatat e shoqërisë civile për të siguruar dialogun politik dhe menaxhimin e njohurive midis niveleve qendrore dhe nënkombëtare të qeverisjes.

Si pjesë e prerogativës së tij të zbatimit të buxhetit dhe për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit, Komisioni mund të marrë pjesë në strukturat e qeverisjes së mësipërme, të ngritura për të drejtuar zbatimin e veprimit.

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Kuadri i monitorimit për punësimin dhe aftësitë. Plani i veprimit i SKPA-së 2023–2030 përfshin një afat të qartë kohor për raportimin mbi progresin e strategjisë. Gjatë ciklit të mëparshëm të strategjisë, Raportet vjetore përgatiteshin rregullisht, duke ofruar informacione të përditësuara dhe analiza mbi zbatimin e masave politike dhe (çdo) sfidë të hasur. SKPA 2013–2020 iu nënshtrua një rishikimi afatmesëm në vitin 2019, në bazë të të cilit masat prioritare u rishikuan dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj u zgjat deri në vitin 2022. Kuadrot e monitorimit gjithashtu kanë informuar dhe udhëhequr hartimin e strategjisë së re SKPA 2023–2030.

Një nga sfidat kryesore të identifikuara në sektorin e punësimit dhe aftësive ka qenë nevoja për të zhvilluar mjete dhe metoda që mund të përdoren për të vlerësuar lidhjet midis rezultateve të ofrimit të shërbimeve dhe qëllimit të politikës për vende pune cilësore dhe mundësi punësimi të denja për të rinjtë dhe të rriturit. Kuadrot e monitorimit dhe vlerësimit për AKAFPK-në dhe AKPA-në, duke përfshirë zyrat e punësimit (ZP-të), qendrat e trajnimit profesional (QTP-të) dhe shkollat e mesme të AFP-së (SHM-të) janë zhvilluar të gjitha me mbështetje të jashtme të PNZH-ve. Kuadri i Monitorimit dhe Vlerësimit që është zhvilluar do të mundësojë mbledhjen, përpilimin dhe ofrimin e informacionit në një mënyrë sistematike, të qëndrueshme, të renditur logjikisht dhe lehtësisht të arritshme nga vendimmarrësit. Ky sistem mund të përdoret për të monitoruar nga afër ofrimin e shërbimeve publike, siç janë shërbimet e AFP-së dhe punësimit. Sistemi gjithashtu ka një ndërfaqe me informacion mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, dhe si e tillë ka aftësi për të matur ndikimin që shërbimet publike dhe Strategjia kanë te përfituesit.

Për monitorimin dhe vlerësimin e punësimit dhe AFP-së, përgjegjësia bie kryesisht mbi AKPA-në dhe AKAFPK-në, pasi në ministrinë përgjegjëse për

[71] Kjo përgjegjësi i është transferuar ministrit të ri të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Pritet një rishikim i ri i Urdhrit të Zyrës së Kryeministrit për këtë qëllim.

punësimin dhe aftësitë nuk ekziston një njësi specifike apo një pozicion i dedikuar për kryerjen e këtij funksioni. Megjithatë, në AKPA është krijuar një njësi e posaçme përgjegjëse për monitorimin e AFP-së dhe kuadri i monitorimit për ofruesit e AFP-së është integruar në Sistemin kryesor të Menaxhimit të IT-së. Në AKAFPK nuk ka një njësi apo pozicion të posaçëm për kryerjen e kësaj detyre. Sistemi Digjital i Menaxhimit të Informacionit i AKPA-së, i cili u vu në funksionim në vitin 2022, ka përmirësuar më tej kapacitetin e monitorimit në aspektin e ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe trajnimit profesional. Një sistem inteligjence për aftësitë është aktualisht në zhvillim e sipër, i cili do të ofrojë analiza të përditësuara të tregut të punës bazuar në përpilimin e të dhënave administrative dhe statistikore. Sistemet e informacionit të menaxhimit digjital do të zhvillohen edhe për menaxhimin e shkollave të AFP-së.

Një tjetër objektiv i lidhur me monitorimin ka qenë përmirësimi i llogaridhënies përmes vlerësimit të progresit dhe performancës, si dhe ofrimi i informacionit me cilësi më të mirë për palët e interesuara përkatëse. Një element kyç për finalizimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit është integrimi dhe përfshirja e tij në kulturën dhe rutinat e institucioneve përkatëse. Arritja e rezultateve nga sistemi do të varet nga përdorimi i rregullt i mjeteve.

Kuadri i monitorimit për mbrojtjen sociale

Raporti Vjetor i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje Sociale 2020–2023 thekson disa sfida lidhur me raportimin mbi disa tregues që sigurohen nga institucione të tjera – për shembull, të dhënat nga Instituti i Statistikave (INSTAT) mbi varfërinë, mirëqenien dhe përfshirjen sociale. Nuk ekziston një strategji e qartë zbutjeje për mënyrën se si mund të adresohen boshllëqet në të dhëna. Krijimi i një kuadri të gjerë monitorimi sektorial është thelbësor, por kjo do të kërkonte angazhim dhe përpjekje të konsiderueshme për të siguruar lidhje më të mira mes sistemeve ekzistuese të informacionit dhe bazave të të dhënave në përdorim. Në të kaluarën e afërt, disa Partnerë Ndërkombëtar të Zhvillimit (PNZH) kanë kontribuar në krijimin dhe promovimin e përdorimit të bazave të të dhënave të fokusuara, si ajo për dhunën në familje, komunitetin rom dhe kategori të tjera. Integrimi dhe konsolidimi i këtyre bazave të të dhënave në një kuadër të vetëm monitorimi mbetet thelbësor. Integrimi i bazave ekzistuese të të dhënave do të kontribuonte gjithashtu në më shumë qartësi për institucionet e përfshira dhe do të përmirësonte efiçencën në përdorimin e burimeve – të cilat tashmë janë të kufizuara. Monitorimi i Strategjisë për Mbrojtje Sociale mbështetet nga disa burime të dhënash – ku burimi kryesor është Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SMI) për Ndihmën Ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, si dhe raportet e Shërbimit Social Shtetëror, përfshirë edhe kontributet nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Përdorimi i Regjistrit Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Social mbetet i kufizuar që nga sulmi kibernetik në korrik 2022 ndaj bazave të të dhënave qeveritare, dhe aktualisht është i shkëputur nga dy SMI-të e tjera që menaxhojnë përfitimet në para.

Raportet vjetore të monitorimit përgatiten për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje Sociale (SKMS). Gjithashtu, raporte periodike mbi zbatimin e reformave në vazhdim kontribuojnë në kuadrin e monitorimit, siç janë raportet nga Grupi i Punës për reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nuk ka një strukturë të dedikuar për monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë për mbrojtje sociale, strategjive të tjera sektoriale dhe planeve të veprimit. Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për monitorimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në nivel qendror dhe në nivelet vendore të qeverisjes e pengon ndjeshëm vlerësimin e ndikimit të politikave dhe cilësinë e vendimmarrjes gjatë gjithë ciklit të politikave dhe në nivele të ndryshme të qeverisjes. Kjo çështje duhet të jetë në fokus të dialogut të vazhdueshëm politik me MSHMS-në.

Monitorimi teknik dhe financiar i përditshëm i zbatimit të kësaj ndërhyrjeje do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues duhet të krijojë një sistem të përhershëm të monitorimit të brendshëm, teknik dhe financiar për ndërhyrjen dhe të përgatisë raporte të rregullta progresi (jo më rrallë se një herë në vit) dhe një raport përfundimtar. Çdo raport duhet të japë një pasqyrë të saktë të zbatimit të ndërhyrjes, vështirësive të hasura, ndryshimeve të ndërmarra, si dhe shkallës së arritjes së produkteve dhe kontributit në arritjen e rezultateve të përgjithshme dhe nëse është e mundur, në momentin e raportimit, kontributin në arritjen e ndikimeve, të matur përmes treguesve përkatës,

duke pasur si pikë referimi Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2023–2030 dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje Sociale (SKMS) 2024–2030. Komisioni mund të ndërmarrë vizita shtesë monitorimi të projektit, si përmes stafit të vet, ashtu edhe përmes konsulentëve të pavarur të rekrutuar drejtpërdrejt nga Komisioni për rishikime të pavarura monitorimi (ose të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e këtyre rishikimeve).

Roli dhe përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave, analizën dhe monitorimin: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të jetë përgjegjëse për monitorimin e përgjithshëm të ndërhyrjes. Dy ministritë e linjës do të jenë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe ofrimin e analizave, si dhe për përgatitjen e raporteve të monitorimit të zbatimit, të cilat do t'i paraqiten GMPIS-së.

5.2 Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj ndërhyrjeje, do të kryhet një vlerësim përfundimtar për këtë veprim ose komponentët e tij nëpërmjet konsulentëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni.

Ky vlerësim do të kryhet për qëllime të llogaridhënies dhe nxjerrjes së mësimeve në nivele të ndryshme (përfshirë edhe për rishikimin e politikave), duke marrë parasysh veçanërisht faktin se ky është një sektor prioritar për Qeverinë dhe shërben si mundësues për një nga nismat kryesore të Planit Ekonomik dhe Investimeve (PEI), siç është garancia rinore.

Vlerësimi i kësaj ndërhyrjeje mund të realizohet individualisht ose përmes një vlerësimi strategjik të përbashkët të operacioneve të mbështetjes buxhetore të kryera së bashku me vendin partner, donatorë të tjerë të mbështetjes buxhetore dhe palë të tjera të rëndësishme.

Komisioni do të krijojë një grup referimi (GR), i përbërë nga përfaqësues të palëve kryesore të interesuara si në nivelin e BE-së, edhe në atë kombëtar (përfaqësues të qeverisë, të organizatave të shoqërisë civile – sektori privat, OJQ-të etj.). Nëse çmohet e nevojshme, do të ftohen të marrin pjesë edhe donatorë të tjerë.

Raportet e vlerësimit do të ndahen me vendin partner dhe palët e tjera të interesuara kryesore, duke ndjekur praktikat më të mira të shpërndarjes së vlerësimit[72]. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, kur është e nevojshme, në marrëveshje me vendin partner, vendosin bashkërisht për veprimet pasuese që duhen ndërmarrë dhe çdo rregullim të nevojshëm, përfshirë, nëse rezulton e nevojshme, edhe riorientimin e projektit.

Shërbimet e vlerësimit mund të kontraktohen sipas një kontrate kuadër.

5.3 Auditimi dhe verifikimet

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për zbatimin e këtij veprimi, në bazë të një vlerësimi të rrezikut, Komisioni mund të kontraktojë auditim ose verifikim të pavarur për një ose disa kontrata ose marrëveshje.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha subjektet që zbatojnë veprime të jashtme të financuara nga BE-ja, kanë detyrimin kontraktual për të informuar audiencat përkatëse për mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre, duke shfaqur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër mbi financimin, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me veprimet përkatëse. Për këtë qëllim, ata duhet të zbatojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022 "Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme" (ose në çdo dokument pasues që e zëvendëson atë).

Ky detyrim do të zbatohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse veprimet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve ose subjektet e besuara ose të deleguara, siç janë agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e Shteteve Anëtare të BE-së. Në çdo rast, një referencë ndaj detyrimeve përkatëse kontraktuale duhet të përfshihet në marrëveshjen përkatëse të financimit, kontratat e prokurimit dhe granteve, si dhe marrëveshjet e kontributit.

Komunikimi do të jetë pjesë integrale e dialogut me vendet partnere dhe çdo përparim ose pengesë do të raportohet si pjesë e vlerësimit të politikave. Mund të ndërmerren aktivitete të përbashkëta informimi dhe komunikimi.

[72] Shihni praktikën më të mirë të shpërndarjes së vlerësimit.

7. QËNDRUESHMËRIA

Qëndrueshmëria politike

Qëndrueshmëria e këtij Veprimi varet kryesisht nga faktorë politikë, financiarë dhe strukturorë. Mbështetja e qëndrueshme politike për reformat në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë është rezultat i negociatave politike dhe marrëveshjes midis krahëve politikë të majtë dhe të djathtë. Ekziston një marrëveshje e përgjithshme nga të gjitha partitë politike mbi nevojën për reforma në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë.

Qëndrueshmëria e burimeve njerëzore

Qëndrueshmëria e reformës varet edhe nga ekzistenca e burimeve të kualifikuara njerëzore. Kjo kërkon punësimin e stafit të kualifikuar për role dhe përgjegjësi të reja (si për shembull në ASHÇAP) dhe trajnim të stafit ekzistues – veçanërisht në nivel bashkiak. Për sa i përket trajnimit të stafit ekzistues dhe atij të ri, objektivat e reformës në strategjitë e reja SKPA dhe SKMS parashikojnë një rritje të konsiderueshme të aktiviteteve trajnuese, të cilat kryesisht do të zhvillohen nga ose në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit/SHKP dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/SSSH-në dhe, në rastin e shërbimeve të kujdesit social, në koordinim me Shkollën Shqiptare për Administratë Publike. Mbështetja financiare dhe teknike nga ekspertiza ndërkombëtare ka rëndësi të madhe për përgatitjen e suksesshme të stafit për menaxhimin dhe zbatimin e mënyrave të reja të dizenjimit dhe ofrimit të shërbimeve – veçanërisht në nivelin bashkiak dhe me OJQ-të. Megjithatë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të pronësisë së palëve të interesuara kombëtare kur zhvillimi i legjislacionit, procedurave, udhëzimeve mbështetet nga asistenca teknike. Kjo do të arrihet përmes ndërtimit të kapaciteteve.

Qëndrueshmëria financiare

Masat e SKPA-së janë të lidhura me një Plan Veprimi të detajuar, i cili është llogaritur financiarisht dhe i vendosur brenda Programit Afatmesëm të Buxhetit. Vlerësimet e kostove që arrijnë në 75.5 miliardë lekë (rreth 650 milionë euro) për një periudhë tetëvjeçare, rezultojnë të arsyeshme duke pasur parasysh nivelin aktual të financimit në sektor. SKMS 2024–2030 është aktualisht në zhvillim dhe qëndrueshmëria e alokimeve financiare për zbatimin e saj do të duhet të vlerësohet në një fazë të mëvonshme. Qeveria ka rritur ndjeshëm buxhetet në sektorin e mbrojtjes sociale, veçanërisht për përfitimet në para (për personat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara), si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe për t'i ofruar lehtësim familjeve për të përballuar efektet e rritjes së çmimeve të energjisë dhe inflacionit.

Në kontekstin e decentralizimit, ekzistojnë dallime të konsiderueshme në aftësitë e bashkive për të mobilizuar të ardhura nga burimet e veta, dhe njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) mbeten kryesisht të varura nga burimet në nivel kombëtar; në veçanti, në lidhje me financimin e mandateve të reja, siç janë shërbimet e kujdesit social.

Kontributet e mbështetjes buxhetore të BE-së për zbatimin e masave të SKPA-së dhe SKMS-së do të zvogëlojnë hendekun financiar dhe do të garantojnë fizibilitetin financiar për të zbatuar objektivat e përcaktuar në këtë Veprim.

SHTOJCA PËR MBËSHTETJE BUXHETORE: RREGULLIMET E DISBURSIMIT, KUSHTET DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

1. Përgjegjësitë

Në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Financimit, autoritetet e vendit partner i dërgojnë një kërkesë zyrtare Komisionit për disbursimin e çdo kësti në përputhje me afatin kohor më poshtë. Kërkesa duhet të përfshijë: (i) një analizë të plotë dhe justifikim për pagesën e fondeve, me dokumentet mbështetëse të kërkuara; (ii) një formular informacioni financiar, të nënshkruar ligjërisht, për të lehtësuar pagesën.

2. Plani tregues i disbursimit

Plani tregues i disbursimit

Viti fiskal i vendit dhe ndarja tremujore	Viti 1 (2025)				Viti 2 (2026)				Viti 3 (2027)				Viti 4 (2028)				Totali në milionë EURO
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	
Kësti fiks në milionë euro			4			1					1				1		7
Kësti i ndryshueshëm në milionë euro						5					6				6		17
Totali në milionë euro			4			6					7				7		24

3. Kushtet e përgjithshme për disbursimin e të gjitha kësteve

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në tabelën më poshtë zbatohen për disbursimin e të gjitha kësteve dhe të gjitha kërkesat për lirim të kësteve duhet të mbështeten nga të gjitha informacionet dhe dokumentet e duhura dhe të përditësuara mbi kushtet e përgjithshme.

Kushtet e përgjithshme për lirimin e të gjitha kësteve

Fusha	Kushtet e përgjithshme	Burimi i verifikimit
Politika publike	Progres i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe besueshmëri dhe rëndësi e vazhdueshme e asaj strategjie ose e çdo strategjie dhe mase pasuese.	Raportet vjetore të progresit të SKPA (Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) (2025–2028), SKMS (Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale) (2024–2028); dhe mbi zbatimin e Planeve të Veprimit përkatës (çdo vit, çdo maj–qershor). Vlerësim i jashtëm, Rishikimi nga Delegacioni i BE-së
Stabiliteti makroekonomik	Mbajtja e një politike makroekonomike të besueshme dhe relevante të orientuar drejt stabilitetit ose progresi i bërë drejt rivendosjes së ekuilibrave kryesorë.	Raportet vjetore të Qeverisë së Shqipërisë (qershor çdo vit, N+1) Raportet e FMN-së, Bankës Botërore, BE-së (vjetore dhe ad hoc) Vlerësimi i DG ECFIN (Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare e Komisionit Evropian) për programin e reformës ekonomike të Shqipërisë, ERP (vjetore) Përfundimet e Nënkomitetit të MSA-së për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (vjetore)
Menaxhimi i financave publike	Progres i kënaqshëm në zbatimin e reformave për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, dhe rëndësia dhe besueshmëria e vazhdueshme e programit të reformës.	Raportet vjetore të Progresit mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare të MFP-së 2024 - 2030 Vlerësime nga palë të treta, p.sh. Banka Botërore, FMN-ja, raportet e lidhura me MFP-në e BE-së Vlerësim i jashtëm, Rishikimi nga Delegacioni i BE-së
Transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit	Progres i kënaqshëm në lidhje me disponueshmërinë publike të informacionit buxhetor të arritshëm, në kohë, gjithëpërfshirës dhe të plotë.	Botimet zyrtare të Qeverisë dhe faqet përkatëse të internetit (proces i vazhdueshëm); Raporti vjetor nga Ministria e Financave mbi progresin e zbatimit të strategjisë së MFP-së. Vlerësimet e palëve të treta, p.sh. Indeksi i Buxhetit të Hapur (çdo vit). Vlerësimi i jashtëm, Rishikimi nga Delegacioni i BE-së.

4. Kushtet specifike për disbursimin e kësteve individuale

[Nuk aplikohet]

5. Modalitetet për llogaritjen dhe disbursimin e kësteve variabël

Treguesit e performancës të përshkruar më poshtë zbatohen për llogaritjen e pjesës së kësteve variable që do të disbursohen. Kërkesat për lirimin e këstit duhet të mbështeten nga të gjitha informacionet dhe dokumentet e duhura mbi treguesit e performancës. Treguesit përshkruhen në detaje në seksionin 6.

Tabela përmbledhëse e treguesve të performancës së këstit variabël

Treguesi	Viti 1 (2025) Objektivat me sasinë/peshën e tyre		Viti 2 (2026) Objektivat me sasinë/peshën e tyre		Viti 3 (2027) Objektivat me sasinë/peshën e tyre	
Nr. 1 - Përfitues të rritur të PNP-së nga grupet e pafavorizuara (programet e nxitjes së punësimit)	10% më e lartë se niveli bazë	1.2 milionë euro ose 24%	15% më shumë se rezultati i vitit të kaluar	1.5 milionë euro ose 25%	15% më shumë se rezultati i vitit të kaluar	1.3 milionë € ose 21.7%
Nr. 2 - Buxheti i rritur për shkollat dhe qendrat e trajnimit profesional	20 për qind më e lartë se niveli bazë	1 milion euro ose 20%	40 për qind më e lartë se niveli bazë	1 milion euro ose 16.7%	75 për qind më e lartë se niveli bazë	1 milion euro ose 16.7%
Nr. 3 - Pjesa e studentëve në sistemin e dyfishtë të AFP-së nga numri i përgjithshëm i studentëve në shkollat e AFP-së	7 për qind	1 milion euro ose 20%	10 për qind	1.5 milionë euro ose 25%	15 për qind	1.5 milionë euro ose 25%
Nr. 4 - Masa të fokusuara te fëmijët	50%	0.8 milion euro ose 16%	60%	1 milion euro ose 16.7%	70%	1.2 milionë euro ose 20%
Nr. 5 - Shërbimet sociale	15 shërbime të reja	1 milion euro ose 20%	20 shërbime të reja	1 milion euro ose 16.7%	30 shërbime të reja	1 milion euro ose 16.7%

Për treguesin nr. 1 në vitin n, rezultatet e arritura në vitin n-1 do të bëhen në mënyrë efektive standardi krahasues kundrejt të cilit vlerësohen objektivat që zbatohen për vitin n. Në raste të veçanta, vetëm në vitin e parë të mbështetjes buxhetore, objektivi për këtë tregues do të matet kundrejt vitit bazë.

Çdo tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%. Pasi secili tregues të jetë vlerësuar dhe secilit prej tyre t'i jetë caktuar një pikë performance, shuma e kështit të ndryshueshëm që do të disbursohet, do të përcaktohet duke mbledhur shumën e rregulluar sipas peshës për secilin tregues individual.

Vlerësimi i treguesve të performancës mund të kërkojë kryerjen e rishikimeve të jashtme ose verifikimit të të dhënave për të informuar vendimet e disbursimit dhe për të kontribuar në forcimin e kuadrit të monitorimit të politikave dhe sistemeve statistikore kombëtare.

Pasi të jetë bërë disbursimi, fondet që korrespondojnë me pjesën e padisbursuar të këstit variabël do të kthehen në programin tregues shumëvjeçar të vendit sipas rregullave në fuqi. Me kërkesë të përfituesit dhe kur justifikohet siç duhet, fondet e padisbursuara mund të rialokohen në komponentin plotësues të mbështetjes së kontratës.

Në raste të jashtëzakonshme, kur ngjarje të jashtëzakonshme ose rrethana në ndryshim kanë penguar përmbushjen e objektivave të rënë dakord më parë, mund të jetë e mundur të hiqet dorë ose të neutralizohet një kusht tregues. Në këtë rast, shuma përkatëse mund të transferohet në këstin tjetër, ose të rialokohet në tregues të tjerë të të njëjtit kést. Raste të tilla duhet të kërkohen nga koordinatori kombëtar

i IPA-s te drejtori i DG NEAR (Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit) dhe mund të autorizohen nga ky i fundit përmes një shkëmbimi letrash ndërmjet dy palëve.

6. Përshkrimi i treguesve të performancës dhe objektivave të përdorur për disbursimin e kësteve variable

Shpërndarja e kësteve variabile do të varet nga arritja e objektivave të përcaktuar për secilin prej treguesve të mëposhtëm të performancës, sipas fishave të treguesve të mëposhtëm:

Treguesi nr. 1 – Përfituesit e PNP-së nga grupet vulnerabël

Titulli i plotë	Numri i përfituesve të PNP-ve [73] të individëve që i përkasin komuniteteve vulnerabël, 30 vjeç e lart
Baza për vitin 2022	*1249 individë* *Burimi: Të dhënat administrative të AKPA-së, transmetim zyrtar nga AKSHI*
Objektivi për vitin 1: 2025	*Rritje 10% mbi nivelin bazë (110% e nivelit bazë)* *1 janar – 31 dhjetor 2025* *Të dhënat administrative të AKPA-së, Raporti Vjetor i AKPA 2025; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2026* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 0.8 milion EURO*
Objektivi për vitin 2: 2026	*Rritje prej 15% krahasuar me vitin e kaluar (115% e vitit të kaluar)* *1 janar – 31 dhjetor 2026* *Të dhënat administrative të AKPA-së, Raporti Vjetor i AKPA 2026; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2027* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1.2 milionë EURO*
Objektivi për vitin 3: 2027	*Rritje prej 15% krahasuar me vitin e kaluar (115% e vitit të kaluar)* *1 janar – 31 dhjetor 2027* *Të dhënat administrative të AKPA-së, Raporti Vjetor i AKPA 2027; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2028* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Karakteristikat e treguesit	
Lloji i treguesit	*Tregues rezultati*
Shënuesi i OZHQ-së	*SDG 8; SDG 1; SDG 5*
Qëllimi	*16020*
Rëndësia/referencandaj politikës publike të vendit	*Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030, Objektivi strategjik 2, Masa prioritare 2.1.1* *Lidhur me objektivin specifik 1 të logjikës së ndërhyrjes së operacionit: Nxitja e zhvillimit të aftësive dhe punësimit duke rritur arsimin, trajnimin dhe integrimin në tregun e punës…*
Përkufizimi dhe llogaritja	Përfituesit e PNP-ve nga grupet vulnerabël konsiderohen si punëkërkues të papunë 30 vjeç e lart, të cilat kanë karakteristikat e mëposhtme: 1) persona me aftësi të kufizuara; 2) romë dhe egjiptianë, 3) persona që përfitojnë nga ndihma sociale; 4) ata me statusin e jetimit; 5) migrantë ose imigrantë të kthyer; 6) persona që marrin përfitime papunësie; 7) persona mbi 45 vjeç; 8) të papunë afatgjatë. Punëkërkuesit e papunë që i përkasin më shumë se njërës prej këtyre kategorive do të merren në konsideratë vetëm një herë, duke i dhënë përparësi karakteristikave në përputhje me listën e numëruar të paraqitur këtu. Të dhënat vjetore përfshijnë përfituesit që kanë filluar programet në vitin aktual buxhetor. Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin total të punëkërkuesve të papunë 30 vjeç e lart nga kategoritë e specifikuara, që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit (PNP) në vitin e synuar me numrin total të punëkërkuesve të papunë 30 vjeç e lart që përfitojnë nga PNP-të në vitin referues (baza për matjen e parë; viti i mëparshëm për matjet pasuese). Njësia matëse: %
Ndarja	Ndarja sipas gjinisë
Mbledhja dhe publikimi i të dhënave	Të dhëna administrative: Të dhëna të prodhuara zyrtarisht nga AKPA në lidhje me mbulimin e PNP-ve dhe të transmetuara zyrtarisht nga MEKI. Përveç kësaj: Raporti Vjetor i Progresit të AKPA dhe raporti zyrtar vjetor mbi zbatimin e SKPA-së. Publikim vjetor; të dhënat janë të disponueshme në baza tremujore sipas kërkesës
Cilësia e të dhënave	*Të dhënat mblidhen dhe administrohen nga AKPA-ja dhe menaxhohen nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të NAES, i cili ka qenë funksional që nga viti 2022.*
Rreziqet ose faktorët e jashtëm	*Treguesi mat efektivitetin e PNP-ve në punësimin e individëve më vulnerabël. Ai ndikohet deri në një farë mase nga alokimet totale të buxhetit për PNP-të; por mat rritjen e mbështetjes nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit për individët më vulnerabël që janë më larg tregut të punës përfitues të PNP-ve. Treguesi është i lidhur drejtpërdrejt me kapacitetin e AKPA-së për ndërmjetësim në punë.*
Konsiderata shtesë	*N/A*

[73] Vetëm PNP-të sipas ligjit të nxitjes së punësimit, bazuar në numrin e përfituesve të PNP-ve nga grupet vulnerabël, duke përjashtuar punëkërkuesit nën moshën 30 vjeç.

Treguesi nr. 2 – Buxheti i rritur për shkollat dhe qendrat e trajnimit profesional

Titulli i plotë	Shpenzimet operative të shkollave dhe qendrave të trajnimit profesional u rritën
Baza për vitin 2023	*361.3 milionë lekë* *Burimi: MEKI/AKPA, MEKI*
Objektivi për vitin 1: 2025	*20 për qind më i lartë sesa niveli fillestar bazë* *Viti financiar 2025* *Të dhëna administrative të MEKI/ AKPA, të dhëna të Sistemit Kombëtar të Thesarit/Ministria e Financave.* *Ky tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 2: 2026	*40 për qind më i lartë sesa niveli bazë* *Viti financiar 2026* *Të dhëna administrative të MEKI/ AKPA-s, të dhëna të Sistemit Kombëtar të Thesarit.* *Ky tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 3: 2027	*75 për qind më i lartë sesa niveli bazë* *Viti financiar 2027* *Të dhëna administrative të MEKI/ AKPA-s, të dhëna të Sistemit Kombëtar të Thesarit.* *Ky tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Karakteristikat e treguesit	
Lloji i treguesit	*Tregues rezultati*
Shënuesi i OZHQ-së	*SDG 8; SDG 1; SDG 5*
Qëllimi	*11330*
Rëndësia/referencandaj politikës publike të vendit	*Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030, Objektivi strategjik 2, Masa prioritare 1.1.1 (Zhvillimi i një sistemi AFP më të rëndësishëm, gjithëpërfshirës dhe të bazuar në prova).* *Në lidhje me objektivin specifik 1 të logjikës së ndërhyrjes së operacionit: Nxitja e zhvillimit të aftësive dhe punësimit duke rritur trajnimin arsimor dhe integrimin në tregun e punës…*
Përkufizimi dhe llogaritja	Treguesi mbulon shpenzimet aktuale (rezultatet) e bëra nga shkollat e AFP-së dhe qendrat e trajnimit profesional brenda çdo viti financiar, duke përjashtuar pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe duke përjashtuar shpenzimet kapitale. Treguesi llogaritet duke marrë diferencën në shpenzimet aktuale të shkollave të AFP-së dhe QFP-ve në vitin e dhënë me shpenzimet aktuale në vitin bazë (2023), dhe duke pjesëtuar diferencën me shpenzimet aktuale në vitin bazë (2023). Njësia e matjes: %
Ndarja	N/A
Mbledhja dhe publikimi i të dhënave	Të dhënat administrative të MEKI/ AKPA, të transmetuara zyrtarisht. Përveç kësaj, të dhënat e Thesarit Kombëtar.
Cilësia e të dhënave	*Shkollat AFP dhe QFP-të janë institucione buxhetore që raportojnë tek AKPA-ja. AKPA-ja bën ndarje buxhetore për shkollat dhe QFP-të në çdo vit buxhetor, bazuar në buxhetin e planifikuar dhe të ndarë për AKPA-në nga MEKI dhe MF-ja në programin buxhetor të Arsimit Profesional (shkollat AFP) dhe programin e Tregut të Punës (QFP). Të gjitha transaksionet financiare të subjekteve buxhetore regjistrohen në Sistemin Kombëtar të Thesarit. Të dhënat prodhohen dhe transmetohen nga AKPA-ja dhe do të verifikohen me të dhënat nga Sistemi Kombëtar i Thesarit. Mund të ekzistojnë disa mospërputhje midis të dhënave zyrtare të transmetuara nga AKPA-ja dhe të dhënave zyrtare financiare të përpiluara nga Sistemi Kombëtar i Thesarit/Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar Shqiptar; për shkak të lëshimeve dhe gabimeve të vogla në regjistrimin e transaksioneve financiare në nivel subjekti buxhetor. Në rast të mospërputhjeve të konsiderueshme, të dhënat e prodhuara nga Sistemi Kombëtar i Thesarit pas publikimit të Raportit Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit do të konsiderohen përfundimtare; por një ndarje e mëtejshme e të dhënave zyrtare në nivelin e shkollave AFP dhe QFP-ve do të kërkohet të transmetohet zyrtarisht nga Ministria e Financave/Sistemi i Thesarit.*
Rreziqet ose faktorët e jashtëm	*Treguesi lidhet me nevojën për të rritur disponueshmërinë e burimeve në mjediset e arsimit dhe trajnimit profesional, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. MEKI/AKPA do të duhet të sigurojë jo vetëm që buxhetet e alokuara për shkollat dhe QAP-të për shpenzimet aktuale të rriten, por edhe që shkollat e AFP-së dhe QAP-të të kenë kapacitetin për të ekzekutuar buxhetet në përputhje me planet.*
Konsiderata shtesë	*N/A*

Treguesi nr. 3 – Pjesa e studentëve në sistemin e dyfishtë të AFP-së

Titulli i plotë	Pjesa e nxënësve në sistemin e dyfishtë të AFP-së nga numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e AFP-së.
Baza për vitin 2023	*0 (viti akademik 2023–2024)* *Burimi: Të dhënat administrative të AKPA-së, të dhënat administrative të MEKI-t, të transmetuara zyrtarisht nga AKPA /MEKI*
Objektivi për vitin 1: 2025	*7% e totalit të studentëve të AFP-së të regjistruar në vitin XII ndjekin sistemin e dyfishtë* *Viti akademik 2025–2026, (të dhënat e regjistrimit aktiv që nga 31 dhjetori 2025)*

	Të dhënat administrative të AKPA; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2026 *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 2: 2026	*10% e numrit të përgjithshëm të studentëve të AFP-së të regjistruar në vitin XII ndjekin sistemin e dyfishtë* *Viti akademik 2026–2027 (të dhënat e regjistrimit aktiv që nga 31 dhjetori 2026)* *Të dhënat administrative të AKPA; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2027* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1.5 milionë EURO*
Objektivi për vitin 3: 2027	*15% e numrit të përgjithshëm të studentëve të AFP-së të regjistruar në vitin XII ndjekin sistemin e dyfishtë* *Viti akademik 2027–2028 (të dhënat e regjistrimit aktiv që nga 31 dhjetori 2027)* *Të dhënat administrative të AKPA, Raporti Vjetor i AKPA 2027; transmetimi zyrtar nga MEKI deri më 31 mars 2028* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1.5 milionë EURO*
Karakteristikat e treguesit	
Lloji i treguesit	*Tregues rezultati*
Shënuesi i OZHQ-së	OZHQ *8;* OZHQ *1;* OZHQ *5*
Qëllimi	*16020*
Rëndësia/referenca ndaj politikës publike të vendit	*Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, objektivi strategjik 2, Masa Prioritare 2.1.1* *Lidhur me objektivin specifik 1 të logjikës së ndërhyrjes së veprimit: Nxitja e zhvillimit të aftësive dhe punësimit duke rritur arsimin, trajnimin dhe integrimin në tregun e punës.*
Përkufizimi dhe llogaritja	Pjesa e nxënësve në sistemin e dyfishtë të AFP-së nga numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e AFP-së. Ky tregues mbulon shkollat publike të AFP-së. Llogaritja: Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të nxënësve që ndjekin sistemin e dyfishtë të AFP-së në vitin XII në çdo vit akademik, me numrin e përgjithshëm të nxënësve që ndjekin vitin XII në shkollat e AFP-së në vitin e dhënë. Numri i nxënësve të regjistruar aktivisht më 31 dhjetor të vitit n do të jetë referenca për vitin akademik n/n+1. Njësia e matjes: Përqindja
Ndarja	Ndarja sipas gjinisë
Mbledhja dhe publikimi i të dhënave	Të dhëna administrative: Të dhëna të prodhuara zyrtarisht nga AKPA në lidhje me numrin e kurrikulave të dyfishta të zbatuara në shkollat e AFP-së, numrin e studentëve të regjistruar dhe që ndjekin programe të dyfishta dhe numrin total të studentëve në shkollat e AFP-së sipas vitit, të transmetuara zyrtarisht nga MEKI. Përveç kësaj: Raporti Vjetor i Progresit të AKPA-së dhe raporti zyrtar vjetor mbi zbatimin e SKPA-së. Botim vjetor; të dhënat janë të disponueshme në baza tremujore sipas kërkesës.
Cilësia e të dhënave	*Të dhënat mblidhen dhe administrohen nga AKPA-ja* *Periodiciteti i treguesit: Vjetor*
Rreziqet ose faktorët e jashtëm	*Treguesi lidhet me hartimin dhe miratimin e kurrikulave kuadër për sistemin e dyfishtë të AFP-së nga AKAFP-ja (Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve) dhe aftësinë e sistemit për t'u angazhuar dhe integruar sektorin privat në sistemin e arsimit profesional. Ky është një proces i vazhdueshëm. Kjo kërkon trajnime shtesë për mentorët në sistemin e dyfishtë, si dhe rritje të ndërgjegjësimit për studentët dhe prindërit mbi përfitimet e sistemit të dyfishtë. Meqë AFP-ja e dyfishtë zbatohet në bashkëpunim me bizneset, AKAFP-ja dhe AKPA-ja do të duhet të punojnë ngushtë me komunitetin e biznesit për të rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi përfitimet e sistemit të praktikës për zhvillimin e fuqisë punëtore në kontekstin e mungesës së vazhdueshme të aftësive; dhe të identifikojnë bizneset me gatishmëri dhe infrastrukturë e kapacitete të duhura për të vendosur studentët në AFP-në e dyfishtë. Sistemi i dyfishtë parashikohet aktualisht të përfshihet në vitin XII të arsimit profesional. AKPA po shqyrton futjen graduale edhe në vitin XI, por kurrikulat përkatëse nuk janë zhvilluar ende. Zgjerimi i sistemit të dyfishtë nuk duhet të përshpejtohet deri në atë pikë sa të dëmtojë cilësinë.*
Konsiderata shtesë	*Treguesi nuk është përfshirë zyrtarisht në NESS 2023–2030. Një projekt pilot për sistemin e dyfishtë të AFP-së u iniciua për herë të parë në vitin akademik 2024–2025, në pesë profile të arsimit të mesëm. Sistemi i dyfishtë zbatohet në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 6.11.2024, "Për vendosjen e rregullave të veçanta që zbatohen për kontratën e praktikës dhe përcaktimin e pagës minimale për praktikën në arsimin dhe trajnimin profesional të dyfishtë".*

Treguesi nr. 4 – Masa të fokusuara te fëmijët

Titulli i plotë	Përqindja e fëmijëve në rrezik varfërie [74] që përfitojnë nga masat e mbrojtjes sociale të fokusuara te fëmijët (ndihma sociale dhe programe të tjera)
Baza për vitin 2021	42% Burimi: Të dhënat administrative të MSHMS-së/INSTAT-it (statistikat mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës)
Objektivi për vitin 1: 2025	*50%* *1 janar – 31 dhjetor 2025* *Të dhëna administrative të MSHMS-së. Raporti Vjetor i SSSH-së (Sistemit të Sigurimeve Shoqërore) 2025, i publikuar deri më 31 mars 2026; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 30 qershor 2026.* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 0.8 milion EURO*
Objektivi për vitin 2: 2026	*60%* *1 janar – 31 dhjetor 2026* *Të dhëna administrative të MSHMS-së. Raporti Vjetor i SSSH-së 2026 i publikuar deri më 31 mars 2027; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 30 qershor 2027.* *Ky tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 3: 2027	*70%* *1 janar - 31 dhjetor 2027* *Të dhëna administrative të MSHMS-së. Raporti Vjetor i SSSH-së 2027 i publikuar deri më 31 mars 2028; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 30 qershor 2028* *Ky tregues performance do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1.7 milionë EURO*
Karakteristikat e treguesit	
Lloji i treguesit	Rezultat
Shënuesi i OZHQ-së	SDG 10: Reduktimi i pabarazive dhe SDG 1: Zero varfëri
Qëllimi	*16011*
Rëndësia/referenca ndaj politikës publike të vendit	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, Qëllimi i politikës A (Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes skemave financiare të duhura, transparente dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë për fuqizimin dhe integrimin, të afta për t'u përballur me rreziqet e krizës), dhe Objektivi specifik/strategjik A1 (Përmirësimi i performancës, përshtatshmërisë dhe reagimit ndaj krizave të skemave financiare për individët (burra, gra, djem dhe vajza) në skemën e ndihmës ekonomike) dhe A3 (Përmirësimi i fokusimit ndaj fëmijëve, vajzave dhe djemve nëpërmjet skemave financiare sensitive ndaj gjinisë dhe një programi mbrojtjeje sociale të fokusuar te fëmijët).
Përkufizimi dhe llogaritja	**Fëmijë (0–18 vjeç)** që marrin përfitime monetare të mbrojtjes sociale të fokusuara te fëmijët brenda programit të ndihmës sociale (NE) dhe/ose programeve të reja të mbrojtjes sociale që planifikohen të krijohen. Pjesa llogaritet duke pjesëtuar numrin total të fëmijëve që përfitojnë nga masat e mbrojtjes sociale të fokusuara te fëmijët (programi i ndihmës sociale dhe/ose programet e reja të mbrojtjes sociale që planifikohen të krijohen) në vitin e synuar me numrin total të fëmijëve në rrezik varfërie të identifikuar nga të dhënat e BE-SILC (Statistikat e Bashkimit Evropian mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës) në vitin e fundit të disponueshëm, shumëzuar me 100. INSTAT-i publikon anketën e të ardhurave dhe kushteve të jetesës (BE-SILC) që mat kushtet e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material në familjet shqiptare. Kjo anketë është plotësisht në përputhje me metodologjinë e EUROSTAT-it dhe metodologjinë e përdorur nga të gjitha shtetet

[74] Shkalla e rrezikut të varfërisë tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje, ku të ardhurat ekuivalente të disponueshme janë nën nivelin e rrezikut të varfërisë.

	anëtare të BE-së. Anketa BE-SILC kryhet çdo vit. Të dhënat më të fundit të disponueshme të anketës janë të vitit 2021. **Shkalla e rrezikut të varfërisë** tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat ekuivalente të disponueshme janë nën nivelin e rrezikut të varfërisë. Njësia matëse: %
Ndarja	Të dhënat nga ndihma sociale (ndihma ekonomike NE) të ndara në nivel individual sipas gjinisë, minoriteteve (romë dhe egjiptianë), aftësisë së kufizuar, grup-moshave. Të dhënat e BE-SILC të ndara sipas gjinisë, grup-moshave.
Mbledhja dhe publikimi i të dhënave	Të dhëna administrative: Të dhënat administrohen dhe menaxhohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe SSSH-ja përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin e Ndihmës Ekonomike, i menaxhuar nga SSSH-ja. Të dhënat administrative prodhohen/konsolidohen nga SSH-ja dhe transmetohen zyrtarisht nga MSHMS-ja. Periodiciteti i matjes: Përfituesit e përfitimeve monetare për fëmijë - Çdo vit, të disponueshme çdo tremujor me kërkesë. Të dhënat e BE-SILC (Statistikat e Bashkimit Evropian mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës) – çdo vit. Raporti Vjetor i Progresit të SSSH-së dhe raporti zyrtar vjetor mbi zbatimin e SKMS-së i përgatitur nga MSHMS-ja. BE-SILC: i publikuar nga INSTAT/EUROSTAT. Të dhënat e BE-SILC janë të disponueshme vetëm me një vonesë minimale prej një viti.
Cilësia e të dhënave	Raporti mbi treguesin duhet të përfshijë numrin e fëmijëve që përfitojnë nga skema e ndihmës financiare në baza mujore. Përveç kësaj, MSHMS duhet t'i publikojë këto të dhëna zyrtare si pjesë të raportit zyrtar vjetor të MSHMS-së mbi zbatimin e strategjisë së SKMS-së.
Rreziqet ose faktorët e jashtëm	SKMS njeh nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme për familjet me fëmijë (të vegjël) në kontekstin kur mbështetja ekzistuese është e papërshtatshme dhe e pamjaftueshme dhe nuk ka program përfitimesh për fëmijë. MSHP-ja ka përgatitur një skicë të shkurtër të një skeme mbështetjeje që synon fëmijët e moshës 0-3 vjeç, e cila pritet të pilotohet në kuadër të skemës "1000 ditët e para të jetës së një fëmije" dhe më pas të pasohet nga zbatimi i saj në nivel kombëtar. Analizat e vazhdueshme të ndikimit të programeve aktuale për adresimin e nevojave të fëmijëve në rrezik varfërie, pritet të kryhen në afatin kohor të strategjisë së re që mbështet hartimin e modifikimeve të nevojshme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve. Masat e propozuara të SKMS-së për të adresuar varfërinë e fëmijëve përqendrohen në zbatimin e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale për fëmijët ekonomikisht të pafavorizuar, sigurimin e aksesit arsimor për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe koordinimin e shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore për të prioritizuar mirëqenien e fëmijëve që jetojnë në varfëri. Krahas kësaj, një nga masat është vlerësimi i fizibilitetit dhe kapaciteteve institucionale për të zhvilluar një Plan Veprimi për Garancinë e Fëmijëve të përshtatur posaçërisht për të lehtësuar varfërinë e fëmijëve në përputhje me udhëzimet e BE-së.
Konsiderata shtesë	Nuk aplikohet

Treguesi nr. 5 – Shërbimet e kujdesit social

Titulli i plotë	Numri i shërbimeve të kujdesit social të ofruara në nivel lokal dhe rajonal, sipas tipologjisë,[75] mbështetur nga Fondi Social
Baza për vitin 2023	*54 shërbime të kujdesit social të mbështetura nëpërmjet Fondit Social (39 shërbime të kujdesit social në nivel bashkiak dhe 15 shërbime të kujdesit social në nivel rajonal)* Burimi: Të dhëna administrative të MSHMS-së
Objektivi për vitin 1: 2025	*69 shërbime të kujdesit social të mbështetura nëpërmjet Fondit Social (ose 15 shërbime të reja të kujdesit social mbi nivelin bazë)* *1 janar – 31 dhjetor 2025*

[75] Ligji për shërbimet e kujdesit social (121/2016, neni 8) përcakton tipologjinë kryesore të shërbimeve sociale, si: (i) shërbime parasociale; (ii) shërbime në qendrat komunitare, duke përfshirë qendrat e zhvillimit; (iii) shërbime në qendrat rezidenciale, duke përfshirë strehat; (iv) shërbime sociale për situata emergjente; (v) shërbime alternative të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror; (vi) shërbime të specializuara; (vii) shërbim këshillimi telefonik ose online.

	Të dhëna administrative të MSHMS-së. Raporti Vjetor i SSSH-së 2025 i publikuar deri më 31 mars 2026; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 31 qershor 2026 *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 2: 2026	*74 shërbime të kujdesit social të mbështetura përmes Fondit Social (ose 20 shërbime të reja të kujdesit social mbi nivelin bazë)* *1 janar – 31 dhjetor 2026* *Të dhëna administrative të MSHMS-së, Raporti Vjetor i SSSH-së 2026, i publikuar deri më 31 mars 2027; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 31 qershor 2027.* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EURO*
Objektivi për vitin 3: 2027	*84 shërbime të kujdesit social të mbështetura nëpërmjet Fondit Social (ose 30 shërbime të reja të kujdesit social mbi nivelin bazë)* *1 janar - 31 dhjetor 2027* *Të dhëna administrative të MSHMS-së. Raporti Vjetor i SSSH-së 2027 i publikuar deri më 31 mars 2028; Raporti Vjetor i Progresit të MSHMS-së mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, i përgatitur deri më 31 qershor 2028* *Ky tregues i performancës do të vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas shkallës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të kalojë 100%.* *Shuma për përfundim të plotë: 1 milion EUR*
Karakteristikat e treguesit	
Lloji i treguesit	*Rezultat*
Shënuesi i OZHQ-së	OZHQ 10: Pabarazitë e reduktuara, si treguesi kryesor i OZHQ-së. OZHQ-të e tjera janë OZHQ 5: Barazia gjinore dhe SDG 16: Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta.
Qëllimi	*16015*
Rëndësia/referenca ndaj politikës publike të vendit	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, Qëllimi i politikës B (Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të arritshme, cilësore dhe të përgjigjshme ndaj gjinisë, si dhe avancimi i deinstitucionalizimit, në partneritet me qeverisjen vendore dhe aktorë të tjerë) dhe objektivi specifik/strategjik B.1: Konsolidimi i procesit të decentralizimit të shërbimeve të kujdesit social për financim të qëndrueshëm dhe të përgjigjshëm ndaj gjinisë, mbulim gjeografik, aksesueshmëri dhe reagim ndaj krizave dhe emergjencave.
Përkufizimi dhe llogaritja	Numri i shërbimeve të reja të kujdesit social të krijuara nëpërmjet Fondit Social në vitin e synuar, duke përdorur fondet e buxhetit të shtetit dhe kontributet e veta nga buxhetet e tyre (fondet sociale lokale). Njësia matëse: numër
Ndarja	Të ndara sipas tipologjisë së shërbimeve të reja të kujdesit social të krijuara të mbështetura përmes Fondit Social sipas bashkisë/rajonit.
Mbledhja dhe publikimi i të dhënave	Të dhëna administrative: Të dhënat për shërbimet e reja të mbështetura nëpërmjet Fondit Social, prodhohen nga MSHMS-ja pas rezultateve të çdo thirrjeje. Të dhënat në lidhje me mbulimin e shërbimeve të kujdesit social në të gjithë vendin prodhohen zyrtarisht nga SSSH-ja dhe transmetohen zyrtarisht nga MSHMS-ja. Përveç kësaj: Raporti i Inspektoratit të Shërbimeve Sociale mbi shërbimet e kujdesit social të mbështetura nëpërmjet Fondit Social. Raporti Vjetor i Progresit të SSSH-së dhe raporti zyrtar vjetor i MSHMS-së mbi zbatimin e SKMS-së. Publikimi vjetor.
Cilësia e të dhënave	*Të dhënat mblidhen dhe administrohen nga MSHMS-ja.*
Rreziqet ose faktorët e jashtëm	Treguesi mat efektivitetin e Fondit Social për të mbështetur zgjerimin dhe diversifikimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit social në nivel lokal dhe rajonal. Ai ndikohet në një shkallë të caktuar nga alokimet totale të buxhetit të shtetit për Fondin Social dhe kapacitetet e strukturave lokale/rajonale për të kontribuar në krijimin e shërbimeve të reja. VKM-ja mbi kriteret për metodologjinë e ndarjes së Fondit Social, aktualisht është duke u rishikuar nga MSHMS-ja. Alokimi për Fondin Social në nivel ministrie të linjës, është përfshirë në programin buxhetor të Kujdesit Social të MSHMS-së. Efektiviteti i qasjes së re/të rishikuar mbetet për t'u vlerësuar pas miratimit dhe zbatimit të saj.
Konsiderata shtesë	*Nuk aplikohet*

SHTOJCA IA
TABELA PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT

Titulli i Programit: Plani Vjetor i Veprimit në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2024
Përfituesi i IPA III: Shqipëria
Referenca e Programit OPSYS: JAD.1354182

Programi		Menaxhim i drejtpërdrejtë								Menaxhim indirekt							Totali		
		Grante			Prokurimi			Mbështetje Buxhetore	TOTALI DM	Menaxhim indirekt me entitete të besuara (IMEE)			Menaxhim indirekt me Përfituesin IPA III (IMBC)			TOTAL IM			
Dritare	Veprimi	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë	Totali
Dritare 1	BE për Luftën Kundër Korrupsionit	1,000,000.00 €	0.00 €	1,000,000.00 €	2,850,000.00 €	0.00 €	2,850,000.00 €	0.00 €	3,850,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	3,850,000.00 €	0.00 €	3,850,000.00 €
Totali Dritare 1		**1,000,000.00 €**	**0.00 €**	**1,000,000.00 €**	**2,850,000.00 €**	**0.00 €**	**2,850,000.00 €**	**0.00 €**	**3,850,000.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**3,850,000.00 €**	**0.00 €**	**3,850,000.00 €**
Dritare 2	BE për Qeverisje Vendore	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	10,000,000.00 €	0.00 €	10,000,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	10,000,000.00 €	10,000,000.00 €	0.00 €	10,000,000.00 €
Totali Dritare 2		**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**10,000,000.00 €**	**0.00 €**	**10,000,000.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**10,000,000.00 €**	**10,000,000.00 €**	**0.00 €**	**10,000,000.00 €**
Dritare 3	BE për Pyjet			0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	13,000,000.00 €	0.00 €	13,000,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	13,000,000.00 €	13,000,000.00 €	0.00 €	13,000,000.00 €
Totali Dritare 3		**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**13,000,000.00 €**	**0.00 €**	**13,000,000.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**13,000,000.00 €**	**13,000,000.00 €**	**0.00 €**	**13,000,000.00 €**
Dritare 4	BE për Sigurinë Ushqimore	**0.00 €**	**0.00 €**	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €		0.00 €	12,500,000.00 €	0.00 €	12,500,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	12,500,000.00 €	12,500,000.00 €	0.00 €	12,500,000.00 €
	BE për Punësim dhe Përfshirje Sociale	0.00 €	0.00 €	0.00 €	4,000,000.00 €	0.00 €	4,000,000.00 €	24,000,000.00 €	28,000,000.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	28,000,000.00 €	0.00 €	28,000,000.00 €
Totali Dritare 4		**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**4,000,000.00 €**	**0.00 €**	**4,000,000.00 €**	**24,000,000.00 €**	**28,000,000.00 €**	**12,500,000.00 €**	**0.00 €**	**12,500,000.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**12,500,000.00 €**	**40,500,000.00 €**	**0.00 €**	**40,500,000.00 €**
Programi TOTAL		**1,000,000.00 €**	**0.00 €**	**1,000,000.00 €**	**6,850,000.00 €**	**0.00 €**	**6,850,000.00 €**	**24,000,000.00 €**	**31,850,000.00 €**	**35,500,000.00 €**	**0.00 €**	**35,500,000.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**0.00 €**	**35,500,000.00 €**	**67,350,000.00 €**	**0.00 €**	**67,350,000.00 €**

SHTOJCA II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

Pjesa I: Dispozitat e zbatueshme për aktivitetet për të cilat përfituesi IPA III është autoritet kontraktues në kuadrin e MIVP-së

Neni 1. Parime të përgjithshme
Neni 1a. Prokurimi dhe dhënia e granteve
Neni 1b. Përjashtimi dhe sanksionet administrative
Neni 2. Komunikimi dhe vizibiliteti
Neni 3. Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni
Neni 4. Llogaritë bankare, sistemete kontabilitetit dheshpenzimet e pranuara
Neni 5. Dispozitat për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA III
Neni 6. Ndërprerja e pagesave
Neni 7. Rikuperimi i fondeve
Neni 7a. Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Pjesa II: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8. Dialogu mbi politikat
Neni 9. Verifikimi i kushteve dhe disbursimi
Neni 10. Transparenca e mbështetjes buxhetore
Neni 11. Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Pjesa III: Dispozitat e zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht metodës së zbatimit

Neni 12. Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimi
Neni 13. Lejet dhe autorizimi
Neni 14. Kërkesat e raportimit
Neni 15. Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 16. Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA dhe Komisionit
Neni 17. Ndryshimet ligjore të Marrëveshjes së Financimit
Neni 18. Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 19. Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 20. Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni 21. Masat kufizuese të BE-së

Pjesa I: Dispozitat e zbatueshme për aktivitetet për të cilat përfituesi IPA III është autoritet kontraktues në kuadrin e MIVP-së

Neni 1
Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës I është të përcaktojë rregullat për zbatimin e detyrave të besuara për ekzekutimin e buxhetit siç përshkruhet në shtojcën I, si dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e përfituesit IPA III dhe të Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa I zbatohet për detyrat e ekzekutimit të buxhetit që i janë besuar përfituesit IPA III vetëm

në lidhje me kontributin e BE-së, ose të kombinuar me fondet e përfituesit IPA III ose fondet e një pale të tretë, në rastin kur këto fonde zbatohen me bashkëfinancim të përbashkët.

2. Përfituesi IPA III mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit (MFKP). Në zbatim të neneve 6, 18, 19 dhe 21, Komisioni rezervon të drejtën të ndërpresë pagesat dhe të pezullojë dhe/ose zgjidhë këtë Marrëveshje Financimi.

3. Përfituesi IPA III respekton kontributin minimal të specifikuar në shtojcën I. Në rastin e kontributeve si nga përfituesi IPA III edhe nga BE-ja, kontributi i përfituesit IPA III vihet në dispozicion njëkohësisht me kontributin korrespondues të BE-së.

4. Për qëllimet e zbatimit të nenit 25 të MFKP-së për mbrojtjen e të dhënave, të dhënat personale duhet:

- të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;
- të mblidhen për qëllime të specifikuara, të qarta dhe të ligjshme, si dhe të mos përpunohen më tej në çfarëdo mënyre që nuk është në pajtim me këto qëllime;
- të jenë të mjaftueshme, relevante dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen;
- të jenë të sakta dhe, sipas rastit, të përditësohen;
- të përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale; dhe
- të ruhen në një formë që mundëson identifikimin e subjekteve vetëm gjatë periudhës së nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale në dokumentet që ruhen nga përfituesi IPA III, në përputhje me pikën 2 të nenit 1a, duhet të fshihen sapo të skadojnë afatet e përcaktuara në atë pikë.

Neni 1a

Prokurimi dhe dhënia e granteve

1. Pa cenuar nenin 18(5) të MFKP-së, detyrat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 1 realizohen nga përfituesi IPA III në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni për prokurimin dhe kontratat grant në veprimet e jashtme, veçanërisht me udhëzuesin praktik për procedurat e kontraktimit për veprimet e jashtme të Bashkimin Evropian (PRAG) që janë në fuqi në kohën e shpalljes së procedurës në fjalë, si dhe në përputhje me standardet e vizibilitetit dhe komunikimit të përcaktuara në nenin 2(2).

Përfituesi IPA III realizon procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, lidh kontratat përkatëse dhe garanton që të gjitha dokumentet e nevojshme për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Pa cenuar nenin 49 të MFKP-së, përfituesi ruan të gjitha dokumentet shoqëruese financiare dhe kontraktuale që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose që nga një datë më e hershme nëse procedura e prokurimit, thirrja për projektpropozime apo procedurës e granteve direkt është shpallur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, deri pesë vjet nga data e mbylljes së programit. Përfituesi IPA III ruan veçanërisht sa më poshtë:

a) Procedurat e prokurimit:

i. parashikimi me provë të publikimit të njoftimit për prokurim, si dhe çdo korrigjim;

ii. emërimi i komisionit të kualifikimit;

iii. raporti i kualifikimit (duke përfshirë shtojcat) dhe aplikimet;

iv. prova e publikimit të njoftimit të aplikantëve të kualifikuar;

v. letrat për aplikantët e shkualifikuar;

vi. ftesa për tender ose dokument të barazvlefshëm;

vii. dosja e tenderit, duke përfshirë shtojcat, sqarimet, procesverbalet e takimeve, provën e publikimin;

viii. emërimin e komisionit të vlerësimit;

ix. relacioni i hapjes së tenderit, duke përfshirë shtojcat;

x. raporti i vlerësimit/negociatave, duke përfshirë shtojcat dhe ofertat e dorëzuara;[76]

xi. njoftimet;

xii. shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës;

xiii. shkresat drejtuar kandidatëve jofitues;

[76] Eliminimi i ofertave jofituese pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

xiv. njoftimi i fituesit/anulimit, duke përfshirë provën e publikimit;

xv. kontratat e nënshkruara, ndryshimet në to, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

b) Thirrjet për projektpropozime dhe grantet direkte:

i. emërimi i komisionit të vlerësimit;

ii. raporti i hapjes dhe administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e dorëzuara;[77]

iii. shkresat drejtuar aplikantëve të kualifikuar dhe të shkualifikuar, pas vlerësimit të projektit konceptual;

iv. raporti i vlerësimit të projektit konceptual;

v. raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raporti i negociatave, bashkë me shtojcat përkatëse;

vi. kontrolli i kritereve kualifikuese dhe dokumenteve mbështetëse;

vii. shkresat drejtuar aplikantëve fitues dhe jofitues me një listë rezervë të miratuar pas vlerësimit të plotë të aplikimeve;

viii. shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës grant;

ix. njoftimi i fituesit /anulimit me provë të publikimit;

x. kontratat e nënshkruara, ndryshimet në to, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

Gjithashtu, dokumentet financiare të përcaktuara në pikat 2(a) dhe 2(b) plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse siç kërkohet nga procedurat e përcaktuara në pikën 1, si edhe me të gjithë dokumentacionin përkatës që lidhet me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operacionale, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve në terren, marrjen në dorëzim të furnizimeve dhe punimeve, garancitë dhe raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

3. Operacionet e bashkëfinancuara nga BE-ja në kuadrin e këtij Programi, mund të përfitojnë fonde nga një organizatë ndërkombëtare, Shtet Anëtar, vend i tretë ose organizatë rajonale.

Neni 1b

Përjashtimi dhe sanksionet administrative

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni për prokurimet dhe kontratat grant, përfituesi IPA II garanton që asnjë prokurim apo kontratë grant e financuar nga BE-ja të mos i jepet një operatori ekonomik apo aplikanti për grant nëse operatori ekonomik apo aplikanti për grant, qoftë vetë ose një person me tagra përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi të, ndodhet në një nga situatat e përjashtimit të përcaktuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA III informon menjëherë Komisionit kur një kandidat, ofertues apo aplikant ndodhet në njërën nga situatat e përjashtimit sipas pikës 1 ose ka kryer parregullsi dhe mashtrim sipas nenit 51(5) të MFKP-së ose ka shfaqur mangësi të theksuara në respektimin e detyrimeve kryesore në lidhje me zbatimin e një kontrate apo granti të financuar nga buxheti i BE-ë.

3. Gjatë procedurave të prokurimit dhe kontratave të grantit, përfituesi IPA III merr parasysh informacionin që përmban sistemi EDES (Sistemi i Diktimit të Hershëm dhe Përjashtimit) i Komisionit. Aksesi në informacion mund të garantohet nëpërmjet pikave ndërlidhëse ose konsultimit duke përdorur këto mjete: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Zyrtari Kontabël i Komisionit, MO15, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me *e-mail* drejtuar BUDG-C01-EXCL- DB@ec.europa.eu, duke vënë në dijeni Komisionin përmes adresës së përcaktuar në nenin 3 të kushteve të veçanta). Çdo kontratë ose grant i lidhur me një kontraktues apo përfituesi granti që ndodhet në situatën e përjashtimit në momentin e lidhjes së kontratës, përjashtohet nga financimet e BE-së dhe mund të zbatohet mekanizmi i korrigjimeve financiare sipas nenit 7a.

4. Kur përfituesi III vihet në dijeni për situatën e përjashtimit sipas pikës 1 në zbatimin e detyrave të përcaktuara në shtojcën I, përfituesi IPA II vendos – në zbatim të kushteve të legjislacionit të brendshëm – refuzimin e operatorit ekonomik apo aplikantit për grant nga procedura në fjalë dhe përjashtimin e tij nga procedurat e ardhshme të prokurimit dhe grantit. Përfituesi IPA III mund edhe të vendosë penalitete financiare proporcionale me vlerën e kontratës në fjalë. Refuzimet, përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare

[77] Eliminimi i ofertave jofituese tre vjet pas mbylljes së procedurës së grantit.

vendosen pas procedurës së kundërshtimit që i garanton të drejtën e mbrojtjes personit në fjalë. Përfituesi IPA III njofton Komisionin sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 2
Komunikimi dhe Vizibiliteti

1. Në përputhje me nenin 24 të MFKP-së, përfituesi IPA II merr masat e nevojshme për të garantuar vizibilitetin e financimit të BE-së për aktivitetet që i janë besuar atij, si dhe përgatit një plan koherent për aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për miratim brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me Manualin e Vizibilitetit dhe Komunikimit për Veprimet e Jashtme të BE-së të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni, i cili është në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 3
Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të realizohen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* për procedurat e prokurimit dhe granteve për fazat si më poshtë:

a) miratimi i njoftimeve të kontratës(ave) për prokurim dhe çdo korrigjim i tyre;

b) miratimi i dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grantet;

c) miratimi i përbërjes së komisioneve të vlerësimit;

d) miratimi i raporteve të vlerësimit, vendimeve të refuzimit dhe përzgjedhjes së fituesit;[78]

e) miratimi i dosjeve të kontratave dhe anekskontratave.

2. Në lidhje me kontrollet *ex-ante*, Komisioni vendos:

a) të kryejë kontrolle *ex-ante* për të gjitha dosjet, ose

b) të kryejë kontrolle *ex-ante* në disa dosje të tilla të përzgjedhura, ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante* në përputhje me pikën 2(a) ose (b), informon përfituesin IPA III për dosjet e përzgjedhura për kontrollet *ex-ante*. Përfituesi IPA III i paraqet Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-ante*, jo më vonë se momenti i dorëzimit për publik të njoftimit të kontratës apo udhëzimeve për aplikantët.

4. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post* për procedurat e granteve që nuk kanë qenë objekt i kontrollit *ex-ante* (brenda 6 muajve nga nënshkrimi i kontratës).

5. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post* në çdo kohë - përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren - për çdo kontratë dhe grant të dhënë nga përfituesi IPA III që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA III i paraqet Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person apo subjekt që të kryejë kontrollet *ex-post* për llogari të vet.

Neni 4
Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuara

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Organi Kontabël dhe Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF) i përfituesit IPA që është Autoriteti Kontraktues për Programin, hap të paktën një llogari bankare në monedhën Euro. Balanca bankare totale për Programin është shuma e balancave për të gjitha llogaritë bankare të Programit që mbahen nga Organi Kontabël dhe të gjithë ONMF-të pjesëmarrës në përfituesin IPA III. Raportimi për të gjitha llogarite bankare që kanë lidhje me secilin program, regjistrohet nëpërmjet sistemit IPA-APP.[79]

[78] Për kontratat e shërbimit, ky hap përfshin kontrolle *ex-ante* në lidhje me miratimin e listës së kandidatëve të përzgjedhur

[79] IPA-APP është aplikacion TI i dedikuar që është zhvilluar nga DG NEAR për të zëvendësuar instrumentin *iPerseus* që përdorej për të monitoruar zbatimin e fondeve të paraanëtarësimit në kuadrin e menaxhimit indirekt nga vendet përfituesve (MIVP).

2. Përfituesi IPA III përgatit dhe i paraqet Komisionit planet e parashikimit të disbursimeve gjatë periudhës së zbatimit të Programit, duke ndjekur modelin në germën (d) të shtojcës III. Këto parashikime përditësohen dhe paraqiten bashkë me çdo kërkesë për fonde sipas nenit 5(1) dhe (3), me raportin financiar vjetor të përcaktuar në nenin 14(2) dhe me parashikimin e kërkesëpagesave të mundshme sipas nenit 33(3) të MFKP-së. Plani i parashikimit të disbursimeve bazohet në nevojat reale dhe aktuale dhe mbështetet nga një analizë e hollësishme e dokumentuar (përfshirë kontraktimet e planifikuara dhe kalendarin e pagesave për çdo kontratë), e cila i vihet në dispozicion Komisionit me kërkesë të tij.

3. Plani fillestar për parashikimin e disbursimeve duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimit vjetor të disbursimeve për të gjithë periudhën e zbatimit, si dhe parashikimet mujore të disbursimeve për 12 muajt e parë të Programit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhje të parashikimit vjetor të disbursimeve për balancën gjatë periudhës së zbatimit të Programit, si dhe parashikimet mujore të disbursimeve për 14 muajt pasues.

4. Përfituesi IPA III krijon dhe mban një sistem kontabël në përputhje me klauzolën 4(3)(a) të shtojcës A të MFKP- së, i cili përmban të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e Programit të parashikuara në shtojcën IV.

5. Në zbatim të nenit 57(2) të MFKP-së, shpenzimet e pranuara në sistemin kontabël që mbahet sipas seksionit 4 të këtij neni, duhet të jenë kryer, pranuar dhe paguar dhe të korrespondojnë me shpenzimet aktuale të vërtetuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren, kur është e nevojshme, për të likuiduar parafinancimin e paguar nga përfituesi IPA III sipas kontratave vendore.

Neni 5

Dispozitat pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA III

1. Çdo kërkesë për parafinancim duhet të përmbajë pasqyrën e shpenzimeve për Programin, si edhe shumat e kontraktuara dhe të disbursuara, si dhe shpenzimet e pranuara.

2. Kërkesa e parë për parafinancim mbulon 100% disbursimet e parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit të disbursimeve sipas nenit 4(2). Kjo kërkesë për parafinancim duhet të mbështetet me mandate bankare për të gjitha llogaritë bankare të Programit, sipas rastit.

3. Përfituesi IPA III paraqet kërkesëpagesat për parafinancim kur balanca totale bankare e Programit bie nën nivelin e parashikimit të disbursimeve për pesë muajt pasues të Programit.

4) Çdo kërkesë për parafinancim duhet të përmbajë:

a) Balancat bankare për Programin në fundin e afatit të kërkesës;

b) Mandatet bankare të përditësuara për të gjitha llogaritë bankare të Programit, nëse ka;

c) Parashikimin e disbursimeve për Programin për 14 muaj nga afati i kërkesës sipas nenit 4(2);

d) Raportimin në IPA-APP.

5. Për çdo parafinancim të mëvonshëm, përfituesi IPA III mund të kërkojë shumën totale të disbursimeve të parashikuara për 14 muaj pas afatit të kërkesës, minus balancat e përcaktuara në pikën 4(a) në datën e afatit të kërkesës për fonde, plus ndonjë shumë të financuar nga përfituesi IPA III sipas pikës 6 e cila nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme parafinancimi nëse balanca totale bankare e mbajtur nga përfituesi IPA III në kuadrin e këtij Programi tejkalon parashikimin e disbursimeve për 14 muajt pasues.

6. Kur pagesa reduktohet sipas pikës 5, përfituesi IPA II duhet të financojë Programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi IPA III mund të kërkojë më pas rimbursimin e atyre fondeve si pjesë e kërkesës së radhës për fonde, të parashikuar në pikën 5.

7. Sipas nenit 33(1) të MFKP-së, Komisioni rezervon të drejtën të kryejë pagesa të pjesshme brenda kufijve të fondeve që ka. Sapo fondet vihen në dispozicion sërish, Komision paguan menjëherë pjesën e mbetur.

8. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë balancat e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se 12 muaj. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin IPA III të japë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të provojë nevojën e vazhdueshme për ato fonde gjatë dy muajve pasues.

9. Interesat e gjeneruara nga llogaritë bankare që përdoren për këtë Program, nuk i takojnë Komisionit.

10. Sipas nenit 33(4) të MFKP-së, nëse Komisioni e ndërpret afatin për kërkesëpagesën për më shumë se dy muaj, përfituesi IPA III mund t'i kërkojë Komisionit një vendim nëse ndërprerja do të vazhdojë.

11. Pasqyra përfundimtare e shpenzimeve, e certifikuar sipas nenit 36(1)(a) të MFKP-së, i dorëzohet ZKA-së jo më vonë se 16 muajt e fundit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 6
Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas përkatësisht neneve 18 dhe 19, si dhe pa cenuar nenet 38 dhe 39 të MFKP-së, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze se përfituesi IPA III ka kryer gabime thelbësore, parregullsi apo mashtrim që vë në dyshim ligjshmërinë apo rregullsinë e transaksioneve në fjalë gjatë zbatimit të Programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, duke përfshirë detyrimet lidhur me zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.

b) Komisioni ka konstatuar se ka shqetësime serioze se përfituesi IPA III ka kryer gabime sistematike dhe të përsëritura, parregullsi, mashtrim apo shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj apo ndonjë tjetër Marrëveshje Financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrim apo shkelje të keni ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit e kontrollit të brendshëm të përfituesit IPA IIIII ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve në fjalë.

Neni 7
Rikuperimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 40 të MFKP-së, Komisioni mund të rikuperojë fonde nga përfituesi IPA III siç parashikon Marrëveshja Financiare, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) mosarritja e rezultateve dhe mospërdorimi i produkteve për qëllimin e synuar sipas shtojcës I;

b) shpenzime të papranueshme;

c) mosrespektim i normës së bashkëfinancimit, sipas shtojcës I;

d) shpenzime të paguara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimit apo shkeljes së detyrimeve në zbatimin e Programit, veçanërisht në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve;

e) dobësi ose mangësi në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të përfituesit IPA III që rezultojnë në korrigjimin financiar.

2. Në përputhje me legjislacionin e brendshëm, ZKA rikuperon kontributin e BE-së që i është paguar përfituesit IPA II nga marrësit e fondeve, të cilët kanë qenë në një nga situatat e përcaktuara në pikën 1, germat b) ose d) të këtij neni apo ato të përcaktuara në nenin 41 të MFKP-së. Fakti që ZKA-ja nuk arrin të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk e pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA III.

3. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga përfituesi IPA III, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paguara mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga përfituesi IPA III ndaj kandidatëve, ofertuesve, aplikantëve, kontraktuesve ose përfituesve të granteve të pagueshme në favor të përfituesit IPA III, ose përdoren sërish për Programin, ose i kthehen Komisionit.

Neni 7a
Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Përveç neneve 42, 43 dhe 47 të MFKP-së, Komisioni jep orientime shtesë për shqyrtimin dhe pranimin e procedurës së llogarive, duke përfshirë korrigjimet financiare dhe mbylljen.

Pjesa II: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8
Dialogu mbi politikat

Përfituesi IPA III dhe Komisioni zotohen që të angazhohen në dialog të rregullt konstruktiv në nivel të duhur për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 9
Verifikimi i kushteve dhe disbursimit

1. Komisioni verifikon kushtet për pagesën e kësteve nën komponentin e mbështetjes buxhetore, siç përcaktohet në lidhjen e shtojcës I.

2. Nëse Komisioni konstaton se nuk janë përmbushur kushte për pagesat, e informon pa vonesë përfituesin IPA III për këtë fakt.

3. Kërkesat për disbursim të paraqitura nga përfituesi IPA III janë të pranueshme për financimin e BE-së, nëse janë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në shtojcën I dhe lidhjen përkatëse dhe janë paraqitur gjatë fazës së zbatimit operacional.

4. Përfituesi IPA III zbaton rregulloret kombëtarë për kursin e këmbimit valutor, në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha disbursimet nën komponentin e mbështetjes buxhetore.

Neni 10
Transparenca e mbështetjes buxhetore

Përfituesi IPA III bie dakord që Komisioni të publikojë këtë Marrëveshjeje Financimi dhe çdo ndryshimi të saj, përfshirë me mjete elektronike, si dhe informacionin bazë për mbështetjen buxhetore që Komisioni e çmon të nevojshme. Përmbajtja e publikimit do të jetë në përputhje me ligjet e BE-së të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11
Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Të gjitha disbursimet e mbështetjes buxhetore apo pjesë të tij mund të rikuperohen nga Komisioni, me respektimin e duhur të parimit të proporcionalitetit, nëse Komisioni konstaton se pagesa ka qenë e pavlefshme për shkak të një parregullsie të rëndë që i atribuohet përfituesit IPA III, veçanërisht nëse përfituesi IPA III ka dhënë informacione të pabesueshme ose të pasakta apo nëse ka pasur korrupsion apo mashtrim.

Pjesa III: Dispozitat e zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht metodës së zbatimit

Neni 12
Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimit

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional dhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2(1) të kushteve të veçanta dhe fillon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe mbaron në datën e fundit për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha gjatë së cilës kryhen të gjitha aktivitetet operacionale të mbuluara me kontrata prokurimi, kontrata grant dhe marrëveshje kontributi. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2(2) të kushteve të veçanta dhe fillon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Autoriteti Kontraktues e respekton periudhën e ekzekutimit operacional kur lidh dhe zbaton kontrata prokurimi, kontrata granti dhe marrëveshje kontributi në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Pa cenuar nenin 29(2)të MFKP-së, shpenzimet e lidhura me aktivitetet janë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së zbatimit operacional. Shpenzimet e kryera para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk janë të pranueshme për financimin e BE-së, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 7 të kushteve të veçanta.

5. Në zbatim të nenit 29(3)(b) të MFKP-së dhe pa cenuar nenin 28 të saj dhe nenin 7 të kushteve të veçanta, shpenzimet e mëposhtme të kryera nga përfituesi IPA III nuk janë të pranueshme për financim në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi:

a) tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;

b) gjobat dhe penalitetet financiare;

c) shpenzimet gjyqësore;

d) humbjet nga kursi i këmbimit të valutës;

e) borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);

f) provizionet për humbje, borxhe apo detyrime potenciale në të ardhmen;

g) kreditime ndaj palëve të treta, përveç kur parashikohet ndryshe në Kushtet e Veçanta;

h) interesi negativ që aplikohet nga bankat apo institucione të tjera financiare.

6. Kontratat e prokurimit, kontratat grant dhe marrëveshjet e kontributit lidhen jo më vonë se tre vjet nga lidhja e Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve më poshtë:

a) ndryshime në angazhimet ligjore tashmë të lidhura, të cilat nuk rezultojnë në rritje të kontributit të BE-së;

b) angazhimet ligjore që nënshkruhen pas zgjidhjes së parakohshme të një kontrate prokurimi ekzistuese;

c) angazhime ligjore në lidhje me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas periudhës së zbatimit operacional

d) ndryshim të subjektit zbatues.

7. Një kontratë prokurimi, kontratë granti apo marrëveshje kontributi që nuk ka rezultuar në ndonjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, zgjidhet automatikisht dhe fondet e saj tërhiqen, përveç rasteve të mosmarrëveshjeve gjyqësore në gjykata apo organe arbitrazhi.

Neni 13
Lejet dhe autorizimi

Pa cenuar nenin 27 të MFKP-së, autoritetet përgjegjëse të përfituesit IPA lëshojnë në kohën e duhur çdo lloj lejeje dhe/ose autorizimi që kërkohet për zbatimin e Programit, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 14
Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit pranë Komisionit, të përcaktuara në nenin 59 të MFKP-së në lidhje me raportin vjetor të zbatimit të asistencës IPA III, KKIPA përdor modelin e vënë në dispozicion nga Komisioni.

2. Për qëllimet e nenit 60 të MFKP-së, KKIPA-ja i dorëzon Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadrin e menaxhimit indirekt të këtij Programi nga përfituesi IPA III, jo më vonë se 16 muaj nga mbarimi i periudhës së zbatimit operacional. KKIPA përdor modelin e vënë në dispozicion nga Komisioni.

3. Për qëllimet e nenit 61(1) të MFKP-së, ZKA paraqet në format elektronik, deri më 15 janar të vitit financiar vijues, një kopje të të dhënave që mbahen në sistemin kontabël sipas nenit 4(4). Kjo kopje shoqërohet me një raport financiar përmbledhës të nënshkruar dhe të paaudituar sipas germës "c" të shtojcës III.

4. Për qëllimet e kërkesave specifike të raportimit në kuadrin e menaxhimit indirekt sipas neneve 61(2)(a) dhe 61(3) të MFKP-së, ZKA i përfituesit IPA përdor modelet e përcaktuara në germat "a" dhe "b" të shtojcës III.

Neni 15
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi garantojnë që përfituesi IPA III të fitojë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi IPA III garanton që Komisioni ose çdo organ apo person i autorizuar prej Komisionit do të ketë akses dhe të drejtën të përdorë materiale të tilla. Komisioni i përdor këto materiale vetëm për qëllimet e veta.

Neni 16
Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA III dhe Komisioni konsultohen bashkë përpara se çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e Marrëveshjes së Financimit të ndiqet më tutje sipas nenit 20.

2. Nëse Komisioni konstaton probleme në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA III për të rregulluar situatën dhe për të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të rezultojë në një ndryshim ligjor, pezullim ose zgjidhje të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni informon rregullisht përfituesin IPA III mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara

në shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në pjesën I të këtyre kushteve të përgjithshme.

Neni 17
Ndryshimet ligjore të Marrëveshjes së Financimit

1. Çdo ndryshim ligjor i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim, si dhe me shkëmbim letrash.

2. Nëse përfituesi IPA III kërkon një ndryshim ligjor, kërkesa i paraqitet Komisionit të paktën tre muaj para se ky ndryshim ligjor planifikohet të hyjë në fuqi, me përjashtim të rasteve të justifikuara sipas rregullave.

3. Komisioni mund të bëjë ndryshime ligjore në dokumentet e shtojcave III dhe IV pa bërë ndryshim ligjor në këtë Marrëveshje Financimi. Përfituesit IPA III informohen me shkrim për çdo ndryshim ligjor të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18
Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim të përcaktuar në procedurat dhe dokumentet standarde të renditura në nenin 18(2) të MFKP-së;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA III nuk përmbush kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA III vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e aderimit/anëtarësimit në BE;

e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi, nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në raste të rënda korrupsioni apo nëse përfituesi IPA III është fajtor për shkelje të rëndë profesionale të faktuar me prova të qarta. Shkelja/kundërvajtja e rëndë profesionale nënkuptohet si në vijim:

- shkelje e ligjeve ose akteve normative të zbatueshme, ose të standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt;

- sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ndikon në kredibilitetin e vet profesional, kur kjo sjellje është me keqdashje apo pakujdesi e rëndë.

f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" nënkupton çdo situatë ose raste të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën në përmbushjen e detyrimeve të tyre, çka nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga kontraktuesit, agjentët apo të punësuarit e tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme me gjithë kujdesin e duhur. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në furnizimin e tyre, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të pretendohen se përbëjnë forcë madhore. Secila palë nuk mund të konsiderohet se ka shkelur detyrimet, nëse pengohet në përmbushjen e tyre nga një forcë madhore për të cilën e ka informuar siç duhet palën tjetër. Secila palë që përballet me forcë madhore informon palën tjetër pa vonesë, duke i deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si dhe merr të gjitha masat për të minimizuar dëmet e mundshme. Nëse forca madhore prek vetëm në një pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm. Asnjëra palë nuk mbahet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore, me kusht që të marrë masa për minimizimin e dëmeve të mundshme.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për kontratat e prokurimit, kontratat grant dhe marrëveshjet e kontributit që janë në proces apo pritet të nënshkruhen.

5. Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit nuk i cenon të drejtën Komisionit që të ndërpresë pagesat dhe të zgjidhë këtë Marrëveshje Financimi sipas neneve 6 dhe 19.

6. Palët e rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit menjëherë sapo e lejojnë kushtet dhe pasi merret miratimi paraprak me shkrim i Komisionit. Kjo nuk cenon mundësinë për t'i bërë ndonjë ndryshim ligjor kësaj Marrëveshjeje Financimi, i cili mund të jetë i nevojshëm për ta përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhave të zbatimit operacional dhe ekzekutimit, ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas nenit 19.

Neni 19
Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Nëse problematikat që çuan në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nuk janë zgjidhur brenda periudhës maksimale prej 180 ditësh, secila palë ka të drejtë ta zgjidhë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

2. Në rastin kur njoftohet zgjidhja, tregohen pasojat për kontratat e prokurimit dhe grantit, si dhe marrëveshjet e kontributit që janë në proces ose do të nënshkruhen.

3. Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk përjashton mundësinë që Komisioni të kryejë korrigjime financiare sipas neneve 43 dhe 44 të MFKP-së.

Neni 20
Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo Marrëveshje interpretohet dhe zbatohet sipas së drejtës së BE-së.

2. Nëse një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin, zbatimin apo vlefshmërinë e Marrëveshjes nuk mund të zgjidhet me konsultim, referohet te Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit sipas Rregullave të Arbitrazhit të vitit 2012, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Përbërja e trupit gjykues

Për pretendimet mbi 500 000 euro: trupi gjykues përbëhet nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër brenda 40 ditësh kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit. Dy arbitrat e caktuar prej palëve caktojnë vetë një arbitër të tretë që të veprojë si arbitër kryesues.

Për pretendimet nën 500 000 euro: trupi gjykues përbëhet nga vetëm një arbitër, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

Nëse trupi gjykues nuk krijohet brenda 80 ditësh kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit, secila palë mund t'i kërkojë Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit ose një autoriteti të paanshëm të pranuar bashkërisht që të caktojë arbitrin(at) e nevojshëm.

b) Selia

Selia e trupit gjykues së arbitrazhit është Hagë, Holandë.

c) Gjuha

Gjuha e punimeve të arbitrazhit është anglisht ose një gjuhë tjetër zyrtare e BE-së e pranuar bashkërisht nga palët. Provat mund të paraqiten në gjuhë të tjera, nëse palët bien dakord.

d) Procedura

Në punimet e arbitrazhit nuk pranohen rekurset për masa të ndërmjetme, ndërhyrjet e palëve të treta apo opinionet amicus curiae.

Nëse njëra palë i kërkon trupit gjykues të trajtojë një informacion apo material si konfidencial, vendimi merret në formën e një urdhri të arsyetuar dhe pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të paraqitur parashtrimet). Trupi gjykues shqyrton arsyet e kërkesës, natyrën e informacionin dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive. Trupi gjykues, në veçanti, mund:

- ta kushtëzojë publikimin me disa detyra specifike; ose

- të vendosë që informacioni/materiali të mos bëhet publik, por të urdhërojë përgatitjen e një versioni apo përmbledhjeje jokonfidenciale të informacionit apo materialit, i cili duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për t'i mundësuar palës tjetër shprehjen e qëndrimeve të veta në mënyrë kuptimplotë.

Nëse trupit gjykues i kërkohet ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, vendimi merret pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të depozituar parashtrimet). Trupi gjykues merr parasysh arsyet e kërkesës dhe kundërshtimet e palës tjetër (nëse ka).

Nëse trupit gjykues i kërkohet interpretimi apo aplikimi i së drejtës së Bashkimit Evropian, trupi gjykues i ndalon punimet dhe i kërkon "Presidentit të Gjykatës së Lartë të Parisit (*Président du Tribunal de grande instance de Paris, 'juge d'appui'*), sipas neneve 1460 dhe 1505 të Kodit të Procedurës Civile të

Francës që t'i kërkojë një vendim paraprak Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 267 të Traktatit të Funksionimit të BE-së (TFBE). Punimet para gjykatës së arbitrazhit rifillojnë sapo merret vendimi nga gjyqtari mbështetës (*juge d'appui*). Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë dhe i gjyqtarit mbështetës është detyrues për trupin gjykues.

Vendimi i arbitrazhit është i formës së prerë dhe detyrues për palët, si dhe zbatohet prej tyre pa vonesa.

Megjithatë, secila palë mund të kërkojë rishikimin e këtij vendimi nga Gjykata e Apelit e Hagës (*Gerechtshof Den Haag*) mbi bazën e legjislacionit të brendshëm. Në këtë rast, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë deri në përfundim të procedurës. Vendimi i gjykatës rishikuese është detyrues për trupin gjykues.

e) Shpenzimet

Shpenzimet e arbitrazhit konsistojnë në:

- tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave;
- shpenzimet e arsyeshme të ekspertëve dhe dëshmitarëve, të cilat miratohen nga trupi gjykues dhe
- tarifat dhe shpenzimet e Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për punimet e arbitrazhit (p.sh. kateringu, puna e punonjësve të administratës, salla, përkthimi).

Tarifat e arbitrave nuk tejkalojnë:

- 30 000 euro për çdo arbitër, nëse shuma e kundërshtuar është nën 1 000 000 euro;
- 15% të shumës së kundërshtuar kur kjo shumë është mbi 1 000 000 euro.

Në çdo rast, tarifa e arbitrave nuk tejkalon 300 000 euro.

Shpenzimet e arbitrazhit përballohen përgjysmë nga palët, përveç kur bien dakord ndryshe.

Palët i përballojnë vetë shpenzimet e tyre për përfaqësim ligjor dhe shpenzime të tjera që i kryejnë në lidhje me arbitrazhin.

f) Privilegjet dhe imunitetet

Marrëveshja për ndjekjen në arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të vitit 2012 të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga privilegjet ose imunitetet që gëzon secila palë.

Neni 21

Masat kufizuese të BE-së

1. Përkufizime:

a) "Masat kufizuese të BE-së" nënkupton masat shtrënguese të miratuara në zbatim të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) ose të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE);

b) "Person i kufizuar" nënkupton çdo subjekt, individ apo grup individësh i caktuar nga BE-ja si objekt i masave kufizuese të BE-së.[80]

2. Në të gjitha marrëdhëniet e tyre, Palët pranojnë që në kuadrin e së drejtës së BE-së, të mos u japin personave të kufizuar fonde apo burime ekonomike të BE-së, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi ose në interes të tyre.

3. Përfituesi IPA III garanton që asnjë transaksion në lidhje me fondet e BE-së, të mos bëhet drejtpërdrejt ose tërthorazi në favor të personave/subjekteve që janë objekt i sanksioneve të BE-së. Përfituesi IPA III zotohet ta respektojë këtë detyrim:

a) duke verifikuar në listën e sanksioneve të BE-së përpara se të nënshkruajnë apo të kryejnë pagesa në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse, çdo kontraktues, përfitues granti dhe marrës përfundimtar me të cilët Përfituesi IPA III ka ose pritet të ketë marrëdhënie kontraktuale direkte (marrës direkt), me qëllim që të konstatojë nëse ky marrës/përfitues është person i kufizuar.

b) duke verifikuar përmes mjeteve të tjera të përshtatshme (që mund të përfshijnë verifikime *ex-post*) mbi bazën e një vlerësimi risku që asnjë subjekt që është person i kufizuar të mos përfitojë tërthorazi fonde të BE-së.

4. Përfituesi IPA njofton menjëherë Komisionin, nëse konstaton se ndonjë marrës/përfitues (direkt ose indirekt) të fondeve të BE-së, është person i kufizuar.

5. Pa cenuar detyrimin në pikën 3 më lart, nëse Komisionin konstaton se përdorimi i asistencës financiare të BE-së në kuadrin e IPA III rezulton ose ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të BE-së, shumat korresponduese nuk janë të pranueshme për asistencë financiare të BE-së në kuadrin e IPA III. Kjo nuk i cenon të drejtat që Komisioni mund të

[80] www.sanctionsmap.eu. Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje midis akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versionet e publikuara në GZ do të kenë përparësi.

ketë për pezullimin apo anulimin e masës së prekur nga kjo shkelje, për rikuperimin e fondeve të BE-së që ka kontribuuar Komisioni, për pezullimin ose zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje financimi.

6. Përcaktimi i masave korrigjuese bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Masat korrigjuese zbatohen vetëm për fondet e BE-së të cilat i janë vënë në dispozicion apo kanë shkuar në favor të një marrësi/përfituesi gjatë periudhës që ka qenë person i kufizuar.

7. Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet e përcaktuara në masat kufizuese të BE-së.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 640 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/07/31 15:27:02 +02'00'
4e535eb9d1d64547b11d744e3ec73ca520250731
15265451031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)